

Prof.Dr. Mimoza Gjokutaj (Çano)
Msc. Eneida Pema

Dr. Adriatike Lami
Florenca Saliaj

LIBËR PËR MËSUESIN

GJUHA SHQIPE 7

Për klasën e 7-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Përmbajtja

PJESA I: DËGJOJMË, FLASIM, SHKRUAJMË, LEXOJMË GJUHËN SHQIPE

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË DËGJUARIT

Dëgjojmë kërkesa, shpjegime, keqkuptime	41
Dëgjojmë anekdota	42
Poetet e sotme	44
Dëgjojmë raporte të shkurtra informuese	46
Udhëzime, shpjegime, receta	47
Argumente rreth përdorimit të internetit	49

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË FOLURIT

Interesat e mia	51
Elemente të gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar	52
Vajza dhe djem	54
Ju dhe të lexuarit	56
Angazhimi ynë në komunitet	57
Konkurs poezie (Aktivitetet shkollore)	59
Përgjegjësitë dhe të drejtat tona	61
Komunikimi në një mjedis virtual	62

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË SHKRUARIT

Shkruajmë një rrëfim personal	64
Shkruajmë mbresa udhëtimit	65
Shkruajmë poezi	66
Si të shkruajmë një intervistë	69
Shkruajmë një letër zyrtare	70
Shkruajmë njoftime	71
Shkruajmë udhëzime	72
Eseja përshkruese	73

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË LEXUARIT

I. Teksti letrar

Rozafati	M.Kuteli	77
Fabula dhe përrall	Ezopi	79
Kali i drunjtë	Mitologjia greke	82
Dy vëllezërit	Tolstoi	84
Ivani dhe lëkura e fokës	Përrallë Skoceze	86
Komandanti i klasës	J. Ruth	88
Çmimet	J. R. Palaçio	90
Përmbytja	I.Kadare	91
Ana flokëkuqja	L. M. Montgomeri	93
Plaku i Ylynecit	L.Skëndo	95
Zbulimi i një të fshehte shekullore	P.Marko (ora e parë)	96
Zbulimi i një të fshehte shekullore	P.Marko (ora e dytë)	98

Bojaxhiu finok	M. Tuen	99
Zoodiaku	M. Meksi.....	100
Princi i vogël	Exupery.....	102
Sekreti i shtëpisë në ishull	R. Riggs (ora e parë)	104
Sekreti i shtëpisë në ishull	R. Riggs (ora e dytë)	105
Kërcimtarja e Dukagjinit	E.Koliqi.....	106
Mandolina e braktisur	Dh.Shuteriqi	107
Çelësi i kopshtit	H.Burnet	109
Madhështia e njerëzve	P. Budi.....	110
Varfëria dhe liria	Çajupi.....	112
Pellazgonia	A. Islami	113
Pasqyra	D. Agolli.....	115
Atdhe	T.Keko.....	117
Mëngjesi	O.Khajam.....	118
Vdekja e një mbretëreshe	R. Qosja (ora e parë)	119
Vdekja e një mbretëreshe	R. Qosja (ora e dytë).....	121
Pas vdekjes	Çajupi (ora e parë)	123
Pas vdekjes	Çajupi (ora e dytë)	125

II. Teksti joletrar

<i>Teksti rrëfimtari joletrar</i> Kronika		126
Përgjigje admirueses	Rouling.....	128
Autobiografia Medalja e artë	G.Dagllas.....	130
Ditari Kur të rriturit marrin zjarr A.Frank.....		132
Intervista Shqetësimet e një studiuesi	V.Kona.....	134
<i>Teksti informativ-shpjegues</i> Shpikja e alfabetit		136
Librat dhe bibliotekat		137
<i>Teksti udhëzues</i> Udhëzime testimi		139
Si të pasurosh fjalorin		141
<i>Teksti argumentues</i> Lavdërimi i atdheut . Lukiani.....		142
Si një roman	D. Penak.....	145
<i>Teksti përshkrues</i> Tirana jonë (guidë)		146

PJESA II: PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS

Fonetikë	149
Fjalëformimi	154
Leksikologji.....	157
Morfologji.....	163
Sintaksë.....	200
Drejtshkrim	
FRAGMENTE PËR DËGJIM	247

35 javë x 5 orë = 175 orë

Kompetencat e fushës	Shkathësitë që do të realizohen në komunikim përmes:	Orë
1. Të dëgjuarit e teksteve të ndryshëm	10	10
2. Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	10	10
3. Të lexuarit e teksteve: letrare dhe Teksteve jolettrare	70 49 21	30 12 7 21 70
4. Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	25	25
5. Përdorimi i drejtë i gjuhës	60	60
Gjithsej		175 orë

Shënim. Orët për bisedat letrare, për testimet janë parashikuar nga orët e të lexuarit. Orët për testimet, diktime, përsëritje janë parashikuar nga të shkruarit, njohuritë për gjuhën, të folurit e të dëgjuarit.

PLANIFIKIMI VJETOR

KOMPETENCAT E FUSHËS	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR–MARS	PRILL–QERSHOR
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	3 orë	2 orë	5 orë
Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	4 orë	4 orë	2orë
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	28 orë	26 orë	16 orë
Të shkruarit për qëllime formale dhe funksionale	7 orë	6 orë	12 orë
Përdorimi i drejtë i gjuhës	27 orë	20 orë	13 orë
Brenda tyre ka:	1 orë test 3 orë projekt 2 orë bisedë letrare 1 orë diktim	1 orë test 3 orë projekt 2 orë bisedë letrare 1 orë diktim	1orë test 3 orë projekt 2 orë bisedë letrare 1 orë diktim

PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NDARË NË TREMUJORË

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: GJUHË SHQIPE

Shkalla: III

Klasa: VII

Viti shkollor: 2016-2017

PËRTREMUJORIN E PARË (Shtator - Dhjetor)

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ

Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç:

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT

Nxënësi:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

KOMPETENCA E TË MENDUARIT

Nxënësi:

- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;

<p>- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.</p>
<p>KOMPETENCA E TË NXËNIT Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; - shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit; - ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
<p>KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses; - bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
<p>KOMPETENCA QYTETARE Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.
<p>KOMPETENCA DIGJITALE Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar. - analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
<p>REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to; - jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon. <p>Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar Nxënësi:</p>

- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;
- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi:

- dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;
- lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

Tekste letrare

- dallon temën, mesazhin dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;
- dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

Tekste joletrare

- dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.).

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi:

- përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi:

- dallon dhe përcakton theksin e fjalës dhe llojet e intonacionit në fjali;
- dallon zanoret dhe llojet e bashkëtingëlloreve (të zëshme dhe të pazëshme. të shurdhëta dhe tingullta);
- përcakton mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- dallon, përdor dhe krijon fjalë të prejdardhura;
- dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve dhe krijon vetë fusha dhe familje fjalësh;
- përcakton klasat e fjalëve;
- klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- analizon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (dallon gjininë asnjansë dhe shumësin e emrave);
- dallon dhe analizon mbiemrat (të nyjshëm, të panyjshëm, gjimi, numër, rasë);
- dallon llojet e përemrave dhe analizon përemrin vector dhe trajtat e shkurtra;
- dallon dhe përcakton mënyrën dhe kohët e foljes;

<p>- zgjedhon foljen në mënyrën dëftore.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Sugjerohet që gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: <i>stuhi mendimi, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, diskutim për njohuritë paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, kubimi, diagrame piramidale, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit</i> etj. Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.</p>
<p>Vlerësimi Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, testeve, pjesëmarrja në biseda e diskutime e leximet jashtë klase, diktimet etj.</p>

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	Java 1	Flasim 1	Interesat e mia	Interesat dhe veprimtaritë tona	<i>Punë me fisha, punë në grup, loja gjuhësore</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në aktivitet dhe debate.	Teksti mësimor, certifikata vlerësimi të përgatitura nga mësuesi/ja, shporta e fishave.
2.		Flasim 2	Elemente të gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar	Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar	<i>Stuhi mendimi, punë në grupe</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen dhe aktivizimin gjatë diskutimit.	Libri, CD, regjistrime, video. Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. <i>Elementet e komunikimit</i>
3.		Dëgjimë 1	Dëgjimë kërkesa, shpjegime, keqkuptime	Dëgjimë dhe diskutimë	<i>Metoda dhe teknika: kllaster, imagjinatë e drejtuar, punë në grupe, rrjet diskutimi, lojë në role.</i>	Vlerësim për të kuptuarit e informacioneve të dëguara.	CD me materialet dëgjimore
4.		Shkruajmë 1	Përcjellim informacione në forma të ndryshme	Shkrimi i mesazheve dhe komunikimi	<i>Diskutim, punë me shkrim</i>	Vlerësim për shkrimin e informacioneve të marra gjatë komunikimit.	Fletore të punëve me shkrim, dosja e nxënësit.
5.		Nj. Gj. Fonetikë 1	Grupet e zanoreve dhe diftongjet	Zanoret dhe artikullimi i tyre	<i>Stuhi mendimesh, punë e drejtuar</i>	Vlerësimi për përcaktimin e diftongjeve dhe grupeve zanorë në fjalë të ndryshme	Teksti mësimor, (Pjesë të incizuara për intonacionin dhe theksat e fjalës dhe të fjalisë)
6.	Java 2	Nj. Gj. Fonetikë 2	Theksi i fjalës, i fjalisë	Theksi i fjalëve	<i>Stuhi mendimesh, diagrami piramidal</i>	Vlerësim për përcaktimin e theksit në fjalë e fjali	Teksti mësimor, materiale plotësuese, harta gjuhësore.
7.		Përforsim Njohuri gjuhësore 3	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. <i>Grupet e zanoreve dhe</i>	Udhëzime	<i>Stuhi mendimesh –punë në grupe</i>	Vlerësim për zgjidhjen e ushtrimeve	Teksti mësimor, materiale plotësuese, harta gjuhësore.

			<i>diftongjet</i>									
8.		Lexojmë Tekst letrar	1	Rozafati M.Kuteli	Njohja dhe shpjegim i rrëfijës	<i>Lexim i strukturuarar</i>	Vlerësim për tiparet e rrëfijës.	Teksti mësimor, materiale plotësuese, harta gjuhësore.				
9.		Lexojmë	2	Fabula dhe përralla	Lexim dhe komentim fabulash	<i>Nxjerje informacioni nga fabulat</i> <i>Punë në grupe</i>	Vlerësim për nxjerje informacioni	Teksti mësimor,				
10.		Lexojmë	3	Fabula dhe përralla	Analizë dhe interpretim fabulash	<i>Empatia dhe punë e pavarur krijuese</i>	Vlerësim për të qartë të situatës dhe aftësisë për të punuar në grup	Teksti mësimor, Fabulat e Ezopit				
11.	Java 3	Lexojmë	4	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Korbi dhe dhelpira La Fonten	Fabulat	<i>Stuhi mendimesh, punë në grupe</i>	Vlerësim për analizën dhe interpretimin e fabulës. Vetëvlerësim mes nxënësve.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.				
12.		Nj. Gj Drejtshkrim	4	Drejtshkrimi i fjalëve me --ie dhe -je	Shqiptimi drejtë i fjalëve që kanë në trup ie, je	<i>Stuhi mendimesh, punë e drejtuar</i>	Vlerësimi i përgjigjeve për gjuhën dialektore..	Teksti mësimor,				
13.		Lexojmë	5	Kali i drunjte Mitologjia greke	Ardhja e kalit dhe taktikat e Odisë.	<i>Lexim i drejtuar dhe punë në grupe</i>	Vlerësim për strukturimin e anës përmbajtës dhe personazheve	Teksti mësimor, incizime, fisha				
14.		Lexojmë	6	Kali i drunjte Mitologjia greke	Shpjegimi i simbolikës së kalit të drunjte	<i>Diskutim në grup, përmbledhje e strukturuar.</i>	Vlerësim për aftësitë ritreguese dhe zbehtëhimin e simbolikave(figurës)	Teksti mësimor, Veprën Odisea, Filmin Troja, mitin përkatës.				
15.		Lexojmë	7	Dy vëllezërit Tolstoi	Njohje dhe vlerësim i përrallës që dominohet prej fatit dhe rrugës që ndjekin njerëzit në jetë.	<i>Lexim i drejtuar me parashikim, hartë personazhi dhe empatia</i>	Vlerësim për mënyrën e të kuptuarit përmes leximit, për hartën e personazhit dhe empatinë.	Teksti mësimor				

16.	Java 4	Nj. Gj. Fjalëformim	5	Mënyrat e fjalëformimit	Giejnë pjesët përbërëse të fjalës	Punë në grup, punë e pavarur, tabela e koncepteve	Vlerësimi i detyrave të klasës për llojet e fjalëve.	Teksti mësimor,
17.		Nj. Gj. Fjalëformim	6	Fjalët e prejardhura, të përbëra, të përngjitura	Analizojnë grupe fjalësh me rrënjë të njëjta	Punë me fisha, punë në grup, loja gjuhësore.	Vlerësim për dallimin e parashitesave.	Teksti mësimor
18.		Lexojmë	8	Ivani dhe lëkura e fokës.	Interpretim përralle përmes mesazhit që ajo përcjell. Analogji dhe krahasim	Lexim i komentuar, analogji dhe krahasim, hartë personazhi, unë di-Unë dua të di- Unë mësova.	Vlerësim për hartën e personazheve, leximin e komentuar, interpretim mesazhi dhe aftësinë për të shkruar një mbyllje përralle.	Teksti mësimor, Varianti i përrallës shqiptare Gërshefëza.
19.		Nj. Gj. Fjalëformim	7	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Mënyrat e fjalëformimit. Fjalët e prejardhura, të përbëra, të përngjitura.	Mënyrat e fjalëformimit.	Stuhi mendimesh, punë e drejtuar, punë në grupe	Vlerësim për dallimin e fjalëve të prejardhura, të përbëra, të përngjitura.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
20.		Dëgjojmë	2	Anekdotat	Dëgjim anekdotash	Stuhi mendimesh , punë e drejtuar	Vlerësim për kuptimin dhe analizën e materialit të dëgjuar	CD me materialet dëgjimore
21.	Java 5	Lexojmë	9	Komandanti i klasës J. Ruth	Bashkëbisedim rreth përvojave personale	Stuhi mendimi, bashkëbisedim, punë në grupe	Vlerësimi për portretizimin e personazhit kryesor, interpretimin e temës.	Teksti mësimor, fotografi, laptop.
22.		Lexojmë 10		Çmimet J.R.Palacio	Diskutim dhe analizë rreth veçantisë njerëzore si edhe vlerave të vërteta	Stuhi mendimesh, komentim shprehjesh, Çfarë-po tani- çfarë	Vlerësim për aftësinë e sjelljes së situatave në klasë, për aftësinë e vlerësimit të personazheve dhe aftësinë e dhënies së	Teksti mësimor dhe vepra "Mrekullia".

32.		Lexojmë 15	Bisedë letrare <i>Lexim jashtë klase</i>	Letërsia artistike	<i>Stuhi mendimesh, lexim me role</i>	dhe përfshirjen në grup. Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim dhe përfshirjen në grup.	Teksti mësimor, vepra artistike
33.		Nj. Gj 12 Leksikologji	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Fusha leksikore dhe fusha semantike. Fjalët e huaja.	Fusha leksikore	<i>Stuhi mendimesh, pyetje-përgjigje, bashkëbisedim, punë në grupe</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në mësim dhe përfshirjen në grup.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
34.		Shkruajmë 2	Shkruajmë rrëfime personale	Shkrimi i një rrëfimi (tregimi të shkurtër)	<i>Punë e drejtuar, punë në grupe, harta e konceptit, punë e pavarur, diskutim</i>	Vlerësim për shkrimin e një ngjarjeje sipas strukturës dhe rregullave përkatëse.	Rrëfime të ndryshme
35.		Shkruajmë 3	Shkruajmë rrëfime personale	Shkrimi i një rrëfimi (tregimi të shkurtër)	<i>Punë e drejtuar, punë në grupe, harta e konceptit, punë e pavarur, diskutim</i>	Vlerësim për shkrimin e një ngjarjeje sipas strukturës dhe rregullave përkatëse.	Rrëfime të ndryshme
36.	Java 8	Nj. Gj 13 Leksikologji	Sinonimet, antonimet, homonimet	Sinonimet, antonimet	<i>Punë e drejtuar, punë në grupe, harta e konceptit, punë e pavarur, diskutim</i>	Vlerësim për dallimin e sinonimeve, antonimeve, homonimeve.	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Sinonimet, antonimet, homonimet
37.		Nj. GJ. 14 Projekt	Projekt: Përdorimi i fjalëve të huaja, të panevojshme	Ndarja e detyrave	<i>Bisedë, klaster</i>	Vlerësim për formulimin e saktë mesazhit.	Teksti mësimor. Materiale ose botime të ndryshme.
38.		Nj. Gj. 15 Projekt GJ.17	Projekt. Përdorimi i fjalëve të huaja, të panevojshme	Prezantimi .	<i>Pyetje – përgjigje, dëgjim i drejtuar, bashkëbisedim, diskutim etj.</i>	Vlerësim në grup.	Teksti mësimor, Materiale ose botime të ndryshme .
39.		Nj. Gj. 16 (Projekt) Gj 18	Projekt. Përdorimi i fjalëve të huaja, të panevojshme	Prezantim	<i>Konkurs, lojë, shkrim i lirë</i>	Vlerësim për analizimin e rasteve të përdorimit pa vend të fjalëve të huaja	Teksti mësimor, Materiale ose botime të ndryshme.

40.		Lexojmë 16	Plaku i Ylyncit L.Skëndo	Njohja dhe analiza e një proze poetike fantastike	<i>Pyejtje-përgjigje, përshkrim personazhesh, portretizim i tyre</i>	Vlerësim për përgjigjet me rend, dhe për përshkrimin e personazheve	Teksti mësimor, materiale për jetën e autorit.
41.	Java 9	Lexojmë 17	Plaku i Ylyncit L.Skëndo	Diskutim mbi simbolikat shprehëse të veçanta të kësaj proze	<i>Analizë simbolesh, ritregim</i>	Vlerësim për zbatimin e drejtë të simboleve dhe aftësinë ritreguese	Teksti mësimor, vepra e plotë e autorit
42.		Nj. Gj 17 Drejtshkrim	Drejtshkrimi i zanores ë në trup të fjalës	Evidentojnë rastet e shkruara në mënyrë të gabuar	<i>Stuhi mendimesh, diskutim, punë me fisha</i>	Vlerësim për punët me shkrim	Teksti mësimor
43.		Shkruajmë 4	Diktum	Rregullat e drejtshkrimit	<i>Diskutim, diktum</i>	Vlerësim për punët me shkrim (saktësinë e shkrimit)	Fragmente për diktum.
44.		Lexojmë 18	Zbulimi i një të fshehte shekullore P.Marko	Rrëfime rreth lavdisë së kohës së ilirëve	<i>Diskutim, lexim në heshtje, të nxënë të këmbime, rrejtë i diskutimit</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e sakta rreth pyetjeve kuptimore të pjesës, interpretimin e cilësive të personazheve mbështetur në fjalët e tyre.	Romani " Shpella e piratëve", teksti mësimor, tabela e zezë, fletore.
45.		Lexojmë 19	Zbulimi i një të fshehte shekullore P.Marko	Rrëfime rreth lavdisë së kohës së ilirëve	<i>Prezantim, leksion i përqendruar, punë e pavarur, ditari dypjesësh</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rrefimin e subjektit mbështetur në strukturën: hyrje, zhvillim, mbyllje, përcaktimin e figurave letrare të përdorura gjatë rrefimit.	Romani " Shpella e piratëve", teksti mësimor, tabela e zezë, fletore.
46.	Java 10	Nj. Gj 18 Morfologji	Klasat e fjalëve	Plotësohen kërkesat e tabelës	<i>Punë me modele, punë e pavarur</i>	Vlerësimi për punimin e ushtrimeve	Teksti mësimor
47.		Lexojmë 20	Bojaxhiu finok M.Tuen	Rrëfime me aventura	<i>Imagjinatë e drejtuar, shkrim në bazë të fjalëve kyç, lexim me role, punë e pavarur</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e pyetjeve lidhur me të kuptuarit e pjesës,	Libri "Aventurat e Tom Sojerit", teksti, tabela e zezë, fletore.

48.		Nj. Gj 19 Morfologji	Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme	Plotësojnë tabelën e gatshme semantike	<i>Punë individuale, punë në grup</i>	interpretimin kuptimor.	Teksti mësimor
49.		Lexojmë 21	Zodiaku M.Meksi	Zodiaku si bashkësi e yjeve.	<i>Diskutim, lexim në heshtje dhe me zë të lartë, punë në grupe, imagjinatë e drejtuar prezantim.</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e sakta të pyetjeve rreth saj, analizën e ideve dhe tematikës së saj.	Materiale të ndryshme rreth gjeografisë së yjeve, teksti, libri me fantazi "TEOTIHUAKANI, VENDI I DIELLIT".
50.		Nj. Gj 20 Morfologji	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Klasat e fjalëve. Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme	Klasat e fjalëve.	<i>Punë në grupe, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i>	Vlerësim për dallimin e klasave të fjalëve, fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, pjesëmarrjen aktive në mësim.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
51.	Java 11	Lexojmë 22	Princi i vogël Exupery	Dialogim mbi ndodhitë fantastike të princit në planetin e dytë	<i>Pyetje-përgjigje të njëpasnjëshme</i>	Vlerësim për saktësinë e përgjigjeve	Teksti mësimor dhe libri "Princi i Vogël"
52.		Lexojmë 23	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Princi i vogël Exupery	Exupery dhe vepra e tij	<i>Imagjinatë e drejtuar, lexim për të kuptuar tekstin, ditari dypjesësh.</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e sakta të pyetjeve rreth pjesës, analizën e ideve dhe tematikës së saj.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
53.		Nj. Gj 21 Morfologji	Emrat e dygjinishëm	Gjinia e emrit	<i>Punë në grupe, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i>	Vlerësim për saktësinë e përgjigjeve, pjesëmarrjen aktive në orën e mësimit.	Teksti mësimor, fletore, tabela.
54.		Lexojmë 24	Sekretit i shtëpisë në ishull R.Riggs	Rrëfimet me mister	<i>Vëzhgim i materialit me videoprojektor, punë e drejtuar, punë e pavarur</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në analizën së tekstit, duke dalluar detajet që i shërbejnë idesë kyçe, përcaktimit të	Romani me fantazi dhe mistere "Sekreti i shtëpisë në ishull", teksti mësimor, tabela e zezë, fletore,

								elementëve të skemës së komunikimit për pjesën.	interneti.
55.								Vlerësim për zgjidhjen e ushtrimeve	Teksti mësuesor, fotografi
56.	Java 12	Nj. Gj 22 Morfologji	Lakimi i emrave	Plotësojnë kërkesat e tabelës				Vlerësim për saktësinë e përgjigjeve, pjesëmarrjen aktive në orën e mësimit.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësuesor.
57.			Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Emrat e dygjinihëm. Lakimi i emrave	Gjinia e emrit				Vlerësim për përdorimin e elementeve të të folurit.	Teksti mësuesor, materiale informuese.
58.			Ju dhe të lexuarit	.Leximi dhe librat				Vlerësimi bëhet për shkrimin më të bukur rreth mbresave gjatë një udhëtimi.	Fletore te punëve me shkrim
59.			Shkruajmë mbresa nga udhëtimet	Shkrimi i përvojave personale				Vlerësim për saktësinë dhe redaktimet e punëve me shkrim.	Teksti mësuesor, punë të nxënësve me shkrim
60.			Rishikimi dhe redaktimi i punës me shkrim	Redaktimi dhe rishikimi i një teksti të shkruar				Vlerësim për saktësinë e punimit të ushtrimeve, pjesëmarrjen aktive në mësimit.	Teksti mësuesor, fletore, tabela.
61.	Java 13	Nj. Gj 24 Drejtshkrim	Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi	Rregullat e drejtshkrimit				Vlerësim për saktësinë e punimit të ushtrimeve, pjesëmarrjen aktive në mësimit.	Teksti mësuesor, fletore, tabela.
62.			Përshtatja e mbiemrit me emrin	Emri dhe mbiemri				Vlerësimi i nxënësit mbështet në idetë që përcjellin në lidhje me perceptimin e temës, zbërthimin kuptimor të shprehjeve të dhëna, përcaktimin e figurave	Teksti mësuesor, albume me veshje krahinore.
			Kërcimtarja e Dukagjinit E.Koliqi	Dashuria për artin					
			Lexojmë 25						

63.		Lexojmë 26	Mandolina e braktisur Dh. Shuteriqi	Diskutojmë rreth dëshirave dhe pasioneve tona.	<i>Stuhi mendimesh, punë në grupe, ditar dypjesësh</i>	letrare. Vlerësimi i nxënësit mbështet në idetë që përcjellin në lidhje me perceptimin e temës, zbërthimin kuptimor të shprehjeve të dhëna, përcaktimin e figurave letrare.	Teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, libri ¹ “60 tregime në një” e shkrimtarit Dhimitër Shuteriqi.
64.		Nj. Gj 26 Morfologji	Shkallët e mbiemrit	Dallohen shkallët e mbiemrit në vargjet apo fraza	<i>Pyetje – përgjigje, punë në grupe dyshe</i>	Vlerësimi i punimit të ushtrimeve	Teksti mësimor
65.		Nj. Gj 27 Morfologji	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Përshatja e mbiemrit me emrin. Shkallët e mbiemrit	Emri dhe mbiemri	<i>Punë në grupe, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i>	Vlerësim për saktësinë e punimit të ushtrimeve, pjesëmarrjen aktive në mësim.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
66.	Java 14	Lexojmë 27	Çelësi i kopshitt H.Burnet	Diskutim rreth rëndësisë që ka natyra për njeriun.	<i>Imagjinatë e drejtuar, lexim për të kuptuar tekstin, ditar dypjesësh.</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në zhvillimin e përmbledhur të ngjarjes, mesazhit që ajo përcjell.	Teksti mësimor, fletore, libri “Kopshti misterioz” .
67.		Dëgjojmë 3	Zbërthojmë përmbajtjen e filmit për fëmijë	Pamje të ndryshme	<i>Punë e drejtuar, punë e pavarur</i>	Vlerësim individual dhe vetëvlerësim.	CD me materialet dëgjimore
68.		Përpunim njohurish (Nga orët e komp. Lexojmë)	Përsëritje	Konceptet gjuhësore dhe letrare të fituara	<i>Punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i>	Vlerësim individual dhe vetëvlerësim.	Teksti mësimor, fletore, tabela.
69.		Shkruajmë 7	Test për tremujorin e parë	Udhëzime	<i>Punë e pavarur</i>	Vlerësim për arritjet e njohurive të këtij tremujori.	Fletë të testimit

PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NDARË NË TREMUJORË

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: GJUHË SHQIPE

Shkalla: III

Klasa: VII

Viti shkollor: 2016-2017

PLANIFIKIMI I LËNDËS PËR

TREMUJORIN E DYTË
(Janar - Mars)

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ

Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT

Nxënësi:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në formë të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim; - shpjegon çartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

<p>KOMPETENCA E TË MENDUARIT Nxënësi: shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme; harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.</p>
<p>KOMPETENCA E TË NXËNIT Nxënësi: - zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; - shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit; - ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.</p>
<p>KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN Nxënësi: - përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses; - bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).</p>
<p>KOMPETENCA QYTETARE Nxënësi: - zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>
<p>KOMPETENCA DIGJITALE Nxënësi: - përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar. analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).</p>

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCEVE TË LËNDËS

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi:

- kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to;
- jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi:

- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;
- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke i përgjigjur pyetjeve;
- identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në media.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi:

- interpreton tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara;
- dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;
- lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

Tekste letrare

- analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme;
- dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;
- dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

Tekste joletrare

- dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.).

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi:

- përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

Përdorimi i drejtë i gjuhës**Nxënësi:**

- dallon dhe përdor folje në kohët e ndryshme të mënyrës dëftore;
- dallon dhe përdor folje në kohët e ndryshme të mënyrës lidhore;
- dallon dhe përdor parafjalët;
- dallon dhe përdor lidhëzat;
- dallon dhe përdor ndajfoljet;
- përdor si duhet shkronjën e madhe në titujt e librave e gazetave;
- shkruan drejt fjalët që kanë e dhe ë në pozicione të ndryshme;
- shkruan si duhet lidhëzat, parafjalët dhe ndajfoljet.
- dallon fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë;
- përcakton funksionet gramatikore të fjalëve në fjali;
- përcakton në fjali kryefjalën e shprehur me emër, përemër, grup emëror;
- dallon kallëzuesin
- dallon llojet e përcaktorëve dhe përcakton mënyrat e shprehjes.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Gjatë orëve të mësimi do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagrame piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, stuhi mendimi, diagrami i Venit etj.*

Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.

Vlerësimi

Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, teste, biseda ose lexime jashtë klase, diktimit etj.

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënët (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
70		Flasim 5	Angazhimi në komunitet	Kujdesi për kafshët dhe problemet e komunitetit	<i>Stuhi mendimesh, punë e drejtuar me fisha</i>	Vlerësim individual për përmbushjen e objektivave të të folurit.	Teksti mësimor, fisha me situata që ndodhin në kohë të ndryshme,
71	Java 15	Përpunim njohurish Tekst tregimtar 28 Dëgjimë 4	Projekt Angazhimi në komunitet	Ndaja e detyrave	Ndaja në grupe, diskutim	Vlerësim për organizimin dhe ndarjen e detyrave brenda grupit.	CD me materialet dëgjimore
72		Përpunim njohurish Tekst tregimtar 29 Flasim 6	Projekt	Prezantim	Prezantim, bashkëbisedim	Vlerësim për organizimin e projektit dhe prezantimin e tij.	Videoprojektor
73		Përpunim njohurish Flasim 7 Tekst tregimtar 30	Projekt	Prezantim	Prezantim, diskutim në grup	Vlerësim për organizimin e projektit dhe prezantimin e tij.	Videoprojektor
74		Shkruajmë 8	Imazhi dhe fjalët	Shkrimi i një teksti rrëfimtari sipas një imazhi të dhënë.	<i>Diskutim, Shkrim i lirë</i>	Vlerësim individual.	Imazhe, fotografi, piktura etj.
75		Shkruajmë 9	Imazhi dhe fjalët	Shkrimi i një teksti rrëfimtari sipas një imazhi të dhënë.	<i>Diskutim, shkrim i lirë</i>	Vlerësim individual për punën me shkrim.	Imazhe, fotografi, piktura etj.
76	Java 16	Nj. Gj Morfologji 28	Zgjedhimi i foljes në mënyrat dëftore dhe lidhore të formës joveprore	Folja dhe mënyrat e saj.	<i>Diskutim, ushtrime. tabela e koncepteve</i>	Vlerësim për dallimin e foljeve në dëftore dhe lidhore të formës joveprore.	Teksti mësimor, fisha
77		Lexojmë Teksti poetik 1	Madhështia e njerëzve P. Budi	Njohje e poezisë së vjetër shqipe. Evokim i së kaluarës	<i>Stuhi mendimesh Evokim dhe reflektim</i>	Vlerësim për mënyrën e saktë dhe të shpejtë dhe dhënies së përgjigjeve dhe për aftësinë e kthimit në histori	Teksti mësimor
78		Lexojmë Teksti poetik 2	Madhështia e njerëzve P. Budi	Tiparet poetike	<i>Përkthim personazhesh</i>	Vlerësim për përshkrimin e personazheve	Teksti mësimor

79	Nj. Gj Morfologji	29	Folja në mënyrat kushtore dhe habitore	Shkruajnë fjalitë dhe thonë ç'kuptim sjellin ato	<i>Bashkëbisedim, punë e drejtuar, punë e pavarur</i>	Vlerësim për dallimin e foljeve në kushtore dhe habitore	Teksti mësimor, tabela
80	Lexojmë Teksti poetik 3		Varfëria dhe liria Çajupi	Diskutim mbi temën e lirisë në poezi	<i>Diskutim</i>	Vlerësim për aftësinë dhënëse të mendimit	Teksti mësimor
81	Nj. Gj Morfologji	30	Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore	Fjali në mënyrën dëshirore dhe urdhërore	<i>Shkrim i lirë, ushtrime</i>	Vlerësim për saktësinë e përgjigjeve.	Teksti mësimor, tabela, harta konceptuale.
82	Lexojmë Teksti poetik 4		Pellazgonia A. Islami	Njohje e poezisë së sotme shqipe dhe evokim i së kaluarës	<i>Pyetje-përgjigje, punë e drejtuar, punë e pavarur</i>	Vlerësim për aftësinë e përgjigjeve	Teksti mësimor. Vëllimi "Përtej Kohës".
83	Lexojmë Teksti poetik 5		Pellazgonia A. Islami	Tipare të poezisë së D. Agollit	<i>Pyetje-përgjigje, punë e drejtuar, punë e pavarur</i>	Vlerësim për aftësinë e shpjegimit dhe të reflektimit	Teksti mësimor dhe vëllimi "Përtej Kohës".
84	Nj. Gj Morfologji	31	Pjesorja dhe format e pashitjelluara	Format e pashitjelluara në gjuhën shqipe	<i>Harta e konceptit, ushtrime</i>	Vlerësim për dallimin e formave të pashitjelluara	Teksti mësimor,
85	Lexojmë Teksti poetik 6		Pasqyra D. Agolli	Tipare të poezisë së Agollit	<i>Zgjerim kuptimi, pema e mendimit</i>	Vlerësim i plotësimit të pemës së mendimit	Teksti mësimor, vëllimi "Pelegriini i vonuar".
86	Nj. Gj Morfologji	32	Foljet gjysmëndihmëse	Analizojnë fjali me folje gjysmëndihmëse.	<i>Punë në grupe dyshe, punë e drejtuar</i>	Vlerësim për punimin e ushtrimeve gjuhësore në tekst.	Teksti mësimor, harta konceptuale për foljet gjysmëndihmëse.
87	Nj. Gj Morfologji	33	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Zgjedhimi i foljes në mënyrat dëftore, lidhore, kushtore, habitore	Folja dhe mënyrat e saj.	<i>Diskutim, ushtrime. tabela e koncepteve</i>	Vlerësim për dallimin e foljeve në dëftore dhe lidhore, kushtore, habitore të formës joveprore.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
88	Lexojmë Teksti poetik 7		Atdhe T. Keko	Atdheu në poezinë moderne	<i>Parashikim me terma paraprakë; diskutim ditë dypjesësh</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështet në komentimin e poezisë, përcaktimin e mesazhit kuptimor.	Teksti mësimor, videoprojektor.

89		Përpunim njohurish Teksti poetik 8	Bisedë letrare	Libra me poezi	Konkurs	Vlerësimi i nxënësit mbështet në komentimin e poezisë, përcaktimin e llojeve të figurave letrare si dhe në analizën e detajeve përshkruese të saj.	Libra artistikë
90		Përpunim njohurish Teksti poetik 9	Bisedë letrare	Libra me poezi	Konkurs	Vlerësimi i nxënësit mbështet në interpretimin e poezisë.	Libra artistikë
91	Java 19	Nj. Gj 34 Morfologji	Trajtat e shkurtra, të bashkuara të përemrave vetorë	Lexojnë vargjet dhe dallojnë trajtat e shkurtra të përemrave vetorë	<i>Tabela e koncepteve, punë në grupe dyshe, punë e drejtuar</i>	Vlerësim për analizën e trajtave të shkurtra të bashkuara.	Teksti mësimor, tabela
92		Lexojmë Teksti poetik 10	Thuaja këngës me gëzim Uitman	Poezi që përshkruajnë natyrën	<i>Parashikim me terma paraprakë, diskutim ditë dypjesësh</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështet në komentimin e poezisë, përcaktimin e llojeve të figurave letrare si dhe në analizën e detajeve përshkruese të saj.	Teksti mësimor
93		Lexojmë Teksti poetik 11	Mëngjesi O.Khajam	Poezi që përshkruajnë natyrën	<i>Parashikim me terma paraprakë, diskutim ditë dypjesësh</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështet në komentimin e poezisë, përcaktimin e llojeve të figurave letrare si dhe në analizën e detajeve përshkruese të saj.	Teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, libri "Rubairat " O Khajam.
94		Nj. Gj 35 Drejtshkrim	Përdorimi i apostrofit	Lexojnë disa fjali dhe vendosin ku duhet apostrofin	<i>Diskutim , punë e pavarur, punë në grupe</i>	Vlerësim për punimin e ushtrimeve.	Teksti mësimor
95		Lexojmë Teksti poetik 12	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. <i>Zilet</i> Edgar Alan Po	Poezia e letërsisë së huaj	<i>Diskutim , punë e pavarur, punë në grupe</i>	Vlerësim për punimin e ushtrimeve.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
96	Java 20	Shkruajmë 10	Diktim	Raste të përdorimit të apostrofit	<i>Të diktuarit me grupe fjalësh dhe fjali</i>	Vlerësim për drejtshkrimin e rasteve me apostrof	Fletore të punëve me shkrim

97		Dëgjimë 5	Poetët e sotme	Dëgjomë nga të tjerët ose nga shoku ynë poezi të interpretuar	Dëgjim i kujdesshëm, punë individuale dhe në grup	Vlerësim për pyetjet pas mënyrës së dëgjimit	CD me materialet dëgjimore
98		Flasim 8	Aktivitetet shkollore Konkurs poezie	Konkursët poetike, flasim për poezinë	Lexim i drejtuar, diskutim	Vlerësim për aftësinë diskutuese	Vepra të autorëve të përmendur aty, ose fletëza e poezi të veçanta të tyre
99		Nj. Gj Morfologji 36	Përemrat vetvetorë, dëftorë, pyetës	Lexojnë disa vargje dhe gjejnë përemrat që kanë mësuar	Punë e drejtuar, punë në grupe	Vlerësim për zgjidhjen e ushtrimeve	Teksti mësimor materiale të tjera
100		Nj. Gj Morfologji 37	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Përemrat vetvetorë, dëftorë, pyetës Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor	Përemri dhe llojet e tij	Tabela e koncepteve, punë në grupe dyshe, punë e drejtuar	Vlerësim për zgjidhjen e ushtrimeve, pjesëmarrjen në orën e mësimit.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
101	Java 21	Shkruajmë 11	Shkruajmë poezi të shkurtra	Shkrimi i poezisë	Zëvendësim fjalësh a fjalish, zëvendësim strofash	Vlerësim për aftësinë e ndjekjes së logjikës poetike	Modele pune me skeletim poezish nga tekste të ndryshme metodike.
102		Shkruajmë 12	Shkruajmë poezi të shkurtra	Shkrimi në vargje	Shkrimi i poezisë	Vlerësim për aftësinë krijuese	Modele pune me skeletim poezish nga tekste të ndryshme metodike.
103		Nj. Gj Morfologji 38	Lidhëzat	Fragmente ose tekste nga libri	Bashkëbisedim, punë në grupe	Vlerësim individual.	Teksti mësimor, lloje të ndryshme tekstesh,
104		Nj. Gj Morfologji 39	Pasthirra	Vendi i pasthirrmeve në gjuhën shqipe	Punë e drejtuar, punë në grupe	Vlerësim për punimin e ushtrimeve.	Teksti mësimor, ,

105		Lexojmë Teksti dramatik 1	Pas vdekjes Çajupi	Komedia	<i>Stuhi mendimesh, lexim, bashkëbisedim, diskutim</i>	Vlerësim për analizën e personazheve të komedisë, mesazhit të saj.	Teksti mësimor, veshje, mjete dekorative për skenën e teatrit.
106	Java 22	Lexojmë Teksti dramatik 2	Pas vdekjes Çajupi	Komedia	<i>Interpretim me role, diskutim, punë në grupe, grafik</i>	Vlerësim për analizën e gjuhës së komedisë, reflektimin rreth saj.	Teksti mësimor, veshje, mjete dekorative për skenën e teatrit.
107		Nj. Gj Drejtshkrim 40	Përdorimi i trepikëshit (...)	Rregullat e drejtshkrimit	<i>Tabela e koncepteve, punë në grupe dyshe, punë e drejtuar</i>	Vlerësim për punimin e ushtrimeve, pjesëmarrjen në mësim.	Teksti mësimor, udhëzues për drejtshkrim.
108		Lexojmë Teksti dramatik 3	Vdekja e një mbretëreshes R.Qosja	Drama	<i>Stuhi mendimesh, lexim, bashkëbisedim diskutim</i>	Vlerësim për dallimin e karakteristikave të një veprë dramatike.	Teksti mësimor, e-libri, foto;
109		Lexojmë Teksti dramatik 4	Vdekja e një mbretëreshes R.Qosja	Drama	<i>Stuhi mendimesh, lexim, dramatizim</i>	Vlerësim për interpretimin e dramës.	Teksti mësimor, e-libri, foto;
110		Teksti dramatik 5	Projekt: Dramatizim	Drama	<i>dramatizim</i>	Vlerësim për interpretimin e dramës.	Veshje, mjete te skenës.
111	Java 23	Teksti dramatik 6	Projekt: Dramatizim	Drama	<i>Dramatizim, diskutim</i>	Vlerësim për interpretimin e dramës.	Veshje, mjete te skenës.
112		Teksti dramatik 7	Projekt: Dramatizim	Drama	<i>Dramatizim, diskutim</i>	Vlerësim për interpretimin e dramës.	Veshje, mjete te skenës.
113		Nj. Gj Morfologji 41	Pjesëzat	Fragmente ose tekste nga libri	<i>Punë e pavarur me shkrim – Diskutim</i>	Vlerësim individual në punimin e ushtrimeve	Teksti mësimor
114		Nj. Gj Morfologji 42	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Lidhëzat, pasthirmat, pjesëzat	Pjesëte pandryshueshme të ligjëratës	<i>Stuhi mendimesh/ tabela e konceptit, punë në grupe, tryeza rrethore</i>	Vlerësim individual në punimin e ushtrimeve, shkëmbim punimesh dhe vetëvlerësim	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
115		Teksti joletrar 1	Teksti rrëfimtari joletrar Kronika	Media e shkruar dhe ajo televizive.	<i>Stuhi mendimesh/ tabela e konceptit, punë në grupe, tryeza rrethore</i>	Vlerësim për kuptimin, analizën dhe reflektimin rreth kronikës.	Teksti mësimor, fotografi, materiale informative për çytetin e Gjirokastres.

116	Java 24	Teksti joletrar 2	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Ëndrra bëhet realitet, Shqipëria në "Francë 2016"	Kronika dhe llojet e saj	Punë e pavarur, punë në grupe.	Vlerësim individual në punimin e ushtrimeve, shkëmbim punimesh dhe vetëvlerësim	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
117		Teksti joletrar 3	Përgjigje admirueses Rouling	Situata e letërkthimit të përgjigjes	<i>Diskutim mbi situata të dhëna, hartë koncepti shkrim letrë me kthim përgjigje</i>	Vlerësim për diskutimin dhe më pas për aftësinë krijuese të letrës	Modele të ndryshme letrash të personave të njohur
118		Nj. Gj Sintaksë 43	Kryefjala	Kryefjala dhe vendi i saj në fjali	<i>Lojë me fjalë të urta, ushtrime</i>	Vlerësim për identifikimin e grupeve të kryefjalës në fjalinë e vogël.	Teksti mësimor, fisha, foto.
119		Nj. Gj Sintaksë 44	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Kryefjala	Kryefjala dhe vendi i saj në fjali	<i>Punë e pavarur, punë në grupe.</i>	Vlerësim për identifikimin e grupeve të kryefjalës në fjalinë e vogël.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
120		Teksti joletrar 4	Biografia Stiv Xhobs	Biografi të njerëzve të shquar	<i>Stuhi mendimesh/ tabela e konceptit, punë në grupe, tryeza rrethore</i>	Vlerësim për kuptimin, analizën dhe reflektimin rreth biografisë.	Teksti mësimor, biografia e Stiv Xhobsit.
121	Java 25	Teksti joletrar 5	Biografia Stiv Xhobs	Biografi të njerëzve të shquar	<i>Stuhi mendimi, klaster, bashkëbisedim</i>	Vlerësim për kuptimin, analizën dhe reflektimin rreth biografisë.	Teksti mësimor, biografia e Stiv Xhobsit.
122		Nj. Gj Sintaksë 45	Kallëzuesi foljor i thjeshtë dhe i përbërë	Fjali me lloje të ndryshme kallëzuesish	<i>Stuhi mendimesh, punë e drejtuar me fisha, punë e pavarur.</i>	Vlerësim për përcaktimin e gjymtyrëve kryesore.	Teksti mësimor, harta konceptuale.
123		Nj. Gj Sintaksë 46	Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin	Kryefjala dhe kallëzuesi	<i>Stuhi mendimi, klaster, bashkëbisedim, punë në grupe.</i>	Vlerësim individual në punimin e ushtrimeve, shkëmbim punimesh dhe vetëvlerësim	Teksti mësimor, harta konceptuale.
124		Nj. Gj Sintaksë 47	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Kallëzuesi foljor i	Kryefjala dhe kallëzuesi	<i>Stuhi mendimi, klaster, bashkëbisedim, punë në grupe.</i>	Vlerësim individual në punimin e ushtrimeve, shkëmbim punimesh dhe vetëvlerësim	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.

125			thjeshtë dhe kallëzuesi foljor i përbërë. Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin	Autobiografia, Medalja e artë	Autobiografia dhe veçoritë e saj	<i>Stuhi mendimesh, INSERT punë në grupe</i>	Vlerësim për dallimin e autobiografisë si loj i tekstit joletrar rrëfimtari, të kuptuarit e brendisë së tekstit, të analizuarit e elementeve dhe strukturës së autobiografisë, interpretimin e ideve të autores.	Teksti mësimor, fotografi, materiale informuese për fitues në garime të ndryshme, videoprojektor.
126	Java 26	Përpunim njohurish (Nga orët e komp. Lexojmë)	Përsëritje		Konceptet gjuhësore dhe letrare të fituara	<i>Punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i>	Vlerësim individual dhe vetëvlerësim.	Teksti mësimor, fletore, tabela.
127		Shkruajmë 13	Test për tremujorin e dytë		Udhëzime	<i>Punë e pavarur</i>	Vlerësim për arritjet e njohurive të këtij tremujori.	Teksti mësimor

PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NDARË NË TREMUJORË

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: GJUHË SHQIPE

Shkalla: III

Klasa: VII

Viti shkollor: 2016-2017

PLANIFIKIMI I LËNDËS PËR

TREMUJORIN E TRETË
(Prill – Maj)

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT

Nxënisi:

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

<p>KOMPETENC A E TË MENDUARIT</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme; - harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; - përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.
<p>KOMPETENCA E TË NXËNIT</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; - shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit; - ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
<p>KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses; - bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
<p>KOMPETENCA QYTETARE</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.]
<p>KOMPETENCA DIGJITALE</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar. - analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË LËNDËS

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi:

- kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to;
- jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

- zgjedh formën e përshatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;
- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve;
- identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në media.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

- interpreton tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara;
- dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;
- lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

Tekste letrare

- analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme;
- dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;
- dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

Tekste joletrare

- dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.).

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

- përdor formën ose modelin e përshatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkuese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

- dallon dhe përdor fjalitë e thjeshta dhe të përbëra si dhe përcakton llojin e tyre;
- gjen dhe përdor në fjali kundrinorin e drejtë;
- gjen dhe përdor në fjali llojet e ndryshme të rrethanorëve;
- krahason fjalitë e thjeshta me fjalitë e përbëra.

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënësve (të sugjeruara)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
128		Teksti joletrar 7	Kur të rriturit marrin zjarr shpejt A.Frank	Ditari	<i>Stuhi mendimesh, leksion i përqendruar, punë në grupe</i>	Vlerësimi i nxënësit mbështetet në dallimin e veçorive gjuhësore dhe atyre strukturore të ditarit si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar.	Teksti mësimor, fotografi, ditare të ndryshme personale apo nga njerëz të njohur, videoprojektor.
129		Teksti joletrar 8	Kur të rriturit marrin zjarr shpejt A.Frank	Ditari	<i>Stuhi mendimesh, leksion i përqendruar, punë në grupe</i>	Vlerësim për interpretimin e ideve të autorit të shprehura në ditarin e saj, argumentimin e qëndrimit të vet ndaj situatës së temës.	Teksti mësimor, fotografi, ditare të ndryshme personale apo nga njerëz të njohur, videoprojektor.
130		Nj. Gj Sintaksë 48	Kundrinori	Lexojnë vargjet dhe gjejnë kundrinorët	<i>Punë e drejtuar, punë me grupe, punë e pavarur</i>	Vlerësim individual.	Teksti mësimor, harta konceptuale
131	Java 27	Teksti joletrar 9	Intervista: Shqetësimet e një studiuesi	Intervista	<i>Stuhi mendimesh, diagrami piramidial, punë në grupe</i>	Vlerësim për të kuptuarit, analizën e ideve dhe atë gjuhësorë të intervistës, reflektimin rreth temës së saj.	Teksti mësimor, fotografi, materiale informuese për problemet e sotme të gjuhës shqipe, videoprojektor.
132		Shkruajmë 14	Si të shkruajmë një intervistë	Intervista	<i>Diskutim, punë e pavarur me modele, imagjinatë e drejtuar.</i>	Vlerësim për shkrimin e një interviste sipas strukturës së saj.	Teksti mësimor, fotografi, materiale informuese për problemet e sotme të gjuhës shqipe, videoprojektor.
133		Shkruajmë 15	Si të shkruajmë një intervistë	Intervista	<i>Diskutim, punë e pavarur me modele, imagjinatë e drejtuar.</i>	Vlerësim për shkrimin e një interviste sipas strukturës së saj.	Fletore të punëve me shkrim

134		Nj. Gj Sintaksë 49	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Kundrinori	Llojet e kundrinorëve	<i>Punë e drejtuar, punë me grupe, punë e pavarur</i>	Vlerësim individual.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
135		Teksti joletrar 10	Teksti informativ-shpjegues Shpikja e alfabetit	Diskutim rreth alfabetit tonë	<i>Stuhi mendimi bashkëbisedim /Punë në grupe, diagramë Veni</i>	Vlerësim për dallimin e tipareve të tekstit informativ-shpjegues	Teksti mësimor, fotografi, laptop.
136	Java 28	Teksti joletrar 11	Librat dhe bibliotekat	Bashkëbisedim rreth përvojave personale	<i>Stuhi mendimi, bashkëbisedim /ditari dypjesësh,puno dyshe/shkëmbe mendime</i>	Vlerësim për dallimin e tipareve të tekstit informativ-shpjegues	Teksti mësimor
137		Nj. Gj Sintaksë 50	Rrethanori i vendit dhe i kohës	Analizojnë disa fjalë të urta	<i>Stuhi mendimesh, punë e drejtuar me fisha</i>	Vlerësim për identifikimin e rrethanoëve.	Teksti mësimor
138		Nj. Gj Sintaksë 51	Rrethanori i shkakut dhe qëllimit	Japin disa fjali me rrethanoërë shkaku e qëllimi dhe i dallojnë	<i>Punë me grupe, punë e pavarur</i>	Vlerësim për identifikimin e rrethanoëve	Teksti mësimor
139		Dëgjojmë 6	Dëgjojmë raporte te shkurtra informuese	Raportet informuese	<i>Punë e drejtuar, punë në grupe</i>	Vlerësim për të kuptuarit e materialit të dëgjuar.	CD me materialet dëgjimore
140		Dëgjojmë 7	Përforcim Dëgjojmë raporte te shkurtra informuese	Raportet informuese	<i>Kllaster,dëgjim i drejtuar (DRTA), punë në grupe</i>	Vlerësim për të kuptuarit dhe analizën e materialit të dëgjuar.	CD me materialet dëgjimore
141	Java 29	Shkruajmë 16	Letra formale Shkruajmë një letër zyrtare	Komunikimi formal me shkrim	<i>Diskutim, punë e pavarur me modele, imagjinatë e drejtuar.</i>	Vlerësim për shkrimin e një letre zyrtare	teksti shkencor, materiale të ndryshme që lidhen me komunikimin, letra zyrtare etj.
142		Shkruajmë 17	Letra formale Shkruajmë një letër zyrtare	Komunikimi formal me shkrim	<i>Diskutim, punë e pavarur me modele, imagjinatë e drejtuar.</i>	Vlerësim për shkrimin e një letre zyrtare	Fletore të punëve me shkrim
143		Nj. Gj Sintaksë 52	Rrethanori i mënyrës dhe sasisë	Gjejnë rrethanoërë në një fragment	<i>Shkrim i lirë,punë në grupe dyshe, punë individuale</i>	Vlerësim për punimin e ushtrimeve dhe të punës me shkrim	Teksti mësimor Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Rrethanoërë

144		Përpunim njohurish (Nga orët e komp. Lexojmë)	Përsëritje. Teksti joletrar dhe letrar	Llojet e teksteve	Diagram Veni, punë e pavarur.	Vlerësim individual, vetëvlerësim.	Teksti mësimor, modele tekstesh
145	Nj. Gj Sintaksë	53	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje	Fragmente ose tekste nga libri	Punë e drejtuar, punë e pavarur.	Vlerësim për saktësinë e ushtrimeve dhe aktivizimin në orën mësimore.	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje
146	Java Sintaksë	30	54	Llojet e fjaltëve të përbëra me bashkërenditje	Fragmente ose tekste nga libri	Punë e drejtuar, punë e pavarur.	Teksti mësimor, harta konceptuale
147	Teksti joletrar	12	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Bicikleta malore	Teksti informativ-shpjegues	Diskutim, punë në grupe, punë e drejtuar: ushtrime praktike	Vlerësim për saktësinë e ushtrimeve dhe aktivizimin në orën mësimore.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
148	Teksti joletrar	13	Bisedë rreth teksteve joletrare Lexim jashtë klase	Tekste joletrare	Bisedë e drejtuar, konkurs	Vlerësim për aktivizimin gjatë konkursit, punën në grup.	Libra, revista, enciklopedi
149	Teksti joletrar	14	Bisedë rreth teksteve joletrare Lexim jashtë klase	Përdorimi i teksteve joletrare	Konkurs, turi i galerisë.	Vlerësim për aktivizimin gjatë konkursit, punën në grup.	
150	Shkruajmë	18	Shkruajmë njohime të shkurtra	Komunikimi formal me shkrim	Diskutim, punë e pavarur me modele, imajinatë e drejtuar.	Vlerësim për shkrimin e një njoftimi	Teksti shkencor, materiale të ndryshme informuese, grafikë, fotografi etj.
151	Nj. Gj Drejtshkrim	55	Përdorimi i pikës dhe i pikëçuditjes	Rregullat drejtshkrimore	Diskutim, punë në grupe, punë e drejtuar: ushtrime praktike	Vlerësim për përdorimin e pikës dhe të pikëçuditjes, vetëvlerësim.	Teksti mësimor, udhëzues për drejtshkrimin
152	Nj. Gj Drejtshkrim	56	Përdorimi i presjes në fjali	Rregullat drejtshkrimore	Diskutim, punë në grupe, hartë konceptesh	Vlerësim për vendosjen e saktë të presjes në fjali, vlerësim mes nxënësve.	Teksti mësimor, udhëzues për drejtshkrimin


153		Teksti joletrar 15	Teksti udhëzues Udhëzime testimi	Udhëzime për të qenë i suksesshëm në një testim	<i>Diskutim, punë në grupe, ushtrim praktik</i>	Vlerësim për aftësinë e shpjegimit të udhëzimit dhe aftësinë për të komentuar këshillat e ndryshme	Teste të ndryshme të standardizuara
154		Teksti joletrar 16	Si të pasurosh fjalorin	Udhëzime se si mund të pasurosh fjalorin tënd	<i>Çfarë dimë-çfarë duam të dimë-çfarë mësuam, hartim i një teksti udhëzues</i>	Vlerësim për metodën Di-Dua_mësova dhe një vlerësim për tekstin udhëzues	Tekste të ndryshme udhëzuese
155		Dëgjojmë 8	Instruksiione, shpjegime	Udhëzimet, shpjegimet	<i>Punë e drejtuar, punë në grupe</i>	Vlerësim për të kuptuarit dhe analizën e materialit të dëgjuar.	CD me materialet dëgjimore
156	Java 32	Flasim 9	Përgjegjësitë dhe të drejtat e nx. në shkollë	Njohja përmes situatave dhe diskutimit të përgjegjësiave dhe të drejtave	<i>Përgjigje referuese apo situative, hartë konceptesh</i>	Vlerësim për diskutimin dhe hartën e konceptit	Teksti mësimor, botime
157		Nj. Gj Sintaksë 57	Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejhtë	Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejhtë	<i>Punë e drejtuar, punë me grupe, punë e pavarur</i>	Vlerësim për dallimin dhe përdorimin e ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejhtë.	Teksti mësimor, Harta semantike konceptuale.
158		Nj. Gj Sintaksë 58	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejhtë	Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejhtë	<i>Diskutim, punë e pavarur</i>	Vlerësim për saktësinë e punimit të ushtrimeve dhe vetëvlerësim.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësimor.
159		Shkruajmë 19	Udhëzime për një lojë kompjuteri	Komunikimi formal me shkrim	<i>Diskutim, punë e pavarur me modele, imagjinatë e drejtuar.</i>	Vlerësim për shkrimin e udhëzimeve	Teksti mësimor, udhëzime të ndryshme
160		Shkruajmë 20	Udhëzime për një lojë kompjuteri	Komunikimi formal me shkrim	<i>Diskutim, punë e pavarur me modele, imagjinatë e drejtuar.</i>	Vlerësim për shkrimin e udhëzimeve	Teksti mësimor, udhëzime të ndryshme
161	Java 33	Shkruajmë 21	Diktim	Drejshkrimi Shenjat e pikësimit	<i>Punë individuale, puno dyshe/shkëmbe mendime</i>	Vlerësim për saktësinë e shkrimit.	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Drejshkrim

162		Teksti joletrar 17	Teksti argumentues Lavdërimi i atdheut Lukiani	Teksti argumentues	Pesëvargëshi -INSERT - punë e pavarur	Vlerësim për të kuptuarit, analizën e tekstit argumentues.	Teksti mësuesor, fotografi, shkrime për atdheun, videoprojektor.
163		Teksti joletrar 18	Pasioni për ndryshimet L. Buskallia	Rëndësia e teknologjisë	Stuhi mendimi, bashkëbisedim /ditari dypjesësh,puno dyshe/shkërmbë mendime	Vlerësim për analizën e gjuhës së tekstit argumentues, reflektimin ndaj tij.	Teksti mësuesor, fisha
164		Teksti joletrar 19	Si një roman D.Penak	Rëndësia e leximit	Diskutim, pyetje- përgjigje,analizë e tipareve, semantike, punë e drejtuar	Vlerësim për analizën e gjuhës së tekstit argumentues, reflektimin ndaj tij.	Teksti mësuesor
165		Teksti joletrar 20	Punimi i fletës së vlerësimit të kompetencave. Teknologjia në shërbim të lexuesve	Teksti argumentues	Punë e drejtuar, punë në grupe	Vlerësim për saktësinë e punimit të ushtrimeve dhe vetëvlerësim.	Fletë të vlerësimit të kompetencave, në tekstin mësuesor.
166	Java 34	Dëgjojmë 9	Argumente rreth përdorimit të internetit Letra e U.Ekos	Dëgjojmë dhe argumentojmë	Punë e drejtuar, punë në grupe	Vlerësim për të kuptuarit dhe analizën e materialit të dëgjuar.	CD me materialet dëgjimore
167		Dëgjojmë 10	Argumente rreth përdorimit të internetit Letra e U.Ekos	Dëgjojmë dhe argumentojmë	Diskutim, imagjinatë e drejtuar.	Vlerësim për të kuptuarit dhe analizën e materialit të dëgjuar.	CD me materialet dëgjimore
168		Flasim 10	Komunikimi në një mjetis virtual	Interneti dhe ne	Punë në grupe, bashkëbisedim	Vlerësim për të folurit rrethshëm dhe me argumente rreth temës	Teksti mësuesor
169		Shkruajmë 22	Eseja argumentuese	Shkrimi argumentues	Punë në grupe, bashkëbisedim	Vlerësim individual për shkrimin e esesë argumentuese	Fletore të punëve me shkrim
170		Shkruajmë 23	Eseja argumentuese	Shkrimi argumentues	Punë me shkrim	Vlerësim individual për shkrimin e esesë argumentuese	Fletore të punëve me shkrim

171	Java 35	Tekst përshkrues joletrar 21 Tirana jonë	Teksti përshkrues joletrar (guidë)	<i>Stuhi mendimesh, mendimi i njëpasnjëshëm</i>	Vlerësim për përgjigjet dhe rrjedhën e tyre	Guida të ndryshme për Tiranën	Tekst përshkrues joletrar Tirana jonë
172		Shkruajmë 24 Tirana jonë	Eseja përshkruese	Shkrimi përshkues	<i>Situata konkrete, tabela e këshillimit hapat e këshillimit</i>	Vlerësim për aftësinë shpjeguese	Ese të ndryshme model
173		Shkruajmë 25	Eseja përshkruese	Shkrimi përshkues	<i>Skeletimi Provoni veten Çfarë dimë-çfarë duam të dimë-çfarë mësuam</i>	Vlerësim për aftësinë e shpjegimit të shembujve skeletues dhe vlerësim për aftësinë krijuese personale	Ese të ndryshme model
174		Përpunim njohurish Njohuri gjuhësore 59	Përsëritje	Udhëzime	<i>Punë në grupe, bashkëbisedim</i>	Vlerësim për përgjigjet, aktivizimin gjatë orës, vetëvlerësim.	Teksti mësimor
175		Njohuri gjuhësore 60	Test për tremujorin e fundit	Udhëzime për testimin	<i>Punë individuale</i>	Vlerësim për arritjet e njohurive të këtij tremujori.	Fletët e testimit

PJESA E PARË: DËGJOJMË, FLASIM, LEXOJMË DHE SHKRUAJMË GJUHËN

Kompetenca Lexojmë: 70 orë



6 orë Projekte

6 orë Lexim jashhtë klase (3x2 orë)

6 orë Fletë vlerësimi e kompetencës: Lexojmë

3 orë përsëritje

**Kompetenca Shkruajmë: 25 orë (20 orë njohuri të reja+5 përpunim njohurish)/
(20 orë njohuri të reja +3 orë diktimit+2 orë testime)**

Kompetenca Dëgjojmë: 10 orë (7 orë njohuri të reja+3 përpunim njohurish)

Kompetenca Flasim: 10 orë (7 orë njohuri të reja+3 përpunim njohurish)

PJESA E DYTË: PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS

60 orë janë njohuri gjuhësore.

70% njohuri të reja gjuhësore: 42 orë

30% përpunim njohurish: 18 orë (13 orë fletë vlerësimi+ 3 orë projekt+1 orë përsëritje+1 orë testim)

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË DËGJUARIT

Data:
PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kërkesa, shpjegime, keqkuptime		Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe diskutojmë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -kërkon, kupton, shpjegon, krahason mirëkupton mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, të shikuara ose të prezantuara, reflekton për to; -kupton kërkesat që bëhen, shpjegon nëse i kërkojnë informacion shtesë; -mirëkupton dhe kontribuon në zgjidhjen e keqkuptimeve; -kupton tekstet e dëgjuara për problematikën që ka në lidhje me situata të paqarta apo të keqkuptuara; -reagon kundërshton ose pranon sugjerime nga materialet e dëgjuara.		Fjalët kyçe: -dëgjim; -kërkesa; -shpjegim; -keqkuptim; -krijim; -situatë; -interpretim, mirëkuptim, adoleshencë.	
Burimet: mjete të teknologjisë CD, regjistrime video.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Kllaster -Imagjinatë e drejtuar -Punë në grupe -Rrjet diskutimi -Lojë në role			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake Hapi i parë – Stuhi mendimi Prezantohet tema e mësimimit nga mësuesi/ja: “ Kërkesa, shpjegime, keqkuptime ” dhe kërkohet që nxënësit të shprehin lirshëm për problematikën që ngre çdo imazh në figurat e ushtrimit 1. duke treguar se pse e mendon ashtu dhe cilat janë ato elemente të komunikimit që e bëjnë të mendojë se situata e komunikimit për çdo imazh lidhet me paqen, konfliktin, mirëkuptimin, këshillimin, sqarimin, shpjegimin.			
II. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë – (punë në grupe – lojë në role) rreth 15 min <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit ndahen në grupe dhe luajnë në role çdo situatë të ushtrimit 1. (konflikti, shpjegimi, keqkuptimi, mirëkuptimi.) - Ndërkohë pas çdo interpretimi nxënësit e tjerë i japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 2. - Cili është problemi? - Është i zgjidhshëm apo jo, është zgjidhur mirë, e mbështesni apo e kundërshtoni zgjidhjen? Pse? - Pas interpretimeve punohet ushtrimi 6. - Hapi i tretë – (rrjet diskutimi) f. 12 koha 10’ - Mësuesi/ja e ndan klasën në dy grupe dhe kërkon që nxënësit, pasi të dëgjojnë të regjistruar apo të lexuar materialin në lidhje me keqkuptimet gjatë lojërave punës, mësimimeve të drejtave, (nxënësit) të pozicionohen me qëndrimet e tyre në <i>pro dhe kundra</i>. 			

<p>Pasi dëgjojnë situatat, grupi <i>pro</i> jep argumente në mbështetje të situatës, grupi <i>kundra</i> jep argumente në kundërshtim të zgjidhjes, si dhe jep argumente që e kundërshtojnë (ushtrimi 4).</p> <p>Hapi i tretë-teknika: (Punë në grupe dyshe) Ushtrimi 7 Nxënësit në grupet bazë tregojnë histori personale, të cilat ngjallin debat për të tjerët. Nxënësit vlerësojnë historinë, pasi e kanë dëgjuar dhe japin argumente në dobi të zgjidhjes pozitive të problemit.</p> <p>III. Përforsim njohurish -Hapi i katërt (teknika konkurs dhe punë në grupe) Ushtrimi 8,7 Dëgjohet një bisedë telefonike. Nxënësit pasi ta kenë dëgjuar do t'i japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 7. Është interesante biseda? Pse ju duket e tillë? Cili është momenti më interesant? Pse ju duket i tillë? Ju pëlqejnë argumentet?Janë bindës? etj...</p>
<p>Vlerësimet në situatë/Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Riprodhojnë situata udhëhequr nga imazhet e tekstit. - Gjejnë dhe përcaktojnë saktë problematikën për çdo situatë. - Japin argumente të sakta udhëhequr nga informacionet e dëguara. - Luajnë në role, dëgjojnë përvoja personale, japin të tyret. - Diskutojnë për konfliktin dhe mirëkuptimin.
<p>Vlerësimi: Vlerësimi i mënyrës së të dëgjuarit dhe reagimit ndaj informacioneve që marrin, kuptimësinë ndaj tyre dhe reagimin. Vlerësohet si e arrirë kjo orë mësimi kur nxënësit kanë treguar vëmendje dhe kanë reflektuar duke treguar kuptimësitë ndaj informacioneve të përcjella përmes pajisjeve teknologjike apo dëgjimit të drejtpërdrejtë të njëri –tjetrit dhe reagojnë pozitivisht duke dhënë edhe zgjidhje. Luajnë në role dhe interpretojnë situata komunikimi në lidhje me kërkesat,shpjegimet dhe mirëkuptimin. Reagojnë ndaj situatave të dëguara, të cilat iu kanë dhënë mundësi për reflektim dhe gjetje argumentesh të përshtatshme.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: <i>Ushtrimi 10,11. Punimet ruben në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.</i></p>

Data:

PLANIFIKIMI DËTOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjojmë anekdota		Situata e të nxënit:	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -dëgjon, kupton dhe nxjerr mesazhe përmes anekdotave. -dëgjon dhe vlerëson me sensin e humorit mesazhet që përcillen mes anekdotave. - vlerëson qëndrime të mençura të individëve të ndryshëm me vlera historike dhe aktuale.</p>		<p>Fjalët kyçe: -dëgjim; -anekdotë; -riprodhim; -interpretim.</p>	

Burimet: mjete të teknologjisë CD, regjistrime në video.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Historia • Teknologjia
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimi -Dëgjim i drejtuar (DRTA) -Punë në grupe -Lojë në role	
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT	
I. Veprimtari paraprake	
Hapi i parë – Stuhi mendimi	
<p>M përmes një regjistrimi jep disa anekdota dhe pyet nxënësit të thonë se për çfarë gjinie letrare flitet. Cilat janë karakteristikat e tyre. Si lindin ato a pëlqehen?</p>	
II. Zhvillimi i situatës	
<ul style="list-style-type: none"> - Hapi i dytë – Dëgjim i drejtuar -DRTA 	
<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja jep të regjistruar ose lexon anekdotën "Skënderbeu dhe Ballabani". Pasi e lexon, bën ndalesën e parë duke iu drejtuar nxënësve pyetjet. 	
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndalesa e parë</i> 	
<ul style="list-style-type: none"> - Kush është Ballaban Pashë Badera? Çfarë i dhuroi ai Skënderbeut? Si iu përgjigj Skënderbeu? A ju pëlqen kjo përgjigje? Pse? 	
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndalesa e dytë:</i> 	
<ul style="list-style-type: none"> - Lexohet anekdota "Mençuria e Lekë Dukagjinit". Pasi e dëgjojnë, nxënësit iu përgjigjen pyetjeve që iu drejton mësuesi: 	
<ul style="list-style-type: none"> - Kush është Lekë Dukagjini?Përse është shquar ai? Si ju duket veprimi i tij/Si e vlerësoni? Bëri mirë apo bëri keq? Çfarë tregon kjo për karakterin e tij? 	
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndalesa e tretë:</i> Dëgjohet anekdota "Ali Pasha dhe Napoleoni". 	
<ul style="list-style-type: none"> - Pyetjet e mësuesit: Si ju duket veprimi i Ali Pashës, pasi keni dëgjuar përgjigjen e tij" Napoleon, më parë dërgo paratë që të marrësh grurin"? 	
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndalesa e katërt:</i> "Anekdota e Sokratit" 	
<ul style="list-style-type: none"> - Pyetjet e mësuesit: Si ju duket përgjigja e parë në lidhje me të hollat? Jeni dakord me këtë këshillë? 	
<ul style="list-style-type: none"> - Si ju duket përgjigja e dytë e filozofit, në lidhje me forcën? 	
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndalesa e pestë</i> (Anekdotat nga jeta e përditshme) 	
<ul style="list-style-type: none"> - 1. Mësuesi pyet: <i>Si ju duket përgjigja e djalit?</i> 	
<ul style="list-style-type: none"> - 2. <i>Si ju duket përgjigja e Anës?</i> 	
<ul style="list-style-type: none"> - 3. <i>Si ju duket përgjigja për indiferentizmin?</i> 	
<ul style="list-style-type: none"> - 4. <i>Si ju duket dialogu mes djemve? Ka humor? Ku qëndron humori?</i> 	
III. Përforsim njohurish	
-Hapi i tretë: Interpretim, lojë në role, punë e pavarur	
<p>Kërkohet të tregohen në grupe anekdota të tjera. Pasi t'i kenë dëgjuar, kërkohet të bëjnë pyetje dhe komente në lidhje me mesazhet që ato përcjellin.</p>	
Punë e pavarur	
<p>Kërkohet të plotësohet tabela e f. 36. E nisin në klasë, por mund ta vazhdojnë edhe si detyrë shtëpie.</p>	
Vlerësimet në situatë/Veprimet në situatë	
<ul style="list-style-type: none"> - Riprodhojnë situata udhëhequr nga imazhet e tekstit. 	
<ul style="list-style-type: none"> - Gjejnë dhe përcaktojnë saktë problematikën për çdo situatë. 	
<ul style="list-style-type: none"> - Japin argumente të sakta udhëhequr nga informacionet e dëguara. 	
<ul style="list-style-type: none"> - Luajnë në role, dëgjojnë përvoja personale, japin të tyret. 	
<ul style="list-style-type: none"> - Diskutojnë për konfliktin dhe mirëkuptimin. 	

Vlerësimi:

Vlerësimi i mënyrës se si janë treguar anekdotat dhe reagimit pas dëgjimit të tyre.
Vlerësohet mënyra se si janë kuptuar dhe si zbërthehen mesazhet mbështetur vetëm në dëgjimin e tyre.
Vlerësohen përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga mësuesit dhe mënyra e argumentimit të tyre.
Vlerësohet mënyra e të treguarit të anekdotave nga ana e nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi i fundit i f.36. Plotësohet tabela dhe rubet në dosjen e punimeve për vlerësim të mëtejshëm

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Poetet e sotme		Situata e të nxënët: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> <i>Kompetenca e të menduarit.</i> <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -rikujton rregullat që duhet të ndjekin gjatë të dëgjuarit; -shpreh përjetimet, ndjenjat që e shoqërojnë gjatë leximit të një poezie; -dallon fjalët kyçe të poezisë; -përcakton mesazhin e poezive; -krahason mesazhet e katër poezive të ndryshme që dëgjon.		Fjalët kyçe: <i>Dëgjoj, rregulla, mesazh, poezi.</i>	
Burimet: Teksti i nxënësit, material nga interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Pyetje -përgjigje -Stuhi mendimesh -Punë e drejtuar -Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimit Hapi 1: Rregullat e të dëgjuarit. Rikujtojmë me nxënësit rregullat e të dëgjuarit <ol style="list-style-type: none"> Është ai/ajo që dëshiron të dëgjojë. Është ai/ajo që i kushton vëmendje maksimale asaj që dëgjon. Është ai/ajo që e kupton atë që dëgjon si dhe qëllimin e atij që flet. Është ai/ajo që mban mend atë që ka dëgjuar. 			

Hapi 2: Pyetje-përgjigje. I drejtoj pyetje klasës rreth asaj që dinë mbi rregullat e dëgjimit.

- Çfarë duhet të kemi parasysh kur jemi duke dëgjuar dikë ose diçka.
- Pse është e rëndësishme të jemi të vëmendshëm?
- Si mund ta shprehim interesin ndaj asaj që dëgjojmë?
- Çfarë duhet të bëjmë nëse nuk kuptojmë diçka gjatë të dëgjuarit?

Hapi 3: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja u prezanton nxënësve mënyrën se si do të zhvillohet kjo orë mësimi.

Lexohen 4 poezitë ku çdo nxënës gjatë dëgjimit shënon në fletore fjalët kyç të secilës poezi.

Janë zgjedhur katër poezi, nga katër poete femra. Askush më mirë se shpirti i një gruaje nuk mund të përcjellë ndjesi dhe emocione të tilla. Secila prej tyre ka sjellë origjinalitet dhe freski në vargjet e poezive.

Para se të dëgjojmë këto poezi, japim **disa këshilla:**

1. Dëgjojeni poezinë si një të tërë.
2. Dëgjojeni më pas pjesë-pjesë, duke u ndalur në vargjet që ju pëlqejnë më shumë.
3. Mendoni pse ju bën të ndiheni mirë.
4. Përsëritimi me zë vargjet pas recituesit.
5. Futuni në atmosferën e dëgjimit përmes qetësisë dhe përqendrimit.
6. Përgjigjuni pyetjeve që lindin pas dëgjimit.

- Prezantimi ose dëgjimi i poezisë “Lule dielli” e autores Adriatike Lami. Nëpërmjet këtyre vargjeve ajo ka dashur të prezantojë femrën, nënën, gruan që do të mbetet gjithmonë një lule dielli. Leximi mund të shoqërohet edhe me ndonjë melodi në sfond.

Fjalët kyçe të poezisë lule dielli: *lule dielli; fytyrë; shija e bukës; forma e gruas; ekzistencë.*

- Dëgjojmë poezinë e dytë “Zogj dimri” të autores Mimoza Ahmeti. Në këtë poezi autorja kërkon të na tregojë lidhjen e pazgjidhshme që ka njeriu me vendin e tij

Pas dëgjimit të poezisë edhe këtu nxjerrim fjalët kyçe: *zogj dimri; diçka të shkurtit; shira;*

përleshemi me retë.

- Më pas lexojmë poezinë e tretë “Ndërgjegje e gjymtuar” e autores Luljeta Lleshanaku. Këtu poetja të duket sikur krijon një lloj paralelizmi midis ndërgjegjes së gjymtuar dhe lakuriqit të natës.

Fjalët kyçe: *lakuriq nate; verbobet; përplasit; shpend i zi.*

- Poezia e katërt “Pritja jote” e autores Flutura Aça. Poetsha, këto vargje ia ka kushtuar djalit të saj, zemra e nënës gjithmonë do ta ketë derën hapur për fëmijët.

Fjalët kyçe: *biri im; nëna është aty; burrë i vogël; revolta adoleshente; era njeri.*

Hapi 4. Stuhi mendimesh: Pas përfundimit të këtyre poezive, i drejtohen pyetje klasës:

- A ju pëlqyen poezitë?
- Cila prej tyre ju pëlqeu më shumë dhe pse?
- Çfarë emocioni ju përcjell poezia “Luledielli”?
- Si e këshillon autorja birin e saj në poezinë “Pritja jote”?
- Çfarë ndjesie provoni kur lexoni poezinë “Ndërgjegje e gjymtuar”?
- Çfarë ju bie më shumë në sy gjatë leximit të poezisë “Zogj dimri”?

Hapi 4: Punë në grupe

Grupi i parë: Pas leximit të poezisë “Luledielli”, nëpërmjet imagjinatës të krijojë një pikturë.

Grupi i dytë: Pas leximit të poezisë “Zogj dimri”, nëpërmjet imagjinatës të krijojë një pikturë.

Grupi i tretë: Pas leximit të poezisë “Ndërgjegje e gjymtuar”, nëpërmjet imagjinatës të krijojë një pikturë.

Grupi i katërt: Pas leximit të poezisë “Pritja jote”, nëpërmjet imagjinatës të krijojë një pikturë.

Detyrë:

Të mësojnë përmendsh një prej poezive dhe ta interpretojnë bukur atë.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Raporti i shkurtër informues		Situata e të nxënit: Raportet informuese	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -dëgjon, kupton të dhënat që prezantohen, kupton përfundimet; -dëgjon dhe vlerëson me sens kritik të dhënat e prezantuara nga raporti; -bën pyetje pas dëgjimit të parë; -kërkon përsëritjen e fragmenteve të veçanta për të qartësuar informacionin mbi të dhënat e paraqitura.		Fjalët kyçe: -raport; -raportim; -të dhëna; -fakte; -shifra.	
Burimet: mjete te teknologjisë, CD, regjistrime në video, materiale informuese rreth bibliotekave.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Kllaster -Dëgjim i drejtuar (DRTA) -Punë në grupe			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake Hapi i parë – Stuhi mendimi Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të bëjnë në grupe të vogla një kllaster për termin “raport” Më pas, mësuesi shfaq disa fragmente të shkruara në stile të ndryshme “raport, përmbledhje, recension” dhe kërkon që nxënësit të dallojnë tekstin që është raport. Kërkon të gjejnë edhe veçoritë, diferencat midis tyre. Nxirren në pah veçoritë e raportit: Shkrim me të dhëna të sakta, me grafikë dhe tabela, i qartë i kuptueshëm, i shoqëruar me fotografi dhe të dhëna me përfundime dhe gjetje.			
II. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë – DËGJIM I DREJTUAR-DRTA-Paraqitje me Power point <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesja jep të regjistruar ose lexon fragmente të një raporti që lidhet me bibliotekat. Kërkon nga nxënësit që ta ndjekin me vëmendje informacionin që lexohet. - Pasi përfundon leximin, mësuesi/ja e ndan raportin në fragmente dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme për çdo fragment. - Nd.1. Për çfarë teme bën fjalë raporti? - Si quhet projekti, rezultat i të cilit është ky raport? - Cili është qëllimi i këtij raportimi? - Nd.2 Cila është biblioteka e parë publike shqiptare? - Kur është krijuar dhe përruar ajo? - Cilat janë bibliotekat më të mëdha në Shqipëri? - Nd.3 Si u përgatit pyetësori? - Kush mori pjesë në realizimin e këtij pyetësori? - Sa rubrika kishte pyetësori? - Rikujtoni një nga pyetjet e pyetësorit? - Nd.4 Çfarë ndodh pas mbledhjes së përgjigjeve të pyetësorit? - Si u përpunuan të dhënat? - Nd.4 Nga të dhënat, sa është sipërfaqja bibliotekë/kokë njeri në rang vendi? - Duke parë grafikun 1. si ju duken të dhënat? 			

<ul style="list-style-type: none"> - Nd.5 - Si mund t'i interpretoni grafikët 2,3, Lexojini ata dhe interpretojini. - Nd. 6 Në lidhje me njerëzit me nevoja të veçanta, cilat janë gjetjet përmes pyetësorit? - Sa orë në javë është mesatarja e qëndrimit në biblioteka? - Nd. 7 Çfarë të dhënash dalin në pah për bibliotekat digjitale? - Çfarë të dhënash i mungojnë raportit? <p>III. Përforsim njohurish</p> <p>-Hapi i tretë: Punë në grupe dyshe</p> <p>Në punë me grupe dyshe përgatitet një material, nxënësit e prezantojnë dhe kërkojnë t'i bashkëngjitet raportit.</p> <p>Riformulim dhe plotësim përfundimesh</p> <ul style="list-style-type: none"> - Thoni 4 nga përfundimet e raportit që ju duken si më të rëndësishmet. Shumën e përfundimeve të gjetura renditeni sipas rëndësisë së tyre duke i vendosur me numra nga 1.....(çdonjëri shkruan 4 përfundimet që sipas tij janë më të rëndësishmet). - Bëjnë një listë me propozime të tjera për raportin për gjëra që duan të ndryshojnë në lidhje me bibliotekat. <p>Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1-2 orë</p> <p>Vlerësimet në situatë/Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dëgjim i drejtuar i raportit. - Nxjerrja në pah dhe krahasimi i raportit me gjini të tjera të shkruari. - Dëgjim i drejtuar dhe reflektim rreth raportit. - Interpretim dhe kuptim të dhënash. - Lexim tabelash dhe grafikësh. - Koment përfundimesh dhe propozime për shtesa apo heqje. <p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësohet si ore e arrirë dhe kompetenca të fituara, kur nxënësit marrin pjesë dhe dëgjojnë me vëmendje, kuptojnë të dhënat e paraqitura, propozojnë për ndryshime, japin ide dhe reflektojnë rreth materialit të dëgjuar.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p> <p><i>Shkruajnë një listë me përfundime për përmirësimin e punës në biblioteka.</i></p>
--

Data:

PLANIFIKIMI DËTOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Udhëzime, shpjegime, receta		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -dëgjon, kupton të dhënat që lidhen me udhëzime,shpjegime dhe përgatitje recetash; -reagon duke treguar se i kupton udhëzimet dhe shpjegimet; -mban shënime duke u mbështetur në materialet që dëgjon;		Fjalët kyçe: -dëgjim; -prezantim; -udhëzime; -shpjegime; -receta.	

<p>-mban mend receta dhe shpjegime në lidhje me përgatitjen e një plani pune apo instruksione për realizimin e një prezantimi.</p>	
<p>Burimet: mjete te teknologjisë, CD, regjistrime në video, teksti mësimor.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia • Qytetaria • Biologjia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Parashikim me terma paraprake -Punë e pavarur -Punë në grupe</p>	
<p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake Hapi i parë – (Parashikim me terma paraprake) Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të vërejnë me kujdes ilustrimet e mësimit dhe më pas u kërkon të parashikojnë se për çfarë bëhet fjalë duke i orientuar dhe përdorur edhe termat të tilla, si: shënim, udhëzim, recetë, projekt, prezantim. Mësuesi/ja u kërkon të ndërtojnë një histori të udhëhequr nga të vërejturit e ilustrimeve dhe termave që u dha për ndihmë. Ato mësuesi mund t'i shkruajë edhe në dërrasën e zezë. Nxënësit për pak minuta ndërtojnë historitë e tyre në lidhje me kërkesën e bërë nga mësuesi.</p> <p>II. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë – Dëgjim dhe punë e pavarur Mësuesi/ja shfaq një regjistrim nëpërmjet CD, në lidhje me ilustrimet e dhëna dhe kërkon që nxënësit të mbajnë shënime në fletore për ato që dëgjojnë. Më pas, për çdo figurë ata duhet të shkruajnë poshtë çdo ilustrimi atë që kanë dëgjuar për secilin prej tyre. Këtu kontrollohet vëmendja gjatë dëgjimit dhe niveli i të kuptuarit të materialit përmes të dëgjuarit.</p> <p>Hapi i tretë -Punë në grupe Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe dyshe dhe i fton të dëgjojnë një regjistrim tjetër në lidhje me disa shpjegime apo instruksione për mënyrën sesi mbillet një pemë. Secili nxënës në grup mban shënimet e tij. Më pas i qartësojnë dhe i rendisin sipas radhës dhe mënyrës së përdorimit. Njëri prej grupit e prezanton materialin. Në shënimet e mbajtura ata duhet t'i përgjigjen pyetjeve;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cili është veprimi i parë që bëhet para se të mbillni një pemë? - Cila është koha më e mirë për ta mbjellë? - Si duhet të veproni për ta përgatitur tokën për të mbjellë? - Cili është udhëzimi i fundit që dëgjuat ?....etj. <p>I. Përforsim njohurish Hapi i tretë - Punë në grupe dyshe Mësuesi/ja kërkon që nxënësi të dëgjojnë me vëmendje përsëri një regjistrim, apo lexim nga ana e saj, të disa udhëzimeve që duhet të ndiqen për një recetë gatimi. Së pari kërkon që pas dëgjimit nxënësit të shkruajnë saktësisht përbërësit e recetës, më pas veprimet që bëhen për realizimin e saj. Ajo kërkon si detyrë që ta zbatojnë në shtëpi, duke zbatuar udhëzimet dhe veprimtaritë praktike të njohura përmes dëgjimit.</p>	

<p>Vlerësimet në situatë/Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dëgjim i drejtuar i regjistrimeve në tre hapa. - Mbajtje e shënimeve mbështetur vetëm në regjistrimet e dëgjuara. - Përgjigje me shkrim të pyetjeve, mbështetur vetëm në regjistrimin e bërë. - Shkrimi i një liste përbërësish (recete gatimi)mbështetur në dëgjimin e regjistrimin. - Realizimi i detyrës praktike mbi bazë të udhëzimeve të marra dhe ndjekjes pikë për pikë të tyre.
<p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësohet si orë e arrirë dhe me kompetenca të fituara kur nxënësit marrin pjesë dhe dëgjojnë në mënyrë të vëmendshme, mbajnë shënime, të cilat vlerësohen si të sakta kur ata i shkruajnë dhe i prezantojnë.</p> <p>Realizimi i veprimtarisë praktike(projektit)jashtë klase flet për ndjekjen e vëmendshme të udhëzimeve dhe shpjegimeve, mbajtjes së shënimeve mbi bazë të dëgjimit të tyre.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p> <p><i>Zbatim i udhëzimeve të materialit të dëgjuar, p.sh: Gatujnë në shtëpi një kek duke respektuar shënimet e mbajtura mbi këtë recetë.</i></p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Argumente rreth përdorimit të internetit		Situata e të nxënit:	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Dëgjon, kupton të dhënat, dallon argumentin. -dallon argumentet kyçe; - përjashton argumentet që nuk përfshihen në materialin e dëgjuar; - reflekton duke mbajtur qëndrim ndaj argumenteve të sjella në ese; -ndjek me vëmendje dëgjimin e esesë dhe përgatit opinionin e vet për të marrë pjesë në bashkëbisedim. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> -argument; -internet; -kujdes; -opinion; -shpjegim; -kujtesë. 	
<p>Burimet: teksti mësimor, regjistrime, CD, materiale rreth autorit U.Eko.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia • Qytetaria 	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>-Minileksion -Punë në grupe –Projekt</p>			

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake

Hapi i parë – Minileksion

Mësuesi/ja pasi prezanton nxënësit me temën i informon dhe lexon një material nga jeta e Umberto Ekos.

Umberto Eko (lindur më 5 janar 1932) është një studiues italian filozof, kritik letrar dhe novelist, më së shumti i njohur për romanin “Emri i Trëndafilut” i botuar në vitin 1980. Ai ka shkruar gjithashtu tekste akademike, libra për fëmijë dhe shumë ese. Ai punoi si redaktor kulture te Radio Televizioni i Italisë (RAI) dhe si profesor në Universitetin e Torinos.

Veprat

Kryevepra e tij “Emri i Trëndafilut” u publikua në vitin 1980. Uilliami i Baskervillit, personazhi kryesor është një anglez i prirur nga logjika me pasion për librat dhe që më pas verbohet nga ky pasion. Personazhi i referohet Jorge Luis Borges, i cili ka ushtruar ndikim të madh te Eko. Borges bëri një jetë murgu dedikuar pasionit të tij për librat deri sa u verbua. Misteri që shoqëron vrasjet në manastir është huazuar nga Përrallat Arabe, “Një mijë e një net”. Më pas kërkon që nxënësit komentojnë materialin që dëgjuan. Mësuesi/ja mirëpret pyetje nga nxënësit.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – (Dëgjim i drejtuar)

- Mësuesi/ja shfaq regjistrimin/ose lexon esenë e U.Ekos: “Përdor kujtesën” me hapa. Pas çdo ndalesë bën pyetje për nxënësit.
- **Nd 1.** Cila është këshilla e parë? A ka të drejtë autori për këtë këshillë? Sa jeni dakord dhe sa jo me këtë këshillë/Argumentoni mendimin.
- **Nd 2** Pse e quan sëmundje mënyrën sesi përdoret interneti nga të rinjtë? A jeni dakord ?
- **Nd3** Pse e quan humbje të kujtesës? Si e kupton shprehjen: ”ke humbur shijen e të nxënësve”?
- **Hapi i tretë- Punë e pavarur**
- Mbi bazë të të vërejturit të fig të ushtrimit 2, f. 146, nxënësit gjejnë dhe argumentojnë pse imazhi që kanë zgjedhur lidhet me përmbajtjen e letrës.

II. Përforsim njohurish

Hapi i tretë - Punë në grupe dyshe, Pyetje- përgjigje në grupe të vogla.

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të ndarë në grupe dyshe t’i japin përgjigje pyetjeve të ushtrimeve 3,4,5,6,7. Mësuesi/ja këshillon që gjatë kohës që japin përgjigje të sjellin sa më shumë argumente. Njëkohësisht të bëjnë edhe pyetje të tjera për të cilat ata kanë nevojë të dinë më shumë informacion

Vlerësimet në situatë/Veprimet në situatë

- Dëgjim dhe kërkim informacioni plus.
- Dëgjim dhe kërkim argumenti.
- Përgjigje të shoqëruara me argumente ndaj pyetjeve që u drejtohen.
- Ndjekje me vëmendje gjatë dëgjimit të esesë.
- Dëgjim dhe reflektim ndaj argumenteve të sjella nga eseja për çështjen e përdorimit të internetit.
- Dhënie opinionesh vetjake.

Vlerësimi:

Vlerësohet si orë e suksesshme, së pari nga pjesëmarrja e nxënësve në debatin që hap kjo temë, nga opinionet dhe argumentet që ata përcjellin në lidhje me këtë temë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkojnë dhe gjejnë informacione të tjera për U Ekon. Lexojnë dhe përmbledhin variantin e plotë të esesë.

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË FOLURIT

Data

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Interesat e mia		Situata e të nxënimit: Flasin rreth interesave dhe dëshirave tona	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjua, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to; -jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon; -reagon kundërshton ose pranon sugjerime nga materialet e dëgjua; -miraton propozime për punë që duhen bërë në bashkëpunim.		Fjalët kyçe: -interesa; -dëshira; -të mësuar; -lexim; -shkrim; -imagjinatë.	
Burimet: mjete te teknologjisë CD, regjistrime video.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metoda dhe teknika -Stuhi mendimi -Punë në grupe -Karrigia e autorit -Konkurs -Rrjet diskutimi			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake Hapi i parë – Stuhi mendimi Prezantohet tema e mësimt nga mësuesi/ja: “Interesat e mia” dhe më pas kërkon që nxënësit të shprehin lirshëm rreth temës. Dëgjojnë njëri-tjetrin mbi interesat dhe dëshirat që kanë për të sotmen dhe të ardhmen. Shprehin miratim në forma të ndryshme.			
II. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë – (dëgjim regjistrimi/përshkrim situatash me gojë nga një nxënës ose mësues) Koha (rreth 10 min) Ushtrimi 1 i librit f.10 Mësuesi/ja kërkon vëmendje nga nxënësit për të dëgjuar situatat e regjistruara (ose që lexohen) që lidhen me botëkuptimin dhe interesat e tyre në lidhje me lojën, të lexuarin dhe të shkruar. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje. Bëjnë pyetje në rast se duan të plotësojnë apo kërkojnë ndonjë sqarim.			
Hapi i tretë – (teknika: karrigia e autorit) Koha rreth 15 min, usht 2 i librit f.10. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të shprehin interesat e tyre për librat që lexojnë duke shkruar në një letër titullin e një libri që kanë lexuar. E dorëzojnë fletën. Mblidhet të gjitha dhe kthehen mbrapsht. Një nxënës tërheq njërin prej tyre. Zbulohet titulli i librit dhe nxënësi që e ka lexuar..Këtu fillon teknika “karrigia e autorit” Nxënësi që e ka lexuar librin del para klasës dhe prezanton përmbajtjen e librit, gjërat që i kanë pëlqyer dhe problematika të tjera që i kanë dalë përpara. Prezanton edhe aspekte nga jeta e autorit. Nxënësit e tjerë pasi e kanë dëgjuar me vëmendje bëjnë pyetje dhe kërkojnë sqarime.			
Hapi i tretë-(teknika : (Punë në grupe dyshe) koha : rreth 10 min, ushtrimi 2 i librit, f.10. A. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të organizohen në grupe ose më shumë dhe kërkohet të shprehin projektin e tyre në lidhje me një model biblioteke të shkollës, personale, të lagjes etj. Nxënësit e tjerë në grup dëgjojnë njëri- tjetrin për propozimet bëjnë pyetje dhe kërkojnë sqarime.			

<p>B . Një grup tjetër diskutojnë së bashku rreth kërkesave të ushtrimit 4 në lidhje me të mësuarit.</p> <p>III. Përforsim njohurish</p> <p>-Hapi i katërt (teknika konkurs dhe punë në grupe)</p> <p>Dëgjohen recitimet nga secili nxënës, bëhen vlerësime. Punohen në grupe ushtrimet (6,7,8). Përshkruajnë cilësi dhe tipare personale në lidhje me interesat dhe dëshirat.</p>
<p>Vlerësimet në situatë/Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanë shprehur ide rreth interesave dhe kanë dëgjuar me vëmendje njëri-tjetrin - Kanë ndjekur me interes regjistrimet në lidhje me interesat e disa bashkëmoshatarëve dhe bëjnë krahasime me veten. - Kanë dëgjuar njëri tjetrin në grup dhe janë shprehur në lidhje me interesat e tyre - Kanë dëgjuar rrëfime dhe mbi bazë të tyre kanë bërë pyetje për shtim informacioni apo sqarime të mëtejshme - Kanë bërë interpretime dhe kanë dhënë vlerësime për mënyrën e recitimit të çdonjërit.
<p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësimi i mënyrës së të folurit dhe të recituarit nga nxënësit për njëri- tjetrin duke shprehur edhe përmes një grafiku, i cili është rezultat i të gjitha hapave të zhvilluara gjatë kësaj ore mësimi.</p> <p>Vlerësohet si e arrirë kjo orë mësimi kur nxënësit kanë treguar vëmendje dhe kanë reflektuar ndaj informacioneve të përcjella përmes pajisjeve teknologjike apo dëgjimit të drejtpërdrejtë të njëri –tjetrit. Nxënësit kanë kuptuar idetë dhe ndjenjat e tyre rreth interesave në lidhje me lojën, leximin ,shkrimin recitimin etj.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p> <p><i>Ushtrimi 10,11. Punimet ruben në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.</i></p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Elemente të gjuhës së folur dhe të shkruar		Situata e të nxënit: Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet; - merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura; - pyet dhe i përgjigjet pyetjeve të drejtuara; 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> -komunikim; -gjuhë e folur; -gjuhë e shkruar; -situata e të folurit; -shenja; -simbole; -kode; -fjalë; 	

<ul style="list-style-type: none"> - bashkëbisedon për tema të caktuar duke argumentuar; - dallon mënyra dhe forma komunikimi. 	<ul style="list-style-type: none"> -skemë komunikimi; -mesazhi, dhënësi, marrësi;
<p>Burimet: teksti mësimor,CD, regjistrime, videoprojektore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimi -Punë në grupe -Punë me grupe ekspertësh 4-she - Minileksion</p>	
<p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i parë – Stuhi mendimi Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të vërejnë fig. e ushtrimit 1 f.13 dhe të flasin për mënyrat e komunikimit të fëmijëve në ilustrimet e paraqitura. Më pas ata shprehen (me shkrim apo me gojë). Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të shprehen për pëlqimet e tyre rreth komunikimit me të tjerët. <p>II. Zhvillimi i situatës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i dytë – Punë në grupe - Pasi mësuesi ka ndarë klasën (në grupe dyshe) kërkon që nxënësit në grupe të krijojnë dhe interpretojnë dialogje për situatat e ngritura në ushtrimin2. (Gr 1: <i>dikush kërkon ndihmë...</i> Gr 2: <i>ka ndodhur një aksident</i>; Gr 3: <i>ka rënë zjarr...</i> Pasi grupet interpretojnë dialogjet, mësuesi/ja kërkon që nxënësit t'i vlerësojnë ato për qartësinë e shprehjeve, mimikën dhe pantomimikën, tonin e zërit, zgjidhjet që u japin situatave të ndryshme (ushtrimi 3 i librit f.13.) <p>Hapi i tretë- Punë me grupe ekspertësh 4-she, Minileksion Mësuesi/ja i organizon në grupe katërshe sipas teknikës <i>Punë me grupe ekspertësh</i> dhe çdo grupi i jep të studiojë informacionin e pjesës së dytë të faqes13. Grupi 1- Mësoni më tepër për komunikimin. Grupi 2- Simbolet. Grupi 3- Komunikimi përmes gjuhës. Grupi 4- komunikimi me shenja. Më pas një nxënës për çdo grup prezanton informacionin e kërkuar, mësuesi/ja kërkon që secili grup të mbrojë vlerat e temës së vet duke nxjerrë në pah përparësitë e çdo mënyre komunikimi. (Bëhet një garë përmes grupeve). Mësuesi/ja prezanton skemën e komunikimit.</p> <p>Hap i katërt (Shpjegim) Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të vizatojnë skemën e komunikimit dhe ta komentojnë atë. Shpjegon termat që lidhen me komunikimin të tilla, si: dhënësi, kodi, kanali, mesazhi, marrësi.</p> <p>I. Përforsim njohurish</p> <p>Hapi i pestë – Punë në grupe dyshe, Punë e pavarur</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punohet ushtrimi 6 f.14 nxënësit përcaktojnë elementet e situatave të komunikimit të paraqitura në ilustrimet e ushtrimit 6.f.14. - Punohet ushtrimi 7. F14. - Nxënësit këmbëjnë dhe vlerësojnë skemat e komunikimit që kanë ndërtuar. 	

- Çdo grup bën një skemë për njërën prej situatave të komunikimit të ushtrimit 7.
Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1orë
Veprimet në situatë <ul style="list-style-type: none"> - Dëgjim i drejtuar i regjistrimeve në tre hapa. - Mbajtje e shënimeve mbështetur në regjistrimet e dëgjuara. - Përgjigje me shkrim e pyetjeve mbështetur në regjistrimin e bërë. - Realizimi i ushtrimeve mbi bazën e udhëzimeve të marra dhe ndjekjes pikë për pikë të tyre.
Vlerësimi: Vlerësohet si orë e arrirë dhe me kompetenca të fituara kur nxënësit marrin pjesë dhe dëgjojnë në mënyrë të vëmendshme, mbajnë shënime, të cilat vlerësohen si të sakta kur ata i shkruajnë dhe i prezantojnë. Realizimi i veprimtarisë praktike (projektit) jashtë klase flet për ndjekjen e vëmendshme të udhëzimeve dhe shpjegimeve dhe mbajtjes së shënimeve mbi bazë të dëgjimit të tyre.
Detyrat dhe puna e pavarur: <i>Ushtrimi 8</i> Bashkëbisedoni për temën: <i>Kompjuteri dhe të mësuarit (në lexim, në shkrim, në zgjidhje problemash etj.).</i>

Data:

PLANIFIKIMI DËTOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Vajza dhe djem		Situata e të nxënit: Marrëdhëniet mes vajzave dhe djemve	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -përshtat të folurën e tij sipas situatës së ngritur në libër për të komunikuar; -merr pjesë në diskutim dhe jep ide; -përfshihet emocionalisht në diskutime që lidhen edhe me çështje vetjake. -argumenton për çështje që lidhen me etiketimet e profesioneve sipas gjinisë (vajzë–djalë).		Fjalët kyçe: -bashkëbisedim; -konflikt; -zgjidhje; -argument; -ide, opinion; -mirëkuptim.	

Burimet: teksti mësimor, CD, regjistrime, videoprojektor.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetaria
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Situata rasti -Rrjet diskutimi -Punë në grupe	
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i parë – Stuhi mendimi - Mësuesi/ja u drejton nxënësve një pyetje “Si e kuptoni bashkëjetesën me njëri - tjetrin në shkollë?” - Kërkon që nxënësit të përgjigjen duke ilustruar me shembuj, raste të problematikave që iu lindin. II. Zhvillimi i situatës <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i dytë – Rrjet diskutimi Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të lexojnë fragmentin e ushtrimit 1, më pas të thonë se kujt i japin të drejtë. Vajzës?Djalit? Pasi nxënësit shprehen, organizohet rrjeti i diskutimit. Grupi <i>pro</i> djalit, bashkohen bashkë dhe grupi <i>pro</i> vajzës bashkohen më vete. Japin mendime pro dhe kundra qëndrimeve të tyre në lidhje me problemin që kanë këta dy fëmijë. Ky hap përfshin edhe ushtrimin 1. - Hapi i tretë- Punë me grupe ekspertësh 4-she, Minileksion Mësuesi/ja udhëzon që në grupe 4-she të diskutojnë rreth marrëdhënieve që kanë me shokët e tyre dhe se sa keq ndjehen, nëse dikush vë në lojë për tipare të veçanta: flokët, ngjyrën e lëkurës, mënyrën e të ecurit etj. (Ushtrimi 3) - Hapi i katërt: Punë në grupe Punohet ushtrimi 5, 6 në tekst. II. Përforsim njohurish Hapi i pestë – Punë me grupe ekspertësh Nxënësit argumentojnë rreth profesioneve për vajza/djem dhe bëjnë propozime. Diskutojnë edhe për sportet për djem e vajza. Sjellin argumente rreth këtyre problematikave që lidhen me çështjen djem-vajza. Punohet dhe diskutohet edhe shprehja e ushtrimit”Bota është një fshat i vogël.” Ideja e kësaj thënieje synon që nxënësi ta zërthejë në këtë mënyrë: Falë teknologjisë njerëzit komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme. Ata ndjehen afër njëri-tjetrit, si kurrë më parë. Komunikimi dhe afrimiteti, ashtu sikur në një fshat të vogël, sjell mungesën e largësisë dhe funksionimin si një grup unik, të gjithë së bashku pa dallime gjinore, raciale, fetare, sociale.	
Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1orë	
Vlerësimet në situatë Veprimet në situatë <ul style="list-style-type: none"> - Shprehin mendime në lidhje me çështje të caktuara. - Gjejnë argumente në lidhje me temën djem-vajza. - Flasin për dallimet dhe paragjykimet vajza-djem. - Mbajnë qëndrime rreth çështjes së diskriminimit për arsye, race, feje, apo për fëmijët me nevoja të veçanta. 	
Vlerësimi: Kjo temë quhet e realizuar kur nxënësit në përgjithësi kanë shprehur opinionet dhe argumente që lehtësojnë dhe mundësojnë vendosjen e marrëdhënieve humane mes njëri-tjetrit dhe respektimin	

e të drejtave të barabarta mes vajzave dhe djemve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

1.Projekti i ushtrimit në fund të faqes dhe:

një listë/ tabelë me profesionet/ sportet e djemve, vajzave dhe djemve –vajzave

<i>Profesione vetëm për djem</i>	<i>Profesione për djem e vajza</i>	<i>Profesione vetëm për vajza</i>
<i>Sporte vetëm për djem</i>	<i>Sporte për djem e vajza</i>	<i>Sporte vetëm për vajza</i>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ju dhe të lexuarit		Situata e të nxënit: Librat dhe leximi	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -jep ide vetjake për mënyrën dhe marrëdhëniet që ka me librat; -iu përgjigjet pyetjeve të një anketë duke dhënë përgjigje të zgjeruara. -shpreh opinione me pëlqim ose mospëlqim për librat që lexon. -përshkruan sjellje dhe mënyra vetjake të lexuari. -përshkruan personazhe (heronjtë e tyre) të librave që ka lexuar, duke shprehur opinione dhe cilësi të veçanta të tyre. -jep argumente pse do t'i ngjajë personazhit në fjalë.		Fjalët kyçe: -lexim; -dëshirë; -libër; -titull; -argument, ide, opinion; -personazh; -fabul, legjendë, përrallë,roman, fantastik-shkencor, dramë, tragjedi, komedi.	
Burimet: teksti mësimor, libra, filma,CD, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria • Arti 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Pyetje përgjigje -Plotësim dhe analizë ankete -Rrjet diskutimi			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i parë – Stuhi mendimi - Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të përshkruajnë ilustrimet e ushtrimit 1. - Nxënësit përshkruajnë personazhet në figura, mënyrat e tyre të të lexuarit. 			

<p>– Japin mendime për mënyra të shëndetshme të qëndrimit gjatë procesit të të lexuarit.</p> <p>II. Zhvillimi i situatës</p> <p>– Hapi i dytë – Plotësim ankete: pyetje- përgjigje Nxënësit plotësojnë kërkesat e ushtrimit 2, 3 të cilat lidhen me pjesë të anketës dukutojnë dhe argumentojnë përgjigjet e tyre në lidhje me kërkesat e ushtrimeve.</p> <p>Hapi i tretë- Punë me grupe ekspertësh 4-she Të ndarë në grupe nxënësit diskutojnë për kohën që shpenzojnë për të lexuarin, japin opinione dhe mbështesin ose jo mendimet e njëri-tjetrit.</p> <p>III. Përforsim njohurish</p> <p>Hapi i katërt – Punë me grupe ekspertësh Nxënësit të ndarë në grupe ekspertësh përshkruajnë personazhin e tyre më të dashur, si dhe librin në të cilin ai prezantohet. Argumentojnë pse e pëlqejnë dhe pse e kanë heroin e tyre. Shpjegojnë pse duan t'i ngjajnë atij.</p>
Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1 orë
<p>Veprimet në situatë</p> <p>-Përshkruhen sjellje që kanë të bëjnë me zakonet e të lexuarit.</p> <p>-Plotësohet anketa dhe nxënësit diskutojnë rreth saj, japin mendime dhe opinione.</p> <p>-Diskutojnë rreth kohës që shpenzojnë për të lexuarin.</p> <p>-Përshkruajnë personazhe.</p> <p>-Japin pëlqime dhe bëjnë krahasime.</p>
<p>Vlerësimi i situatës</p> <p>Tema quhet e realizuar kur të gjithë nxënësit kanë marrë pjesë aktivisht duke përshkruar zakonet e tyre të të lexuarit, personazhet që pëlqejnë më tepër dhe duke dhënë mendime rreth llojeve të ndryshme të teksteve letrare që ata lexojnë. Shprehen se si organizohet dita e tyre në raport me të lexuarin.</p>
<i>Detjre: Lista e librave të lexuara gjatë vitit. Përshkrimi i dy prej tyre (përmbajtja, personazhet).</i>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Angazhimi ynë në komunitet		Situata e të nxënit: Angazhimi ynë në komunitet: kujdesi për kafshët dhe mjedisin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	

<p>Nxënësi/ja: -jep ide vetjake për mënyrën e organizmit të jetës në komunitet dhe marrëdhëniet në të; -shpreh opinione me pëlqim ose mospëlqim për mënyrat e mbajtjes së kafshëve në komunitetin ku jeton; -përshkruan lidhjen e kafshëve me njeriun; -përshkruan vepra arti që lidhen me kafshët; -përshkruan lojëra elektronike që kanë si personazh kafshët.</p>	<p>-angazhim; -kontribut; -përfshirje; -qytetari; -kopshte zoologjike.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, libra, filma, CD, videoprojektor.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria • Arti • Biologjia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p style="text-align: center;">-Pesëvargësh -Rrjet diskutimi -Veprimtari praktike në komunitet</p>	
<p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i parë – Pesëvargësh - Bëni një pesëvargësh për kafshën tuaj më të dashur. \lexojeni para të tjerëve <i>Emër</i> <i>Mbiemër+mbiemër</i> <i>Folje+folje\ =folje</i> <i>Fjali me katër fjale</i> <i>Fjalë sinonime me vargun e parë.</i> - Tregojnë përvoja personale si sillen me kafshën e tyre të dashur. <p>II. Zhvillimi i situatës</p> <p style="padding-left: 40px;">Hapi i dytë - Rrjet diskutimi Klasa e ndarë në dy grupe të mëdha diskuton për marrëdhëniet e njerëzve me kafshët, për qytetarinë e njerëzve në sjelljet e tyre me kafshët (usht 4,5)</p> <p style="padding-left: 40px;">Hapi i tretë -Punë në grupe Përshkruajnë mesazhet që përcjellin kafshët në art, pikturë,skulpturë etj ushtrimi 6)</p> <p>IV. Përfundim njohurish</p> <p>Hapi i tretë – Veprimtari në komunitet Njohja me kafshët që bashkëjetojnë në komunitetin e tyre, organizimi i një panairi ku të prezantojnë kafshët shtëpiake të komunitetit.</p>	
<p>Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1orë</p>	
<p>Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përshkruajnë ilustrime dhe argumentojnë për çështjet që trajtohen përmes tyre. -Përshkruajnë kafshë shtëpiake dhe sjellje të njerëzve në lidhje me to: dashurinë, kujdesin, 	

mirëmbajtjen etj.

-Argumentojnë mesazhe që përcjellin veprat e arit në qendër të të cilave janë kafshët në dobi të tyre.

-Përshkruajnë raportet e njeriut me botën e kafshëve.

-Kryejnë veprimtari në komunitet në lidhje me mirëmbajtjen e kafshëve shtëpiake.

Vlerësimi:

Kjo temë është e realizuar kur nxënësit kanë përshkruar raportet e tyre me kafshët, jetën e kafshëve në komunitetin ku ata jetojnë, përshkrimin e veprave të artit ku janë përshkruar kafshë të ndryshme dhe realizimin e një projekti në komunitet, përmes të cilit kanë dhënë një mesazh për mbrojtjen e jetës së kafshëve në komunitet.

Detyrë: Njihuni me kafshët që bashkëjetojnë në komunitetin tuaj, organizoni një veprimtari në komunitet *Panair* (me parakalimin e kafshëve shtëpiake, të prezantuara me veshje apo zbukurime të tjera). Projekt: Organizoni një veprimtari me temë “Mbroni dhe ndihmoni kafshët”. Secili nga ne mund të bëjë një ndryshim duke mbrojtur jetën e kafshëve në komunitetin ku bën pjesë. Diskutoni në grupe për të gjetur mënyrat e duhura, të cilat mund t’i shpëtojnë kafshët nga jeta e rrugës dhe keqtrajtimi. Falë jush, jeta e tyre mund të bëhet më e mirë.

Shënim: Kujtesë për orën e ardhshme: Gjeni poezi të autorëve: Lasgush Poradeci, Ali Podrimja, Visar Zhiti, Arjan Leka etj, dhe sillini ato në klasë. (Në funksion të orës në vijim: Konkurs poezie)

Data:

PLANIFIKIMI DËTOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Konkurs poezie		Situata e të nxënit: Interpretojmë poezi	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -reciton dhe interpreton poezi të ndryshme; -diskuton për brendinë e poezive; -diskuton rreth gjuhë së poezive të interpretuara; -komenton vargje poetike; -përshkruan mbresat dhe ndjesitë që përjeton nga leximi ose recitimi i një poezie.		Fjalët kyçe: -poezi; -ndjenjë; -ndikim; -varg; -mbresa; -konkurs.	

<p>Burimet: teksti mësimor, libra me poezi, videoprojektor.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria • Arti
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p style="text-align: center;">-Stuhi mendimi -Interpretim/Konkurs -Punë në grupe -Punë me grupe ekspertësh</p>	
<p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i parë – Stuhi mendimi - Mësuesi/ja iu drejton nxënësve pyetjen: Përse flasim për poezinë ? - Nxënësit japin përgjigje të ndryshme ashtu si ata i mendojnë. <p style="text-align: center;">II. Zhvillimi i situatës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i dytë – Konkurs - Mësuesi/ja organizon një konkurs ku të gjithë nxënësit do të përgatisin një apo dy strofa nga një poezi e autorëve Lasgush Poradeci, Ali Podrimja, Visar Zhiti etj, poezitë e të cilëve i kanë sjellë në klasë dhe nxënësit zgjedhin vetë autorin që pëlqejnë. - Pasi i kanë përgatitur dhe lexuar që më parë sipas radhës, nxënësit i interpretojnë ato. Bëhen vlerësime mbi mënyrën e recitimit ... Ndahen certifikata vlerësuese dhe çmime. <p style="text-align: center;">Hapi i tretë- Punë në grupe</p> <p>Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë rreth problematikave që ngrihen në ushtrimin 1.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Brendisë së poezive që lexuan. - Titujve të poezive. - Figurave letrare. - Mesazheve që përcjellin. - Mbresave që u lindin gjatë dëgjimit të poezive që konkurruan. <p style="text-align: center;">Përforcim njohurish</p> <p>Hapi i pestë – Punë me grupe ekspertësh</p> <p>Njihen më këshillat për poezinë dhe diskutojnë rreth tyre në grup. Më pas kur kthehen në grupet bazë i shpjegojnë këto këshilla.</p>	
<p>Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1orë</p>	
<p>Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Flasin për poezinë - Interpretojnë dhe recitojnë poezi. - Japin vlerësime për poezitë që dëgjuan, të interpretuara nga shokët. - Marrin dhe japin këshilla për dëgjimin e poezisë. 	
<p>Vlerësimi:</p> <p>Kjo situatë mësimore quhet e arrirë kur të gjithë nxënësit janë pjesëtarë aktivë nëpërmjet të folurit rreth poezisë, marrin pjesë në konkursin e poezisë, vlerësohen dhe vlerësojnë të tjerët për interpretimet e tyre, marrin dhe japin këshilla në lidhje me poezinë.</p>	
<p>Detyrë: Projekt për përgatitjen e një pasditeje poetike.</p>	

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përgjegjësitë dhe të drejtat tona		Situata e të nxënit: Të drejtat dhe e detyrat e fëmijëve	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -diskutojnë dhe vlerësojnë qëndrimet e bashkëmoshatarëve për probleme të përbashkëta. -iu përgjigjen pyetjeve të ngritura për një diskutim tematik. -vlerësojnë dhe japin mendime për përmirësimin e zbatimit të të drejtave dhe detyrave të tyre.		Fjalët kyçe: -diskutim; -rregullore; -situatë; -dokument.	
Burimet: teksti mësimor, libra, rregullore, udhëzime.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria • Arti 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Kllaster -Diskutim rreth një situatë -Rrjet diskutimi -Punë me grupe ekspertësh			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake <ul style="list-style-type: none"> - Hapi i parë – Mësuesi/ja nxit të folurin e nxënësve duke iu kërkuar të plotësojnë një kllaster në grup rreth termave rregullore dhe të drejta, përgjegjësi. II. Zhvillimi i situatës: Punë në grupe dhe rrjet diskutimi në grup rreth situatave 1, 2. Hapi i dytë: Punë në grupe <i>Grupi 1, 3, diskutojnë rreth situatës 1</i> <i>Grupi 3, 4 diskutojnë rreth situatës 2</i> Pasi zhvillohen diskutimet në grup, një përfaqësues i grupit jep qëndrimet në emër të grupit. Mund të marrin pjesë në diskutim edhe nxënës të tjerë, të cilët duan të shtojnë diçka. Hapi i dytë- Punë në grupe, Pyetje- përgjigje Në grupe të ngritura, nxënësit iu japin përgjigje çështjeve që lidhen me: -Të drejtat e nxënësve. -Përgjegjësitë e tyre. -Çështje të rregullores së shkollës.			
III. Përforcim njohurish Hapi i pestë – Punë me grupe ekspertësh Nxënësit rishikojnë rregulloren e shkollës dhe e plotësojnë me nene të tjera. Për këtë diskutojnë në grupe ekspertësh. Çdo grup punon me një nen të rregullores. Ata e diskutojnë dhe propozojnë shtesa të mundshme.			
Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1orë			
Veprimet në situatë -Diskutojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.			

<p>-Argumentojnë me qëndrime pro dhe kundër rreth sjelljeve të nxënësve të ngritura në situatat 1, 2.</p> <p>-Analizojnë rregulloren e shkollës.</p> <p>-Bëjnë shtesa dhe heqin nene në rregulloren aktuale.</p> <p>-Propozojnë ndryshime.</p>
<p>Vlerësimi</p> <p>Është një mësım i arrirë kur nxënësit kanë marrë pjesë aktivisht në analizën e situatave, kanë bërë propozime për përmirësimin e dokumentacionit të shkollës (rregulloren e saj) duke shprehur qëndrime për përmirësim të mëtëjshëm.</p>
<p>Detyrë: Shkruajnë një përmbledhje me propozime për rregulloren e shkollës pas diskutimeve që kanë bërë.</p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Komunikimi në një mjedis virtual		Situata e të nxënit: Teknologjia	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <p>-diskuton rreth mënyrave të reja të komunikimit;</p> <p>-shpjegon konceptin mbi rrjetet sociale;</p> <p>-diskuton për përfshirjen e tij/saj në rrjetet sociale;</p> <p>-argumenton për anët pozitive dhe negative të fushës së elektronikës në komunikim.</p>		<p>Fjalët kyçe:</p> <p>-komunikim virtual;</p> <p>-komunikim global;</p> <p>-rrjet social;</p> <p>-universale;</p> <p>-komunikim me kode;</p> <p>-kompjuter;</p> <p>-truri.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, celular, lap top, videoprojektor.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teknologjia 	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>-Diskutim -Power point -Rrjet diskutimi -Punë me grupe me grupe ekspertësh</p>			

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**I. Veprimtari paraprake****Hapi i parë – Diskutim i lirë**

-Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të diskutojnë në grupe të vogla dyshe për mënyrat alternative të komunikimit. Orientohen nga figurat e ushtrimit 1. Nxënësit flasin dhe argumentojnë.

II. Zhvillimi i situatës**Hapi i dytë – Rrjet diskutimi në grupe 4-she**

Grupi 1, 3, diskutojnë për kërkesën e ushtrimit 2.

Grupi 3,4 diskutojnë rreth situatës 3.

Pasi bëhen diskutimet në grup, një përfaqësues i grupit jep qëndrimet në emër të grupit.

Hapi i tretë- rrjet diskutimi

Mësuesi organizon klasën në dy grupe të mëdha dhe kërkon pre tyre të diskutojnë rreth kërkesës së ngritur në ushtrimin 4. (Studimet tregojnë se të rinjtë janë të prirë drejt komunikimit të shkurtër dhe me kode. Pse

kjo tendencë? Argumentoni.)

Nxënësit, pasi shpjegojnë fenomenin, japin argumente pro dhe kundra rreth kësaj situate.

III. Përforcim njohurish**Hapi i pestë – Punë me grupe ekspertësh**

Nxënësit komentojnë figurën dhe flasin për rrjetet sociale, japin pëlqimin e tyre dhe flasin për mënyrat e përdorimit të internetit.

Koha mësimore: Sugjerohet që kjo situatë të zhvillohet 1orë

Veprimet në situatë

- Diskutojnë rreth komunikimit përmes rrjeteve sociale.
- Argumentojnë me qëndrime pro dhe kundër përdorimit të tyre në mjedise publike, në shkollë dhe në familje.
- Përshkruajnë mënyra alternative të përdorimit virtual, shprehin pëlqime ose jo.
- Japin argumente në lidhje me komentet e U. EKOS në lidhje me përparësinë e trurit të njeriut ndaj kompjuterit.
- Diskutojnë rreth rrjeteve sociale.

Vlerësimi:

Pjesëmarrja e nxënësve në diskutime, përfshirja emocionale e tyre dhe me argumente, janë një komponent që flet për një arritje të orës së mësimit. Gjithashtu qëndrimet e tyre dhe përshkrimi i sjelljeve vetjake, që kanë, në lidhje me komunikimin në botën e sotme virtuale janë një element tjetër që flet për kthimin e botës virtuale së tyre në një komponent që iu shërben për të mësuarin e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës.

Detyrë

Përgatitni një diskutim me temë: Mjetet moderne të komunikimit, mundësi dhe sfidë.

Organizoni diskutimin tuaj mbështetur në argumente dhe pika kyçe.

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË SHKRUARIT

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë një rrëfim personal		Situata e të nxëniet: Shkrimi i një rrëfimi (tregimi të shkurtër)	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç <ol style="list-style-type: none"> 1) kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2) kompetenca e të nxëniet; 3) kompetenca e të menduarit; 4) kompetenca qytetare. 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan një ngjarje nga jeta e tij duke iu përmbajtur elementeve të strukturës së rrëfimit; - respekton rregullat e drejtshkrimit gjatë shkrimit të rrëfimit; - vlerëson rrëfimet e bëra nga shokët e tij. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> -rrëfim; -strukturë; -hyrje; -zhvillim; - pikë kulmore; -mbyllje; -paragraf; 	
Burimet: teksti mësimor, rrëfime të nxënësve nga jeta e tyre etj., një tabelë me skemën e strukturës së tregimit, një tabelë e plotësuar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e drejtuar +punë në grupe; Punë e drejtuar -Harta e konceptit Punë e pavarur - Diskutim			
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>- Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Punë e drejtuar +punë në grupe: -Ç’do të thotë të rrëfesh? Si i kuptoni ju fjalët” rrëfim personal”?</p> <p><u>Punë në grupe. Tek tregimi “Çmimet”:</u> Gr.1: Gjeni hyrjen dhe tregoni të dhënat që jepen tek ajo, duke iu përgjigjur pyetjeve: Kush?, Ku?, Kur? Gr.2. Tregoni veprimet kryesore tek zhvillimi: Si nisi veprimi? Si vazhdoi? Ku është pika kulmore? Gr. 3: Çfarë shkruhet tek mbyllja?</p> <p>- Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar+harta e konceptit -Si ndërtohet rrëfimi? Ç’duhet të paraqesim në hyrje? Po te zhvillimi? Po tek mbyllja? -Sa paragrafë zë hyrja? Po zhvillimi ç’vend duhet të zërë në raport me hyrjen? Po mbyllja?</p> <div style="text-align: center; margin-top: 20px;"> <pre> graph TD A[Ndërtimi i rrëfimit] --> B[HYRJA -Zë një paragraf -Kush?, Ku?, Kur?] A --> C[ZHVILLIMI -Zë të paktën 3 paragrafë -Si zuri fill ngjarja? -Veprimet vazhduese të ngjarjes -Pika kulmore] A --> D[MBYLLJA -Zë një paragraf -Zgjidhja e problemit -Mbyllja si mesazh, përfundim, përjetim] </pre> </div>			

<p><u>Lexim i drejtuar i tekstit. Sqarime për pyetjet e nxënësve.</u> Demonstrimi i rezultateve të arritura + diskutim. <u>Punë e pavarur me shkrim. Ftesë për të krijuar tregimin tuaj</u> <i>Rrëfimi për një ndodhi të veçantë...</i> - Në familje ndihesh mirë, por herë pas here të ndodh të diskutosh apo debatosh me dikë prej pjesëtarëve. - Në ato rrethana do kishit dashur “të vepronit sipas kokës suaj.. - Një dështim në shkollë ju ka mësuar të bëheni më syçelët.. - Ajo ishte dita kur keni pasur vërtet fat..</p>
<p>Nxënësit janë të lirë të zgjedhin një nga temat e dhëna ose një temë tjetër që kanë dëshirë. Nxënësit duhet të hartojnë sipas modelit të dhënë një rrëfenjë personale nga përvoja e tyre Nëse nxënësit mbarojnë, mund të lexohen disa prej punëve të tyre, ku nxënësit do të diskutojnë mbi ndërtimin e rrëfenjës.</p>
<p>Vlerësimi: Bëhet vlerësimi për përshkrimin e një ngjarjeje; shtjellimin e ngjarjes sipas elementeve të strukturës së tregimit; për respektimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë shkrimit të tregimit, si dhe për vlerësimin që jep nxënësi për tregimet e shokëve të tij</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit mund ta ripunojnë në shtëpi rrëfimin.</p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mbresa udhëtimi		Situata e të nxënit: Shkrimi i përvojave personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore Nxënësi/ja: – shkruan rreth mbresave gjatë udhëtimeve të tij; – punon sipas karakteristikave e rregullave për këtë lloj shkrimi; – diskuton rreth punëve me shkrim të shokëve të tij.		Fjalët kyç: -udhëtim; -rrëfim letrar; -udhëpërshkrim; -mbresa; -vend.	
Burimet: teksti mësimor, materiale të ndryshme nga nxënësit që i ndihmojnë për të pasqyruar më mirë mbresat e tyre.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Muzika • Artet • Gjeografia	

<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje-përgjigje - Punë e pavarur me shkrim - Diskutim</p> <p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>- Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje Nxsis nxënësit të rikujtojnë dhe një herë çfarë duhet të kenë parasysh kur përshkruajnë një udhëtim dhe se cilat janë disa nga veçoritë e udhëpërshkrimit. Në lidhje me këtë drejton pyetjet: - <i>Cilat janë detajet që mbizotërojnë në një përshkrim udhëtimi?</i> - <i>Cilës klasë e fushë leksikore i përket ato?</i></p> <p>Lexim i drejtuar i tekstit.+harta e konceptit Kujtoj më nxë në sit cilat janë rregullat e udhëpërshkrimit, të njohur në klasë n e gjashtë . Këto rregulla shkruhen në tabelë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshkrimi i çastit të parapërgatitjes dhe të nisjes. 2. Përshkrimi i rrugës që përshkohet dhe disa emra vendesh ku kalohet. 3. Përshkrimi i gjërave më të rëndësishme nga vendi që vizitohet, pozita e tij gjeografike, klima, objektet, tradita kultura e atij vendi, ndodhitë, të papriturat etj. 4. Mbyllja e shkrimit me mbresat dhe emocionet që kanë marrë nga ai udhëtim. <p>Duhet t'u kujtojmë nxënësve se fjalët që përdoren më shumë në një udhëpërshkrim janë foljet, emrat që tregojnë elemente gjeografike e historike të shoqëruara me mbiemra e ndajfolje vendi.</p> <p>- Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e pavarur me shkrim ✚ <i>Shkruani mbresa udhëtimi duke zgjedhur njëren nga temat e mëposhtme:</i> <i>Liqeni i Pogradecit</i> <i>Udhëtim në kaltërsi</i> <i>Autostop</i></p> <p>Nxënë sit janë të lirë të zgjedhin një temë tjetër që u pëlqen. Nxënësit duhet të respektojnë rregullat e shkrimit të një rrëfimi letrar.</p> <p>- Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim Pasi mbarojnë me punimin e tyre, zgjedh dy-tre nxënës për ta lexuar detyrën e tyre. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje, diskutojnë për shkrimet e dëgjua dhe japin vlerësimin e tyre për njëri-tjetrin. Orientoj diskutimin që nxënësit të bëjnë dallimin mes rrëfimit letrar dhe atij joletrar.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësimi bëhet për shkrimin më të bukur rreth mbresave gjatë një udhëtimi; analizimit të gjuhës së rrëfimit letrar; si dhe aktivizimit në diskutimin e punës me shkrim.</p>
--

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë poezi		Situata e të nxënësve: Krijojmë poezi	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 			

<p>3. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 4. <i>Kompetenca personale.</i> 5. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -përcakton strukturën e poezisë; -analizon modele të ndryshme poezish; -krijon poezi për të shprehur emocionet dhe ndjenjat e tij/saj.</p>	<p>Fjalët kyçe: Poezi, vargje, ndjenjë, natyrë, arte.</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit, poezi të ndryshme.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Historia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Prezantim -Pyetje – Përgjigje -Punë e pavarur me shkrim - Diskutim</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p>	
<p>Hapi I: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Pyetje – Përgjigje Mësuesi/ja pyet nxënësit rreth njohurive që kanë për poezinë dhe elementet e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ç'është poezia? • Çfarë transmeton ajo? • Përse shkruajmë poezi? • Si ndërtohet një poezi? • Ç'lloj figurash përdoren më shumë në to? 	
<p>Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja: Të shkruarit është një proces krijimi, të cilin njeriu e mëson gjatë jetës. Poezia shkruhet me ndjenjë e mendim. Ajo lind:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si shprehje e emocioneve; • Si shprehje e mendimit personal; • Si përkushtim i veçantë. 	
<p>Këshilla për të shkruar poezi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Përmbajuni idesë që doni të shprehni. ❖ Lidhjeni idenë me përjetimet tuaja. ❖ Lexoni më parë poezi të ngjashme, ndiqni modele. ❖ Krijoni strukturën: shkruani në strofa, vargje të shkurtra dhe me rimë. ❖ Përdorni figura letrare: epitete, krabasime. ❖ Ndryshoni shpesh vendin e fjalëve në vargje. ❖ Përsëritni fjalët që japin mesazhe. ❖ Lexojeni vetë pasi ta keni shkruar, që të kuptoni nëse ka ritëm. ❖ Shikojeni të shkruar, poezia duhet të duket bukur. 	
<p>Hapi III – Punë e pavarur me shkrim.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Plotësoni më tej mendimin se përse shkruajmë: <ul style="list-style-type: none"> • Shkruajmë për të përcjellë një emocion. • Shkruajmë kur duam të ndajmë një gëzim, një mërzi. • Shkruajmë kur duam të përcjellim atë që ndiejmë etj. 2. Zëvendësoni fjalët me të zeza me fjalë të përafërta, duke ruajtur kuptimin e poezisë. Kur të jesh mërzitur shumë – lodhur. 	
<p>Në raft të librave kërkoni- mes faqeve të librave, në shënime.</p>	

3. *Shkruani fjalë në vendet bosh.
Në dhomë kish hyrë një zog*

Nuk cicërinte dot

S'e ngrobte asnjë varg balade

Asnjë peizazh

Gruaja e mori në duar, si një fole

Ia puthi krabët. E ngrohu _____

Pas pak tej dritareve dëgjohet

Ciu-ciu

Nëpër shi

4. *Në vendin bosh shkruani një varg që i shkon kësaj poezie.
U zunë rrugët me dëborë*

Rri dritareve me orë

Në mendime futur rri

Era zë të ulërijë

Gjithë rrugët mbenë shkrete

Bora s'ka ndër mend të shkrijë

-
5. *Shkruani vargjet e mëposhtme në gjuhë standarde.
E kandshme asht hana – e këndshme është hëna*

Kur del me zana -kur del me zanat

E n'tokë me dritë përndahet – e në tokë me dritë shpërndahet

Hyjëzit që shndrisin – Hyjet që shndrijnë

6. *Vendosini një titull poezisë së mëposhtme dhe kthejeni atë në prozë.
Titulli :*

Këto kopshte ku fryn era

Muar ngjyrën e floririt

Se ç'm'i shkel balukeprera

Këto kopshte ku fryn era

Pranvera, pranvera

Po mi çel në mes të girit

Këto kopshte ku fryn era

Muar ngjyrën e floririt.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit nxjerrim konkluzionet dhe bëjmë vlerësime për krijimet që ata kanë ndërtuar vetë.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë një intervistë		Situata e të nxënësve: Shkrimi i një interviste	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca personale.</i> 6. <i>Kompetenca qytetare.</i> 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja:		-intervistë;	
– shkruan pyetje për intervistën sipas një qëllimi të caktuar;		-qëllim;	
– punon sipas karakteristikave e rregullave për këtë lloj shkrimi;		-intervistues;	
-shkruan saktë nga ana gjuhësore-drejtshkrimore;		-i intervistuari;	
– diskuton rreth punëve të shokëve të tij.		-pyetje;	
		-përgjigje;	
		-strukturë.	
Burimet: teksti mësimor, materiale të ndryshme nga nxënësit, albume me fotografi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		• Qytetaria	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
Pyetje-përgjigje - Tabela INSERT-Punë e pavarur me shkrim - Diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

- Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:

Pyetje-përgjigje

Nxis nxënësit të rikujtojnë dhe një herë çfarë duhet të kenë parasysh kur hartojnë një Intervistë dhe se cilat janë disa nga veçoritë e saj në ndërtim dhe përmbajtje. Në lidhje me këtë drejtoj pyetjet:

-Ç'është intervista? Si realizohet ajo? Kë intervistojmë zakonisht? Për ç'qëllim intervistojmë?

- **Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela INSERT.**

a. Nxënësit lexojnë tekstin, vendosin shënimet: / (TICK), +, -, ? dhe plotësojnë tabelën INSERT.

/	+	-	?

b. Diskutim në çifte dhe më pas në grup rreth çështjeve:

-Kushtet e realizimit të intervistës: Zgjedhja e të intervistuarit. Marrja e informacioneve të plota për fushën dhe kontributin e të intervistuarit. Përcaktimi i vendit dhe formave të intervistimit.

-Përcaktimi i qëllimit të intervistës.

-Hartimi me kujdes i pyetjeve që nxisin mendime nga i intervistuari.

- Hyrje për prezantim të të intervistuarit dhe qëllimit të intervistës.

-Etika në komunikim.

-Regjistrimi me saktësi i përgjigjeve Dhënia e saktë e fakteve pa i keqinterpretuar.

-Shkruhen me kujdes dhe saktësi nga ana gjuhësore-logjike-strukturore pyetjet dhe përgjigjet.

-Kontrolli përfundimtar.

- **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur**

Hartoni një intervistë me një figurë të njohur nga bota e sportit, artit, letërsisë etj.

Pasi mbarojnë me punimin e tyre, zgjedh dy-tre nxënës për ta lexuar detyrën e tyre. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje, diskutojnë për punën e shokut dhe japin vlerësimin e tyre për njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Vlerësimi bëhet për intervistën më të bukur, të hartuar sipas modelit dhe rregullave për këtë lloj shkrimi.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë një letër zyrtare		Situata e të nxënit Komunikimi formal me shkrim	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i>			
2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i>			
3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i>			

4. <i>Kompetenca qytetare.</i> 5. <i>Kompetenca personale.</i>	
Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore Nxënësi/ja: – përcakton qëllimin e komunikimit; – shkruan në mënyrë të pavarur një material rreth një tematike të caktuar; – realizon saktë shkrimin e tij/saj, nga ana drejtshkrimore;	Fjalët kyç: -shkruajmë; -imagjinatë; -histori;
Burimet: teksti shkencor, materiale të ndryshme që lidhen me komunikimin, letra zyrtare etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: -Qytetaria
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diskutim - Punë e pavarur me modele - Imagjinatë e drejtuar.	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>- Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim Nxënësit risjellin në vëmendje njohuritë mbi skemën e komunikimit letrar dhe elementet e saj</p> <p style="text-align: center;">Dhënësi ← → Mesazhi ← → Marrësi</p> <p>Diskutohet me nxënësit rreth shkrimit formal dhe llojeve të tij e më saktësisht rreth letrës zyrtare duke drejtuar vëmendjen tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ qëllimi i shkrimit ✚ përmbajtja ✚ saktësia drejtshkrimore <p>- Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e pavarur me modele Nxënësit ndjekin hap pas hapi strukturën dhe përbërjen e një letre zyrtare sipas skemës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ prezantimi ✚ identifikimi i problemit ✚ propozimi për zgjidhjen e problemit ✚ mbyllja e letrës <p>- Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Imagjinatë e drejtuar – punë individuale Në shembullin e dhënë në tekst nxënësi përcakton elementet e strukturës dhe përmbajtjes së një letre zyrtare.</p>	
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit duhet të shkruajnë një letër zyrtare me një problematikë të përcaktuar nga ata vetë.	

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë njoftime		Situata e të nxënësve Komunikimi formal me shkrim	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i>			

<p>3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca qytetare.</i> 5. <i>Kompetenca personale.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore Nxënësi/ja: – përcakton qëllimin e komunikimit; – shkruan sipas formatit standard, një njoftim të caktuar; – realizon një shkrim të saktë nga ana drejtshkrimore.</p>	<p>Fjalët kyç: -shkruajmë; -njoftim; -histori;</p>
<p>Burimet: teksti shkencor, materiale të ndryshme informuese, grafikë, fotografi etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim - Punë e pavarur me modele - Imagjinatë e drejtuar</p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>- Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim Nxënësit shohin me vëmendje fotografitë e dhëna në libër duke analizuar dhe shpjeguar funksionin parësor të tyre (dhënien e informacionit) dhe mënyrën e paraqitjes së tyre Diskutohen me nxënësit këto çështje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ç`është njoftimi? • Kush e shkruan njoftimin? • Mënyrat e shpërndarjes së tij. <p>- Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e pavarur me modele Nxënësit ndjekin hap pas hapi formatin standard të një njoftimi sipas skemës së paraqitur në tekst. Listojmë informacionet që marrim nga njoftimi Përcaktojmë kush e shkruan njoftimin Dallojmë mënyrën e shpërndarjes së tij</p> <p>- Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Imagjinatë e drejtuar – punë individuale Punohen dhe plotësohen ushtrimet nr. 2, 3 (pika a,b) në tekst.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Shkrimi i njoftimeve të shkurtra me tematikë të lirë .</p>	

Data:

PLANIFIKIMI DËTOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë udhëzime		Situata e të nxënësve Komunikimi formal me shkrim	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç</p> <p>1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca qytetare.</i> 5. <i>Kompetenca personale.</i></p>			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore Nxënësi/ja: – përcakton qëllimin e komunikimit; – shkruan një udhëzues për një lojë të caktuar; – realizon një shkrim të saktë nga ana drejtshkrimore;	Fjalët kyç: -shkruajmë -udhëzim -lojë
Burimet: teksti shkencor, materiale të ndryshme që lidhen me botën imagjinare të fëmijëve	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Arti • Teknologjia
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim - Punë e pavarur me modele - Imagjinatë e drejtuar	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimin</p> <p>- Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim Nxënësit pyeten rreth mënyrës se si e kalojnë ata kohën e lirë . -Cilat janë disa nga lojërat tuaja të preferuara? -Si keni mësuar të luani me këto lojëra?</p> <p>- Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e pavarur me modele -Udhëzimet shërbejnë për të mësuar të tjerët se si të luajnë. Ato shpjegojnë qartë objektivin e lojës dhe rendisin informacionet rreth saj. Për të shkruar udhëzimet rreth një loje të caktuar duhen pasur parasysh disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdorimi i vetës së dytë; • foljet në kohën e tashme (mënyra urdhërore) por edhe mënyra lidhore me foljet modale; • shkrimi i udhëzimeve sipas ecurisë logjike; • renditni udhëzimet me anë të paragrafëve duke vendosur numra ose shenja dalluese <p>- Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Imagjinatë e drejtuar – punë individuale - Nxënësit shkruajnë udhëzimet rreth një loje të përzgjedhur prej tyre.</p>	

Data:

PLANIFIKIMI DËTOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë ese përshkruese (ora e parë)	Situata e të nxënit: Eseja përshkruese		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca qytetare.</i> 			

<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -kujton tiparet e tekstit përshkrues (të mësuara në vitin e shkuar); -analizon modele të eseve të ndryshme përshkruese, duke i krahasuar ato; -rendit tiparet e tekstit përshkrues joletrar; -shndërron një tekst përshkrues letrar në joletrar.</p>	<p>Fjalët kyçe: Eseja përshkruese, paragraf përshkrues, përfytyrim, gjuhë e figurshme.</p>
<p>Burimet: Libri “Si të shkruajmë ese”, libri i nxënësit, modele të gatshme esesh, fletë nga ditari me paragrafë përshkrues etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeografia
<p align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diskutim - Informacioni i ri - Punë e drejtuar</p>	
<p align="center">Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>Hapi I: Diskutim: Lexohen fragmentet e shkëputura nga dy ese nxënësish dhe diskutohet për secilin prej tyre. Cila nga të dyja afron me esenë përshkruese? Zbuloni disa karakteristika të saj. Nxënësi i parë tregon duke përdorur mjaft elementë përshkrues: pushimeve aq fantastike të fundjavës; lumturia e madhe që më përfshin ashtu papritur dhe vrullshëm; Ndihem i frymëzuar dhe i gatshëm për shkollën; Më pushton si me magji buzëqeshja dhe humori i mrekullueshëm i vëllait të vogël etj.</p> <p>Hapi II: Informacioni i ri. Çfarë është teksti përshkrues joletrar? -Teksti përshkrues joletrar është lloj shkrimi që përdoret në enciklopedi, guidave të ndryshme apo edhe në materiale shkencore. -Ashtu sikurse në tekstin përshkrues letrar, edhe në këtë lloj teksti përshkruhet një vend, person, kafshë apo ngjarje. -Përshkrimet e këtij lloji përbëhen nga ndjenjat dhe emocionet e një grupi (jo vetëm të një personi). P.sh., kur përshkruajmë një qytet për një guidë turistike, aty flasim për bukurinë e qytetit duke bashkuar këndvështrimin tonë me të atyre që e kanë vizituar atë më parë. Kështu teksti përshkrues joletrar shkruhet me profesionalizëm dhe art të vërtetë. -Përmes tekstit përshkrues joletrar, ne zgjojmë kuriozitetin duke ndikuar te të tjerët. -Teksti përshkrues joletrar shkruhet me një gjuhë të bukur, me figuracion të kursyer dhe detaje.</p> <p>Hapi III. Punë e drejtuar: Nxënësit plotësojnë me fjalë a shprehje vendet bosh në esenë përshkruese letrare. Më pas e shndërrojnë atë në një ese përshkruese joletrare.</p> <p>Plotësoni me fjalë a shprehje vendet bosh në esenë përshkruese joletrare të mëposhtme. Më pas, shndërrojeni atë në një ese përshkruese joletrare. Shkolla që do të shohim sot në dokumentar është një godinë e vogël, <u>e pozicionuar</u> në zonën më të bukur të Zvicrës, rrëzë një mali <u>të lartë</u> dhe buzë një liqeni <u>artificial</u>, në mes të gjelbërimit, ajrit <u>të pastër</u> dhe larg <u>zburmës</u> së qytetit, plot lule të llojeve <u>të ndryshme</u> dhe fusha <u>të gjera</u>, ku zhvillojnë lojëra të ndryshme <u>fëmijët</u>. Asgjë nuk do ju pëlqejë më shumë se fushat sportive, në të cilat zhvillohen çdo vit kampionate <u>kombëtare</u>. Pishina <u>të mbuluara</u> dhe <u>të mirësishtuara</u> përdoren gjatë stinës <u>së ftohtë të dimrit</u>. Përveç këtyre, laboratorët <u>lëndorë</u> dhe biblioteka <u>e shkollës</u> ndihmojnë nxënësit për rezultate të larta. E gjitha kjo është një pamje <u>mbresëlënëse</u> e një shkolle, me të cilën ia vlen bashkëpunimi në mjaft fusha. Ata janë edhe mikpritës <u>të shquar</u>, që dinë <u>të mirëpresin</u>.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështetet në krahasimin e teksteve përshkruese për të dalluar tiparet e tyre, përdorimin e fjalëve të duhura në një tekst përshkrues letrar dhe shndërrimin e tij në një tekst përshkrues joletrar.</p>	
<p>Detyrat: Shkruani një ese përshkruese joletrare, me jo më shumë se 150 fjalë, me temë: <i>Qyteti im</i>.</p>	

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë ese përshkruese (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Eseja përshkruese	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca qytetare.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: Eseja përshkruese, paragraf përshkrues, përfytyrim, gjuhë e figurshme.	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> -zbaton me korrektësi hapat për hartimin e një eseje përshkruese joletrare; -shkruan një ese përshkruese joletrare, sipas përfytyrimit që i jep një pikturë, fotografi; -respekton elementet e një eseje: hyrjen; zhvillimin; përfundimin; -përshkruan qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura veprën e tij, duke krijuar përfytyrime tek lexuesi; -shkruan duke përdorur fjalor të pasur; -shkruan duke synuar saktësi gjuhësore. 			
Burimet: Pamje, fotografi, fletore të punëve me shkrim.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare:	
		<ul style="list-style-type: none"> • Gjeografia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
-Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme - Praktikë e drejtuar -Praktikë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimi:			
<p>Hapi I. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë.</p> <p>Hapi II. Praktikë e drejtuar. Renditim hapat që sugjerojmë të ndiqen për shkrimin e një eseje përshkruese.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Planifikoni punimin tuaj: bëni një skemë me pikat kryesore. -Shkruani esenë tuaj: Filloni të shkruani me një rend detajesh që ndjekin njëri-tjetrin. -Rilexoni atë që shkruat duke shtuar dhe hequr fjalë. Silleni esenë në formën më të mirë. -Redaktojeni esenë tuaj: vëreni nëse i jeni përshtatur plotësisht temës së dhënë, rregulloni fjalët dhe fjalitë, nga kuptimi dhe nga ana gramatikore. Kujdesuni për drejtshkrimin dhe pikësimin. Në fund, ajo duhet të duket bukur në fletën tuaj. -Ndajeni me të tjerët (dorëzoheni, lexojeni para të gjithëve, afishojeni në stenda apo në gazetën e shkollës etj.). <p>Hapi III. Praktika e pavarur. Shkrimi i esesë përshkruese</p> <p>Duke parë fotografinë e dhënë në libër, shkruani një ese përshkruese joletrare në formën e guidës, ku të ngacmoni përfytyrimin e shokëve tuaj për ta vizituar këtë vend.</p>			

Nxënësi/ja ndjek **këshillat** për të shkruar një ese përshkruese joletrare:

-Shikoni fotografinë dhe shkruani titullin e esesë.

-Mendoni se çfarë doni të shprehni. Përshtatjuni natyrës së një guide.

-Shikojeni me imtësi dhe përcaktoni rëndësinë e secilit detaj. Kujdes: asnjë prej tyre nuk është i parëndësishëm.

-Përdorni folje që shoqërohen me ndajfolje, si p.sh.: *ndriçonte nga të gjitha anët*, lëndina të gjelbra shfaqen përpara...;

rrugët e gjera dhe ndërtesat e larta të kudondodhura...; mos harroni mbiemrat, por këtu këta nuk janë pjesë e epiteteve dhe shprehjeve të figurshme.

-Kujdesuni që të mos mbizotërojë rrëfimi, por përshkrimi.

-Kujdesuni që t'i pëlqejë syrit, "zërit" tonë të brendshëm, të krijojë përfytyrime, imazhe, tablo imagjinare.

-Ndajeni në paragrafë. Mirë janë tre, shumë mirë 5.

Vlerësimi:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë

KRITERI II: STRUKTURA 1 pikë

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 1 pikë

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË LEXUARIT

I. TEKSTI LETRAR

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rozafati M.Kuteli		Situata e të nxënit: Legjenda e Rozafës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon rrëfenjën për t'iu përgjigjur pyetjeve që lidhen me kuptimin e pjesës; -ritregon përmbajtjen duke u mbështetur në pikat kryesore të rrjedhës së ngjarjeve; -zbulon cilësitë e personazheve duke nxjerrë përfundime rreth tyre; -analizon gjuhën e rrëfenjës së lexuar; -zbulon veçoritë e rrëfenjës; -dallon elementin e jashtëzakonshëm si veçori e rrëfenjës; -diskuton rreth temës, duke sjellë shembuj të tjerë konkretizues.		Fjalët kyçe: <i>Tre vëllezër, mur, besë, vashë, zemrat rrahin, murosje</i>	
Burimet: Teksti i nxënësit, material mbi legjendat shqiptare, episode nga filmi "Muri i Gjallë".		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Historia • Gjeografia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Diskutim -Stuhi mendimesh -Pema e mendimit –Lexim në heshtje -Punë e drejtuar -Ditari dypjesësh -Punë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutim <ul style="list-style-type: none"> ➤ Cilat legjenda keni lexuar? (Gërzhet, Kostandini e Dhoqina, legjenda e Skënderbeut etj.) ➤ A përcjellin ato mesazhe nëpërmjet përmbajtjes së tyre? ➤ Janë krijime të reja apo të hershme? ➤ Çfarë tregon ekzistenca e tyre, cili është roli i legjendave në letërsi? ➤ Ç'dini për legjendën e Rozafës? Flasin rreth autorit: <i>Mitrush Kuteli (1907-1967)</i> <i>Dhimitër Pasko është emri i tij i vërtetë. La një trashëgimi letrare të gjerë, të pasur, origjinale dhe përherë të freskët. Ai ishte mjeshër i fjalës shqipe. Botoi librat me tregime: "Ago Jakupi e të tjera rrëfime", "Tregime të moçme shqiptare", "Xixëllonja" etj.</i>			

Kujtojmë:

Teksti rrëfimtar letrar është një tekst në të cilin rrëfohen fakte reale ose imagjinare, të vendosura në hapësirë dhe në kohë, të bashkuara në një mënyrë të tillë që të formojnë një histori në të cilën bashkëveprojnë personazhe me role të ndryshme.

Ndërtimi i njohurive të reja: Pema e mendimit

Subjekt që mbështetet



- Legjenda-rrëfim fantastik, në bazë të së cilit qëndron një ngjarje që ka ndodhur në realitet ose një ngjarje historike.

Proza është një lloj letrar ose joletrar që ndryshe nga poezia nuk shkruhet në vargje, por në rreshta.

Rrëfenja është një tregim i shkurtër për një ndodhi të vërtetë ose të trilluar, zakonisht me shtjellim të thjeshtë.

Lexim i drejtuar: Njihen nxënësit me përmbajtjen e pjesës. “Rozafati” është një rrëfenjë ndërtuar sipas legjendës së murosjes. Në qendër të saj është flijimi për ngritjen e mureve të kalasë që do të shërbenin si mbrojtëse të jetës. Kujtojmë shkurtimisht përmbajtjen e legjendës: *Fjala u dha nga të tre vëllezërit, por vetëm vëllai i vogël e mbajti.*

Lexojmë fragmentin me intonacionin e duhur, duke e ndarë atë në paragrafë dhe duke nënvizuar fjalët e reja.

Punë e drejtuar- Reflektim kuptimor

Pyetja 1. Nxënësit shkruajnë 4 fjali sipas renditjes së kryerjes së veprimeve.

Ditari dypjesësh- Bota e brendshme e nuses së vogël shprehet në fragment.

Fragment	Gjendja shpirtërore
- Shëndoshë ju, o tim kunetër. Po unë do t’ju lë një porosi: Kur të më muroni në mur, synë e djathtë të ma lini jashtë, dorën e djathtë të ma lini jashtë etj..	Një grua legjendare, e fortë, që nuk dridhet përpara vendimit që është marrë. Dhembja shpirtërore jepet dhe ndihet edhe nëpërmjet gjuhës së tekstit (pashirrma O).

Punë e pavarur. Punohet **pyetja 4** sipas kërkesës: Gjuha e rrëfenjës është:

- e thjeshtë;
- e qartë;
- me shumë folje;
- me fjali të shkurtra dhe me shprehje frazeologjike;
- me dialogë.

Pyetja 5: Gjeneri në tekst: një shprehje frazeologjike, një folje të mënyrës dëshirore dhe një shprehje përshëndetëse që janë karakteristike të rrëfenjave.

- lidhuni me besa-besë;
- kështjella qëndroftë;
- Shëndoshë ju, o tim kunetër.

Pyetja 6: Një nga motivet më të njohura që trajtohet këtu është mbajtja e fjalës së dhënë. Diskutoni për këtë cilësi të traditës sonë duke e lidhur edhe me raste të tjera nga krijimtaria popullore, ku ajo është përdorur.

- Besa e Kostandinit.
- Ymer Agë Ulqini.

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në përgjigjet e tyre rreth përmbajtjes, analizën e personazheve, rrëfenjës si lloj rrëfimi, gjuhës së saj dhe reflektimit rreth temës së saj.


Detyrë:

Gjeni në veprën e Mitrush Kutelit një rrëfenjë tjetër që mbështetet mbi krijimet popullore dhe shkruani disa karakteristika të saj.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fabula dhe përralla (ora e parë)		Situata e të nxënit: Fabulat dhe përrallat	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca qytetare.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -përcakton fabulën si lloj i krijimtarisë letrare; -interpretin fabulat, duke përdorur teknikat përkatëse, si intonacioni, mimika, gjestet; -dallon fjalitë e lidhura kuptimisht me temën e secilës nga fabulat e dhëna; -shpjegon veçoritë e gjuhës humoristike të fabulave; -gjen fjalët kyçe të fabulave të dhëna.		Fjalët kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopr rac, kallëp floriri, thesarin e fshehur; 2. Mbret, djalë, luan, pikturë, ëndërr gënjeshtarë; 3. Lepur, breshkë, kaçube, qëndrësë; 4. Leopard, elefant, hienë, shkel, këlysh, klithmë. 	
Burimet: Teksti i nxënësit, fabula nga autorë të ndryshëm, maska kafshësh.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe, folklori. 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diagrami i Venit - Stuhi mendimesh- Praktikë e drejtuar – Praktikë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimi:			
Punë paraprake: Diskutojmë me nxënësit për fabulat. Ndërtojmë diagramin e Venit ku japim të përbashkëtat dhe ndryshimet midis tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Cilët janë fabulistët më të njohur në botë dhe në Shqipëri? – Ezopi, La Fonteni, Fedri, Çajupi, D. Agolli...etj. • Më pas 2 nxënës interpretojnë disa fabula. 			



Hapi I- Lexim i drejtuar. Nxënësit lexojnë bukur, të ndarë në role fabulat. Gjatë leximit nënvizojnë dhe fjalët e reja e më pas i shpjegojmë ato.

- *Koprrac* – njeri dorështrënguar.
- Kallëp floriri – copë druri a metali në një formë katërkëndore.
- *Dekika* - minuta.
- *Sukë* – vend i ngritur mbi një fushe, kodër e ulët.
- *Shullë* – vrimë nga del uji i mbledhur në një gropë.
- *Kuturis* – u ngatërroua.
- *Hienë* – kafshë e egër gjitare me trup si të ujkut.

Hapi II Punë me tekstin – Praktikë e drejtuar

Kuptojmë tekstin: 1. Më poshtë, janë renditur disa fjali që japin informacion rreth temave të fabulave të mësipërme. Ju duhet të gjeni se kujt i përket secila prej tyre, duke shkruar në krah numrin e fabulës përkatëse.

- ❖ Në të vërtetë, princin e vrau luani _____ (Djali dhe mbreti i pikturuar – Ezopi)
- ❖ Ndonjëherë fiton ai që reziston më shumë dhe jo më i shkathëti, më i shpejti. _____ (Breshka dhe lepuri)
- ❖ Nëse pasurinë nuk e përdor, e humbet. _____ (Koprraci dhe floriri i tij – Ezopi)
- ❖ Kur je i pikëlluar, edhe shpagimi i gënjeshtarit të ndihmon _____ (Hakmarrja e leopardit)

Hapi III- Interpretimi dhe gjuha e tekstit: Praktikë e pavarur

Mesazhi i një krijimi letrar është ideja, mësimi, morali që përcillet te lexuesi.

2. Fabulat e përcjellin mesazhin përmes humorit. Shpjegoni rolin e gjuhës humoristike duke e ilustruar me shembuj nga fabulat më lart.

Fabula e parë: Kur ishte aty, ti në të vërtetë nuk e kishe, sepse nuk e përdore as edhe një herë.

Fabula e dytë: (dy paragrafët e fundit)

Fabula e tretë: (Jo,gabohesh,- tha më në fund. Nuk e kanë bërë elefantët, por dhitë. Dhitë e vranë tim bir!

Fabula e katërt: (Breshka eci gjithë ditën...)

3. Mesazhet e fabulave vijnë në formën e një zinxhiri me fjalë kyçe. Gjeni nga tri fjalë kyçe për secilën fabul.

- Koprrac,kallëp floriri,thesarin e fshehur;
- Mbret,djalë,luan,pikturë,ëndërr gënjeshtarë;
- Lepur,breshkë, kaçube, qëndresë;
- Leopard,elefant,hienë,shkel,këlysh,klithmë.

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në përgjigjet që kontrollojnë të kuptuarin e pjesës, interpretimin e saj kuptimor, si dhe formulimin e mesazhit.

Detyrat : Gjeni një fabul tjetër dhe interpretoni mesazhet dhe këshillat e saj.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema Mësimore: Fabula dhe përralla (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Fabulat	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca qytetare.</i> 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -formulon mesazhin dhe moralin e fabulës në formën e këshillave; -analizon idetë që përcjellin fabulat; -analizon veprimet e personazheve; -analizon përdorimin e gjuhës në mënyrë të figurshme; -ndërton një situatë, e cila trajton problemin kyç të fabulës;		Fjalët kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopracc, kallëp floriri, thesarin e fshehur; 2. Mbret, djalë, luan, pikturë, ëndërr gënjeshtare; 3. Lepur, breshkë, kaçube, qëndresë; 4. Leopard, elefant, hienë, shkel, këlysh, klithmë. 	
Burimet: Teksti i nxënësit, fabula nga autorë të ndryshëm, maska kafshësh.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha shqipe, folklor	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

-Praktikë e drejtuar – Punë në grupe - Praktikë e pavarur

Organizimi i orës së mësimt

Hapi I: Punë me tekstin

Kuptojmë tekstin: Praktikë e drejtuar

Fabulat japin mesazhe në formën e këshillave. Shkruani në tabelë këshillat që morët nga këto fabula. Më pas, shpjegoni rëndësinë e secilës prej tyre në jetën e përditshme.

<i>Fabula</i>	<i>Këshilla/mesazhi që merrni</i>	<i>Shpjegimi juaj</i>	<i>Shembull</i>
<i>Kopracci dhe floriri i tij</i>	<i>Nëse pasurinë nuk e përdor, e humbet.</i>	<i>Njeriu duhet të dijë ta vlerësojë dhe ta përdorë ashtu si duhet pasurinë.</i>	<i>Kur ishe aty, ti në të vërtetë nuk e kishe, sepse nuk e përdore as edhe një herë.</i>
<i>Djali i mbretit dhe luani i pikturuar</i>	<i>Në të vërtetë, princin e vrau luani.</i>	<i>Njeriu duhet të dijë t'i përballojë vetë vështirësitë.</i>	<i>"Egërsirë e mallkuar, për shkakun tënd dhe të ëndrrës gënjeshtare të tim eti, jam mbyllur këtu, në një pallat, si në një burg. E ç'mund të të bëj?"</i>
<i>Hakmarrja e leopardit</i>	<i>Kur je i pikëlluar, edhe shpëtimin i gënjeshtarit të ndihmon.</i>	<i>Përpara se të kryejë një veprim, njeriu duhet të dijë të vërtetën për të mos shkuar vetë në gabim.</i>	<i>Me një shpërthim të dhunshëm zemërimi, në shenjë hakmarrjeje, mbyti ç'gjeti përpara.</i>
<i>Breshka dhe lepuri</i>	<i>Ndonjëherë fiton ai që reziston më shumë dhe jo më i shkathëti më i shpejti.</i>	<i>E rëndësishme në jetë është se sa mund të rezistosh përballë vështirësive dhe jo vetëm të ecësh.</i>	<i>-Hë!-tha lepuri.-Tash po e shof se s'qenka shpejtësia, por qenka qëndresa ajo që ban punë!</i>

Hapi i dytë- Punë në grupe

Grupi I: Arsyetoni si arriti kopracci të fitonte një kallëp floriri?- Shiti gjithçka që kishte.

Grupi II: Pse mendoni që djalin në të vërtetë e vrau luani? Çfarë tregon kjo? Frika e realizimit të ëndrrës.

Grupi III: A ju kënaq fakti që fituese në fund është breshka? Arsyetoni veprimin e lepurit.-Po -Hë!-tha lepuri.-Tash po e shof se s'qenka shpejtësia, por qenka qëndresa ajo që ban punë!

Grupi IV: Pse prindërit e leopardit të vogël gabuan? A është hakmarrja një pasion primitiv? (- Sepse besuan një

gënjeshtrën dhe zemërimi n, më pas u kalua në hakmarrje).

Hapi III. 3. Interpretimi i tekstit- Praktika e pavarur

Pse fabulat quhen ndryshe edhe tregime për kafshë? (sepse personazhet janë kafshë)


Punohet për dallimin e figurave letrare, ndër të cilat personifikimet.

Personifikimi-është një figurë stilistike me anë e së cilës sendit ose kafshës i vishen tiparet e njeriut. Gjërat pa shpirt e pa vetëdije paraqiten sikur mendojnë, veprojnë e flasin si njerëz.

Hapi IV. 4. Reflektojmë rreth tekstit

Nëpërmjet ilustrimit, është paraqitur një pjesë nga biseda ndërmjet dy bashkëbiseduesve që kanë lexuar fabulën “ Kopranci dhe floriri i tij”.

Diskutoni për bisedën e tyre.



Vlerësimi i nxënësve mbështetet në analizën ideore të fabulave, analizën e gjuhës së tyre dhe argumentimit rreth temës.

Detyrat: Mësoni përmendsh një fabul dhe interpretojeni atë në klasë.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Kali i Drunjtë</i> L. Orvieto		Situata e të nxënit: Pabesia e njerëzve për të arritur qëllimet e tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon për të kuptuar përmbajtjen; -zbulon veçoritë e rrëfimit; -identifikon personazhet duke shprehur edhe pëlqimin e vet rreth tyre; -dallon figurat letrare dhe tregon funksionin e tyre; -ritregon ngjarjen në formë të shkurtuar nëpërmjet një paragrafi.		Fjalët kyçe: <i>Kali i drunjtë, akej, dinak, trojanë, Laokonti, gjarpër, falltar.</i>	

Burimet: Teksti i nxënësit, libri "Iliada", filmi "Troja" etj	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Historia • Teknologjia 						
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Hulumtim -Ditar dypjesësh -Lexim i drejtuar –Rrjet i diskutimit –Harta semantike (Figurat letrare)							
Organizimi i orës së mësimi							
Punë parapërgatitore. Në fillim nxënësit shohin fragmente nga filmi "Troja"; ku tregohet heroizmi i heronjve Akil dhe Hektor.							
Hapi i parë. Lidhja me temën me njohuritë e mëparshme:							
Stuhi mendimesh:							
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ç'dini për Luftën e Trojës? ➤ Cilët janë heronjtë kryesorë? ➤ Kush ishte Zeusi? 							
Hapi i dytë. Informacioni i ri. Në fillim njihemi me historinë që do të lexojmë në këtë fragment. Historia që i paraprin rrëfimit flet për luftën e famshme Greko-Trojane, luftë e cila nisi për shkak të Helenës, gruas së bukur greke me të cilën u dashurua Paridi, djali i Priamit dhe vëllai Hektorit. Lufta nis dhe këtu vdesin shumë trima, si Hektori nga kampi Trojan, Akili nga kampi Grek. Tashmë jemi në momentin kur Odisea u sugjeron grekëve një dredhi për të fituar luftën. Kjo dredhi është Kali i drunjtë.							
Hapi i tretë. Lexim i drejtuar. Mësuesi/ja zgjedh një nxënës të lexojë fragmentin me intonacionin e duhur.							
Etapat e punës							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Cilët janë personazhet e këtij fragmenti? (Odisea, Sinoni, Kasandra etj) 2. Si na portretizohen dy personazhet që i japin kthesë veprimi. Ilustroje me fragmente (gjej figurat letrare). 							
Odisea: dinak etj.							
Sinoni: dinak; i mençur, shtinjak etj.							
Hapi i katërt. Reflektim kuptimor							
Pyetja e tretë. Lidhni këtë fragment me ngjarjen historike.							
<i>Deri sa Odiseas t'i vijn` mendttë, krijimi i këtij kali, Trojan po korrnin vetëm fitore, dhe humbet e Akejve sa vinin e po shtoheshin...</i>							
Nxënësit shkruajnë momentin që shënon pikën kulmore të rrëfimit - Dalja e grekëve nga Kali, hyrja e tyre në Trojë. (luftëtarët zunë të zbritnin sërish në bregdet, të armatosur për luftim dhe të etur për gjak).							
Hapi i pestë. Punë e drejtuar							
<i>Subjekti është tërësia e ngjarjeve, e veprimeve, e konflikteve etj, nëpërmjet të cilave dalin në pah karakteret dhe tiparet dalluese të personazheve dhe zbulohet përmbajtja e një vepre letrare.</i>							
<i>Përmbledhja është paraqitje me pak fjalë e thelbit të përmbajtjes së një teksti.</i>							
Nxënësit ritregojnë ngjarjen në formë të shkurtuar, përmes një paragrafi. (Ushtrimi8)							
Hapi i gjashtë. Punë e pavarur							
<table border="1" style="width: 100%;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%;">Fragmenti</th> <th style="width: 50%;">Komenti</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="164 1626 807 1749"> Është i gjallë Kali! Do të luftojë baraz me 1000 armiq! E shoh! Do të mundemi, do të vdesim! Kali merr frymë, ecën, mban armë! Nuk e shikoni që është i gjallë? Mos e shpini në Trojë! </td> <td data-bbox="807 1626 1445 1749"></td> </tr> <tr> <td data-bbox="164 1749 807 1787"></td> <td data-bbox="807 1749 1445 1787"></td> </tr> </tbody> </table>	Fragmenti	Komenti	Është i gjallë Kali! Do të luftojë baraz me 1000 armiq! E shoh! Do të mundemi, do të vdesim! Kali merr frymë, ecën, mban armë! Nuk e shikoni që është i gjallë? Mos e shpini në Trojë!				
Fragmenti	Komenti						
Është i gjallë Kali! Do të luftojë baraz me 1000 armiq! E shoh! Do të mundemi, do të vdesim! Kali merr frymë, ecën, mban armë! Nuk e shikoni që është i gjallë? Mos e shpini në Trojë!							
Ushtrimi 4: Analizoni simbolikën e Kalit të Drunjtë. Kur përdoret shprehja: <i>si Kali i Trojës?</i>							
Përgjigje: Kali është simboli i dredhisë dhe mashtrimit. Naiviteti njerëzor nuk mund të shpagohej veçse me këtë formë. Në asnjë rast nuk i duhet besuar kundërshtarit, ai gjithnjë gjen format për të të sulmuar dhe krijuar iluzione miqësie. Njeriu duhet të jetë gjithnjë syhapur.							
-Dallimi i figurave letrare:							

- Kujtojmë figurat e mësuara në klasën e 6-të:

Simboli është një figurë me kuptim të dyfishtë, e cila paraqet një send, një frymor a një dukuri nëpërmjet një sendi, një frymori a një dukurie tjetër, që bëhet përfaqësues. Shembull: Harpagoni (personazhi kryesor i komedisë "Koprraci" të Molierit) është simboli i koprracisë.

Krahasimi është përjasje ose përafrim midis dy imazheve që arrihet duke bashkuar fjalët përkatëse me ndihmën e lidhëzave. Kështu pra, vihen përballë fjalët që shënojnë dukuri, sende a frymore me fjalët që kanë ngjashmëri dhe lidhen me lidhëzat: si, ashtu si, porsì, etj.

Epiteti është një fjalë përcaktuese, mbiemër, që i shtohet një emri për t'i pasuruar kuptimin, duke i dhënë bukuri artistike, duke shprehur një vlerësim apo qëndrim nga autori.

Hiperbola është figurë stilistike, që ndërtohet mbi bazën e zmadhimit jashtë mase, deri në tepri të qenieve, sendeve a tipareve të tyre, për të bërë përshtypje ose për të theksuar mendimin.

*Dinak, i mençur – epitet
Si shtinjak i mrekullueshëm – krahasim
Si dy flakë - krahasim
Mbanin mijëra flakë – hiperbolë*

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në kuptimin e përmbajtjes së pjesës, dallimin e pikës kulmore të saj, veçorive të rrëfimit, grupimin e personazheve sipas rolit në rrëfim, shprehjen e pëlqimeve rreth tyre (personazheve), analizën e gjuhës figurative të përdorur, ritregimin e ngjarjes në formë të shkurtuar.

Detyrë: Gjeni një personazh tjetër nga mitologjia, emri apo vepra e të cilit sot merret si model. Sillni në klasë informacionet dhe përshkrimet tuaja për të.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Dy vëllezërit</i> L. Tolstoi		Situata e të nxënit: Morali i përrallave	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: -përkufizon (rikujton)përrallën si krijimtari gojore e popullit; -dallon temën e përrallës; -analizon personazhet e përrallës, duke i krahasuar ata;		<i>Dy vëllezër, gur, lumturi, mbretërimi, I varfër, I pasur, kujtime</i>	

<p>-interpretton veprimet e personazheve; -analizon shprehjet e figurshme (fjalët e urta) në ndërtimin e përrallës; -vendos veten në pozitën e personazhit dhe argumenton veprimet e tij/saj.</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësit, përralla nga autorë të huaj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Folklori
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve - Diskutim paraprak -Informacioni i ri -Lexim i drejtuar -Punë me tekstin</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi</p>	
<p>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtojmë ç’kemi mësuar për përrallat. -Ç’quajmë përrallë? -Çfarë rregullash duhen ndjekur për të shkruar një përrallë? -Ku ndryshon përralla nga tregimi? Po nga fabula? -Si përfundojnë përrallat?</p> <p>Hapi i dytë: Informacioni i ri. Njihemi me jetën dhe veprën e Lev Tostoi. Lev Tostoi ishte shkrimtar rus, novelist, dramaturg dhe filozof. Rrjedh nga familja aristokrate e Tolstoilve. Megjithëse jeta e tij ishte shumë e vështirë, përsëri ai u bë një nga emrat më të rëndësishëm të letërsisë, jo vetëm ruse, por dhe botërore. Duke i treguar regjimit carist forcën dhe vullnetin e tij. Veprat kryesore të tij janë “Ana Karenina”, “Lufta dhe paqja”. Përveç këtyre kryeveprave, ai ka shkruar dhe krijime, të cilat janë bërë popullore për tematikën dhe stilin e tyre. E tillë është dhe përralla “Dy Vëllezërit” e cila na rrëfen historinë e dy vëllezërve dhe rrugët e ndryshme që ata ndjekin në jetë. Cili prej vëllezërve ka ndjekur rrugën e dukur? Këtë le ta shohim...</p> <p>Hapi i tretë: Lexim i drejtuar. Lexohet përralla sipas kësaj ndarjeje. Nxënësi i parë: “Dy vëllezërit u nisën për një udhëtim së bashku”... deri te... “më në fund të gjejnë lumturinë të dy tok”. Nxënësi i dytë: “Më i madhi iu përgjigj”...deri te... “dhe i vogli u nis fill i vetëm”. Nxënësi i tretë: “Me të hyrë në pyll”...deri te... “dhe treguan peripecitë e tyre”. Nxënësi i katërt: “Kështu pra, - tha vëllai i madh”... deri te... “nuk ke asgjë për të rrëfyer”.</p> <p>Hapi i katërt: Punë me tekstin <i>Tema e një shkrimi tregon një anë të jetës që pasqyrohet në një vepër, kurse Ideja është mendimi kryesor që e përshkon atë.</i> Nxënësit dallojnë temën dhe idenë kyçe të përrallës. Mbas secilit paragraf ndërtohet një pyetje që i drejtohen nxënësit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si i parashikoni ngjarjet në përrallë? 2. Cilat do të ishin përgjigjet e mundshme të secilit vëlla? 3. Çfarë mendoni se i ndodh vëllait të vogël? 4. Çfarë mendoni se mund të thonë vëllezërit? <p>Nxënësit japin përgjigjen e më pas shohin atë që ndodh duke nxjerrë në pah ndryshimet midis asaj që parashikuan dhe asaj që ndodh realisht.</p> <p>Hapi i pestë: Punojmë me fjalët e reja duke dhënë shpjegimin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Finok:</i> I hollë nga mendja e dinak që vepron me dhelpëri e djallëzi. ➤ <i>Mbishkrim:</i> fjalë e gdhendur mbi një gur, mbi një pllakë a diku tjetër për të shënuar diçka, për të përkujtuar një njeri ose një ngjarje; epigraf ➤ <i>Lakmon:</i> kam dëshirë të madhe të pangopur për të pasur vetë diçka; e teproj në diçka. ➤ <i>Peripeci:</i> vështirësi. <p>Këto fjalë nxënësit i përdorin në fjali.</p> <p>Hapi i gjashtë: Punë e pavarur Kujtojmë ç’dimë për fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike. Fjalë e urta janë shprehje të krijuara nga populli, të cilat përcjellin një mesazh. Shprehje frazeologjike: përdorimet e ngurosurat të një fjale, të cilat zëvendësohen me një sinonim të saj p.sh: <i>më priti me krahe hapur- më priti me gëzim</i></p>	

Pas kësaj, nxënësit nënvizojnë në tekst fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike të përdorura, i shkruajnë ato në fletore duke i analizuar dhe nga ana gjuhësore.		
Fjalë e urtë	Ndërtimi gjuhësor	
Kush lakmon, gabon.	Përemër pyetës + folje + folje (fjal)	
Shprehje frazeologjike	Sinonimi i saj	Ndërtimi gjuhësor
la krisi vrapit, sa më hanë këmbët...	Iku me shpejtësi.	Grupe foljore.
Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit të të kuptuarit të përrallës, analizën e saj ideore, atë të personazheve, gjuhës së përdorur, si dhe reflektimin rreth saj.		
Detyrë: Pse na duken të vërteta ndodhitë e përrallave? Si lidhen ato me jetën e përditshme?		

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Ivani dhe lëkura e fokës</i> Përrallë Skoceze (B. Trout)		Situata e të nxënit: Përrallat botërore	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon për të identifikuar përrallën si lloj të letërsisë gojore; -zbërthen strukturën e përrallës; -dallon organizimin e përrallës sipas rendit kronologjik; -përcakton mesazhin e përrallës; -analizon gjuhën e përrallës.		Fjalët kyçe: <i>Peshkatari, nata e Mesverës, guva, lëkurë foke, deti.</i>	
Burimet: Teksti i nxënësit, përralla nga autorë të huaj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Folklori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Pema e mendimit -Diskutim -Lexim i drejtuar - Stuhi mendimesh - Punë me tekstin -Punë me grupe, Punë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimi ➤ Hapi i parë: Rikujtojmë njohuritë që kemi marrë për përrallat. Pema e mendimit:			

Tregime popullore ku gërshetohen elementët realë me ato fantastikë

keqes

së shëmtuarës

pozitiv- negativ

Figuracion i fuqishëm

Mbizotëron fryma e aventurës

Ka të papritura

Përralla

Tema: a) e mira kundër së

b) e bukura kundër

c) virtyti kundër vesit

Personazhet:

Struktura: hyrje-zhvillim-mbyllje

Hapi i dytë: Diskutim

Nxënësit tregojnë përralla që ua kanë treguar gjyshërit ose prindërit kur kanë qenë të vegjël. Dëgjohen përrallat e treguara në mënyrë të përmbledhur.

Hapi i tretë: Lexim i drejtuar

Mësuesi/ja zgjedh dy nxënës për të lexuar zinxhir përrallën.

Gjatë leximit, nxënësit nënvizojnë figurat letrare (ato që kanë marrë), shprehjet frazeologjike etj.

Hapi i katërt: Stuhi mendimesh. Për të kuptuar përrallën i drejtojmë pyetje klasës:

- Ku zhvillohet kjo përrallë?
- Cilët janë personazhet e përrallës?
- Kur vendos të shkojë djali te puna?
- Pse iku vajza në fund të përrallës?
- A ju kujton ndonjë përrallë shqiptare ky fragment? (Vajza e liqenit ose Gërzhetëza)

Hapi i pestë: Punë me tekstin

Nxënësit marrin njohuri për detajet dhe rolin e tyre në përshkrim.

Detaji është pjesë e diçkaje (hollësi) dhe shpreh një kuptim të veçantë. P.sh., detaje të përmbajtjes, detaje të paraqitjes së

personazheve, detaje të përshkrimit të natyrës etj.

Punohet me pyetjen: Cili detaj tregon prejardhjen e vajzës?

Rendi kronologjik është renditja e ngjarjeve sipas rrjedhës së tyre në kohë. Në një rrëfim ngjarjet rrëfohen në rend kronologjik ose jo.

Nxënësit ndalen në momentet që kërkojnë pyetjet e dhëna në ushtrimin 3. Përshkruhet shkurtimisht se çfarë ndodh në secilën kohë.

Shkruhet në tabelë, përkufizimi për mesazhin.

Mesazhi i një krijimi letrar është ideja, mësimi, morali që përcillet te lexuesi.

Hapi i gjashtë: Punë në grupe. Klasa ndahet në tre grupe

Grupi i parë shpjegon me fjalë të tjera kuptimin e secilës prej fjalëve në tabelë. (ushtrimi 6).

Grupi i dytë zgjedh në alternativat e dhëna mesazhin e pjesës.

Grupi i tretë dallon në tekst paragrafët me dialog, ato me rrëfim dhe përshkrim.

Hapi i shtatë: Punë e pavarur

Nxënësit plotësojnë tabelën sipas rubrikave të kuptimit: *Unë di - Unë dua të di më tej - Nga kjo gjë, unë mësova.*

Vlerësimi:

Në fund të orës së mësimi bëhet vlerësimi i disa nxënësve dhe për të parë përvetësimin e kësaj teme nga ana e tyre.

Detyrë: Mendoni sikur kjo përrallë të mbaronte në momentin: *Gruaja kishte ikur...* Shkruani një mbyllje tjetër, ku të tregoni se ku iku gruaja e Ivanit, duke ndjekur strukturën e mëposhtme:

Gruaja shkoi _____

Ajo shkoi, sepse _____

Ajo ndryshoi mendje, sepse _____

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Komandanti i klasës Jozef Ruth		Situata e të nxënit: Bashkëbisedim rreth përvojave personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -shkruan nga një fjali përmbledhëse për paragrafët e saj; -ritregon pjesën duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse; -përshkruan karakterin e personazhit duke bërë lidhjen ndërmjet paraqitjes së jashtme dhe botës së tij të brendshme; -dallon cilësitë e personazhit kryesor; -interpretos arsyet që e shtyjnë personazhin në veprim; -gjen në tekst fraza të përdorura për të përshkruar personazhin, të cilat janë shprehje të figurshme; - reflekton duke dhënë argumente rreth problemit kyç të temës.		Fjalët kyçe: -shkollë; -shembull; -komandanti i klasës; -ambicie; -plan;	
Burimet: teksti mësimor, fotografi, laptop.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimi -Bashkëbisedim -Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimi			
Zhvillohet një diskutim rreth pyetjeve: Si veproni për të fituar vlerësimin e shokëve dhe shoqeve të klasës? Ambicia është një cilësi negative apo pozitive? Diskutoni duke argumentuar përgjigjet tuaja. Ndërtimi i njohurive të reja: → Prezantimi i pjesës së re Zhvilloj një bisedë hyrëse në të cilën prezantoj titullin e tregimit “ Komandanti i klasës ”. Në këtë tregim, autori austriak Jozef Ruth rrëfen historinë e Antonit, një nxënës i rregullt e me rezultate shembullore, por që mban brenda vetes një qëllim e dëshirë të fshehur: të bëhet senator. Lexojmë tekstin për të zbuluar se si do të veprojë Antoni për t’i zënë vendin shokut të tij. → Lexim shprehës i tekstit			



Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm (me shpejtësinë dhe intonacionin e duhur).

Pyes për përshtypjet e para rreth tekstit:

- A ju pëlqeu ky tregim?

- Çfarë ju pëlqeu më shumë?

→ **Fjalët dhe shprehjet e reja**

U kërkohet nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja. Shkruhen fjalët në dërrasën e zezë, zbërthehet kuptimi i tyre dhe nxënësit formojnë fjali me to.

→ **Kuptimi**

Ndaj nxënësit në grupe dhe secilin grup u caktoj për të punuar ushtrimet nga teksti.

Grupi I: U lë kohë ta rilexojnë në heshtje pjesën për formuluar nga **një fjali përmbledhëse** për katër paragrafët e saj.;

Ritregohet pjesa duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

Grupi II: Përshkruhet karakteri i personazhit duke bërë lidhjen ndërmjet paraqitjes së jashtme dhe botës së tij të brendshme.

Dallohen cilësitë e personazhit kryesor.

Grupi III: Interpretohen arsyet që e shtyjnë personazhin në veprim.

Grupi IV: Gjehen në tekst fraza të përdorura për të përshkruar personazhin, të cilat janë shprehje të figurshme.

Grupi V: Reflektohet duke dhënë argumente rreth problemit kyç të temës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Pasi punojnë, nxënësit lexojnë punët e tyre.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi për formulimin e **fjalive përmbledhëse** sipas paragrafët të saj, ritregimin e pjesëve duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse, portretizimin e personazhit kryesor, interpretimin e arsyeve që e shtyjnë personazhin në veprim, gjetjen e frazave të përdorura për të përshkruar personazhin, të cilat janë shprehje të figurshme, reflektimin me argumente rreth problemit kyç të temës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Për secilin nga llojet e mëposhtme të shkrimit, është dhënë një situatë. Zgjidhni si detyrë atë që ju pëlqen më shumë.

- Një letër drejtuar mësuesit/es në të cilën i kërkoni falje për mungesën e sinqeritetit në një situatë.
- Një rrëfim të shkurtër nga përvoja juaj, kur keni bërë plane të pandershme për të arritur një qëllim.
- Një shkrim argumentues në të cilin mbronni tezën se ambicia e tepruar shpesh të çon në rrugë të gabuar.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Çmimet R.J. Palacio		Situata e të nxënët: Vlerat njerëzore	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - lexon rrjedhshëm dhe me intonacion; -shpreh ndjenjat dhe përjetimet pas leximit; -interpretin gjendjen shpirtërore të personazhit kryesor; -zbërthen kuptimin e fjalëve të personazheve; -reflekton rreth personazheve,cilësive të tyre; -interpretin gjuhën e tekstit; -analizon mesazhet që përcjell ky fragment.		Fjalët kyçe: <i>Ndarja e çmimeve, medalje, miqësi, mirësi, karakter.</i>	
Burimet: Teksti i nxënësit, libri “Mrekullia”, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Diskutim -Prezantimi i pjesës -Lexim i drejtuar -Stuhi mendimesh -Praktikë e drejtuar - Praktikë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kontrolli i detyrave të shtëpisë. Lexohen disa detyra duke diskutuar më parë rreth tyre.			
Diskutim. Diskutojmë me nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Çfarë vlerësojmë më shumë te një njeri: Pamjen e jashtme apo sjelljen dhe veprimet e tij? ➤ A do të pranoje të kishe një shok/ shoqe, që ka probleme të caktuara, të të folurit, të të dëgjuarit, apo të paraqitjes së jashtme? 			
Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Prezantimi i pjesës.</i> Në fillim njihemi me jetën dhe veprën e Palaços. Autorja ka arritur të trajtojë me mjeshtëri në këtë roman jetën e Agusit. Libri “Mrekullia” është ribotuar 40 herë në ShBA, ku ka shitur mbi një milionë kopje, duke u renditur në listën e librave më të shitur në SHBA. Agustin Pollman ka lindur me disa deformime të rënda në fytyrë, por ëndërron të jetë një fëmijë si gjithë të tjerët. Ai është mësuar me vështrimet dhe me shakatë e hidhura, e megjithatë tmerrohet kur prindërit i thonë që e kanë regjistruar në shkollë. Për shkak të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe pamjes së tij, ai nuk ka mundur të shkojë në shkollë, por është shkolluar në shtëpi. Tan që ka mbushur 11 vjeç prindërit e bindin që ai tu bashkohet fëmijëve të zakonshëm dhe kështu fillon aventura e Agit në shkollën Bicher Prep. Ky roman përmban mesazhe të rëndësishme për të gjithë. Të rriturve u rikujton se sa mizore mund të jetë bota e fëmijëve, sidomos kur këta janë “të veçantë” dhe se sa dhimbje mund të mbartë ajo. Ndërsa fëmijëve u jep mesazhe ndërgjegjësimi, tolerance dhe miqësie që në kohëra si këto tonat janë gjithmonë e më të rralla.			
Libri me një fjali: Nëse mund të zgjedhësh midis sjelljes me drejtësi dhe sjelljes me mirësi, zgjidh mirësinë.			
Lexim i drejtuar: Lexojmë pjesën me role, me intonacionin e duhur duke nënvizuar dhe fjalët e reja. Më pas i shpjegojmë ato:			

Akivist – Veprimtar, anëtar i një komuniteti.

Skllavëri – mungesa e lirisë.

i paepur - që nuk trembet nga vështirësitë, pengesat etj.

Punë me tekstin

Stuhi mendimesh:

1. Ku zhvillohen ngjarjet?
2. Cilët janë personazhet?
3. Cilat janë çmimet që merren?
4. Kush është Agustin Pullman?
5. Çfarë çmimi fiton ai?
6. Ç'do të thotë ky çmim për të?

Praktikë e drejtuar

Pyetja e shtatë - Mësuesja drejton pyetjen:

A do të besojnë të tjerët që ai është njësoj si ata përtej pamjes së jashtme?

Nxënësit japin mendimin e tyre.

Praktikë e pavarur

Pyetja e tetë. Nxënësit gjejnë pjesën që u pëlqen më shumë duke argumentuar përse zgjodhën atë pjesë.

-Shpjegoni pse madhështia është e vështirë të vlerësohet.

Përgjigje: Madhështia është një virtut i rrallë. Ajo qëndron në thjeshtësinë dhe jo mendjemadhësinë. Sa më i thjeshtë , aq më i mençur është njeriu. Populli ynë thotë: Kalliri bosh e mban kokën përpjetë.

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori gjatë rrëfimit, si dhe reflektimin rreth temës.

Detyrë: Tregoni raste në shkollën tuaj të dhënies së çmimeve për vullnetarizëm apo shërbime të ndryshme ndaj shkollës dhe komunitetit.

Sillni në vëmendjen e të gjithëve disa lloje çmimesh që mbajnë emra të personave të njohur, rrëfeni kontributet e tyre dhe shpjegoni lidhjen e emrit të çmimit me kontributin.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Përmbytja</i> I.Kadare		Situata e të nxënit: Rreth Gjirokastrës, qytetit të gurtë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 3.Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon pjesën për t'iu përgjigjur pyetjeve të saj kuptimore;		Fjalët kyçe: Pika shiu,pullaz,rrokullisen,sterna,gjyshja,ki amet.	

-analizon personazhet dhe sjelljet e tyre në fragment; -interpretion fjalët dhe frazat e dhëna të përdorura në tekst; -dallon paragrafët ku rrëfëhet nga ata ku përshkruhet; -reflekton rreth ideve të pjesës.		
Burimet: Teksti i nxënësit, foto nga Gjirokastra, videoprojektor, materiale për Kadarenë etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Historia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diskutim - Stuhi mendimesh- Punë në grupe – Praktikë e drejtuar – Praktikë e pavarur		
Organizimi i orës së mësimit:		
Hapi I: Diskutim <ol style="list-style-type: none"> 1. Kush nga ju ka vizituar Gjirokastrën? Keni fotografi ose pamje nga qyteti i gurtë? - Nxënësit janë të lirë të japin mendimin e tyre. 		
Hapi II : Ndërtimi i njohurive të reja. Nxënësit njihen me jetën dhe veprën e I.Kadare. <p>I.Kadare u lind në Gjirokastër, më 28 janar 1936, në një familje të mesme qytetase. Ka mbaruar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Fillimisht njihet si poet: “ Frymëzimet djaloshare”, “ Shekulli im “, “ Përse mendohen këto male “ etj.</p> <p>Më pas ai filloi të shkruante në prozë, me suksesin e tij të parë, romanin “ Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “ Kronikë në gur”, “ Kështjella”, “Dimri i madh “ etj. Është për të disatën herë kandidat për çmimin “ Nobel”.</p> <p>“ Përmbytja “ është një fragment nga romani “ Kronikë në gur”. Ngjarjet zhvillohen në qytetin e Gjirokastrës, gjatë Luftës së II Botërore. Gjithçka shihet me sytë e një fëmije. Ndodhitë i lidh rrëfimtari. Romani flet për njerëzit, jetën dhe zakonet e kohës, herë me ngjarje të thjeshta, herë të zmadhuara. Vepra ka ngjyra dhe përcjell optimizëm.</p>		
Hapi III- Lexim i drejtuar. Nxënësit lexojnë zinxhir tekstin për t`u njohur dhe për ta kuptuar më mirë atë. Gjatë leximit nënvizojmë dhe fjalët e reja. Pas përfundimit të leximit shpjegojmë kuptimin e fjalëve të reja. <p><i>Lug – ulluk.</i></p> <p><i>Sternë – depo e gërmuar në tokë për të mbledhur dhe ruajtur ujën e shiut.</i></p> <p><i>Bishtuk – kandil i thjeshtë etj.</i></p>		
Hapi IV.Stuhi mendimesh. <ol style="list-style-type: none"> 1. Pas përfundimit të leximit për të kuptuar a është kuptuar si duhet ky tekst, i drejtojmë klasës disa pyetje. <ul style="list-style-type: none"> • Kur zhvillohen ngjarjet? • Çfarë po ndodhte në shtëpi? • Cilët janë personazhet që marrin pjesë? • Ç’rol luan gjyshja gjatë përmbytjes? • Si u arrit të shpëtohej nga përmbytja? 2. Nxirrni nga teksti informacionin që e parapërgatit lexuesin për përmbytjen. 		
<pre> graph TD A[Detajet] --> B[Pikat e shiut gjendeshin befaz në lugun e ngushtë] A --> C[Babai mënjanoi lugun] A --> D[Ujë të ëshhtë ngjitur deri te gryka] </pre>		
Hapi V. Punë në grupe <p>Grupi I : Të zgjerojnë kuptimin e shprehjeve të mëposhtme: Çdo të keqeje në këtë botë i gjendet shërimi –Njeriu në saje të vullnetit të vet arrin gjithçka.</p>		

M'u ngroh zemra kur pashë kaç njerëz - U ndjeva mirë në praninë e të tjerëve.

Grupi II: Të analizojnë tekstin.

Të gjejnë në fragment ngjarjen dhe të tregojnë se si përshkruhet ajo.

Përgjigje - Sterna ishte mbushur me ujë dhe rrezikonte të përmytje gjithë shtëpinë. Ajo përshkruhet nëpërmjet gjuhës së fëmijës në mënyrë naëve. Ai i shpirtëzon pikat e shiut dhe duket sikur flet me to.

Grupi III: Të interpretojnë tekstin.

Si e përjetojnë personazhi kryesor dhe pjesëtarët e tjerë të familjes përmytjen në shtëpinë e tyre?

Djalit gjithçka i duket normale, nuk kupton shumë se çdo të ndodhte po të mbushej sterna, është gjyshja ajo që e qetëson.

Të tjerët vraponin për të shpëtuar shtëpinë. Më e frikësuar është nëna (nëna lëshoi një klithmë të vogël).

Hapi VI. Punë e pavarur

8. Të plotësojnë tabelën me disa mbiemra që përshkruajnë qytetin dhe shpjegoni rëndësinë që ka secili prej tyre.

Mbiemri	Shpjegimi
I pjerrët	Vend i pjerrët që zbret tatëpjetë.
E murrme	Ngjyrë e mbyllur si në të zezë.


9. Të rrëfejnë ndodhi nga fëmijëria e tyre.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimi nxjerrim konkluzionet në bazë të atyre objektivave që ne parashtruar në krye, ku së bashku me nxënësit rikujtojmë edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur ato që mësuam. Bëjmë vlerësime për disa nxënës.

Detyrat: Kadare spikat si shkrimtar që krijon shumë neologjizma ose fjalë të reja. Gjeni dy fjalë të tilla në këtë fragment ose nga krijimtaria e autorit dhe shpjegoni kuptimin e tyre.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
1. Tema mësimore: <i>Ana flokëkuaja</i> Lusi Mod Montgomeri		Situata e të nxënës: Diskutojmë rreth jetës në shkollë, marrëdhënieve mes shokëve dhe shoqeve të klasës.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç			
1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i>			
2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i>			
3. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: -dallon pohimet e sakta lidhur me përmbajtjen e pjesës; - duke u nisur nga shprehjet e përdorura nga autori, portretizon personazhin; -shkruan në kuptimin e drejtpërdrejtë shprehjet e figurshme të dhëna; - vlerëson sjelljen e personazhit dhe imagjionon veten në vend të njërit prej personazheve.		-nxënë; -dështim; -bishtalecit të gjatë e të kuq; -bërtiti e zemëruar; -u tall; -e vendosur;	

<p>Burimet: teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, libri “Ana flokëkuqja”. Mund të ndiqen episode filmike në linkun: https://www.youtube.com/watch?v=qdglss_WHjU</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Diskutim paraprak -Lexim për të kuptuar tekstin -Ditari dypjesësh</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim paraprak Rrëfëni përvoja personale të raporteve që keni me njëri-tjetrin në klasë. Kujtoni përmbajtjen e pjesës “Kur isha fëmijë” të autorit Karlo Kolodi, që keni zhvilluar në klasën e shkuar.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim për të kuptuar tekstin, Ditari dypjesësh Prezantoj titullin e pjesës dhe me pak fjalë përmbajtjen e saj.</p> <p>Ky fragment është shkëputur nga romani “Ana flokëkuqja”, i autores kanadeze Lusi Montgomeri. Ana Shirli është një vajzë e vogël jetime, e cila sapo ka filluar një jetë të re. Pas një jete të vështirë, fati po tregohet i mirë me Anën, ajo ka pranë kujdesin dhe dashurinë e njerëzve që e birësuan, ngrohtësinë e shoqes së saj të ngushtë, Dianës, por jo gjithçka është kaq e lehtë në botën që e rrethon. Në shkollë Anës i duhet të përballet me një realitet krejt të panjohur. Portreti dhe personaliteti i saj ngacmojnë kureshtjen e Gilbertit, djalit të bukur dhe të pëlqyer për vajzat e klasës, por njohja e tyre nuk është aspak e mbarë. Çfarë do të ndodhë mes Anës me flokë të kuqe dhe Gilbertit? Lexohet pjesa me intonacionin e duhur. Shkruhen në tabelë fjalët e reja dhe përdoren ato në fjali. Mbështetur në frazat e dhëna në tabelën e ushtrimit 2, plotësohen cilësitë e Anës, personazhit kryesor.</p>	
<p>Shprehjet</p> <p>Nuk është sjellje e bukur t`i shkelësh syrin një vajze që nuk e njeh. ...ajo po endej larg, në një ëndërrim të mrekullueshëm. Ana e vështroi e hakërryer Ajo nuk qau, as nuk e vari kokën Ana doli jashtë duke e mbajtur lart kokën e saj të kuqe Unë nuk do ta fal kurrë Gilbert Blithin</p>	<p>Cilësitë e personazhit</p> <p>Njeh, respekton dhe vlerëson etikën e sjelljes. Ana është vajzë ëndërrimtare, plot imagjinatë. Ana ka karakter të fortë, ajo zemërohet nga padrejtësitë. Ana është vajzë krenare.</p> <p>Zemërimi i Anës është i fortë, ajo nuk i ndryshon lehtë mendimet e veta.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësi/ja jep vlerësime rreth dy personazheve. Gjithashtu vendoset në pozicionin e njërit prej tyre dhe imagjinojnë mënyrën e tij të sjellurit në situatën e rrëfimit.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështetet në dallimin e pohimeve të sakta lidhur me përmbajtjen e pjesës, portretizimi i personazhit, shkrimi i kuptimit të drejtpërdrejtë për shprehjet e figurshme të dhëna, vlerësimi i sjelljeve të personazhit.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:Shkruani një mbyllje tjetër për fragmentin. Ndryshoni rrjedhën e ngjarjeve, duke u kujdesur që varianti juaj të jetë sa më interesant.</p>	

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Plaku i Ylynecit L. Skëndo (Mithat Frashëri)		Situata e të nxënësve: Historia e popullit shqiptar	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: -lexon pjesën për t'iu përgjigjur pyetjeve për kuptimin e saj; -ritregon ngjarjet kyçe të pjesës; -ritregon pjesën përmes pikave kryesore të përmbajtjes; -shpjegon kuptimin e një paragrafi të caktuar shkurtimisht; -portretizon personazhet; -analizon simbolikat e personazheve -dallon elementët dramatikë, si pjesë përbërëse e tregimeve të Lumo Skëndos.		<i>Shkëmbi i Ylynecit, gojëzezë, fushëgëzim, lumturi</i>	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, materiale për jetën e Lumo Skëndos, videoprojektor.		<ul style="list-style-type: none"> • Historia • Gjeografia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
-Kontroll njohurish -Situata e të nxënësve -Lexim i drejtuar -Stuhi mendimesh -Praktikë e drejtuar -Praktikë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>Hapi i parë. Kontrolli i detyrave të shtëpisë. Lexojmë dhe diskutojmë disa prej tyre.</p> <p>Hapi i dytë. Kujtojmë historinë e popullit tonë. Në videoprojektor shohim pamje filmike ose foto që japin informacion rreth historisë së Shqipërisë.</p> <p>Hapi i tretë. Informacioni i ri</p> <p>Marrim një informacion të shkurtër për jetën e Mit'Hat Frashërit dhe prozën e tij:</p>			
<p>Mit'Hat Frashëri i njohur në letërsinë shqipe me pseudonimin Lumo Skëndo u lind në Janinë dhe në moshën tre vjeçare shpërngulet me familjen në Stamboll. Ka punuar në administratën Turke.</p> <p><i>Veprat: Hi dhe shpuzë, Novela dhe kujtime, Plagët tona; Ese etj.</i></p> <p>Tregimi <i>Plaku i Ylynecit</i>, rrok temën e Shqipërisë. Në të flitet për mërgimtarin që kthehet në atdhe dhe në ndalesën e tij të parë ndeshet me një plak të moçëm. Nga biseda me të dhe pamjet që ka përballë, kuptojmë se ai sheh dy realitete, Shqipërinë e djeshme dhe të sotme. Autori përcjell mesazhin se Shqipëria qëndron mbi çdo fat që i ka sjellë koha.</p> <p>Hapi i katërt. Lexim i drejtuar. Lexojmë fragmentin zinxhir me intonacionin e duhur. Gjatë leximit nënvizojmë fjalët e reja, i shpjegojmë ato duke i përdorur dhe në fjali.</p> <p><i>Qasme</i> – afrohu.</p> <p><i>Pelegrin</i> – ai që shkon në kohë të caktuar në vende të ashtuquajtura të shenjtja.</p> <p><i>Brerore</i> – rreth i shkëlqyer që shihet për qark një sendi të shndritshëm</p> <p><i>Huruvejkë</i> – kukuvaikë.</p> <p><i>Ekspres</i> – shprehi .</p> <p><i>Inoçente</i> – i pafajshëm.</p> <p>Hapi i pestë. Punë me tekstin. Stuhi mendimesh.</p> <p>Mësuesja i drejton pyetje klasës</p>			

1. Ku dhe kur zhvillohet ngjarja?
2. Në ç'vetë tregohet ajo?
3. Me kë bisedon autori?
4. Çfarë fshihet brenda shkëmbit?
5. Si quhej foshnja në djep?

Hapi i gjashtë. Reflektimi kuptimor

Pyetja e gjashtë: Çfarë ka parë plaku i Ylynecit? – Ai ka parë gjithçka...

Ç'përfaqësonte plaku? - kohën (ilustrojeni me fjali nga teksti).

Hapi i shtatë. Punë e pavarur

Portretizo:

plakun – mjekër të bardhë si dëborë mali, sytë e kaltër si ujët e Vjosës, flokë të bardhë, por fytyrë djaloshi. shkëmbin – një pìrg i trashë, i madh, madhështor me një bukuri të egër e të çuditshme.

Vlerësimi:


Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore.

Detyrë: Proza “Plaku i Ylynecit” përngjan me përrallën. Gjeni detaje që ju fusin në botën e përrallës.

Data:

DATA:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zbulimi i një të fshehte shekullore Petro Marko (ora e parë)		Situata e të nxënit: Rrëfime rreth lavdisë së kohës së ilirëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit</i> 3. <i>Kompetenca e të nxënit</i> 4. <i>Kompetenca qytetare</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon pjesën dhe u përgjigjet pyetjeve; -interpretin cilësitë e personazheve mbështetur në fjalët e tyre; -plotëson hartën e personazheve të pjesës.		Fjalët kyçe: -peshkatori plak; -shpella; -det; -piratët; -beteja; -luftëtarët; -guxim;	
Burimet: Romani “ Shpella e piratëve”, teksti mësimor, tabela e zezë, fletore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Historia • Gjeografia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Diskutim -Lexim në heshtje - Të nxënësit me këmbime - Rrjeti i diskutimit			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: -Diskutim

A keni lexuar apo dëgjuar për piratët?

Dëgjoj diskutimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: -Lexim në heshtje -Punë e drejtuar

Prezantoj shkurtimisht pjesën.

Pjesa e mëposhtme është shkëputur nga romani “ Shpella e piratëve” i autorit Petro Marko. Në qendër të rrëfimit është një grup i guximshëm fëmijësh, të cilët gjatë ekspeditës së tyre përballen me të papritura interesante, zbulojnë plot të fshehta, vende e ndodhi që i

takojnë një kohe të shkuar. Shoqëruesi i përhershëm i tyre është një peshkatar plak, i cili i frymëzon dhe i ndihmon në aventurat që ia lënë vendin njëra-tjetrës.

Lexohet pjesa në heshtje nga nxënësit.

Pas leximit të pjesës, diskutohet në grup për përgjigjet e ushtrimit 1, i cili synon zbërthimin e kuptimit të saj.

-Cila është e fshehta e Shpellës së Piratëve?

...kapedan Gjikë Gjonbaba, që guxonte të futej shpeshherë në shpellë, na paskësh thënë se nga e majta e Shpellës është një shkallë e në fund të shkallës një hyrje. Atje na paska ndezur një direk karave prej pise, e si e ndezi, doli menjëherë jashtë, hipi në majë të Karavait, atje lart, dhe vuri re në çdo skutë, se mos dilte gjëkund tym. Dhe, siç thotë gojëdhëna, tymi doli nga e majta e fshatit të vjetër. Zbriti nga maja e Karavait, shkoi atje ku dilte tymi dhe gjeti daljen e Shpellës së Piratëve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur -Të nxënësit me këmbime - Rrjeti i diskutimit

Grupi I vijon me përgjigjet e ushtrimit 1.

Grupi II dhe Grupi III

plotëson hartën e personazheve të tregimit.

Personazhi	Si është?	Çfarë thotë?	Çfarë bën?	Ku duket kjo?
Peshkatar	I dashur, i komunikueshëm, trim,	U rrëfen djemve rreth jetës së tij pranë detit.	Qëndron pranë djemve dhe udhëheq ata në aventurat, në zbulim të Shpellës së Piratëve.	Ilustrime nga teksti.

Grupi IV punon ushtrimin:

- Çfarë cilësish të fëmijëve tregon fraza: “Ne do të futemi dhe do të dalim!”

-Fjalët e fëmijëve dëshmojnë kurajën dhe guximin e tyre.


- Po ju, a keni ndërmarrë nisma të tilla? Vetëm apo në grup?
Nxënësit përgjigjen në formën e një rrjeti diskutimi.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e sakta rreth pyetjeve kuptimore të pjesës, interpretimin e cilësive të personazheve mbështetur në fjalët e tyre, plotësimin e hartës së personazheve të pjesës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Prezantoni në formë të shkruar apo me fotografi informacione dhe fakte për temën: “Shpella e Piratëve”.

Data:
PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zbulimi i një të fshehte shekullore Petro Marko (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Rrëfime rreth lavdisë së kohës së ilirëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit</i> 3. <i>Kompetenca e të nxënit</i> 4. <i>Kompetenca qytetare</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -prezanton materialet e gjetura dhe të përpunuara rreth temës; -rrëfen subjektin mbështetur në strukturën: hyrje, zhvillim, mbyllje; - interpreton kuptimin e shprehjeve të figurshme të përdorura në fragment; - përcakton llojin e figurave letrare të përdorura gjatë rrëfimit.		Fjalët kyçe: -peshkatari plak; -shpella; -det; -piratët; -beteja; -luftëtarët; -guxim;	
Burimet: Romani “ Shpella e piratëve”, teksti mësimor, tabela e zezë, fletore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Historia • Gjeografia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Prezantim -Leksion i përqendruar -Punë e pavarur -Ditari dypjesësh			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Prezantohen në klasë materiale të ndryshme rreth piraterisë në kohën e sundimit romak. Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar Rrëfëhet subjekti, duke u mbështetur në hyrjen, zhvillimin, mbylljen. <i>Autori ka përdorur teknika shprehëse për të mbajtur lart tensionin e rrëfimit. Kështu përdoren:</i> Fjalitë e thjeshta dhe të shkurtra. Situata të papritura që lënë në pritje lexuesin. Ritëm rrëfyes i ngadaltë. Gjuhë e pasur figurative. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: -Punë e pavarur –Ditari dypjesësh Punohet me gjuhën dhe mjete stilistike të përdorura nga autori gjatë rrëfimit. • Shpjegoni kuptimin e frazave të mëposhtme dhe përcaktoni ç’figura letrare janë ato. <i>U ngopa me erën e jetës –(u ndjeva i kënaqur nga bukuria e peizazhit) – figura letrare e metaforës</i> <i>Ilustrimi në tekst: U ngopa me erën e jetës dhe me shpejtësi delfinësh arrita, ja, këtu ku jemi tani.</i> <i>kisha vendosur t’i merrja me vete në fund të detit –(doja t’i mbaja të fshehta) – figura letrare e hiperbolës</i> <i>Ilustrimi në tekst: – Këto që po ju tregoj unë, kisha vendosur t’i merrja me vete në fund të detit...po më mirë po ua lë juve, se ju jeni trima, ju jeni stërnipërit e gjyshërve tanë kapedanë.</i>			
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në prezantimin e materialeve rreth temës, rrëfimin e subjektit mbështetur në strukturën: hyrje, zhvillim, mbyllje, interpretimin kuptimor të shprehjeve të figurshme të përdorura në fragment, përcaktimin e figurave letrare të përdorura gjatë rrëfimit.</i>			
Detyrat dhe puna e pavarur: Edhe pas orës së dytë, vijon gjetja e materialeve dhe informacioneve për “Shpellën e piratëve”. (Prezantoni në formë të shkruar apo me fotografi informacione dhe fakte për temën: “Shpella e Piratëve”)			

Data:


PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Bojaxhiu finok Mark Tuen		Situata e të nxënit: Rrëfime me aventura	
<p>1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i></p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -u përgjigjet pyetjeve dhe plotëson alternativat lidhur me të kuptuarit e pjesës; -interpreton se si i kupton dy fjalitë mbyllëse të pjesës; -diskuton dhe mban qëndrimin personal për përgjigjet e dhëna; - dallon emërtimet humoristike të përdorura nga autori për personazhin kryesor, momentin në të cilin shfaqen; - përcakton mjetin stilistik të përdorur në frazat e dhëna; -reflekton rreth tekstit duke argumentuar qëndrimin e tij ndaj temës.		Fjalët kyçe: -lyej murin; -oborr; -plan; -punë;	
Burimet: libri "Aventurat e Tom Sojerit", teksti, tabela e zezë, fletore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Imagjinatë e drejtuar - Shkrim në bazë të fjalëve kyç - Lexim me role -Punë e pavarur			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: -Imagjinatë e drejtuar - Shkrim në bazë të fjalëve kyç Krijoni një ngjarje të shkurtër, duke përdorur fjalët e dhëna: mur, furçë, dredhi, i varfër, shumë i pasur. Tregojeni atë para klasës. Pritshmëritë janë: nxënësi/ja lidh fjalët sipas imagjinatës së drejtuar. Ai në bazë të fjalëve kyçe improvizon ngjarje të shkurtra. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me role Prezantoj me pak fjalë thelbin e pjesës: Kjo pjesë është shkëputur nga libri "Aventurat e Tom Sojerit" i autorit amerikan Mark Tuein. Tom Sojeri, paraqitet në këtë rrëfim me një aventurë të re, sa të këndshme aq edhe dinake. Dredhia e Tomit këtë herë ka shpikur një mekanizëm të veçantë: ai vë të tjerët të bëjnë punën e tij. Por, si e ka arritur ai këtë? Lexohet me role pjesa. Shpjegohen fjalët e reja dhe përdoren ato në fjali. Punohet me pyetjet e nivelit kuptimor. Qëllimi i bisedës midis Tomit dhe Benit është: Beni kërkon të zbulojë shkakun e indiferencës së Tomit. Plani i Tomit është: Të shtiret sikur e pëlqen aq shumë punën që bën, sa nuk mund ta ndajë dot me të tjerët. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: -Punë e pavarur Ushtrime <ul style="list-style-type: none"> • Gjeni emërtimet humoristike të përdorura nga autori për personazhin kryesor. Në cilin moment të ngjarjes shfaqen ato? -artisti bojaxhi është përdorur për Tomin. -Beni i drejtohet: -E, or plak? <ul style="list-style-type: none"> • Si i kuptoni dy fjalitë mbyllëse të pjesës? 			

<p>Dy fjalitë mbyllëse në tekst: Kështu, pa menduar fare, zbuloi një ligj të madh që rregullon veprimet e njerëzve. Ky ligj thotë se: për të bërë që fëmija ose i rrituri ta dëshirojë ose ta pëlqejë një punë, duhet vetëm një kusht - që këtë gjë të mos e arrijë me lehtësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesa është e këndshme në tërë zhvillimin e saj, por aq më tepër në mbyllje ku autori përmbledh atë cfarë Tomi, personazhi kryesor nxjerr si mësim nga situata. Nuk është një ligj i shkruar, por një mësim plot humor dhe praktik për një aventurier si Tomi.
<p>Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e pyetjeve lidhur me të kuptuarit e pjesës, interpretimin kuptimor, diskutimin dhe mbajtjen e qëndrimit personal, dallimin e mjeteve stilistike, argumentimin e qëndrimit ndaj temës.</i></p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Tregoni me gojë ose me shkrim një ngjarje të lexuar, të dëgjuar ose të jetuar, tema e së cilës të trajtojë një aventurë gazmore.</p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zodiaku Mira Meksi		Situata e të nxënit: Zodiaku si bashkësi e yjeve.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon pjesën dhe i përgjigjet pyetjeve rreth saj; - përshkruan sipas autorit banorët e zodiakut; -përshkruan mjedisin e rrëfimit, duke ilustruar me fraza nga teksti; -gjen në tekst fjalitë nga janë shkëputur frazat e dhëna; shpjegon kuptimin e tyre dhe shkruani shprehjet sinonime; -shkruan fjalët dhe shprehjet që i përkasin fushës së gjeografisë.</p>		<p>Fjalët kyçe: -qielli; -toka; -yje; -muzikë; -Binjakët; -zodiaku; -Peshorja; -koha;</p> 	
<p>Burimet: Materiale të ndryshme rreth gjeografisë së yjeve, teksti, tabela e zezë, libri me fantazi “TEOTIHUAKANI, VENDI I DIELLIT”.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeografia 	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

-Diskutim – Lexim në heshtje dhe me zë të lartë -Punë në grupe -Imagjinatë e drejtuar - Prezantim**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim**

A i besoni horoskopit? Cilës shenje i përkisni? Shkruani shkurtimisht disa nga të dhënat e shenjës suaj dhe lexojini para klasës.

Dëgjoj diskutimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim në heshtje dhe me zë të lartë

Pjesa “Zodiaku” është shkëputur nga libri “Teotihuakani, vendi i diellit” i autores Mira Meksi. Zodiaku është brezi qiellor që ka dymbëdhjetë dhomëza, secila me emrin e saj. Dielli shkon si bujtës në këto dhomëza, kështu një muaj në çdo dhomëz, bëjnë dymbëdhjetë muaj, pra një vit të tërë. Dy personazhet: Syshpuza dhe Bolid Zemërhekuri (guri magjik) vizitojnë zodiakun dhe aty takojnë me radhë shenjat e zodiakut, ndër të cilët: binjakët, peshoren...

Lexohet pjesa me intonacionin e duhur.

Shpjegohet kuptimi i fjalëve të reja.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të nivelit kuptimor.

Punohen në grupe ushtrimet që analizojnë pjesën. Përcaktohet mjedisi i rrëfimit, i cili është fantastik.

Përshkruhet ai, duke u mbështetur në frazat nga teksti.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: -Punë në grupe -Imagjinatë e drejtuar - Prezantim

Punohet ushtrimi 4 për të analizuar gjuhën e tekstit.

Fraza Kuptimi Shprehja sinonime

shqeu sytë u habit hapi sytë

s'bënte asnjë lëshim korrekt nuk lëshonte pe

fët e fët shumë shpejt sa hap e mbyll sytë

Ushtrimi 5: Cili është shpjegimi juaj për fjalën: Observatori-kalendar? Ilustroni fjalinë në të cilën është përdorur kjo fjalë. Çfarë efekti mendoni se krijon kjo fjalë në gjuhën e rrëfimit?

Togfjalëshi është një sajesë e imagjinatës së autores. Fjalja në të cilën është përdorur në tekst është kjo: *Gjeografinë e qiellit mund ta njohësh vetëm nga kubeja e Observatorit-Kalendar, domethënë, s'e njeh dot hiç.*

Ky vend imagjinari, paraqitet si një pikë nga e cila mund të soditësh dhe kuptosh jetën e yjeve.

Shkruhen fjalët dhe shprehjet që i përkasin fushës së gjeografisë.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e sakta të pyetjeve rreth saj, përshkrimin sipas autorit të banorëve të zodiakut, përshkrimin e mjedisit të rrëfimit, gjetjen në tekst të fjalive nga janë shkëputur frazat e dhëna; shpjegimin e kuptimit të tyre dhe shkrimit të shprehjeve sinonime, shkrimit të fjalëve dhe shprehjeve që i përkasin fushës së gjeografisë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Krijojmë me imagjinatë Peshorja e Madhe e Kohës

Imagjinoni sikur vendosni në peshore kohën tuaj. Përshkruajeni atë.

- Renditni gjërat që i bëni gjatë ditës, p.sh.:

Unë luaj sport, qëndroj në shkollë, studioj, lundroj në internet, ushqehem, gatuj, pastroj dhe vë rregull në dhomën time, bisedoj me shokët/shoqet, vizatoj, i bie një vegle muzikore, këndoj, fle gjumë, ëndërroj, lexoj libra jashtëshkollorë, shoh TV, bëj pazar, shkruaj në ditarin tim, kujdesem për kafshën time shtëpiake, ofroj ndihmë vullnetare për komunitetin, ... (mund të shtoni edhe veprimtari të tjera).

- Përcaktoni kohën (në minuta), që zë secila në ditën tuaj. A mendoni se peshorja e kohës suaj është e mirekuilibruar?

Data:

PLANIFIKIMI DITOR


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Princi i vogël</i> A. S. Exupery		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin - planetet	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon pjesën dhe i përgjigjet pyetjeve rreth saj; -përshkruan personazhet nga këndvështrime të ndryshme; -zbulojnë fjalitë me humor në tekst; -analizojnë gjuhën e pjesës; -argumentojnë rreth thënieve të personazhit kryesor.		Fjalët kyçe: mendjemadhi, adhuruesi, princi i vogël, kapele, përshëndetje	
Burimet: Teksti i nxënësit, libri i Exuperisë, fletore, fotografi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Stuhi mendimesh -Imagjinatë e lirë –Diskutim -Lexim me role -Punë në grupe - Mendim i lirë – Punë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi I: Kontroll i detyrave të shtëpisë. Lexojmë disa nga detyrat e dhëna.			
Hapi II: Diskutim. Lexojmë kuptimin e fjalës “mendjemadh” në fjalor dhe më pas nxënësit japin mendimin e tyre rreth kuptimit të kësaj fjale. Mendjemadh – që i pëlqen shumë mendja e vet dhe nuk pranon a nuk përfill mendimin e të tjerëve, që kujton se është më i dituri, më i mençuri; që i duket vetja kushedi se ç’është. Pas diskutimit kalojmë në temën e re që ka lidhje pikërisht me mendjemadhësinë.			
Hapi III – Informacioni i ri			
Antoine de Saint Exupery (1900-1944):” Princi i vogël “ është vepra e fundit e autorit të njohur francez , botuar në vitin 1943 në gjallje të tij dhe përbën një tjetër hap të këtij krijuesi serioz për të përpunuar pikëpamjet e tij mbi botën dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve për t’ia parashtruar ato vëmendjes së lexuesve. Në qendër është një djalë i vogël që papritur takon princin, vizitor nga një planet tjetër. Princi i rrëfen djalit histori për planetet dhe histori të ndryshme rreth takimit të tij me Tokën. Historitë janë të çuditshme plot aventura, por mbi të gjitha edhe me këshilla të dobishme.			
Hapi III: Lexim i drejtuar. Lexojmë pjesën sipas roleve. Gjatë leximit nënvizojmë edhe fjalët e reja , të cilat më pas i shpjegojmë.			
<i>Monotoni</i> – të qenit gjithnjë i njëjtë, pa ndryshime e pa larmi.			
<i>Adhuroj</i> – kam dashuri të zjarre dhe nderim të madh për dikë.			
<i>Brohoras</i> – thërras e përplas duart në shenje miratimi a gëzimi për diçka ose për dikë.			
102			

Hapi IV- 1. Stuhi mendimesh

- Kush jetonte në planetin e dytë? (jetonte një mendjemadh).
- Çfarë ju bën përshtypje në pamjen e jashtme të mendjemadhit? (kapelja që mbante në kokë).
- Ç’detaj i kujton princit vizitën e mëparshme te mbreti? Ku duket gatishmëria e princit ndaj mendjemadhit?(përplasja e shuplakave)
- Shkruani fjalinë ku mendjemadhi shpjegon se ç’është adhurimi. (“Të adhurosh” do të thotë të pranosh që unë jam më i bukur, më i veshuri, më i kamuri dhe më i mençuri në tërë planetin).

Hapi V –2. Analizë teksti. Përshkruani natyrën e personazheve nga tri këndvështrime të ndryshme:


- Si del para jush natyra e princit të vogël dhe e mendjemadhit?



- Si e sheh mendjemadhi princin?



- Si e sheh princi mendjemadhin?



Hapi VI – Punë në grupe

Grupi I. Fragmenti ka nota humor. Zbuloni fjalitë që ju bëjnë të buzëqeshni dhe thoni pse ndodh kjo.

Fjalitë me humor	Si i kuptoni ju?
Sa kapele të lezetshme paskeni! Më duhet për të përshëndetur të tjerët. Për t’i përshëndetur kur më brohorasin.	

Grupi II. Gjeni shprehjet e princit të vogël që tregojnë zgjuarsinë e tij dhe jepni mendimin tuaj për këshillat dhe arsyetimet e tij të arta.

Princi i vogël	Shprehje të princit	Mendimi juaj për to
Arsyeton	Po që kapela të bjerë poshtë ç’duhet bërë?	
Jep këshilla	Të rriturit qenkan vërtet të çuditshëm.	

Hapi VI- Punë e pavarur – Gjuha e tekstit .

Shpjegoni të kundërtën që mbartin fjalët:

Mendjemadh – human

Princ i vogël –princ i madh

Fjala “mendjemadh” është e parme apo jo e parme?


Pyetje: Cili është mesazhi që përcolli ky fragment?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet për përgjigjet e sakta lidhur me kuptimin e pjesës, analizën e personazheve, formulimin e mesazhit të pjesës.

Detyrë: Lexoni fragmentin e dhënë në tekst dhe shkruani dhe ju një histori të ngjashme, ku mesazhi të jetë: Detyra është detyrë.

Data:


PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Sekreti i shtëpisë në ishull</i> Ransom Rigs (ora e parë)		Situata e të nxënit: Rrëfimet me mister	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 4. <i>Kompetenca digjitale.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -shkruhet zhvillimi i përmbledhur i ngjarjeve, sipas hyrjes, zhvillimit, mbylljes; -analizon tekstin , duke dalluar detajet që i shërbejnë idesë kyçe; - përcakton elementet e skemës së komunikimit për pjesën.		Fjalët kyçe: -histori; -të çuditshme; -jetimorja e Uellsit; -ishull; -gjyshi; -fotografi;	
Burimet: Romani me fantazi dhe mistere “Sekreti i shtëpisë në ishull”, teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Vëzhgim i materialit me videoprojektor - Punë e drejtuar - Punë e pavarur			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Vëzhgim i materialit me videoprojektor Ndiqni në klasë episodet e shkëputura nga filmat me mister dhe fantazi. Komentojini ato. Shfrytëzohet linku: https://www.youtube.com/watch?v=wVegDhDxLeU			
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar Kjo pjesë është shkëputur nga romani me fantazi dhe mistere “Sekreti i shtëpisë në ishull” i autorit bashkëkohor amerikan Ransom Rigs. Midis djalit dhe gjyshit ka një lidhje të veçantë. Gjyshi i rrëfen të nipit për jetën e tij, e cila nuk i ngjason aspak të zakonshmes. Jakobi jeton në dilemën e dy botëve, asaj reale dhe ireale, deri kur në rrjedhë të tyre, ngjarjet dhe sekreti i shtëpisë në ishull zbulohen... Lexoj pjesën me intonacionin dhe tonin e duhur. Shkruhet zhvillimi i përmbledhur i ngjarjeve, sipas hyrjes, zhvillimit, mbylljes.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur Punohen ushtrimet për të analizuar pjesën. • Fotografitë e gjyshit janë shumë të çuditshme. Çfarë i bën ato të besueshme? Detajet e përshkrimit dhe fjalët e gjyshit, mënyra se si ai i paraqet janë zgjedhje të autorit që i japin pjesës			

<p>ngjyrën e misterit dhe fantazisë.</p> <p>Ushtrimi3</p> <ul style="list-style-type: none"> Përcaktoni elementët e skemës së komunikimit për pjesën “Sekreti i shtëpisë në ishull”: Referenti: Fëmijëria dhe kujtimet e gjysh Portmanit <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 15px; padding: 5px; text-align: center;">Dhënësi: Autori</div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 15px; padding: 5px; text-align: center;">Mesazhi: Fantazia është një mënyrë për të kuptuar realitetin.</div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 15px; padding: 5px; text-align: center;">Marrësi: Ne, lexuesit</div> </div> <p style="text-align: center;">Kodi: Gjuha e shkruar</p>
<p>Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në shkrimin e zhvillimit të përmbledhur të ngjarjeve, sipas hyrjes, zhvillimit, mbylljes, analizës së tekstit, duke dalluar detajet që i shërbejnë idesë kyçe, përcaktimit të elementëve të skemës së komunikimit për pjesën.</i></p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni një tregim të shkurtër me fantazi dhe mister. Shoqëroni tregimin tuaj me fotografi apo skica, të cilat përshtaten me brendinë e tij.</p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Sekreti i shtëpisë në ishull</i> Ransom Rigs (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Rrëfimet me mister	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -zbërthen kuptimin e fjalëve të personazheve; -argumenton pohimin e dhënë nga autori; -vlerëson efektin që krijojnë ilustrimet figurative, imazhet në rrëfimet me fantazi dhe mister.		Fjalët kyçe: -histori; -të çuditshme; -jetimorja e Uellsit; -ishull; -gjyshi; -fotografi;	
Burimet: Romani me fantazi dhe mistere “Sekreti i shtëpisë në ishull”, teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Vëzhgim tekstor -Rrjeti i diskutimit -Punë e pavarur -Imagjinatë e drejtuar			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Vëzhgim tekstor Lexohen tregimet e gjetura me fantazi dhe mister. Vërehet në to mënyra e organizimit të subjektit, krijimit të mjedisit fantastik, personazheve dhe përshkrimit të tyre, stilit i cili duhet të përcjellë atmosferën e misterit dhe të ankthit.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Rrjeti i diskutimit</p>			

<p>Vijon punimi i ushtrimeve në tekst për të analizuar pjesën.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Autori, i cili rrëfen ngjarjen, në mbyllje të pjesës shprehet: <i>I besojmë përrallat, gjersa çmimi i këtij besimi rritet shumë...</i> <p>Si e kuptoni këtë pohim? Argumentoni.</p> <p>Përrallat janë kuptimi parë që fëmija merr për jetën. Në personazhet e tyre ai gjen të mirën dhe të ligën, mëson dhe nxjerre mesazhe që e ndjekin nga pas gjatë gjithë fëmijërisë. Realiteti për fëmijën është një ndërthurje me përrallat, ai do t'i besojë dhe ka nevojë ta bëjë këtë. Kështu edhe autori është rritur me to, ato kanë qenë realiteti i tij, derisa një ditë përballja me një realitet tjetër, atë ku jeton realisht i përplasat në fytyrë. Është ky moment kur kushton shumë të jetosh në botën e përrallës.</p> <p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: -Punë e pavarur -Imagjinatë e drejtuar Nxënësi/ja vlerëson efektin që krijojnë ilustrimet figurative, imazhet në rrëfimet me fantazi dhe mister. Komentohen fotografitë e tregimeve të sjella në klasë.</p>
<p>Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në zbrëthimin e kuptimit të fjalëve të personazheve, argumentimin e fjalëve të personazheve, vlerësimin të efektit që krijojnë ilustrimet figurative, imazhet në rrëfimet me fantazi dhe mister.</i></p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani rreth efektit që krijojnë ilustrimet në rrëfimin tuaj.</p>

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kërcimtarja e Dukagjinit E. Koliqi		Situata e të nxënit: Bukuria e gruas shqiptare	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon fragmentin me intonacionin përkatës; -dallon pikën kulmore të pjesës; -shpjegon përshtypjen e krijuar pas leximit të pjesës, duke ilustruar me fjali apo fraza për secilin rast; -portretizon figurën e Lules, duke përshkruar veprimet e saj; -interpretton gjuhën e tekstit.</p>		<p>Fjalët kyçe: Lulja, uj i kulluet, princa, zana, bajloza, flutura e Shqipnis.</p>	
<p>Burimet: Teksti i nxënësit, material për letërsinë e vjetër shqipe.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Folklori • Historia 	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimesh -Praktikë e drejtuar -Praktikë e pavarur</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi i parë: Flasim rreth autorit: **Ernest Koliqi** (Shkodër, 1903 - Romë, 1975) ishte mësues, poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, madje dhe dramaturg, ministër arsimit, botues dhe pedagog. Ndër veprat e tij mund të përmendim: *Tregtar flamujsh* (1935), *Pasqyrat e Narçizit* (1936), përmbledhja "Hija e Maleve", etj. Në shkrimet e tij Koliqi sjell një botë krejt origjinale shqiptare, të përcjellë me një gjuhë të thjeshtë dhe të pasur.

Hapi i dytë: Informacioni i ri. Nxënësit njihen me përmbajtjen e pjesës.

"Kërcimtarja e Dukagjinit" është një prozë e shkurtër (autori i quan: novela) e shkrimtarit Ernest Koliqi, në të cilën Skënderbeu shpall një konkurs për kërcimtare në të mirë.

Në fragmentin e mëposhtëm jepet momenti i kërcimit të Lules, mbesës së Lekë Dukagjinit, e cila dallon nga të gjitha kërcimtares e tjera, përfshirë dhe tyrkinën.

Lexohet pjesa dhe përmbledhet subjekti i saj.

Hapi i tretë: Lexim i drejtuar

Lexohet pjesa sipas paragrafëve dhe për secilin paragraf ndërtohet nga një fjali.

Hapi i katërt: Fjalët e reja

Shpjegohen fjalët e vjetra duke i përdorur ato edhe në fjali.

Hapi i pestë: Praktikë e drejtuar

Pyetja e parë: Portretizimi i Lules na shfaqet në dy anë; si vajzë dhe si kërcimtare. Jepni ndryshimet.

Pyetja e dytë: Nxënësi gjen paragrafët përshkrues në këtë fragment.

Hapi i gjashtë. Praktikë e pavarur.


Të përshkruajnë se si e imagjinojnë ata Lulen (portret fizik) dhe kërcimin e saj, i cili karakterizohet me krahët e shqiponjës dhe me bukurinë e zanave.

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori gjatë rrëfimit, si dhe reflektimin rreth temës.

Detyrë: Gjeni poezinë "Vallja shqiptare" të Ismail Kadaresë dhe kthejeni në prozë.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Mandolina e braktisur</i> Dhimitër Shuteriqi		Situata e të nxënit: Diskutojmë rreth dëshirave dhe pasioneve tona.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit</i> 3. <i>Kompetenca e të nxënit</i> 4. <i>Kompetenca qytetare</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		- mandolina; - pasioni; - një gëzim të patregueshëm; - kohë provimesh;	
- zhvillon imagjinatën e tij duke ndërtuar një tekst; - analizon përmbajtjen e pjesës, duke dhënë përgjigje të sakta; - përcakton figurat letrare.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Burimet: teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, libri "60 tregime në një" e shkrimtarit Dhimitër Shuteriqi.		• Muzika	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
-Stuhi mendimesh -Punë në grupe -Ditar dypjesësh**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi/ja u paraqet nxënësve fotografi ose vizatime të veglave muzikore (çifteli, klarinetë, mandolinë) duke u drejtuar pyetjen:

- Karakteristikë e cilës krahinë të Shqipërisë janë këto vegla muzikore?

Përgjigjet e sakta do të ishin: Çiftelia – Veriu Klarineta – Jug, Shqipëri e mesme Mandolina – Korçë.

Prej këtej, mësuesi/ja bën lidhje me temën e re të mësimin “Mandolina e braktisur”. Bëhet leximi zinxhir i pjesës. Gjatë kohës që lexojnë, nxënësit nëvizojnë fjalët të cilave nuk ua dinë kuptimin. Pas leximit punohet me fjalorin. Përdoret teksti për fjalët e shpjeguara në të, ndërsa fjalët e tjera të panjohura shkruhen në tabelë, u bëhet i njohur kuptimi dhe kërkohet që nxënësit të ndërtojnë fjali të ndryshme me to.

U drejtohet nxënësve një bllok pyetjesh për të zbërthyer kuptimin e përmbajtjes.

- Cili është qëndrimi i babait për pasionin e të birit?

- Çfarë ndodh me pasionin e tij për muzikën me kalimin e kohës?

- Çfarë emocionesh përjeton personazhi kur sheh pas shumë vitesh mandolinën?

Tregoni në mënyrë të përmbledhur ngjarjen që prej paragrafit të pestë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe, Ditar dypjesësh. Nxënësit të ndarë në dy grupe punojnë me ditarin dypjesësh. **G I** Bëni komentin tuaj për fjalinë e dhënë.

Fjalja	Komenti im
“Mandolina me zogjtë e saj të heshtur, me telat e saj të këputur sikur më qortonte rëndë e më thosh se i kisha dalë i pabesë.”	Marrëdhënia mes personazhit dhe mandolinës ishte aq e ngushtë sa largimi prej saj konceptohej si një tradhti. Mandolina ishte personi që personazhit tonë i largonte vetminë dhe i plotësonte çdo boshllëk...

G II Përcaktoni figurat letrare në frazat e dhëna.

Frazat.	Lloji i figurës letrare.
<i>Dashuria e muzikës kishte ndezur në mua një ndjenjë shumë të madhe, e cila më pushtoi të gjithin. ...mandolina ime u ringjall. Vetmia më peshoi përbrenda menjëherë ...mandolina ime dukej sikur ta kishin mbërthyer në vend fjetet e panumërta të merimangave.</i>	Metaforë Metaforë Similitudë Metaforë

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Nxënësi/ja jep vlerësime rreth personazhit kryesor, dëshirës dhe pasionit për t’i rënë mandolinës dhe përgjegjësisë për të ndjekur shkollën. Nxënësit imagjinojnë mënyrën e tij të të sjellurit në situatën e rrëfimit.

Vlerësimi:


Vlerësimi i nxënësit mbështet në idetë që përcjellin në lidhje me perceptimin e temës, zbërthimin kuptimor të shprehjeve të dhëna, përcaktimin e figurave letrare.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani pesë fjali, kryefjala e të cilave të jetë fjala: Muzika.

Psh: Muzika është arti i të menduarit nëpërmjet tingujve.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Çelësi i kopshtit Burnet		Situata e të nxënimit: Diskutim rreth rëndësisë që ka natyra për njeriun.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: 1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2.Kompetenca e të menduarit 3.Kompetenca e të nxënimit 4.Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -përmbledh ngjarjen sipas paragrafëve të dhënë; - dallon mesazhin që përcjell pjesa; - vazhdon rrëfimin e tekstit sipas imagjinatës së tij.		Fjalët kyçe: -vajza; - kopshti; - gushëkuqi; - kureshtje; - lule shumëvjeçare; - gëzim; - çelës i vjetër.	
Burimet: teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, libri “Kopshti misterioz” mund të ndiqen pamje filmike rreth mjedisëve natyrore(kopshti me imazhe të ndryshme ngjyrash”.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Biologjia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Imagjinatë e drejtuar -Lexim për të kuptuar tekstin -Ditari dypjesësh			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Imagjinatë e drejtuar. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë titullin e fragmentit: ÇELËSI I KOPSHTIT FRANCES. H. BURNETT U drejton nxënësve pyetjen: Si mendoni, çfarë tregon ky titull? Përshkruani imazhet dhe ngjyrat që përfitoni në vetëdijen tuaj. Nxënësit japin disa mendime, të cilat mësuesi nuk i kundërshton, por kërkon prej tyre të arsyetojnë për opinionet e dhëna. Më pas të bëjnë përqasjen ndërmjet saj dhe fragmentit të tekstit. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim për të kuptuar tekstin, Ditari dypjesësh. Mësuesi/ja informon nxënësit se ky fragment është shkëputur nga romani “Kopshti sekret” i autores anglo-amerikane Frances Hodgson Burnett. Midis Merit, protagonistes kryesore, natyrës dhe kopshtit ka lidhje të forta shpirtërore. Duke njohur e zbuluar kopshtin e mistershëm, paralelisht vajza zbulon plot të vërteta. Mrekullia e natyrës dhe magjia e pranverës transformojnë personalitetin e vështirë të vajzës duke rrëzuar muret e ftohta që i rrethonin shpirtin dhe duke zbuluar çelësin e dëshirave të saj.</p> <p>- lu tërhiqet vëmendja nxënësve te fjalët e shkëputura në krye të tekstit, për të formuar një fjali të plotë . Cili është kuptimi i kësaj fjalie? Mësuesi/ja e lexon fragmentin me qëllim që nxënësit të shijojnë rrëfimin dhe përshkrimin misterioz të kopshtit, duke krahasuar dhe përfytyrimin e tij me fragmentin e dhënë. Gjatë leximit nxënësit mund të kërkojnë shpjegim për ndonjë fjalë që nuk e kuptojnë, të cilën e shpjegon mësuesi/ja. Mbështetur në ushtrimet e tekstit nxënësit lexojnë pjesën në heshtje për të plotësuar ditarin dypjesësh. Shkruajnë shkurtimisht çfarë ndodh në secilin prej paragrafëve, duke përcjellë dhe mesazhin.</p>			
Paragrafi	Zhvillimi i përmbledhur i ngjarjeve		
I	Shëtitja e vajzës në kopsht në pragun e pranverës solli ndryshim të gjendjes shpirtërore te vajzës, biseda me kopshtarin tregon se sa kënaqësi sjellin bukuritë e natyrës për të cilat asnjëherë nuk duhet të reshtim kujdesin për to. Në mjedise të tilla ndjen dëshirën,		

	nevojën e çuditshme për të komunikuar me çdo gjallesë si vëzhguesja më e mirë e çdo ndryshimi. Gushëkuqi është dëshmitari më i mirë i këtij mjedisi.
II	Vajza është një vëzhguese e vëmendshme e çdo detaji dhe kureshtjen e saj mund ta shuajë ai banori i përhershëm i kopshtit, gushëkuqi . Nëpërmjet paralelizmit figurativ “ ajo filloi t’i fishkëllente, t’i fliste dhe ta përkëdhelte me fjalë, kurse zogu vazhdonte të kërcente dhe të cicëronte” tregohet më së miri se natyra vërtet të tjetërson. Kënaqësia është e njëlojtë për çdo qenie të gjallë. <i>”dukej sikur donte t’i tregonte vajzës se edhe një gushëkuq mund të jetë po aq i rëndësishëm sa një njeri.”</i> . Natyra brenda vetes fsheh dhe mistere dhe për të zbuluar këto të fshehta të duhet çelësi për të hapur dyert e saj. Dëshirat e vajzës shtohen më shumë me gjetjen e këtij çelësi. Përcillet mesazhi: <u>Ta duash natyrën, ta mbrosh dhe të kujdesesh për të sot e çdo ditë. Kujdesi për kopshtin tregon kujdesin për një të ardhme më të mirë.</u>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Nxënësi/ja jep vlerësime rreth mesazheve që përcjell teksti , duke treguar rëndësinë që ka natyra në shëndetin tonë si dhe misteret që ajo përmban.	
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështetet në <i>zhvillimin e përmbledhur të ngjarjes, mesazhit që ajo përcjell, detyrat tona për të ardhmen.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdoni ngjarjen, duke i vendosur episodit tuaj rrëfimtari shkrimin tuaj, titullin: “Gushëkuqi tregon rrugën”	

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Madhështi e njerëzve</i> P. Budi		Situata e të nxënit: Historia e popullit shqiptar dhe heroizmi i bijve të tij.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja -lexon poezinë me intonacionin e duhur; -ndërton fjali me fjalët e reja; -nënvizon figurat letrare dhe tregon përdorimin dhe funksionin e tyre; -kthen në prozë poezinë.		Fjalët kyçe: <i>Pleq bujarë, djem të rij, perandorë, letërorë.</i>	
Burimet: Teksti i nxënësit, material për letërsinë e vjetër shqipe, poezi të tjera të Pjetër Budit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Kontroll njohurish -Stuhi mendimesh -Praktikë e drejtuar -Praktikë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi i parë: - Kontroll njohurish

Mësuesi/ja kontrollon detyrat e shtëpisë dhe lexon disa prej tyre.

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh

- Cilët janë disa nga autorët e vjetër shqiptarë?
- Kujtoni dhe recitoni disa vargje nga këta poetë.
- Çfarë rëndësie kanë patur ata në zhvillimin e letërsisë sonë?

Hapi i tretë: - Informacioni i ri

Njihen nxënësit me jetën dhe veprën e Pjetër Budit.

Pjetër Budi nga Guri i Bardhë i krahinës së Matit, ishte një intelektual me kulturë të gjerë për kohën kur jetoi dhe punoi. Që në moshën 21 vjeçare iu kushtua karrierës kishtarë si prift i thjeshtë e më pas zëvendës i përgjithshëm i komunitetit katolik në Serbi, dhe vitet e fundit të jetës lëshoi i Zadrimës.

Veprat në gjuhën shqipe janë: “Doktrina e Krishterë”, “Pasqyra e të rrëfyerit”, “Rituali Roman”.

Hapi i tretë: Lexim i drejtuar. Lexojmë poezinë me intonacionin e duhur si dhe shpjegojmë kuptimin e fjalëve të vjetra.

Hapi i katërt: Punë me tekstin**Rikujtojmë figurat letrare:**

Kujtojmë nga klasa e 6-të:

Pyetja retorike ndërtohet duke pyetur, pa kërkuar përgjigje, për t'i dhënë vargut ngarkesë emocionale e për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit a lexuesit.

Përsëritja artistike është rimarrje e fjalëve, grupeve të fjalëve apo fjalive të njëjta me qëllim theksimin dhe forcimin e shprehjes artistike. Përsëritja krijon muzikalitet dhe ritëm, si në poezi, por edhe në prozë.

Mësojmë:

Poezia organizohet në strofa ose monokolonë vargje që ndjekin njëra tjetrën pa ndarje. Strofat në varësi të vargjeve që kanë, janë disa llojesh: dyvargëshe, katërvargëshe, gjashtëvargëshe, etj, në përgjithësi vargjet çifte.

1. Nënvizojmë pyetjet retorike të poezisë:

P.sh.: Ku janë ata pleq bujarë,

Që qenë përpara ne

E ata trima sqimatarë

Të çpejtë si rrufe?

2. Togfjalëshi i përsëritur “ku janë ata...?” përveçse realizon pyetjen retorike, ç’efekt tjetër jep?

- Rikthen kohën e shkuar.

Hapi i pestë: Praktikë e drejtuar

3. Ç’do të thoni për mbiemrat: të ri, të vobeg(të), të begatë në strofën e fundit? Po për krahasimin “sikur i pret me shpatë”

Hapi i gjashtë: Praktikë e pavarur

4. Shënojmë pranë çdo emri **epitetet** dhe **krahasimet** dhe më pas i analizojmë.

Emra	Epitete	Krahasime
Pleq	Bujarë	Të çpejtë si rrufe
Djem	Të lulzuem	
Zotni	Madhështor	Si të zotnuem
Letorë	Të urtë	Porsi vdorë

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori në poezi, si dhe reflektimin rreth temës.

Detyrë: Përkthyeri një personazh nga ditët e sotme që ka karakteristikat e një njeriu si në strofën e pestë.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Varfëria dhe liria A.Z. Çajupi		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: i varfër , i lirë, mbret, pallat, shes lirinë.	
Nxënësi/ja: -përcakton temën e poezisë; -shpjegon lidhjen midis konceptit të lirisë dhe pamundësisë për ta pasur atë; -shpjegon rëndësinë e fjalës “ liri “ në këtë poezi; -analizon gjuhën e përdorur nga Çajupi në poezi.			
Burimet: Teksti i nxënësit, shkumësa me ngjyra, pamje nga vendi ynë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		<ul style="list-style-type: none"> • Historia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
-Stuhi mendimesh -Imagjinatë e drejtuar -Diskutim -Lexim me role -Punë në grupe			
Organizimi i orës së mëimit:			
<p>- Hapi I: Ndërtimi i njohurive të reja:</p> <p>a) Prezantimi i pjesës së re dhe autorit. Jeta vepra e Çajupit.</p> <p>A.Z.Çajupi ka lindur në Sheper të Zagorisë, në vitin 1866. Studimet e larta i kreu në Kajro, ku u vendos përfundimisht dhe punoi për një farë kohe si avokat. Nga fundi i shek XIX mori pjesë gjallërisht në lëvizjen patriotike shqiptare . Më 1902 botoi librin “ Baba Tomorrow” si dhe veprat dramaturgjike: “ 14 vjeç dhëndër”, “ Martesa e avokatit”, etj. Poezia “ Varfëria dhe liria “ godet shtypjen dhe pabarazinë shoqërore ku ngrihet lart e me dinjitet jeta e lirë.</p> <p>Hapi II: a) Prezantimi i pjesës së re – Lexojmë poezinë me radhë, me intonacionin e duhur duke nënvizuar fjalët e reja.</p> <p>b) <i>Fjalët dhe shprehjet e reja –</i> <i>Ergjend – argjend</i> <i>Madhëri – madhështi</i> <i>I lexojmë ato duke i përdorur në fjali për t’i bërë edhe më të kuptueshme.</i></p> <p>Hapi IV: Stuhi mendimesh -Pyetje rreth përmbajtjes</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Cila është tema e kësaj poezie? Të qenit i lirë.</i> - <i>Çfarë do në të vërtetë poeti? –Do të jetojë në vendin e tij, edhe pse i varfër.</i> - <i>Ku duket thjeshtësia e poetit? – Në fjalët që përdor “Nukë dua për të ngrën e për të pirë/nuk mund ta shes lirinë”</i> <p>Hapi V: Analiza dhe interpretimi i poezisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Si i përgjigjet poeti ftesës imagjinare të mbretit: “ Hajde në pallat me mua’ Të gëzosh dhe ti në botë”,</i> 			

Do t'i them: Zot nukë dua:

Për të ngrënë e për të pirë

Nuk mund ta shes lirinë.

- Shpjegoni lidhjen midis konceptit të lirisë dhe pamundësisë për ta patur atë –(robëria, pushtimet).
- Sipas poetit liria është: nder, pasuri.
- Si e shpjegoni rëndësinë që i jep lirisë dhe pamundësisë për ta pasur atë (jeta nën pushtimet e huaja, izolimi etj)

Hapi VI: Praktikë e drejtuar:

-Gjeni fjalët kyçe të kësaj poezie.

Fjalët kyçe: i varfër, i lirë, mbret, pallat,shes lirinë.

Punohet me gjuhën e poezisë:

Kujtojmë:

Anafora është përsëritja e një fjale a një togu në fillim të dy a më shumë vargjeve ose frazave.Psh:

dua lirinë dhe ndere,

dua të bëj si të dua...

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit nxjerrim konkluzionet në bazë të atyre objektivave që ne parashtruam në krye të orës duke dëgjuar edhe vetë përshtypjet e nxënësve mbi këtë poezi dhe mesazhit që përcolli, por edhe kënaqësisë që u dha. Bëjmë vlerësime për disa nxënës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni disa fjalë të urta që i përshtaten tematikës së kësaj poezie.

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa VII
Tema mësimore: Pella(z)gonia A. Islami		Situata e të nxënësve: Dita e Verës dhe historia e saj.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e te menduarit. 3. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon rrjedhshëm dhe me intonacion poezinë e dhënë; -shpjegon qartë dhe saktë kuptimin e fjalëve të reja; -shpreh ndjenjat dhe emocionet pas leximit të tekstit; -analizon tiparet e poezisë.		Fjalët kyçe: Pellazgët, ilirët, Dita e luleve, degë shelgu, vezë.	
Burimet: Teksti i nxënësit, materiale të ndryshme për festimin e Ditës së Verës në krahina të ndryshme të Shqipërisë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Historia 	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

-Diskutim - Informacion i ri - Lexim i drejtuar –Stuhi mendimesh - Punë në grupe – Punë e pavarur

Organizimi i orës së mësimit:

Hapi I: Diskutim: Kujtojmë së bashku me nxënësit ç’dimë për Ditën e Verës, festimin e saj. Kur është festuar për herë të parë, etj.

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë. Festimi kryhet në nderim të natyrës dhe bimësisë që merr jetë në këtë datë. Shenja dalluese e këtij festimi është gatimi i ballokumeve. Më 13 Mars njerëzit marrin një tufë të vogël bari të njomë bashkë me rrënjët dhe dheun që ta kenë në mëngjesin e datës 14 Mars në shtëpi. Kjo ditë festohej që në lashtësi.

Disa nxënës tregojnë se si festohet kjo festë në familjen e tyre. Në fund e mbyllim këtë diskutim me leximin e prozës poetike “ Dita e Verës” të F.Konicës.

Hapi II – Informacioni i ri

Abdylazis Islami ka lindur në vitin 1930 në Tetovë. Rrjedh nga një familje kurbetllinjsh. Që në bankat e shkollës filloi të merrej me krijimtari artistike për fëmijë e të rritur, por poezinë e parë e botoi në vitin 1954. Ka punuar si mësues dhe gazetar. Ka shkruar : “ Këngët e zgjuara; “ Mëngjesi në fshat”, “ Kujtime dhe ëndrra “ etj. Disa autorë shqiptarë i kanë shkruar veprat e tyre duke u mbështetur në kohët e vjetra, apo mbi pjesë të historisë. Me të njëjtën frymë janë shkruar vargjet e kësaj poeme “ Pella(z)gonia”. Autori paraqet lashtësinë tonë përmes pamjeve të bukura e festive dhe një mendimi që përcjell krenari.

Hapi III- Lexim i drejtuar. Dy nxënës lexojnë bukur poezinë me intonacion e duke respektuar shenjat e pikësimit.

Hapi IV- Stuhi mendimesh

- *Cila është tema kryesore e këtij krijimi? – Krenaria e të qenit shqiptar, historia dhe trashëgimia e saj.*
- *Kujt i referohet autori për këtë temë? Festimit të Ditës së Verës duke sjellë në vëmendje gjithë historikun e saj, festimet, karakteristikat.*
- *Si e kuptoni titullin? E lashtë, si festë në krijimin e saj që në kohën e pellazgëve.*
- *Cili personazh përshkruhet më lart?- Arianda, perëndesha e Pellazgëve.*
- *Gjeni llojin e strofës dhe të rimës.(strofa katërshe, rimë e kryqëzuar).*

Hapi IV –Nxënësit punojnë me pyetjet e studimit të tekstit.

2. Disa nga tiparet e poezisë janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Shpjegoni si i kuptoni ato.

Tipar i poezisë	Si e kuptoni?
Trajton temën e lashtësisë	Nëpërmjet vargjeve trajton temën e
Autori nëpërmjet vargjeve tregon dhe përfshin ngjarje dhe subjekte nga jeta e pellazgëve.	Poeti vargëton dhe përcjell idetë e t emocionit, ndjesisë,shpirtit poetik.
Poezia është e pasur me mjete stilistike.	Poezia ka shumë figura letrare.

Hapi V – Punë në grupe

-Çfarë ju sjellin ndërmend festimet e përshkruara përmes vargjeve?

-Cila është tradita jonë për festën e pranverës?

Plotësoni skemën e mëposhtme:

Grupi I : Festa e pranverës në lashtësi, përshkruar nga autori	Grupi II : Festa e pranverës sot, tradita dhe përvoja juaj	
Në çdo derë shtëpie vendosej nga një degë shelgu, zienin vezë; luftëtarët parakalonin para mbretëreshës dhe ajo u shpërndante atyre dhurata.	Ndezim zjarre, vendosim verore, bëjmë ballokume, organizojmë dreka familjare etj.	
Hapi VI- Punë e pavarur		
<ul style="list-style-type: none"> • Të kthejnë në prozë poezinë. • Të gjejnë në poezi fjalët: 		
Fjalë që na çojnë në histori	Fjalë që japin pamje dhe situata fantastike	Fjalë që përcjellin mesazhe dhe krenari
Arianda; pellazgët; mbretëreshë ilire; famfaret;	E bardhë, me lëkurë dhe zemër; lindi drita ilire; adhuronte dhe festonte për nder të saj;	Autoritet të rrallë; kur ishte ajo dhe pellazgët në Ballkan, s'kishte ilirë, as grekër, as popull tjetër;
Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori në këtë poezi, si dhe reflektimin rreth temës.		
Detyrë: Gjeni poezi të tjera të këtij autori dhe sillni në klasë opinione e komente të ndryshme rreth tij.		

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë Shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema Mësimore: Pasqyra D. Agolli		Situata e të nxënësve: Dashuria dhe respekti për veten.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i> 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: -lexon rrjedhshëm dhe me intonacion poezinë; -u përgjigjet pyetjeve që kanë lidhje me të kuptuarit e poezisë; -shpreh ndjenjat dhe përjetimet e tij pas leximit; -analizon gjuhën e figurshme që përdor autori në poezi.		<i>Pasqyrë të jetës, tryezë e mardhur, fajtorë, dele, qethur me gërshtë.</i>	

<p>Burimet: Teksti mësimor, materiale për jetën e Dritëro Agollit, vepra me poezi <i>Pelegrini i vonuar</i>.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Shkrim i lirë -Bashkëbisedim -Diskutim -Punë në grupe</p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Kontroll i detyrave të shtëpisë Mësuesi/ja aktivizon 2-3 nxënës me leximin e detyrave të shtëpisë dhe më pas i vlerëson ata.</p> <p>Shkrim i lirë. Mësuesi/ja shtron para nxënësve pyetjen: <i>“A na ka ndodhur që të jemi para pasqyrës dhe të bisedojmë me të? Të shihemi, të përqeshim fytyrën tonë?”</i> <i>(Pasqyra është një detaj shumë i rëndësishëm. Të parën gjë që bëjmë në mëngjes është dalja para saj. Herë na duket vetja bukur, herë përgjumësh, herë e marrim inat pasqyrën).</i></p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja Kuptimi dhe mesazhi: Prezantim i poezisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë, autorin si dhe na jep pak të dhëna për jetën dhe veprën e D. Agollit. <p>Dritëro Agolli; shkrimtar, publicist, veprimtar shoqëror, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Lindi në Menkulas të Devollit, më 1931. Dritëro Agolli është një nga figurat qendrore të letërsisë shqipe. Veprat e tij kryesore janë: <i>Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo; Komisari Memo, Trëndafili në gotë, Arka e djallit, Në rrugë dolla, Lypësi i kohës, Pelegrini i vonuar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Leximi shprehës i poezisë: mësuesi/ja i kërkon një nxënësi për ta lexuar atë me intonacionin e duhur. <p>Pyetja e parë – Punë dyshe Nxënësit në dyshe plotësojnë në tekstin e tyre nga një fjali për secilën strofë. Strofa 1: Ne jemi fajtorë që tryeza është bosh.</p> <p>Pyetja e dytë – Mesazhi Jeta jonë është pasqyrë e vuajtjes, nënshtrimi gjithashtu.</p> <p>Gjuha dhe stili Pyetja e tretë: Mësuesja i drejton pyetje klasës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ A ju pëlqen titulli i poezisë? ➤ Fjala pasqyrë është dhënë në kuptimin e parë apo të figurshëm? <p>Pyetja katërt: Nënvizojmë figurat letrare:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Të mardhur</i> – epitet ➤ <i>Si dy uritha</i> – krahasim ➤ 	
<p>Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë.</p>	
<p>Detyrë: Gjeneroni një poezi tjetër të këtij autori dhe shpjegojeni në klasë.</p>	

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Atdhe T. Keko		Situata e të nxënësve: Poezi për atdheun	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -përcakton optimizmin që përcjell kjo poezi nëpërmjet fjalëve; -zbulon himnizimin që poeti i bën natyrës; -analizon ndjesitë që përcjell poezia nëpërmjet përdorimit të figurave letrare.		Fjalët kyçe: I dhembshur, pranverë mahnitëse, vendi im, breza, dashuri.	
Burimet: Teksti i nxënësit, materiale për jetën e autorit, videoprojektor, fletore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">• Historia		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Prezantim -Stuhi mendimesh- Punë dyshe- Praktikë e drejtuar – Praktikë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimt:			
Hapi I: Nxënësit lexojnë poezi të ndryshme për atdheun.			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja:			
- Jeta dhe vepra e autorit			
- Teodor Keko (1958 -2002) ka qenë shkrimtar dhe publicist shqiptar. Ka lindur në Tiranë. Ndoqi studimet e larta në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë dhe Letërsi. Ai i filloi publikimet e tij në vitin 1980 dhe është autor i 15 volumeve në zhanre të ndryshme, si: poezi, dramë, novela dhe tregime si: “Loja”, “Lajmëtarja e vdekjes”, “Shënimet e një gruaje” etj.			
Hapi III: Prezantimi i pjesës së re– Lexojmë poezinë me intonacionin e duhur, duke nënvizuar fjalët e reja.			
Fjalët dhe shprehjet e reja: E paepur – nuk thyhet a nuk lëkundet. Të kallkanta – të akullta. Sfidante - me qëndrim të guximshëm e mospërfillës ndaj kundërshtarit. I lexojmë ato duke i përdorur në fjali për t'i bërë edhe më të kuptueshme.			
Hapi IV. 1. Stuhi mendimesh; Punë dyshe			
a) <i>Kujt i kushtohet poezia?- Atdheut të tij.</i>			
b) <i>Gjeni shprehje optimizmi të poetit në poezi- pranvera mahnitëse; zemra mbeti e paepur; ulli përjetësisht i gjelbër etj.</i>			
c) <i>Zgjeroni me fjalët tuaja mendimin: “ Ne ty apo ti na zgjat neve jetën? ”</i>			
Hapi V. Analizojmë dhe interpretojmë poezinë: Praktikë e drejtuar			
2. <i>Zbuloni si e ka himnizuar natyrën poeti në strofën e parë? Nëpërmjet përshkrimit të natyrës: vendi Im i dhembshur – dimra të butë</i>			
<i>Pranverë mahnitëse që s`të le të vdesësh).</i>			
3. <i>Shpjegoni kuptimin e strofës së dytë duke nxjerrë në pah mesazhet që vijnë nga historia (Vendi ynë me</i>			

ndryshimet e mëdha, me problemet e veta, me varfërinë, por përsëri, ajo mbeti e paepur duke sfiduar gjithçka.

4. Përshkruani ndjenjën e lartë të poetit në strofën e tretë. Me se lidhet ajo? – Lidhet me dashurinë e pakushtëzuar që një njeri ka për vendin e tij dhe me të qenit brez pas brezi në këto troje).

5. Si e kuptoni metaforën në vargun: “Vendi im, një ulli përjetësisht i gjelbër “do të qëndrojë gjithmonë ndër shekuj dhe duke përcjellë mesazhe Paqeje dhe dashurie në botë).

Kujtojmë:

Metafora emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi a dukurie tjetër që i ngjan. Pra, metafora është përdorimi i një fjale në një kuptim

të ngjashëm, por të ndryshëm nga kuptimi i saj i zakonshëm.

Hapi VI: Gjuha e poezisë:


- Çfarë ndjesish sjell te ju përdorimi i përsëritur i përemrit **im** (vendi im)? - E personalizon duke e bërë të vetën. Krijon lidhje pronësie me vendin. Shpjegoni me fjalët tuaja kuptimin e fjalëve:
Shpatullgjerë – njeri trupmadh me shpatulla të gjera.
Këmbëmbledhur – me këmbë në tokë.

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori në këtë poezi, si dhe reflektimin rreth temës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ktheni poezinë në prozë. Ruani fjalët kyçe dhe figuracionin në tekstin tuaj përshkrues.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mëngjesi O. Khajam		Situata e të nxënit: Poezi për natyrën	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të nxënit 4. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - zbulon detajet përshkruese të poezisë; - përcakton llojet e figurave letrare; - bën analizën metrike të poezisë; - ----krahason poezinë “Mëngjesi” me poezinë “Thuaja këngës me gëzim”, duke nxjerrë në pah elementet e përbashkëta dhe ndryshimet që ato kanë.		Fjalët kyçe: - mëngjesi; - dielli gjahtar; - retë; - trëndafili; - bilbili;	
Burimet: : teksti mësimor, tabela e zezë, fletore, libri “Rubairat “ O Khajam		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Biologjia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Parashikim me terma paraprakë -Diskutim -Ditar dypjesësh			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikim me terma paraprakë, ditar dypjesësh

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe:

U kërkohet nxënësve të shkruajnë një tekst të shkurtër mbështetur në fjalët kyçe: mëngjesi, dielli gjahtar, pikojnë vesë retë, qesh trëndafili, bilbili i shkretë. Shkrimi të jetë i shkurtër rreth 5-6 fjali. (Nxënësit mund të punojnë në poezi ose prozë) u lihet kohë e mjaftueshme për punë, rreth 10 min.

Lexohet poezia nga mësuesi/ja. Më pas nxënësit e lexojnë atë në heshtje dhe nënvizojnë fjalët e panjohura. Njihen me kuptimin e këtyre fjalëve mbështetur në fjalorin e tekstit. Nxënësit krahasojnë shkrimet e tyre me të poezisë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim. Ditar dypjesësh.

Nxënësit rikthehen në tekst për t'u përgjigjur pyetjeve të dhëna:

-Cilat janë detajet e përshkrimit të peizazhit në këtë poezi?

Ç'lloj strofe ka përdorur autori në këtë poezi?

-Vëreni me kujdes rrokjet e fjalëve në fund të vargjeve. A kanë përputhje me njëra-tjetrën? Diskutohen përgjigjet e dhëna.

Frazat e dhëna.	Lloji i figurës letrare.
<i>Mëngjesi me shigjet` e grisi perden e natës Yjt` i arratisi Dielli gjahtar me rreze kapi çdo majë mali Nga Dimri ferr, Pranvera qiell Qesh trëndafili e thotë</i>	Epitet metaforik (dielli gjahtar), Metaforë (dielli me rreze kapi çdo majë mali) Shkallëzimi Antitezë Personifikim


Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Nxënësi/ja jep vlerësime rreth detajeve përshkruese të poezisë.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në komentimin e poezisë, përcaktimin e llojeve të figurave letrare si dhe në analizën e detajeve përshkruese të saj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Krahasoni detajet e përshkrimit të natyrës në këtë poezi me ato në poezinë: "Thuaja këngës me gëzim"

DATA**PLANIFIKIMI DITOR**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Vdekja e një mbretëreshë</i> Rexhep Qosja (ora e parë)		Situata e të nxënit: Drama	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - lexon me shprehësinë dhe intonacionin e duhur një tekst dramatik; - analizon monologun si element i gjinisë dramatike; - tregon brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore të tij; - analizon dhe gjykon personazhin e tekstit duke u ndalur te fjalët dhe veprimet e saj.		Fjalët kyç: -dramë; -mbretëreshë;	

	
--	---

monolog;
-tradhti;

<p>Burimet: teksti mësuesor, e-libri, foto;</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia</p>
--	--


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
-Stuhi mendimesh -Lexim -Bashkëbisedim -Diskutim

Organizimi i orës së mësimit

-Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Stuhi mendimi*

Mësuesi/ja u kërkon fëmijëve të thonë çfarë dinë lidhur me dramën.

Plotëson me përgjigjet e nxënësve skemën.




Nëse nxënësit kanë vështirësi për t'u përgjigjur, ndihmohen nga mësuesi/ja.

-Ndërtimi i njohurive të reja

→ **Prezantimi i pjesës së re**

Mësuesi/ja u flet nxënësve shkurtimisht për autorin (shumë pak të dhëna për jetën dhe veprën e Rexhep Qoses) dhe për monodramën “Vdekja e një mbretëreshe”.

	<p>Akademik: Rexhep Qosja Ditëlindja: 1936 Vendlindja: Kosovë</p>	<p>Episode letrare - (1967) Dialog me shkrimtarë (1968) Panteoni i rralluar - (1973) Vdekja më vjen prej syve të tillë - (1974)</p>
---	--	---

→ **Leximi i tekstit**

Prezantoj pjesën duke thënë se është një shkrim i mbështetur në teknikën e monologut (monologu është bisedim me vetveten, prandaj ka funksion të ngjashëm me dialogun). Bëhet interpretimi nga mësuesja, apo një nxënës.

→ **Fjalë dhe shprehjet e reja**

U kërkohet nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja. Shkruhen fjalë në dërrasën e zezë, zërthehet kuptimi i tyre dhe nxënësit formojnë fjali me to.

→ **Pyetje rreth të kuptuarit**

Lexoni monodramën dhe përgjigjuni pyetjeve:

Lexoni pjesën dhe rendisni pohimet e mëposhtme sipas zhvillimit të ngjarjeve. Vendosni numrat përkatës në kutitë përbri.

- Mbretëresha Teutë ndihet e revoltuar.
- Mbretëresha ndihet krenare për virtytet e popullit të saj.
- Mbretëresha është e vendosur, ajo kurrë nuk do të dorëzohet.
- Pushtimi i vendit të saj, vetëm sa do të shtojë lavdinë e përjetshme.
- Mbretëresha është e ndërgjegjshme për fundin e saj të vetmuar.
- Mbretëresha dënon tradhtinë rrotull saj.
- Mbretëreshën Teutë nuk mund ta mposhtë asgjë.

Çdo përgjigje e nxënësve shoqërohet me shembuj dhe detaje nga teksti.

→ **Tregim i brendisë së tekstit**

-Cilën pjesë mund ta konsiderojmë si pikë kulmore të ngjarjes?

-Nëse do ta shoqëroje me muzikë kjo pjesë, ç'lloj muzike do të ishte ajo?

→ **Analiza e personazheve**

-Sa personazhe ka në këtë tekst? Cila është ajo?

Mbretëresha Teutë

-Ç'tipare ka mbretëresha? (trime, e mençur, e dashur, fisnike, e vendosur, etj).

-Cila është veçoria e kësaj pjesë? Si është e ndërtuar ajo? (është e ndërtuar me monolog).

-Cilat vepra shkruhen në këtë mënyrë? (Veprat dramatike.)

-Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutim

- A ju pëlqeu ky tekst? Pse?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë?
- Çfarë përjetuat ju ndërsa e lexuat atë pjesë?

Vlerësimi: Vlerësohen pozitivisht nxënësit që e lexojnë dhe interpretojnë bukur pjesën; dallojnë karakteristikat e një vepre dramatike, nxorën tiparet e personazhit dhe i ilustruan me pjesë nga teksti;

Detyrë shtëpie: Interpretimi i fragmentin. Në varësi të mundësive, nxënësit mund të kujdesen edhe për veshjet e personazhit duke iu referuar ilustrimeve në tekstin e nxënësit.



DATA


PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Vdekja e një mbretëreshë</i> Rexhep Qosja (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Drama	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: – analizon karakterin e personazheve nëpërmjet fjalëve që thonë; – dallon veçoritë e monologut në fragment;		Fjalët kyç: -dramë; -mbretëreshë; -monolog;	

<p>- gjykon dhe jep vlerësimin e tij rreth ideve të ndryshme në tekst; - interpreton me ndjenjë rolin e një personazhi; - gjykon për interpretimin (e një roli) e shokëve ose shoqeve të klasës.</p>	<p>-tradhti; -interpretim;</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, skenë e improvizuar për dramatizimin e pjesës.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Historia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Interpretim me role - Diskutim - Punë në grupe -Diagram Veni</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>-Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Interpretim me role Dy-tre nxënës interpretojnë monodramën “Vdekja e një mbretëreshë “. Nxënësit e tjerë së bashku me mësuesin vlerësojnë interpretimin e tyre. Në punën përgatitore për këtë interpretim mund të përfshihen edhe nxënës të tjerë, të cilët angazhohen në përgatitjen e kostumeve.</p> <p>-Ndërtimi i njohurive të reja → Analizojmë tekstin Mësuesi/ja pyet:</p> <p>a) Cila është ideja që përcillet nëpërmjet kontrastit në paragrafin e dytë? Mësuesja kujdeset që nxënësit të shprehën qartë.</p> <p>b) Monologu i mbretëreshës Teutë është madhështor dhe dramatik. Këtë dimension e krijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> o personazhi kryesor; o tema; o mjedisi; o subjekti. <p>→ Gjuha e tekstit Mësuesi/ja pyet:</p> <p>a) Përcaktoni në tekst: kohën e foljeve dhe vetën e rrëfimit.</p> <p>b) Dalloni në tekst: fjalitë mohore, fjalitë lejore, fjalitë pyetëse, fjalitë urdhërore, fjalitë pa folje,</p> <p>→ Reflektojmë rreth tekstit U kërkohet nxënësve të komentojnë thënien e mëposhtme: “Madhështia e shpirtit duron me dinjitet padrejtësitë”. Demokriti Bazohuni në shembuj nga historia, letërsia apo shkenca, duke përmendur figura të shquara, që frymëzojnë njerëzimin.</p> <p>-Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Punë në grupe (Diagramë Veni) Me anë të diagramit mësuesja kërkohet që nxënësit të dallojnë fragmentet që bëjnë diferencimin e së mirës nga e keqja.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësohen pozitivisht nxënësit që e lexojnë dhe interpretojnë bukur pjesën; dallojnë karakteristikat e një vepre dramatike, nxjerrin tiparet e personazhit dhe i ilustruan me pjesë nga teksti.</p>	
<p>Detyrë shtëpie: Vizatoni portretin e mbretëreshës Teutë.</p>	

DATA
PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pas vdekjes Çajupi (ora e parë)		Situata e të nxënit: Komedia	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: – lexon: a. për të dalluar komedinë, si lloj i tekstit letrar; b. për të treguar brendinë e tekstit dramatik; – formulon mesazhin e tekstit dramatik; – gjykon dhe vlerëson mesazhin e komedisë sipas këndvështrimit dhe përvojës personale; – lidh mesazhin e tekstit me aktualitetin; – diskuton dhe gjykon për veset negative të kohës.		Fjalët kyç: -dramë; -komedi; -dialog; 	
Burimet: teksti mësimor, materiale informative për autorin, fotografi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh Lexim Bashkëbisedim Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi -Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimi Mësuesi/ja u kërkon fëmijëve të thonë çfarë dinë lidhur me komedinë. Plotësohet me përgjigjet e nxënësve skema.			
			
Nëse nxënësit kanë vështirësi për t'u përgjigjur, ndihmohen nga mësuesi/ja me anë të pyetjeve: Komedia -A e dini se çfarë është komedia? - A keni ndjekur ose parë ndonjëherë ndonjë komedi? - Çfarë ju ka bërë për të qeshur? - A ju pëlqen ndonjë komedi? Cila është ajo?			
-Ndërtimi i njohurive të reja → Prezantimi i pjesës së re Mësuesi/ja prezanton titullin e pjesës së re dhe autorin (i shkruan në dërrasën e zezë). Flitet shkurtimisht për jetën dhe veprën e autorit.			

	<p>Andon Zako Çajupi (27 mars 1866 - 11 korrik 1930), ishte poet i shquar, veprimtar patriot dhe shqiptar. Ka lindur në Sheper të Zagorisë (Gjirokastër)</p>	<p>"Baba Tomorri" 1902 "Burri i dheut" - tragjedi 1908 "14 vjeç dhëndër" - komedi</p>
---	--	---

→ **Lexim me role**
Mësuesi/ja ndan rolet dhe u kërkon nxënësve të nënvizojnë pjesën që ju pëlqen më shumë ose që i bën për të qeshur.

→ **Fjalë dhe shprehjet e reja**
U kërkohet nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja. Shkruhen fjalë në dërrasën e zezë, zërthehet kuptimi i tyre dhe nxënësit formojnë fjali me to.

→ **Pyetje rreth të kuptuarit**
-Cila është tema e bisedës mes dy personazheve?
-Pse janë të shqetësuar ata?
-Ç përmbajtje kishte nekrologjia e Lulushes?
-Cila është arsyeja e pakënaqësisë dhe zemërimit të Adham-Utit?

→ **Ritregimi i brendisë e tekstit**
1-2 nxënës thonë me fjalët e tyre brendinë e tekstit.

→ **Mesazhi**
Mësuesi/ja pyet: *Cili është mesazhi që merrni nga kjo komedi?*

→ **Pyetje(Diskutim)**
Vesi që godet **Çajupi** është shtirja e njerëzve, ku përmes situatave komike demaskon mediokritetin, mendësitë e prapambetura, njerëzit dritëshkurtër që shqetësohen për kotësira.
Më pas mësuesi/ja i lë nxënësit të diskutojnë rreth shfaqjeve të tilla sot.

- A njihni njerëz me vese të tilla?
- Çfarë mendoni për ta? Ç'këshillë do t'u jepnit?

-Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Diskutim

- A ju pëlqeu ky tekst? Pse?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë?
- Çfarë përjetuat ju ndërsa e lexuat atë pjesë?

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin e komedisë, si lloj i tekstit letrar; për zbërthimin dhe rrëfimin e brendisë të tekstit dramatik; për formulimin e mesazhit të tekstit dramatik; për gjykimin dhe vlerësimin e mesazhit të komedisë sipas këndvështrimit dhe përvojës personale dhe lidhjen me aktualitetin dhe veset negative të kohës.

Detyrë shtëpie: Mësuesi udhëzon një grup nxënësish që të ndajnë rolet dhe orën e ardhshme të interpretojnë fragmentin nga komedia "Pas vdekjes". Në varësi të mundësive, nxënësit mund të kujdesen edhe për veshjet e dy personazheve duke iu referuar ilustrimeve në tekstin e nxënësit

DATA
PLANIFIKIMI DITOR


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pas vdekjes Çajupi (ora e dytë)		Situata e të nxënësve: Komedia	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: – analizon karakterin e personazheve nëpërmjet fjalëve që thonë; – dallon veçoritë e dialogut në fragment; – zbulon gjuhën e komedisë (mjetet e realizimit të humorit); – gjykon dhe jep vlerësimin e tij rreth ideve të ndryshme në tekst; – interpreton me ndjenjë rolin e një personazhi; – gjykon për interpretimin (e një roli) e shokëve ose shoqëve të klasës.		Fjalët kyç: -personazh komik; -personazh kryesor; -humor; -dialog;	
Burimet: teksti mësimor, veshje, mjete dekorative për skenën e teatrit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Interpretim me role - Diskutim - Punë në grupe - Grafik			
Organizimi i orës së mësimin			
-Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Interpretim me role Dy nxënës interpretojnë me role pjesën “Pas vdekjes”. Nxënësit e tjerë së bashku me mësuesin vlerësojnë interpretimin e tyre. Në punën përgatitore për këtë interpretim mund të përfshihen edhe nxënës të tjerë, të cilët angazhohen në përgatitjen e kostumeve.			
-Ndërtimi i njohurive të reja → Analizojmë tekstin Mësuesi/ja pyet: c) A mendoni se është qesharak shqetësimi i personazheve? Interpretoni duke argumentuar. Mësuesi/ja kujdeset që nxënësit të shprehin qartë.			
d) Për të shkaktuar të qeshurën dhe humorin, Çajupi: <ul style="list-style-type: none"> ○ krijon karaktere komike; ○ krijon situata komike; ○ përzgjedh fjalët; ○ analizon ngjarjet; ○ kritikon sjelljet. 		Humori është aftësia ose cilësia e njeriut për të shkaktuar të qeshurit duke paraqitur anët argëtuese të realitetit. Teknikat humoristike përfshijnë: përshkrimin e situatave dhe të personazheve me karakteristika komike, lojërat e fjalëve, batutat, si dhe shprehjet e ekzagjeruara.	
→ Reflektim rreth tekstit U kërkohet nxënësve të komentojnë thënien e mëposhtme: “Shqetësimi për gjëra të kota të bën qesharak”. Argumentoni shpjegimet tuaja me raste nga aktualiteti, të cilat përputhen me temën e diskutimit.			
-Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit gjejnë pjesët që u pëlqejnë më shumë dhe që i bëjnë për të qeshur dhe diskutojnë rreth tyre.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për dallimin e komedisë, si lloj i tekstit letrar; për zbërthimin dhe rrëfimin e brendisë të tekstit dramatik; për formulimin e mesazhit të tekstit dramatik; për gjykimin dhe vlerësimin e mesazhit të komedisë, për interpretimin e komedisë.			
Detyrë shtëpie: Krahasoni gjuhën e përdorur nga Çajupi në komedi. (Referojuni edhe asaj të përdorur në komedinë “Katërbëdhjetë vjeç dhëndër” të trajtuar në klasën e gjashtë). Përzgjidhni fjalët dialektore dhe ato që mendoni se kanë një formë të ndryshme nga gjuha standarde. Nxirrni konkluzione dhe prezantoni ato, duke përdorur një program kompjuterik, p.sh.: <i>Powerpoint</i> .			

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR KOMPETENCËN E TË LEXUARIT

II. TEKSTI JOLETRAR

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kronika Një ditë "në shtëpinë Kadare"		Situata e të nxënit: diskutim rreth mënyrave të informimit: medies së shkruar dhe asaj televizive.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> <i>Kompetenca e të menduarit</i> <i>Kompetenca e të nxënit</i> <i>Kompetenca qytetare</i> <i>Kompetenca digjitale</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij; -dallon veçoritë e kronikës, si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar; - rendit sipas kohës kur kanë ndodhur faktet e kronikës; - gjeni në tekst frazat në të cilat rrëfimtari bëhet subjektiv; -analizon veçoritë e titullit; - krahason llojet e teksteve rrëfimtare joletrare.			
Burimet: teksti mësimor, fotografi, materiale informative për qytetin e Gjirokastrës, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat shoqërore • Arti • Historia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimesh/ tabela e konceptit -Punë në grupe -Tryeza rrethore			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:

Stubi mendimesh/ tabela e konceptit

Shtohet pyetja për diskutim:

-Ç' dini për tekstin joletrar?

Nxënësit/et sjellin idetë e tyre, të cilat mësuesi i zgjeron dhe plotëson në dërrasë të zezë (*tabela e konceptit*).

Teksti rrëfimtari joletrar

Qëllimi i tekstit rrëfimtari joletrar është të rrëfejë ngjarje të jetuara, copëza nga jeta e personave.

Rrëfimi bazohet në fakte, duke përfshirë vende, data, personazhe ngjarjesh reale.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Pas leximit të kronikës Një ditë në “shtëpinë Kadare” nëpërmjet teknikës *pyetje-përgjigje*, nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 1.

-Cili është interesi i turistëve ndërsa vizitojnë shtëpinë?

Përgj: Kërkojnë të shikojnë dhe prekin nga afër muret dhe harqet e gurta të shtëpisë, në të cilën ka lindur dhe ka kaluar fëmijërinë dhe rininë e hershme Kadareja.

Shpjegohet se ç'është kronika, si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar.

Kronika është një lloj shkrimi gazetaresk, që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve. Në të rrëfehen fakte të ndodhura në realitet.

Informacioni në të u përgjigjet pyetjeve: *Çfarë? Ku? Kur? Kush? Si?* Dallojmë kronika sportive, kronika të ngjarjeve etj.

→ Fjalët dhe shprehjet e reja

U kërkoj nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja. Shkruhen fjalët në dërrasën e zezë, zërthehet kuptimi i

tyre dhe nxënësit formojnë fjali me to.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur***Punë në grupe***

Mësuesi/ja i ndan nxënësit me grupe dhe secili prej tyre punon me:

Grupi I punon ushtrimin: Renditni sipas kohës kur kanë ndodhur faktet e kronikës: -çeli dyert në 80-vjetorin e lindjes së Kadaresë.

-u dogj aksidentalisht në nëntor të vitit 1999

- **Grupi II** punon ushtrimin: Nënvizoni frazat ku është përmendur koncepti: shtëpi. Shkruani emërtimet e përdorura në tekst për të.

Psh: shtëpia e lindjes/ shtëpia e gurtë/të banesës së Ismail Kadaresë/duke parë objektin në vend/ky monument/“Shtëpia Kadare”.

- **Grupi III** punon ushtrimin: Gjeni në tekst frazat në të cilat rrëfimtari bëhet subjektiv.

Psh: ka marrë një profil të veçantë arkitektonik

- **Grupi IV** punon ushtrimin: Çfarë ju bën përshtypje në titullin e kronikës? Si është i ndërtuar ai nga ana gjuhësore? Titulli i kronikës formulohet mbi bazën e informacionit qendror që ajo trajton. Nga ana gjuhësore është: emër, parafjalë, emër, emër.

Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura

Veprimtari praktike

Tryeza rrethore, përmes së cilës nxënësit/et reflektojnë rreth krahasimit të llojeve të teksteve

<p>rrëfimtare joletrare, duke u përqendruar në tri elemente: qëllimi i shkrimit, struktura, veta e rrëfimit.</p> <p>Kronika Letra Udhëpërshkrimi</p>
<p>Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në të kuptuarit e përmbajtjen së tekstit të dhënë, dallimin e veçorive të kronikës, si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar, renditjen kronologjike të fakteve të kronikës, analizën e gjuhës së autorit dhe titullit të pjesës, krahasimin e llojeve të teksteve rrëfimtare joletrare.</i></p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni në gazeta, revista, internet, kronika të llojeve të ndryshme. Përpunojini materialet e tyre, shkurtojini dhe lexojini në klasë. Diskutoni rreth ngjarjeve të tyre.</p>

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Përgjigje admirueses</i> XH.Rouling		Situata e të nxënësve: Letra të ndryshme	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> <i>Kompetenca e të menduarit.</i> <i>Kompetenca personale.</i> <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> -rendit (rikujton) llojet e letrave; -zbulon problematikat e letrës; -analizon nga ana kuptimore tekstet e letrave; -analizon gjuhën e letrave. 		<p>Fjalët kyçe: Letër, paragraf, mesazh, formula hyrëse, mbyllëse.</p>	
<p>Burimet: Teksti mësimor, interneti, modele letrash personale.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe 	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diskutim - Lexim i drejtuar - Stuhi mendimesh- Punë në grup- Punë e pavarur</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimit:</p> <p>Hapi I. Diskutim Lexoni vetëm fillimet e letrave të mëposhtme dhe diskutoni rreth dallimeve mes tyre. Letra 1: Letër që Abraham Linkoln ia dërgon mësuesit të djalit të tij.</p>			

Letra 2. Letër që një qytetar ia dërgon kryetarit të Bashkisë (pjesët hyrëse, fjalët që përdorim etj).

Hapi II: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Lloje letrash: Letër zyrtare, ankesë, letër personale etj.

Hapi III. Lexim i drejtuar


Lexojmë fragmentin e dhënë:

Hapi IV. Stuhi mendimesh. Përgjigjuni pyetjeve në tabelën e mëposhtme:

Thoni llojin e letrës më lart	Kush e ka shkruar letrën?	Kujt i drejtohet?	Me ç'qëllim është shkruar?
Letër admirimi	Xh.K.Rouling	Sajsha	Falënderim, vlerësim.

-Nxirrni problematikat që dalin gjatë leximit të letrës.

Psb: Mendoj se problemi qëndron në faktin se adoleshenca, pavarësisht se shpesh shihet gabim si koha kur të rinjtë rebelohen e thyejnë rregullat, në fakt kërkon që të gjithë të përshtaten, nëse duan të jenë popullorë ose të paktën "të rebelohen" pasi të kenë veshur "rrobat" e dubura!



- ✓ Pse letra e Sajshas i duket e pabesueshme autores?
- ✓ Çfarë provon një adoleshente si Sajsha?
- ✓ Si e kuptoni fundin e letrës? Të faleminderit shumë që më shkrove...

Hapi IV. Punë në grup

Grupi I 5. Të plotësojnë me shembuj:

- a) Kujdesi i autores për lexuesen e vogël _____
- b) Kujdesi nga autorja në gjetjen e fjalëve _____
- c) Mirënjohja e autores _____

Grupi II.7. Të plotësojnë tabelën:

Çfarë mësoni nga letra e autores?	Çfarë doni të dini më tej? Çfarë mund t'i ketë shkruar më parë Sajsha autores?

Grupi III.8. Gjeni disa fjalë a shprehje që shërbejnë vetëm në shkrimin e letrave.

Hapi V. Punë e pavarur. Vendoseni veten në pozitën e Sajshas. Çfarë përgjigjeje do t'i ktheni autores?

Vlerësimi i nxënësve mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori në këtë letër, si dhe reflektimin rreth temës.

Detyrat : Bëni një provë të vogël. Shkruajini një letër shkrimtarit tuaj të preferuar.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Medalja e artë</i> Gabriela Dagllas		Situata e të nxënimit: Autobiografia dhe veçoritë e saj	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> <i>Kompetenca e të menduarit</i> <i>Kompetenca e të nxënimit</i> <i>Kompetenca qytetare</i> <i>Kompetenca digjitale</i>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -dallon autobiografinë si lloj i tekstit joletrar rrëfimtari; -u përgjigjet pyetjeve të mësuesit/es rreth brendisë së tekstit; -analizon elementet e strukturës së autobiografisë; -shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij/saj duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.		Fjalët kyçe: -akrobaci; -ushtrime; -publiku; -vendi i parë; -medalje; -sakrifica.	
Burimet: teksti mësimor, fotografi, materiale informuese për fitues në garime të ndryshme, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat shoqërore • Arti • Edukimi fizik 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimesh - INSERT -Punë në grupe			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimesh</i> -Kujtoni ngjarje gati të pabesueshme që japin shembuj frymëzimi të këmbënguljes dhe vullnetit.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Pas leximit të pjesës “Medalja e artë”, nëpërmjet teknikës <i>pyetje-përgjigje</i> , nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 1. Shpjegohet se ç’është autobiografia, si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar, sipas përkufizimit të dhënë në libër.			
- Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT Rikujtojmë se shenjat e tabelës INSERT janë;			
√ Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t’i kuptojë.	+ Për njohuritë që i ka mësuar më parë	– Për njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa ai i kujton	? Njohuri të reja që nuk arrin t’i kuptojë
Nxënësit punojnë në tekst me shenjat e tabelës INSERT duke specifikuar njohuritë e reja dhe ato që janë të pakuptueshme. Ndihmohen në të kuptuarin e njohurive për theksin e fjalës në lloje të ndryshme fjalësh.			



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur***Punë në grupe***

Mësuesi/ja i ndan nxënësit me grupe dhe secili prej tyre punon me:

Grupi I punon ushtrimin 1, duke iu përgjigjur pyetjeve të nivelit kuptimor:

Pyetje: Kush është Gabriele Dagllas?

Përgjigje: Gabrielle Douglas është një gjimnaste amerikane, e cila ka fituar medaljen e artë në garimin botëror të Lojrave Olimpikë 2012. Autobiografia e saj është një model frymëzimi dhe shembull i këmbënguljes dhe vullnetit, si rruga e vetme për të përmbushur ëndrrat tona.

Pyetje: Si pret publiku debutimin e saj në skenë?

Përgjigje: Ndërsa bëra akrobacinë e parë, publiku shpërtheu në brohoritje.

“Po, e bëra shkëlqyer pozicionim e parë!” Turma ndërkaq duartrokiste.

Pyetje: Çfarë e shqetëson gjimnasten gjatë garës?

Përgjigje: Viktoria Komova ishte e fundit që doli në tapet atë mbrëmje. Dhe gjatë gjithë kohës e pashë ushtrimin e saj nga vija anësore, ndërsa koka më vinte vërdallë. *“A do ta rimarrë lavidinë e saj Viktoria? A do t'i bëjë ballë rezultati im? A do të shkoja në shtëpi me një medalje të artë?”*

Pyetje: Cili është rezultati final i garës?

Përgjigje: Më në fund, ja ku doli. Rezultati final i garës ishte: Gabriel Dagllas, 62.232, Viktoria Komova, 15.100. Isha në vendin e parë.

Pyetje: Cila është rëndësia e fitores së kësaj gare?

Përgjigje: Atë natë unë shkrova tri histori: isha afro-amerikania dhe femra e parë me ngjyrë e çdo kombësie, që kisha fituar një medalje të artë në garën individuale gjithëpërfshirëse. Isha femra e katërt amerikane që fitoja një medalje të artë. Dhe u bëra, edhe gjimnastja e parë amerikane që mora medaljen e florinjte, si skuadër dhe si individ, në një seksion të vetëm lojërash olimpikë. Ia kisha dalë mbanë!

Pyetje: Si i përjeton gjimnastia çastet e fitores?

Përgjigje: Ndërsa tingujt e njohur filluan, duart m'u drodhën ndërsa një vrundull i ri lotësh m'u mblodh në cepat e syve. U mbusha thellë me frymë dhe vështrova publikun përreth. Gjatë gjithë kohës mendoja: *“Mos po ëndërroj?”*

Ndërsa qëndroja para mijëra, para miliona njerëzish, që më shikonin nga çdo skaj i botës, një vazhdë kujtimesh m'u shfaqën si film në kokë.

Grupi II punon ushtrimin: Gjeni në tekst fjalitë në të cilat autorja:

- Rrëfen ngjarjet e ndodhura në çastin e rrëfimit.
- Rrëfen kujtimet e saj.
- Përshkruan emocionet dhe përjetimet gjatë garimit.

Grupi III punon ushtrimin: Gjeni në tekst 3 fakte dhe 3 opinione të autores.

Opinione:

1. Befas m'u duk vetja si ylli i një koncerti rok!
2. Floriri dukej më i rëndë nga ç'e kisha imagjinuar.
3. M'u duk sikur prita një përjetësi derisa doli rezultati im

Fakte:

1. Gjatë ceremonisë së shpërndarjes së medaljeve, një zyrtar më vuri rreth qafës fjongon e gjerë e të purpurt që mbante medaljen time të artë.
2. Rezultati final i garës ishte: Gabriel Dagllas, 62.232, Viktoria Komova, 15.100.
3. Ndërsa bëra akrobacinë e parë, publiku shpërtheu në brohoritje.

Grupi IV punon ushtrimin: Në mbyllje të autobiografisë, autorja shprehet: *“Në një çast mendova që të gjitha, sakrificat, dëmtimet, malli për shtëpinë, që të gjitha ia kishin vlejtur”*. Jepni vlerësimin

<p>tuaj për këtë gjykim të saj dhe argumentoni se ku qëndron çelësi i suksesit të çdo fitoreje. Përgjigje: E vlerësoj mendimin e Gabrielës. Autorja mendon se rruga e sakrificave e ka kurorëzuar me sukses dhe kjo ia ka vlejtur. Çelësi i çdo fitoreje, qëndron tek këmbëngulja, përkushtimi, pasioni.</p>
<p>Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në dallimin e autobiografisë si lloj i tekstit joletrar rrëfimtar, të kuptuarit e brendisë së tekstit, të analizuarit e elementeve dhe strukturës së autobiografisë, interpretimin e ideve të autores.</i></p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ngjarje autobiografike nga jeta juaj, duke sjellë fakte reale dhe opinione personale. Prezantoni ato në klasë dhe diskutoni rreth tematikës, ideve dhe mesazheve që përcjellin.</p>

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Kur të rriturit marrin zjarr</i> Ana Frank		Situata e të nxënësve: Ditari	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> <i>Kompetenca e të menduarit</i> <i>Kompetenca e të nxënësve</i> <i>Kompetenca qytetare</i> <i>Kompetenca digjitale</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon ditarin e dhënë për të kuptuar përmbajtjen e tij; -dallon veçoritë gjuhësore të ditarit si lloj i tekstit rrëfimtar joletrar; -analizon elementet e strukturës së ditarit; -interpretonte idetë e autores të shprehura në ditarin e saj; -argumenton qëndrimin e vet ndaj situatës së temës.</p>		<p>Fjalët kyçe: -zënkë; -diskutim; -inat; -qesharake; -modeste; -gjykim.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, fotografi, ditare të ndryshme personale apo nga njerëz të njohur, videoprojektor.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat shoqërore 	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimesh - Leksion i përqendruar -Punë në grupe</p>			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimesh</i></p>			

Diskutoni si e kuptoni shprehjen: “Po deshe ta njohësh një njeri, duhet që të paktën një herë të zihesh me të”.

Variant përgjigjeje: Gjatë diskutimeve dhe debateve njerëzit zbulojnë personalitetin e tyre të vërtetë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Pas leximit të fragmentit të shkëputur nga ditari i Ana Frankut, “*Kur të rriturit marrin zjarr*”, nëpërmjet teknikës *pyetje-përgjigje*, nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 1.

Shpjegohet se ç’është ditari, si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar.

Ditari është një lloj shkrimi, i cili përmban shënime të përditshme a të kohëpaskohshme, nga shkruesi i tij për ngjarje nga jeta vetjake.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur

Punë në grupe

Mësuesi/ja i ndan nxënësit me grupe dhe secili prej tyre punon me:

Grupi I punon ushtrimin: Plotësoni tabelën:

Lloji	Ky shkrim është një ditar
Tiparet e strukturës	Ka hyrje, zhvillim, mbyllje, bazohet në faktet personale të shkruarit, ndjek rendin kronologjik të rrëfimit.
Tiparet gjuhësore	Rrëfihet në vetën e parë, me gjuhë të thjeshtë, subjektive sipas përjetimeve personale, përdoret koha e tashme për të treguar ngjarje dhe emocione që ndodhin në çastin e rrëfimit, por edhe kohët e shkuara, si e pakryera, ose e kryera e thjeshtë, për ngjarje të ndodhura në kohën e shkuar.

Grupi II punon ushtrimin: Shkruani kuptimin e fjalëve të përdorura në fragment:

Modest: i thjeshtë, jo mendjemadh...

Shamatë: zhurmë

Grupi III punon ushtrimin: Emërtoni figurat letrare dhe shkruani përbri kuptimin e secilës.

si domate-krahasim

marrin zjarr-shprehje frazeologjike

Grupi IV punon ushtrimin: Kur më të rriturit ju qortojnë, por nuk bien në një mendje dhe janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, ju:

- prisni sa të gjejnë gjuhën e përbashkët;
- përpiqeni të mbroheni, por çorientoheni ngaqë ata ndërhyjnë vazhdimisht;
- e kaloni me humor situatën që krijohet;
- qëndroni të heshtur duke pritur që diskutimi të fashitet;
- nervozoheni dhe debatoni gjallërisht sa në njërin krah në tjetrin.

Nxënësi/ja zgjedh njërin nga alternativat dhe argumenton qëndrimin e vet.

Vlerësimi:


Vlerësimi i nxënësit mbështetet në dallimin e veçorive gjuhësore dhe atyre strukturore të ditarit si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar, interpretimin e ideve të autores të shprehura në ditarin e saj, argumentimin e qëndrimit të vet ndaj situatës së temës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani në formë ditari një ngjarje mbresëlënëse nga jeta juaj. Prezantoni ditaret tuaja në klasë dhe diskutoni rreth tematikës së tyre.

Detyra synon thellimin në botën e fëmijës, interesat dhe shqetësimet e tij. Kjo mund të zbulohet nëpërmjet tematikave.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Shqetësimet e një studimesi Viron Kona</i>		Situata e të nxënit: Intervista	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> <i>Kompetenca e të menduarit</i> <i>Kompetenca e të nxënit</i> <i>Kompetenca qytetare</i> <i>Kompetenca digjitale</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -dallon qëllimin e intervistës; -analizon elementet e strukturës së intervistës; -dallon informacionin e rëndësishëm në tekst; -gjen citimet e përmendura gjatë intervistës; -argumenton këndvështrimin e tij rreth intervistës.</p>		<p>Fjalët kyçe: -gjuha shqipe; -probleme; -gabime gjuhësore; -masa mbrojtëse.</p> 	
<p>Burimet: teksti mësimor, fotografi, materiale informuese për problemet e sotme të gjuhës shqipe, videoprojektor.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat shoqërore • Shkenca e gjuhës 	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimesh - Diagrami piramid -Punë në grupe</p>			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimesh</i> Shtohet pyetja për diskutim: Cilat nga format e fjalëve të mëposhtme do përdornit në të folurin tuaj? listoj/rendis eksperiencë/përvojë gjysmë/gjysëm ekspresiv/shprehimor efekt/ndikim hobi/pasion teka/kapriçio edicion/botim aktuale/e tanishme Shënim: Fjalët e selektuara janë variantet e duhura. Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami piramid Pas leximit të intervistës, nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 1. -Qëllimi i kësaj interviste është: -Alternativa e saktë: të pyesë gjuhëtarin për problemet e gjuhës shqipe;</p>			

- Shpjegohet se ç'është intervista, si lloj i tekstit rrëfimtari joletrar.

Qëllimi kryesor i intervistës, është transferimi i informacionit nga të intervistuarit tek intervistuesit. Intervistuesi bën pyetje, i intervistuari përgjigjet. Nuk ka një platformë të përcaktuar të llojit të pyetjeve që bëhen në një intervistë, por në varësi të kohës në dispozicion, intervista ka një hyrje dhe një mbyllje.

Intervista “Shqetësimet e një studiuesi”

Kush është i intervistuari ?	Po intervistuesi?	Cilat janë problemet që ajo trajton?	Si mund të zgjidhen ato?	Pse është e rëndësishme kjo temë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur

Punë në grupe

Mësuesi/ja i ndan nxënësit me grupe dhe secili prej tyre punon me:

Grupi I punon ushtrimin: Dalloni informacionin e rëndësishëm në tekst lidhur me çështjet e mëposhtme. Rishkruani përbri tyre, fjalët e autorit shkurtimisht.

1. Tradita lidhet me lëvrimin e autorëve të letërsisë së vjetër dhe atyre të Rilindjes.
2. Zbatimi i drejtshkrimit të njësuar dhe i normave të shqipes standarde duhet të jetë kërkesë e domosdoshme dhe e përhershme.
3. Mirëpo, të mësosh dhe të vlerësosh gjuhët e huaja, nuk do të thotë aspak të mos vlerësosh (e aq më pak të nënvlerësosh) gjuhën tënde!
4. Gjuha shqipe ka sot një numër problemesh që duhen njohur dhe sidomos shumë gabime e shtrembërime ligjërimore që duhen shmangur e përmirësuar.

Grupi II punon ushtrimin: Shkruani tri tipare gjuhësore të kësaj interviste:

1. Foljet janë kryesisht në kohën e tashme.
2. Fjalitë janë kryesisht me bashkërenditje.
3. Ka leksik të pasur dhe janë përdorur terma, si p.sh: shtrembërime ligjërimore, drejtshqiptim, normë, barbarizma, huazime, redaktimit e të korrektimit gjuhësor, gjuhës së njësuar (standarde).

Grupi III punon ushtrimin: Gjeni citimet e përmendura gjatë intervistës. Shpjegoni funksionin e tyre.

Ne i mbahemi parimit të shprehur nga Eqrem Çabej, i cili theksonte: “Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture”.

Citati është pjesë, fragment i marrur fjalë për fjalë nga ndonjë vepër ose nga ndonjë fjalim dhe që përdoret për të vërtetuar ose sqaruar një mendim.

Grupi IV punon ushtrimin: Jepni dhe argumentoni këndvështrimin tuaj rreth intervistës.

Mendoj se intervista trajton problemet kryesore me të cilat ndeshet sot Gjuha Shqipe.

1. Ka huazime
2. Zhargoni i kudogjendur
3. Shkruhet me gabime
4. Shqiptohet me gabime

Diskutimi hyrës prek edhe situatat, p.sh: problemet reflektohen në media, internet, tekste, gazeta etj.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kuptimin e përmbajtjes së intervistës, dallimin e informacionit kyc në tekst, dallimin e citimeve, reflektimin rreth saj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Çfarë mesazhi ju transmeton figura e dhënë në tekst? Shkruani si e kuptoni atë.

Projekt: Krijoni një album me biografite e gjuhëtarëve të shquar shqiptarë.

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Shpikja e alfabetit</i> Teksti informues-shpjegues		Situata e të nxënësve: Diskutim	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i>			
Rezultatet e të nxënësve të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -evidenton sistemet e lashta të shkrimit; - plotëson skemën e komunikimit; - shkruan informacionet që merr nga teksti për çështje të ndryshme; - analizon llojet e fjalive në paragrafin e fundit; - krahason shkrimin e lashtësisë me kompjuterin.		Fjalët kyçe: -alfabet; -hieroglifet; -shkronjë; -papyrus; -pergamena; - stil.	
Burimet: teksti mësimor, fotografi, laptop.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Qytetaria • Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimi -Bashkëbisedim /Punë në grupe – Diagramë Veni			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimi Zhvillohet një diskutim rreth pyetjeve: - Cilat kanë qenë sistemet e lashta të shkrimit? - Ku shkruanin njerëzit e lashtë? Nxënësit sjellin mendimet e tyre, të cilat plotësojnë njëri-tjetrin. Ndërtimi i njohurive të reja: → Prezantimi i pjesës së re Plotësoj njohuritë e nxënësve përmes një minileksioni të shkurtër mbi: <i>shpikjen e fenikasve, karakteristikat e shkrimit të tyre, ndikimi i tyre në alfabetet e tjera, materiali më i përshtatshëm për të shkruar...</i> → Lexim shprehës i tekstit Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm (me shpejtësinë dhe intonacionin e duhur).			

Pyes mbi elementët e skemës së komunikimit (dhënësi, marrësi, kodi, kanali, mesazhi).
P.sh - dhënësi- autori që ka shkruar tekstin, - kodi,- gjuha e shkruar.

→ **Fjalët dhe shprehjet e reja**

U kërkohet nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja. Shkruhen fjalët në dërrasën e zezë, zëbërthehet kuptimi i tyre.

Ndaj nxënësit në grupe dhe secilit grup u caktoj për të punuar ushtrimet nga teksti.

Grupi I: Shkruani informacionet që merrni nga teksti për:

Fenikasisit-

Sistemin e ri të shkrimit-

Zakonet njerëzore të të shkruarit-

Grupi II: Cila është koha e foljeve të përdorura më së shumti në këtë tekst?

Grupi III: Ç`lloj fjalish janë përdorur në paragrafin e fundit të tekstit?

Pasi punojnë, nxënësit lexojnë punët e tyre.

→ **Kuptimi**

Bëni një Diagramë Veni për të krahasuar shkrimet e lashtësisë (mbi pergamenë, papirus, letër) me kompjuterin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Pasi punojnë, nxënësit lexojnë punët e tyre.

Vlerësimi: Bëhet vlerësimi për aktivizimin dhe përgjigjet e dhëna gjatë kësaj ore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- *Si ka evoluar shkrimi i gjuhës shqipe? (Shkrim shpjegues)*

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Librat dhe bibliotekat Teksti informues-shpjegues		Situata e të nxënit: Bashkëbisedim rreth përvojave personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca personale.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -përcakton objektin për të cilin shpjegohet; -rendit bibliotekat botërore sipas përmasave të tyre; - analizon mënyrën si vepron autori për të shpjeguar temën; - ilustron përmes tekstit karakteristikat gjuhësore të tij.		Fjalët kyçe: -bibliotekë; -katalog; -kartela; -adresë;	

<p>- shpjegon përmes reflektimit të tij/saj personal mbi çështje të ndryshme.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, fotografi, laptop.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qytetaria • Historia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Stuhi mendimi -Bashkëbisedim /Ditari dypjesësh -Puno dyshe/Shkëmbe mendime</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimi Zhvillohet një diskutim rreth pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat mjete na vijnë në ndihmë për të gjetur një libër në bibliotekë ? - Çfarë shpjegohet rreth kësaj çështjeje në këtë tekst ? - Si klasifikohen bibliotekat? <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet duke sjellë edhe ilustrime përmes eksperiencave të tyre personale në lidhje me çështjet e mësipërme.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: → Prezantimi i pjesës së re Duke u mbështetur në përgjigjet e nxënësve, zhvillohet me ta një bisedë hyrëse në të cilën prezantohet titulli i pjesës “Bibliotekat”.</p> <p>Përmes kësaj pjese ne zgjerojmë njohuritë rreth bibliotekave. Ato janë të ndryshme si për nga madhësia(ndahen në të mëdha e të vogla), ashtu edhe për nga llojshmëria e tyre (Kombëtare, publike, special, universitare, shkollore, etj.). Si mund të gjejmë një libër në bibliotekë dhe pse është e rëndësishme saktësia e të dhënave.</p> <p>→ Lexim shprehës i tekstit Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm (me shpejtësinë dhe intonacionin e duhur). Pyes për përshtypjet e para rreth tekstit: - <i>Cili nga përcaktimet e dhëna në tekst për bibliotekat ju pëlqen më shumë? Pse?</i></p> <p>→ Fjalët dhe shprehjet e reja U kërkoj nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja. Shkruhen fjalët në dërrasën e zezë, zberthehet kuptimi i tyre dhe nxënësit formojnë fjalë me to. Përmes teknikës <i>ditari dypjesësh</i> nxënësit plotësojnë tabelën përkatëse. (realizohet analiza se si vepron autori i këtij teksti për të shpjeguar).</p>	
<p>Ecuria dhe zhvillimi i bibliotekave botërore</p>	<p>Është llogaritur se i gjithë arsenal i librave dyfishohet çdo katër vjet e gjysmë. Vetëm në Shtetet e Bashkuara, çdo vit botohen më shumë se 150 000 libra.</p>
<p>Hapat që duhet të ndiqen për të gjetur një libër në bibliotekë.</p>	<p>Në fillim duhet të mësojmë nëse ky libër ndodhet në bibliotekë. Për këtë na ndihmon katalogu alfabetik, i cili është një sirtar me kartela. Çdo libër është regjistruar në një kartelë të veçantë, kurse kartelat janë të radhitura sipas alfabetit (sipas mbiemrave të autorëve). Kërkojmë germën dhe kartelën e librit, që na duhet. Në qoshen e majtë, lart ndodhet “adresa” e librit. Kjo quhet edhe “shifra e plotë”, me anë të së cilës, në çdo lloj biblioteke, ne mund ta gjejmë shpejt librin që na duhet. Ai,</p>

	që do të dijë të përdorë katalogun, asnjëherë nuk do të ngatërrohet mes morisë së librave.	
- Më pas, nxënësit në heshtje plotësojnë tabelën e mëposhtme, përmes së cilës evidentojnë karakteristikat e tekstit.		
Karakteristika për gjuhën e tekstit	e saktë/e gabuar	Ilustrimi
- E thjeshtë	-	-
- E qartë	-	-
- Me shifra e me data	-	-
- Me shpjegime	-	-
- Me citime	-	-
- Objektive	-	-
- Subjektive	-	-
Nxënësit punojnë në heshtje e më pas prezantojnë punën e tyre para grupit të klasës. → Kuptimi Nxënësit sipas teknikës <i>Puno dyshe/shkëmbe mendime</i> sipas mënyrës si janë ulur punojnë me: ▪ Shpjegoni kuptimin e thënies: Dhoma pa libra është sikurse trupi pa shpirt! (Ciceroni) Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pasi punojnë, nxënësit lexojnë punët e tyre.		
Vlerësimi: Bëhet vlerësimi për aktivizimin dhe formulimin e përgjigjeve të nxënësve: klasifikimi i bibliotekave, renditja e tyre sipas përmasave, mënyra si vepron autori për të shpjeguar, karakteristikat gjuhësore të tekstit, etj..		
Detyrat dhe puna e pavarur: Shpjegoni si funksionon biblioteka e shkollës suaj. A jeni anëtar i saj? Sa libra përmban ajo? Ç'loj librash janë?		

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Udhëzues testimi</i> Teksti udhëzues		Situata e të nxënit: Udhëzimet	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 3. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 4. <i>Kompetenca personale.</i> 5. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i>			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon tekstin udhëzues për ta kuptuar atë; -analizon tiparet gjuhësore të tekstit udhëzues; -analizon strukturën e tekstit udhëzues.</p>	<p>Fjalët kyçe: Tekst udhëzues, folje,mënyrë lidhore,urdhërore, këshillon, urdhëron etj.</p>												
<p>Burimet:Teksti i nxënësit, manuale përdorimi, testime dhe udhëzime testimesh etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe 												
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diskutim - Pema e mendimit- Lexim i drejtuar- Bashkëbisedim- Punë e drejtuar – Punë e pavarur</p>													
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>Hapi I: Diskutim: Shihni udhëzuesit e mëposhtëm. Çfarë informacioni ju japin ato? Nxënësit janë të lirë të shprehin mendimin e tyre</p> <p>Hapi II. Pema e mendimit. Kujtojmë ç’dimë për tekstin udhëzues.</p> <div style="text-align: center;"> </div> <p>Hapi III. Lexim i drejtuar. Lexojmë fragmentin duke u njohur me kuptimet e fjalëve me shkronja të zeza.</p> <p>Hapi IV. Bashkëbisedim.</p> <ol style="list-style-type: none"> Shkruani disa pyetje që ju lindin përpara një testimi <ul style="list-style-type: none"> A do të mund t’u përgjigjem saktë të gjitha kërkesave të testit? Çfarë do të ketë: më shumë pyetje me alternativa apo me shtjellim?...etj. Renditni udhëzimet kryesore të tekstit më lart: Përse na shërbejnë këto udhëzime? 													
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Çfarë duhet të kenë parasysh nxënësit kur punojnë në një testim?</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Udhëzim 1.</td> <td>Të lexohen shënimet me vëmendje për të marrë një informacion të përgjithshëm</td> </tr> <tr> <td>Udhëzim 2</td> <td>Të lexojnë me vëmendje fragmentin e zgjedhur.</td> </tr> <tr> <td>Udhëzim 3.</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Udhëzim 4.</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Udhëzim 5.</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nr.	Çfarë duhet të kenë parasysh nxënësit kur punojnë në një testim?	Udhëzim 1.	Të lexohen shënimet me vëmendje për të marrë një informacion të përgjithshëm	Udhëzim 2	Të lexojnë me vëmendje fragmentin e zgjedhur.	Udhëzim 3.		Udhëzim 4.		Udhëzim 5.		
Nr.	Çfarë duhet të kenë parasysh nxënësit kur punojnë në një testim?												
Udhëzim 1.	Të lexohen shënimet me vëmendje për të marrë një informacion të përgjithshëm												
Udhëzim 2	Të lexojnë me vëmendje fragmentin e zgjedhur.												
Udhëzim 3.													
Udhëzim 4.													
Udhëzim 5.													
<p>Hapi V. Bashkëbisedim.</p> <p>4. Si e kuptoni shprehjen “ Më jep një pyetje të mirë që të mund të të jap një përgjigje po kaq të mirë”.</p> <p>Hapi VI. Punë e pavarur:</p> <p>5. Nxirrni përfundime rreth testimit të fundit që keni zhvilluar në lëndën e gjuhës? Cilat nga udhëzimet me lart keni respektuar aty?</p>													
<p>Vlerësimi: Në fund të orës së mësimi nxjerrim konkluzionet. Bëjmë vlerësime për disa nxënës.</p>													

Detyrat : - Lexoni pyetjen bashkë me udhëzuesin shoqërues dhe përgjigjuni pyetjes duke e patur parasysh atë.

Lexoni me vëmendje fjalinë dhe nënvizoni fjalët që japin kuptimin kryesor dhe që tregojnë natyrën ëndërrimtare të Anës. Diskutoni zgjedhjen tuaj.

Ana ndenji pak në dhomë dhe më pas doli jashtë. Ngriti sytë nga qielli dhe po vështrohte yjet...

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Si të pasurosh fjalorin</i> Teksti		Situata e të nxënësve: Udhëzimet	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca qytetare.</i> 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: Fjalor i pasur, përshtypje, frazë, përfytyrim, çmoj etj.	
Nxënësi/ja: -lexon pjesën për t'iu përgjigjur pyetjeve të saj kuptimore; -analizon pjesën duke interpretuar idetë e saj; -analizon strukturën e saj, tiparet si tekst udhëzues; -analizon gjuhën e tekstit.			
Burimet: Teksti i nxënësit, fjalorë të ndryshëm, tekste udhëzuese etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
<ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe 			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
-Diskutim - Lexim i drejtuar - Stuhi mendimesh - Punë e drejtuar – Punë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimt:			
<p>Hapi I. Diskutim Flisni rreth librit të fundit që keni lexuar. Shprehni mendimet tuaja dhe në fund tregoni se cili nga nxënësit u shpreh më bukur. Pse mendoni kështu?</p>			
<p>Hapi II. Lexim i drejtuar. Lexojmë fragmentin duke u njohur me kuptimet e fjalëve me shkronja të zeza. I shpjegojmë ato.</p>			
<p>Hapi III. Stuhi mendimesh</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Plotësojmë tabelën: 			
Çfarë dimë rreth pasurimit të fjalorit?	Çfarë mësojmë nga teksti që lexuam rreth pasurimit të fjalorit?	Përse na shërbejnë këto udhëzime?	

<p>Sa më shumë libra të lexojmë, aq më shumë e pasurojmë fjalorin tonë me fjalë dhe shprehje të bukura. Një fjalor i pasur na ndihmon shumë në diskutimet tona mes shokëve, si dhe në shkollë, apo gjetiu.</p>	
<p>2. Shpjegoni pse bëhesh “më i pasur” duke pasuruar fjalorin tënd. Shkruani në formën e udhëzimeve mendimet tuaja.</p> <p>3. A duket më i bukur një njeri kur flet bukur? Shkruani në formën e udhëzimeve mendimet tuaja.</p> <p>4. Kujtoni dhe analizoni një figure publike që flet bukur. Shkruani në formën e udhëzimeve si mund t’i afrosh modelit të të folurit bukur.</p>	
<p>Hapi IV. Praktikë e drejtuar. <i>Interpretojme tekstin.</i></p>	
<p>5. <i>Përvoja njerëzore ka treguar se puna e veçuar vetëm me fjalorët nuk mund të të bëjë njeri më të mirë, as më të ditur dhe as më të këndshëm. Me çfarë dubet kombinuar tjetër dija dhe kultura që të kesh rezultate sa më të mira në përshtypjen që lë gjatë përdorimit të fjalorit vetjak?</i></p>	
<p>Hapi V. Praktikë e pavarur. <i>Gjuha e tekstit</i></p>	
<p>6. <i>Gjatë tekstit hasim këtë mendim:</i> ...Kur ju shkruani: “djali u ul në divan me kokën mes duarve” dhe “djali u lëshua në divan me kokën mes duarve”.</p>	
<p><i>Në fjalinë e parë fjalia është e saktë dhe korrekte në të shprehur. Në fjalinë e dytë ajo ka forcë më të madhe shprehëse, mendimi është më i detajuar, ka leksik të veçantë dhe tingëllon më bukur në të shprehur.</i></p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështetet në të kuptuarit e tekstit udhëzues, analizën, interpretimin dhe reflektimin rreth tij.</p>	
<p>Detyrat: Shkruani një tekst të thjeshtë ku të jepni këshilla se si mund të dukeni bukur në një festë.</p>	

Data:

PLANIFIKIMI DITOR


<p>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: III</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: <i>Lavdërimi i atdheut</i> Lukiani</p>		<p>Situata e të nxënës: Teksti argumentues</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç</p>			
<p>1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 4. <i>Kompetenca personale.</i> 5. <i>Kompetenca qytetare.</i></p>			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon pjesën për ta kuptuar atë; -formulon një pesëvargësh me fjalën kyçe; -flet shkurtimisht për autorin e pjesës; -dallon argumentet që mbështesin tezën; -interpretin efektin që krijojnë frazat në gjuhën e argumentimit; -dallon frazat ku shprehen fakte dhe opinione; -argumenton këndvështrimin e tij për temën.</p>	<p>Fjalët kyçe: -atdheu; -i shtrenjtë; -i lartë; -dielli; -mirënjohës;</p>		
<p>Burimet: teksti mësimor, fotografi, shkrime për atdheun, videoprojektor.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat shoqërore • Historia 		
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Pesëvargëshi -INSERT -Punë e pavarur</p>			
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Ndërtoni një pesëvargësh me fjalën: atdheu</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT</p>			
<p>Shkurtimisht për autorin: Lukiani lindi rreth viti 120 të erës së re, në qytetin Samosata të Sirisë dhe vdiq në Egjipt rreth vitit 190. Ishte orator i famshëm, i njohur për natyrën e mprehtë të shkrimeve të tij satirike. Fama e tij, megjithatë, është e lidhur kryesisht me dialogjet me përmbajtje morale, filozofike dhe fetare karakterizuar nga një stil satirik dhe polemik, djegës sidomos ndaj cinikëve. Ai u përkushtua në mbledhjen e historive dhe legjendave të traditës greke.</p>			
<p>Pas leximit të pjesës së Lukianit “Atdheu”, nxënësi/ja rrethoni shkronjën V, kur pohimet përputhen me tekstin dhe, në rastin e kundërt, shkronjën G.</p> <p>Nxënësit punojnë me shenjat e tabelës INSERT në fletore dhe pasi e përfundojnë atë, e kategorizojnë duke e përmbledhur me fjalët e tyre çdo koncept që kujtojnë ose mësojnë rreth tekstit argumentues.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kujtojmë: Teksti argumentues ka si qëllim të bindë lexuesin për një çështje të caktuar nëpërmjet fakteve, shembujve, provave dhe gjykimeve praktike. Autori i një teksti bindës formulon një çështje, e cila shfaqet e gatshme për lexuesin ose është e nënkuptuar. Çështja është një pohim, një ide kyçe, mbi të cilën ndërtohet i gjithë teksti. Vërtetësia e kësaj çështjeje dhe argumentimi rreth saj varen nga opinionet e autorit, argumentet që ai sjell për ta mbështetur atë dhe për ta bindur lexuesin. • Mësojmë: Teza është një pohim në të cilin shprehet një gjykim a parim, vërtetësia e të cilit duhet provuar e duhet argumentuar; • Argumenti është arsyetim që përdoret për të vërtetuar ose për të kundërshtuar një mendim; provë që sillet për të mbrojtur (argument pro) ose për të hedhur poshtë diçka (argument kundër). 			
<p>√ Nxënësit e dinë informacionin që po lexojnë</p>	<p>+</p> <p>Informacioni i ri për nxënësit</p>	<p>-</p> <p>Nxënësit e dinin ndryshe informacionin e ri</p>	<p>?</p> <p>Informacioni që nuk arrin ta kuptojë</p>

<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur</p> <p>Grupi I:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në tabelën e mëposhtme, shkruani argumentet e dhëna në tekst, duke u orientuar nga fjalët kyçe përkatëse. 		
<p>Teza ⇒</p>	<p>Nuk ka asgjë më të shtrenjtë se atdheu për njeriun, pasi ky e lind, e rrit dhe e edukon.</p>	<p>Fjalë kyçe</p>
<p>Argumenti I ⇒</p>	<p>Shumëkush mund të mahnitet nga madhështia dhe fuqia e qyteteve të huaja, nga bukuria dhe shkëlqimi i ndërtesave të tyre, por, për të dashur, të gjithë duan atdheun.</p>	<p>dashuri, atdhe</p>
<p>Argumenti II ⇒</p>	<p>Se edhe diellin, çdo njeri e ka parë në fillim në atdhe.</p>	<p>diell, atdhe</p>
<p>Argumenti III ⇒</p>	<p>dhe gjithsecili ka nisur të flasë në vendlindjen e babait, duke mësuar së pari të belbëzojë në gjuhën amtare.</p>	<p>gjuhë amtare</p>
<p>Argumenti IV ⇒</p>	<p>duhet të jesh mirënjohës kur përfiton të mira kaq të mëdha.</p>	<p>përfitim, mirënjohës</p>
<p>Grupi II:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nënvizoni në tekst nga dy fjali ku: <ul style="list-style-type: none"> shprehen fakte: Se edhe diellin, çdo njeri e ka parë në fillim në atdhe. shprehen opinione: Unë mendoj se të gjitha shprehitë, të gjitha dijet njerëzit i fitojnë për t'i shërbyer sa më shumë atdheut; edhe pasuritë ata i shtojnë nga dëshira që t'i shpenzojnë për të mirën e atdheut. autori bëhet subjektiv: Shumëkush mund të jetë kënaqur, ndoshta edhe tej masës, duke soditur mrekulli të panumërta në vise të huaja, por askush nuk është verbuar aq shumë nga begatia e tyre, sa të harrojë atdheun e vet. <p>Grupi III:</p> <ul style="list-style-type: none"> Secili prej paragrafëve të tekstit fillon me frazat e mëposhtme: <i>Është thënë qëkuri se...; Në rast se ...; Unë mendoj se...; Dhe, sipas mendimit tim...</i> Cili është efekti që krijojnë këto fraza në gjuhën e argumentimit? Përgjigje: Këto fraza që janë tipar i gjuhës së argumentimit, paraqesin këndvështrimin e dhënë nga autori, në mënyrë krejt të lirë dhe subjektive. <p>Grupi IV:</p> <ul style="list-style-type: none"> Çfarë është atdheu për ju? Argumentoni. Nxënësi/ja argumenton duke sjellë fakte, shembuj dhe dëshmi që mbështesin tezën se atdheu është i shtrenjtë. Mund të referohet në thënie dhe fjalë të urta për atdheun. <p>Grupi V: punon me tipin e fjalëformimit të fjalëve të dhëna.</p>		
<p>Vlerësimi:</p> <p><i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në të kuptuarit e pjesës; formulimin e një pesëvargëshi me fjalën kyçe, dallimin e argumenteve që mbështesin tezën, interpretimin e efektit që krijojnë frazat në gjuhën e argumentimit; dallimin e frazave ku shprehen fakte dhe opinione, argumentimin e këndvështrimit të tij/saj për temën.</i></p>		
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni dhe lexoni në klasë materiale të ndryshme, tematika e të cilave të jetë: “Shqiptarët jashtë atdheut”. Diskutoni rreth tyre.</p>		

Data:

PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Si një roman</i> Daniel Penak		Situata e të nxënit: Rëndësia e leximit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç <ol style="list-style-type: none"> <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> <i>Kompetenca e të menduarit.</i> <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> <i>Kompetenca personale.</i> <i>Kompetenca qytetare.</i> 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon pjesën për të kuptuar përmbajtjen e saj; -diskuton rreth temës; -analizon gjuhën e tekstit argumentues; - argumenton rreth temës duke referuar në shembuj konkretë.		Fjalët kyçe: -im bir; -lexim; -tradhti; -televizor; -vetmi.	
Burimet: teksti mësimor, fotografi, materiale informuese për problemet e sotme të leximit, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat shoqërore • Letërsia 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Diskutim -Pyetje-përgjigje -Analizë e tipareve semantike -Punë e drejtuar			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim Renditni pesë arsye pse ju pëlqen që një vepër: -ta lexoni në variantin e shkruar, si libër; -ta shihni në variantin filmik.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetje-përgjigje; Analizë e tipareve semantike Pyetje: Si ndihet biri i autorit përballë librit? Përgjigje: Tani, ai e sheh veten të vetmuar përballë një libri aspak miqësor. Sot gëlimi i padeshifrueshëm i shkronjave ia merr frymën deri edhe orvatjeve të tij për të ëndërruar.			
Pyetje: Cila ka qenë lidhja e fëmijës me leximin? Përgjigje: Ne: ai, përralla dhe vetë ne, formonim një trini, pjesëtarët e së cilës pajtoheshin çdo mbrëmje; Ai, gjithë zell, priste atë pjesë të përrallës që e kishte më shumë qejf, të cilën e recitonte me vete në çastin e volitshëm; pastaj vinin pjesët e tjera, më të vështira për t'u kuptuar, ku lidheshin nyjat e tërë mistereve, por, pak e nga pak, ai kuptonte gjithçka,			
Analizë e tipareve semantike			
Leximi	Qëllimi	Marrëdhënia juaj me të	Libri i fundit që keni
			Libri që po lexoni
			Një thënie për leximin
			Teza e autorit
			Qëndrimi juaj ndaj tezës
			Krahasoni veten si lexues fëmijë

			lexuar					dhe lexues i sotëm

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e drejtuar

- Interpretoni frazën: “Sa e rëndë kjo tradhti!”

Përgjigje: Nëpërmjet saj autori nënkupton që: fëmijët janë të vetmuar në procesin e leximit;

- Gjatë argumentimit, autori, herë pas here, shprehet edhe në mënyrë subjektive. Zbërtheni kuptimin dhe llojin e figurave të përdorura:

<i>Shprehja</i>	<i>Kuptimi</i>	<i>Figura letrare</i>
<i>... bëhet vërtetë fjalë për një plagë dashurie</i>	
<i>... ta nxjerrë atë ëndërr nga burgu</i>		

- Ç`mendim keni për rolin e leximit te njeriu? Argumentoni duke referuar në shembuj konkretë.

Nxënësi/ja jep argumente: shembuj, dëshmi, fakte të cilat mbrojnë tezën së leximi është shumë i rëndësishëm për njeriun. Librat janë miqtë e përhershëm, këshilluesit më të mirë. Leximi pasuron imagjinatën dhe fjalorin.


Individët që lexojnë kanë arritje më të larta në shkollë, punë dhe janë të vlerësuar në diskutimet shoqërore.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në të kuptuarin e përmbajtjes së tekstit, analizën e tij strukturore dhe argumentimin e nxënësit rreth temës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Argumentoni thënien:



“Nëse ke një kopsht dhe një bibliotekë, atëherë ke gjithçka që të duhet.”

Cicero

Data:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: <i>Tirana jonë</i>		Teksti përshkrues	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:		Situata e të nxënit: Historiku i Tiranës	
<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</i> 2. <i>Kompetenca e të menduarit.</i> 3. <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.</i> 			

<p>4. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</i> 5. <i>Kompetenca qytetare.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: -lexon tekstin përshkrues dhe u përgjigjet pyetjeve të tij kuptimore; -identifikon momentet kryesore të këtij teksti, që zgjojnë imagjinatën e lexuesit; -analizon rolin e detajeve në tekst; -dallon fjalët kyçe që krijojnë imazhin e vendit që përshkruhet; -analizon gjuhën e përdorur në përshkrim; -shndërron pjesën në mënyrë të përmbledhur në një tekst përshkrues krejtësisht objektiv.</p>	<p>Fjalët kyçe: Tirana, godinë arkitekturore, histori, rrënojat e zabuluara, rritet si fëmijë.</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit, episode filmike nga <i>youtube</i>, fotografi për qytetin e Tiranës, materiale informuese, piktura të Tiranës etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Historia • Gjeografia • Gjuha shqipe
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: -Diskutim - Pema e mendimit- Lexim i drejtuar- Punë në grup - Punë e drejtuar - Punë e pavarur</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimt:</p>	
<p>Hapi I- Diskutim. Përpara se të lexojmë tekstin, diskutojmë rreth kësaj situate. <i>-Ja çfarë tha, një ditë, një i intervistuar në një televizion: “Lexova një përshkrim nga të buajt rreth zonës së Valbonës. M'u duk mjaft i bukur dhe më lindi dëshira ta vizitoj atë vend”.</i> Drejtohet pyetja: -Përse mendoni se ndodh kjo? (Nxënësit janë të lirë të japin mendimin e tyre).</p> <p>Hapi II. Pema e mendimit: Në bazë të mendimeve që nxënësit dhanë, nxjerrim dhe karakteristikat e tekstit përshkrues: Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë, duke informuar dhe duke treguar si është ndërtuar një objekt, cilat janë tiparet e një personi, të një kafshe, të një mjedisi, apo të një dukurie.</p>	
<p>Kohët foljore: e tashmja e pakryera. Karakterizohet nga përdorimi i shumtë i mbiemrave.</p>	
<p>Hapi III. Lexim i drejtuar. Nxënësit lexojnë fragmentin e dhënë në tekstin mësimor. Gjatë leximit, nënvizojmë detajet dhe fjalët kyçe.</p>	

Hapi IV. Punë në grup Grupi I: Plotëson tabelën		
Cili është qëllimi në tekstin e dhënë?	Çfarë përshkruhet në këtë tekst?	Si jepet përjetimi i shkruarit?
Të përshkruajë	Qyteti i Tiranës	
Grupi II: Identifikon momentet kryesore që zgjojnë imagjinatën. (Mënyra se si qyteti ka ndryshuar ndër vite). Grupi III: Analizon rolin e detajeve në tekst (Institucionet, ndërtesat e vjetra etj). Gjen dy figura letrare dhe shpjegon rolin e tyre. <i>Si të shenjtë – Krahësim</i> <i>Ky qytet ka njerëz dhe zemër që rreh - personifikim</i> Hapi V. Diskutim: Nxënësit japin mendimin e tyre për shprehjen: Tirana i do miqtë, i mirëpret ata, i ul në sofër, i nderon si të shenjtë. 1. Pse autori kthehet në histori? Cili është roli i saj kur paraqitet në një guidë? Hapi VI. Punë e drejtuar: 2. Shkruani disa mbiemra që e bëjnë përshkrimin tërheqës? (i zhurmshëm, i vogël, i madh, e re, e vjetër etj). 3. Shkruani fjalët kyçe të këtij përshkrimi: Tirana, godinë arkitekturore, histori, rrënojat e zabuluara, rritet si fëmijë. 4. Zëvendësoni fjalën “të shenjtë” me një fjalë me kuptim të afërt? (të çmuar). Hapi VII. Punë e pavarur: Të kthejnë pjesën e dhënë në një përshkrim krejtësisht objektiv duke mbajtur parasysh këto këshilla: <ul style="list-style-type: none"> ❖ Mos përdorni figura letrare. ❖ Mos u përqendroni në përjetimin për bukuritë e qytetit, por thjesht informacioneve rreth tij. 		
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështetet në përgjigjet e tyre lidhur me nivelin e të kuptuarit të tekstit përshkruar, analizën e tij strukturore, si dhe analizën e gjuhës së tij përshkruese. Gjithashtu, vlerësohet për shndërrimin e paragrafëve subjektiv të përshkrimit në objektivë.		
Detyrë: Shikoni pamje të ndryshme nga Tirana dhe diskutoni se çfarë tregojnë ato. Kushtojuni vëmendje detajeve dhe atmosferës së përgjithshme. Përshkruajeni Tiranën sipas pamjeve dhe imagjinatës suaj në mënyrë të tillë që të ngjallni interes të vizitorët		

1. FONETIKË

TEMA: GRUPET E ZANOREVE DHE DIFTONGJET

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Fonetikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Grupet e zanoreve dhe diftongjet		Metoda e teknika: - Puna në grup; - stuhi mendimi; - punë e pavarur; - lojë gjuhësore.	Fjalë kyçe: zanore, bashkëtingëllore, fonema, shkronja- tingulli, grupe zanorë, diftongje.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- lojë gjuhësore</i> -Mësuesi/ja përgatit regjistrime me zë për shqiptimin e zanoreve dhe grupet zanorë ua, ue, ie, ye duke i shoqëruar edhe me fjalët që i kanë në trup këto grupe zanorë, si: pyes, miell, diell, dëgjues. Këto fjalë nxënësit i ndajnë në rrokje; py-es, mi-ell, di-ell, dëgju-es</p> <p><i>Hapi i dytë-punë në grupe dyshe</i> - Mësuesja/ja kërkon nga nxënësit/et që t'i përsëritin grupet e zanoreve në grupe dyshe, pastaj nxënësit/et të japin fjalë që kanë në trup këta zanorë dhe t'i shkruajnë në fletore.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja <i>Hapi i tretë-Lojë zinxhir</i> - Nxënësit/et punojnë me rubrikën "Kujtojmë". Përsëritin alfabetin me lojën zinxhir. Hapi i katërt - Në rubrikën ku prezantohen shtatë zanoret e gjuhës shqipe, dhe mënyra e shqiptimit të tyre, nxënësit punojnë në grupe. Shqiptojnë zanoret. Hapi i pestë - Në tabelat e dhëna në libër, nxënësit/et dallojnë grupet zanore ua, ue, ie, ye nga diftongjet.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Hapi i gjashtë-Punë në grupe</i> Ushtrimi 1, nxënësit/et gjejnë grupet zanore dhe diftongjet. Klasa e ndarë me dy grupe, secili grup, nxënësit/et radhë, njëri pas tjetrit dalin në dërrasë të shkruajnë fjalët me grupe zanore dhe grupi tjetër me diftongje. Cili grup do të mbarojë më parë fiton garën. <i>Hapi i shtatë-Punë e pavarur, punë në grupe</i> Ushtrimet 2, 3, 4, 6, 7, 8 nxënësit/et i punojnë në libër me grupe dyshe, këmbëjnë librat, qortojnë gabimet e njëri-tjetrit. Mësuesja/si kontrollon punët e tyre. <i>Hapi i tetë- Shpjegim</i> Mësuesi/ja shpjegon ushtrimin 5 si duhet ta plotësojnë; të nxjerrin 6 fjalë që kanë në trup të tyre diftongje dhe t'i përdorin në fjali. Lexojnë disa nx. fjalitë duke shqiptuar me zë diftongjet.</p>				
<p>Zgjidhja e ushtrimeve: Ushtrimi 1. Shtruar(GZ), Iyer(GZ), Maria(D), ktheu(GZ), kuptuar(GZ), kaluar(GZ) Ushtrimi 2. australian, austriak, aviator, ambicioz, bankier, dietë, hierarki, hieroglif, aziatik, ballkaniadë, higjienë, silicium, simpozium, kantier, aksion, ambicioz, antibiotik diagonale, materie, biologji, magnezium, raciaj, pianist, materializëm, koleksion, komision, diagramë, dialekt, komunikacion, leksion, minierë, mumie, studion televizion, diatezë, elegjiak, pediatër, kalcium, kalium, radio, herbarium, moratorium, akuarium.</p>				

<p>Ushtrimi 3. U afrua(D) kuptuar(D) kaluar(D) kujtua(D), shkruar(D), kthye(D), takua(D) Ushtrimi 4. Arsyë-arsyetoj. Unë nuk e arsyetoj këtë çështje kështu. Krye-kryetar. Kryetari i bashkisë ka përgjegjësinë për grumbullimin dhe Përpunimin e plehrave të qytetit. Luaj-luajtje. Luajtje të tillë nuk kisha parë ndonjëherë. Pyet-pyetje. Kush ka pyetje të tjera për mësimin?</p> <p>Ushtrimi 5. bankier-mision; Bankieri kishte një mision të rëndësishëm radio-dietë; dëgjova në radio një dietë për mjekimin e diabetit. antibiotikë-dietologe. Dietologia nuk lejon përdorimin e antibiotikëve.</p> <p>Ushtrimi 6. E diel, miell, diell, qiell, fier, diellor, qiellor, ziej, ndiejmë. Dielli lindi herët. Fyell, arsyë, dyer, pyes, i arsyeshëm. Dyert janë të hapura për miq të mirë. Dragua, bluaj, thua, krua, shkruaj. Thuaj një fjalë të mirë për të. Botues, dëgjuës, mësues. Mësuesi i klasës së parë nuk harrohet lehtë.</p> <p>Ushtrimi 7. Lak-i lakueshëm. Ky tel që është i lakueshëm, na duhet tani. Ndryshe-i ndryshueshëm. Emri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës. Mjaft-i mjaftueshëm. Nuk është i mjaftueshëm ky ujë për lulet në vazo.</p> <p>Ushtrimi 8. Racial, akuarium, babait, punoi, bankier, lexues, kaun, ou? ambicioz, uo?</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi shqipton qartë tingujt e zanoreve dhe diftongjet, dallon tingullin nga shkronja, dallon grupet zanore nga diftongjet, drejtshkruajnë fjalët që kane në trup grupe zanorë dhe i shkruajnë saktë ato.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII; • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon komunikimin.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi në situatën e të nxënës; - Vlerësim të punës në grup dhe gjatë lojës gjuhësore; - Vlerësimi në zgjidhjen e ushtrimeve. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrimin 9 (sipas kërkesës). - Plotësimi i fletës në fletoren e verifikimit të kompetencave. - Mëso përmendësh alfabetin, përsërit bashkëtingëlloret e zëshme, të pazëshme, tingëllyese, nga kl. 6

TEMA 2: THEKSI I FJALËS DHE I FJALISË

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Fonetikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Theksi i fjalës dhe i fjalisë		Metoda e teknika: - puna në grupe dyshe; - puna e pavarur.	Fjalë kyçe: rrokja e theksuar, theksi fundor, parafundor, tejfundor. Theksi i fjalisë, intonacioni.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë- Puna me fisha

Mësuesi/ja u jep nxënësve në tabelë dhe në fisha disa fjalë dhe së bashku vendosin theksin e tyre: *mik, qen, det- fjalë njërrokëshe*

liri, mollë, emër, femër, pulë- theksi bie te rrokja e parafundit

stoli, liri, shtëpi, baba, fole- theksi bie te rrokja e fundit.

flutura, kumbulla, pluhuri- theksi bie te rrokja e parë (tejfundore)

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i dytë- punë e pavarur

Nxënësit/et lexojnë në heshtje informacionin e dhënë në libër për theksin e fjalëve në gjuhën shqipe:

- rrokja e theksuar në çdo fjalë;
- rrokja e theksuar në fund të fjalës;
- rrokja e theksuar në rrokjen e parafundit;
- rrokja e theksuar në rrokjen e parë të fjalës.

Hapi i tretë- punë e pavarur

Nxënësit/et lexojnë fjalët që janë dhënë me theks fundor, parafundor, tejfundor dhe theksin e fjalisë; në fjalitë pyetëse, urdhërore, dëftore. Japin nxënësit. shembuj të tjerë, veçojnë fjalën që duan të theksojnë.

Hapi i katërt- minileksion

Mësuesi ndalet në: këshilla për të folur dhe për të lexuar në mënyrë të qartë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve:

Hapi i pestë- punë në grupe

Nxënësit/et punojnë në dyshe ushtrimin 1, 2, 3, (në libër). Pastaj i kontrollojmë ushtrimet një e nga një, ku nxënësi/ja shqipton fjalën dhe qortojnë rastet kur kanë vendosur gabim theksin në fjalë dhe te fjalive të ush. 3.

Hapi i gjashtë- punë e pavarur

Ushtrimi 4-5 i punojnë dy nxënës/e në dërrasë, shkruajnë fjalitë me fjalët e dhëna që formojnë homonime duke ndryshuar theksin.

Hapi i shtatë-punë në grupe

Ushtrimet 6-7 në punën me grupe siç jepet në libër. Nxënësit vlerësojnë qëndrimin emocional të shokut në lidhje me tekstin që lexon.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Vëllai i madh është gati një kokë më i madh dhe shumë më i fortë se Arbëi. Këshilla e Jonit iu duk më e arsyeshme. Por, në fakt, vetëm pak më vonë Franci e kuptoi se edhe këshilla e tij nuk vlente. Në të vërtetë atij nuk i pëlqen ta trembë më vëllanë e tij të madh.

Ushtrimi 2. Libri; miku; çanta;

kumbulla, petulla, fletorja

punuakëshim, stërvitemi, tjetërsohet

Ushtrimi 3. Divan të madh; një baule; simpatikë; kështu; mendjeje; zhytur në mendime; kohë.

Ushtrimi 4. Nuk shihje fletë peme gjëkund. Librit iu gris një fletë nga fundi.

E hoqi vazon e luleve nga dritarja. Sa bukur e hiqte vallen.

Malli i skaduar duhet hequr nga dyqani. Kam mall për vendlindjen time.

Vera është stina më e bukur e vitit. E shtruan tavolinën me verë të mirë.

Po pres një shoqe për në koncert. Ma jep mua ta pres bukën me feta të holla.

Ushtrimi 5. Vesh- vesh diçka në trup; vesh- organ i njeriut për dëgjim

fletë- fletë peme; fletë libri a fletoreje.

<p>vaj- vaj që gatuajmë; vaj- vajtojnë për dikë që ka vdekur. shkurt-muaji shkurt; fol shkurt, si ndajfolje. Ushtrimi 6, 7 Do të punohen në pjesët e leximit.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon theksin e fjalës, e dallon kur është fundor, para fundor, tejfundor, thekson qartë fjalët, dallon kur fjala ndryshon kuptimin me ndryshim të theksit, përcakton edhe theksin e fjalive dëftore, urdhërore, pyetëse.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> libri i gjuhës shqipe, klasa VII; fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> zhvillon komunikimin.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi në punë në grup për veprimet në situatë; Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimeve dhe të detyrave të shtëpisë. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ushtrimi 7 (sipas kërkesës) Fleta e verifikimit të kompetencave

2. DREJTSHKRIMI

TEMA: DREJTSHKRIMI I FJALËVE ME IE DHE JE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve me ie dhe je		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grup; Puna e pavarur; Pyetje në dyshe. 	Fjalë kyçe: Rrokje e hapur, rrokje e mbyllur, rregulla drejtshkrimore, drejtshqiptimore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- Lojë gjuhësore</i> Nxënësit japin disa fjalë që mbajnë në trup grupet ie, je .</p> <ul style="list-style-type: none"> e diel, diell, fier, shpie, shtie, ziej, përziej, etj ndjesë, i ndjeri, mjel, nxjerr, vjel, përcjell, sjell, etj. <p>Këto fjalë nx. mund t'i përdorin në fjali.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i dytë- memorizim shembujsh./lojë gjuhësore</i> Një nxënës lexon në libër 9 rastet e dhëna për fjalët që shkruhen me ie dhe je.</p> <p><i>Hapi i tretë- punën në grupe</i> Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri - tjetrit për rastet e përdorimit të fjalëve me ie dhe je, duke dhënë edhe shembuj.</p> <p><i>Hapi i katërt-Turi i galerisë</i> Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në tabelë shkruajnë me bojëra uji 2-3 rregulla të përdorimit të shkronjës së madhe dhe i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit, sidomos fjalët: ziej, ndiej, përziej, bie në kokën e kryer te thjeshtë dhe ne formën joveprorë.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Hapi i pestë-punë individuale</i> Ushtrimi 1, një nxënës e punon në dërrasë, kurse klasa i shkruan saktë fjalët në fletore,</p>				

qortojnë gabimet në të shqiptuar.

Hapi i gjashtë-punë në grupe dyshe

Ushtrimet 2, 3, nxënësit i plotësojnë në tabelat e librit në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre.

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimet 5-6 i punojnë dy nxënës/ e në dërrasë(të njëjtat folje, por me kërkesa ë ndryshme.

Nxënësit/et në fletore punojnë me ushtrimin. 7 sipas kërkesës)

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 2. unë bie bija shtie shtija

Ti- bie; bije; shtie; shtije

Ai- bie; binte; shtie; shtinte

Ne- biem; binim; shtiem; shtinim

Ju- bini; binit; shtini; shtinit.

Ata- bien; binin; shtien; shtinin

Ushtrimi 3. Zierja, miell, diell, fier, diellor.

Zierja me avull e zarzavateve bën që të ruhen vlerat ushqimore të tyre.

Mielli i mirë bën edhe kekun të mirë.

Populli thotë se dielli duket që në mëngjes.

Bima e fierit ka shumë vlera kurative.

Eklipsi diellor është dukuri e rrallë në natyrë.

Ushtrimi 4. Ziente; ndiente; zjeu; ndjeu; zjeftë; ndjeftë

Ziente nga inati që puna nuk po ecte si duhet.

E ndiente që sëmundja po përparonte.

Zjeu shpejt gjella sot. E ndjeu aromën e veçantë të zambakut në dhomë.

Zjeftë nga inati! Nuk dua t'ia di për të.

Ndjeftë gjithmonë gëzime në familjen tënde!

Ushtrimi 5. Mjel; vjel; mbështjell;mbjell; përcjell; sjell; nxjerr; tjerr; çjerr; mjelëse; mbjellje; përcjellës; pjellor; sjellje; ujësjellës.

Ushtrimi 6. Ndjenjë; ndjesi; nxjerrje; i ndjeri; ndjeshmëri; parandjenjë; i pandjeshëm; i nxjerrë; i panxjerrë.

Ushtrimi 7. Të ziejë; të ndiejë; të përziejë

Ti ziej; ti ndiej; ti përziej

Ju zieni; ju ndieni; ju përziëni.

Ushtrimi 8. Mjel vjel; sjell përcjell; tjerr nxjerr.

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përdor drejt grupet ie, je në trup të fjalëve, i shqipton saktë ato duke respektuar rastet e drejtshkrimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.

Burimet:

- Libri i gjuhës shqipe, klasa VII.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.
- Fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe

3. FJALËFORMIMI

TEMA 1: MË NYRAT E FJALË FORMIMIT TË FJALË VE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Leksikologjia	Shkalla: III	Klasa: VII								
Tema mësimore: Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve		Metoda e teknika: - Puna në grup; - Puna e pavarur e drejtuar; - Tabela e koncepteve.	Fjalë kyçe: Morfema, fonema mbaresa, rrënja, nyja, parashtesa, prapashtesa, prejardhja, nyjëzimi, kompozimi, përngjitja, konversioni.									
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit												
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë- Lojë ra gjuhësore-gramatikore Nxënësit dallojnë mbaresën te fjalët: hap-a fush-at mal-et hap-i fush-ën mal-i hap-ën fush-a mal-in Mësuesi shpjegon se pjesa e fjalës, pasi heqim mbaresën e quajmë morfemë rrënjore. Hapi i dytë- tabelë koncepti Cilat janë pjesët përbërëse të fjalëve? Nxënësit analizojnë fjalët e mëposhtme: Fjala ka formën dhe përmbajtjen e saj.p.sh. gazet+ar= g+a+z+e+t+a+r (tinguj, shkronja) 1. Një njeri që punon për mbledhjen dhe publikimin e lajmeve etj.(përmbajtja)</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;"> </div> <div style="text-align: center;"> </div> </div> <p>Cilat janë morfemat e këtyre fjalëve? Pse? Morfemat e këtyre fjalëve= rrënjë+prapashtesë/ = parashtesë+rrënjë</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i tretë- INSERT Një nxënës/e lexon me zë informacionin në libër dhe së bashku nënvizojmë termat: morfemë rrënjore, dhe ndajshesore, mbaresë, parashtesë, prapashtesë, nyjë prejardhja, nyjëzimi, kompozimi, përngjitja, konversioni, Nxë në si pasi e lexojnë vendosin në tabelë gjërat një i dinin, konceptet e reja dhe pyetje në lidhje me to. INSERT</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 25%;">+ e di</td> <td style="width: 25%;">V e re</td> <td style="width: 25%;">- E di ndryshe</td> <td style="width: 25%;">? Dua të di</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table> <p>Hapi i katërt- memorizim konceptesh Analizojmë shembujt në libër dhe përkufizojmë termat e mësipërm: - Morfema rrënjore e fjalës përmban kuptimin themelor të saj. -Nyja është morfemë fjalëformuese ose trajtëformuese që qëndron para disa fjalëve të cilat lakohen; emra, mbiemra, përemra. -Parashtesa është morfemë fjalëformuese, e cila qëndron para rrënjës. -Prapashtesa është morfemë fjalëformuese, e cila qëndron pas rrënjës. - Mbaresë është morfemë që qëndron në fund të fjalës dhe tregon tiparet gramatikore të saj</p>					+ e di	V e re	- E di ndryshe	? Dua të di				
+ e di	V e re	- E di ndryshe	? Dua të di									

<p>(gjini, numër, rasë, kohën, vetën, mënyrën etj.)</p> <p>Hapi i pestë- punë në grupe</p> <p>Nxënësit/et në grupe dyshe punojnë me tabelën në libër, që jepen mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe, përsëritin shembujt.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</p> <p>Hapi i gjashtë- punë në grupe dhe demonstrim</p> <p>Ushtrimi 1, 4, 5, 6 nxënësit i punojnë në grupe dyshe, pastaj këmbajnë librat, qortojnë punën e njëri - tjetrit. këto ushtrime i kontrollojnë mësuesja para klasës.</p> <p>Hapi i shtatë- punë e individualizuar</p> <p>Ushtrimet 2, 3 i punojnë dy nxënës në dërrasë dhe thonë pse janë fjalë të prejardhura, apo të përbëra.</p>	
<p>Zgjidhje e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1. <u>Të parme</u>: ranë, shira, rrodhën, litarë, shiu, brisku, këpus, era, retë, e zeza, grisen, hapej, ngastër, i vogël, qielli, dielli, pare, sermi, vijat, arave, duf, kanalet, toka, mushkëritë, merr, frymë, afsh, të madh, shtjella, erërave, qielli, mbytej, ndihej, rrogoz, i madh.</p> <p><u>Jo të parme</u>: fillim, të dendura, shfaqej, i zbehur, i zvogëluar, kulluese, shfrynin, Anësore, çlironte, e përmytura,</p> <p>Ushtrimi 2. shkollor; detar; këngëtar; orar, gazetar;</p> <p>Ushtrimi 3. hekurpunues, kryeqytet; vendstrehim, qendërmbrojtës, mesfundor, rrobalarës, flokartë</p> <p>Ushtrimi 4. Udhëtari-udhë(rrenja) tar(Prapashtesa) i(mbaresa) Emrin- emër(rrënja) in(mbaresa) Historinë-histori(rrënja) në(mbaresa) Kuriozitetin- kurioz(rrënja)tet(prapashtesë) in(mbaresa) Internautëve- internaut(rrënja) ve(mbaresa) fjalë e huaj</p> <p>Ushtrimi 5. udhëtar, skenarët, ndërplanetare , përgjumësh -të prejardhura;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Askush, gjithnjë - e përngjitur ▪ Mendjehapur- e përbërë. ▪ Pesëmbëdhjetëditëshi- mënyra e përzier ▪ E bukura, të ardhmen- me nyjëzim <p>Ushtrimi 6. Fëmijë-t; për-dor-in; kamer-at; regjistër-uar; burim-et; të mësua-rit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkarko-hen; praktik-o-hen; nëpërmjet- e përngjitur; pajis-je-je; ▪ Inter-aktiv-e; sh-faqe-je; të drejt-për-drejtë(e përngjitur), film-uar ▪ Fjalët e tjera janë morfema rrënjore. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p><i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi dallon pjesët përbërëse të fjalës, morfema rrënjore, morfema ndajshesore (parashtesa, prapashtesa, mbaresa, nyja). Dallon fjalët e parme, jo të parme dhe mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe.</p>	
<p>Burimet:</p> <p>- Teksti i gjuhës shqipe, klasa VII.</p> <p>- Fleta për verifikimin e kompetencave.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <p>- Zhvillon komunikimin.</p>
<p>Vlerësimi:</p> <p>- Vlerësim në veprimtari në situatën me gojë.</p> <p>- Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimit me gojë e me shkrim.</p>	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <p>Ushtrimi 7, (sipas kërkesës)</p>

Tema 2: Fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Fjalëformimi	Shkalla: III	Klasa: VII								
Tema mësimore: Fjalët e prejardhura, të përbëra dhe te përngjitura		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Puna e pavarur; • Loja gjuhësore. 	Fjalë kyçe: fjalë e prejardhur me parashtesë, me prapashtesë, me para + prapa shtesë njëkohësisht, fjalët e përbëra, të përngjitura									
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit												
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</p> <p>Hapi i parë- kllaster Jepen në tabelë fjalët; shkronjë, punë, dorë dhe nx. thonë fjalë të tjera që të kenë këto morfema rrënjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> -shkronjë: shkronjor, shkrim, përshkrim, shkruaj, dorëshkrim etj. -punë: punoj, punim, përpunim, ripunim, punësim, punëdhënës etj. -dorë: dorëzoi, dorëzim, përdor, dorezë, dorështrënguar etj. <p>Këto fjalë kanë formuar familje fjalësh. Si janë përfutur?</p> <p>Hapi i dytë- punë e pavarur Për familjet e fjalëve, nxënësit japin kuptimin e çdo fjale, duke i përdorur në fjali, pra janë përfutur fjalë të reja me ndihmën e parashtesave dhe prapashtesave, por edhe duke u bashkuar dy morfema rrënjore.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja:</p> <p>Hapi i tretë- INSERT punë në grupe Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë në libër për temën e re dhe përsëritin në dyshe *ç' janë parashtesat, prapashtesat, mbaresat,</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallojnë fjalët e prejardhura me parashtesë, • dallojnë fjalët e prejardhura me prapashtesë, • dallojnë fjalët e prejardhura me para + prapashtesë. • Dallojnë fjalët e përbëra dhe të përngjitura <p>INSERT</p> <table border="1"> <tr> <td>+ e di</td> <td>V e re</td> <td>- E di ndryshe</td> <td>? Dua të di</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table> <p>Hapi i katërt- lojë zinxhir Me lojën zinxhir nxënësit përsëritin parashtesat e prapashtesat që janë dhënë në tabelë, japin edhe fjalë të reja të formuara me to. Mësuesi ndalet në fjalët e përngjitura dhe drejtshkrimin e tyre (sidomos të ndajfoljeve, të numërorëve, të parafjalëve). U dikton nx. 10 fjalë t'i shkruajnë në fletore dhe ata kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, si i kanë shkruar.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</p> <p>Hapi i gjashtë-Punë e pavarur Ushtrimi 2, 3, i punojnë dy nxënës në dërrasë, sipas kërkesave të ushtrimeve.</p> <p>Hapi i shtatë- punë në grupe Ndërkohë klasa në grupe dyshe punojnë me shkrim në fletore ushtrimet 5, 6, (sipas kërkesave).</p> <p>Hapi i tetë-punë e pavarur</p>					+ e di	V e re	- E di ndryshe	? Dua të di				
+ e di	V e re	- E di ndryshe	? Dua të di									

Përgjigjen nxënësit në tabelë, përgjigjen nxënësit e klasës për ushtrimet 5, 6, 7, qortojnë gabimet me ndihmën e mësuesit.

Hapi i nëntë-punë e pavarur

Ushtrimet 1, 4, e gjithë klasa i punojnë në libër dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Të prejardhura: rrallo-heshin; të ftoh-ta; gad-ishull-it; tako-im-et, të fundit.

Të parme: vi-nin; shkak; kish-in; shoqat-at; dit-ëve; erdh-ën

Ushtrimi 2. Dit-ar; treg-tar; dit-or; punë-tor; meso-im; lind-je.

Ushtrimi 3. Frymëmarrje; bukëpjekës; duhanpirës; zjarrfikës; udhërrëfyes.

Meshollë; letërnjoftim; kokëmadh; hekurkthyes.

Ushtrimi 4. S-kuq; i pa-drejtë; sh-thur; nën-kupto-j; zh-duk; për-kujto-j; i pa-dalë;

I pa-di-tur; i pa-ngrë-në; zh-vesh-je; sh-pal-os; mbi-vlerë-so-j;

Para-thën-ie; nën-drejt-Or; stër-nip; stër-dhëmb.

Ushtrimi 5. Shpalos, shthur, shpërthej, shpërfill, shqep

Zhdredh; zhdëmtoj; zhvesh; zhduk; zhbllokoj

Çarmatos, çaktivizoj, i çrregullt, çrregulloj, çliro.

Ushtrimi 6. Hyrje; blerje; mësim; lexim; përgjim; çarje; prerje; shkuarje; hartim;

Lyerje. Lyerja e shkollës bëhet në pushimet e verës.

Hyrja e saj është bërë e re. Mësimi fillon në orën 800. Blerjet e mjeteve

shkollore bëhet nga bashkia e qytetit. Hartimi dhe leximi i planit edukativ

para nxënësve u bë nga mësuesja.

Ushtrimi 7. verilindje; dritëhije; veriperëndim

kryeqendër; dorështrënguar; vendbanim.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi dallon fjalët e prejardhura me pjesët përbërëse, parashtesa + rrënja+ prapashtesa, formon fjalë të reja të prejardhura, pasuron fjalorin me fjalë të reja, i përdor në fjali. Dallon fjalët e përbëra dhe të përngjitura, i shkruan ato drejt.

Burimet:

- Teksti i gjuhës shqipe, klasa VII.
- Fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin.

Vlerësimi:

- Vlerësim në veprimtari në situatën e të nxënit.
- Vlerësim me gojë në lojën zinxhir.
- Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimit.

Detyra dhe puna e pavarur:

Gr.1 Ushtrimi 8 (sipas kërkesës)

Gr.2 Ushtrimi 9, plotësojnë tabelën me fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura, duke i zgjedhur nga pjesa “Kali i drunjtë”.

3. LEKSIKOLOGJI

TEMA3.: FUSHA LEKSIKORE E SEMANTIKE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Leksikologjia	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fusha leksikore e semantike		Metoda e teknika: - Puna në grup; - Puna e pavarur; -Tabela e koncepteve.	Fjalë kyçe: fushë leksikore, forma, kuptimi, kuptim i figurshëm, fushë semantike	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë-punë në grupe dyshe

Nxënësit në punë në grupe dyshe analizojnë fjalët:

- Ngjyrë = n+gj+y+r=ë → Forma
- Ngjyrë = Vetë fizike e një trupi për të thithur një pjesë të dritës që bie mbi të dhe për ta pasqyruar pjesën tjetër me rreze të një gjatësie të caktuar. (kuptimi)
- Sport= s+p+o+r=t → Forma
- Sport = Veprimtaria për zhvillimin e gjithanshëm dhe kalitjen e trupit nëpërmjet ushtrimeve fizike, lojërave të ndryshme (kuptimi 1)
- Sa për sport, për të kaluar kohën, pa rëndësi, kot (kuptimi 2)

Hapi i dytë-demonstrim

Mësuesja dhe nxënësit japin edhe shembuj të tjerë për të qartësuar formën dhe kuptimin e fjalës.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë- INSERT

Nxënësit lexojnë informacionin në libër për kuptimin e fjalëve dhe fushën leksikore duke përdorur edhe shenjat e INSERTIT. Ndalen te tabela ku jepen kuptimet e fjalëve (fusha leksikore dhe fusha semantike).

+	V	-	?
---	---	---	---

Hapi i katërt- Listë fjalësh dhe kuptime të para, të dyta, të treta, etj

Nxënësit shprehin mendime për sporte të ndryshe që ata e ushtrojnë më tepër dhe pse. Këto janë një bashkësi sportesh (fjalësh) që ju ushtroheni me dëshirë e pasion.

-Numërojnë llojet e lojërave të tyre në fëmijëri e deri sot.

Hapi i pestë- memorizim konceptesh

Nxënësit lexojnë tabelën në libër, me fushat leksikore e semantike të fjalës ngjyrë dhe përkufizojë se ç'është fusha leksikore, fushë semantike.

Fusha semantike mbështetet mbi fusha konceptore, si: përmasa, njësia matëse, forma, koha, lënda(e lëngët, e gaztë, e ngurtë)

3. Prezantim dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë- punë në grupe

Nxënësit në grupe dyshe punojnë ushtrimet 1, 2, i përdorin fjalët e dhëna në fjali për të dhënë kuptimin e tyre (Sipas shembullit të ushtrimit 2)

Pasi kontrollojmë punën e njëri - tjetrit, lexojnë fushën leksikore dhe semantike të fjalëve: sport, kompjuter, muze.

Sport: futboll, basketboll, mundje, not, vrap, gjimnastikë etj. (fusha leksikore)

sportet e rënda, sportet e ujit, sportet dimërore, lojërat olimpike...(fusha semantike)

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimi 3, 4, 5, i plotësojnë në libër, fjalët e dhëna i gupojnë sipas fushës leksikore, gjejnë fjalët, gjejnë fushën leksikore. Ushtrimin 5, e punojnë me grupe pesëshe, duke gjetur fjalë të një fushe leksikore të pjesa letrare “Breshka dhe lepuri”

Hapi i tetë- vlerësim

Mësuesi kontrollon punën e tyre, vlerësojnë vetë nxënësit punën e njëri - tjetrit.

- Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Lojërat: loja kukafshehti, loja me toparasa, loja me shami, shah, domino, letra, etj.

Sporti: futboll, basketboll, alpinizëm, qitje, volejball, atletikë, çiklizëm etj.



Ushtrimi 2. Fjala sport: fusha leksikore- sportet e rënda, sportet e ujit, sportet dimërore.

Fusha semantike- sportet e rënda përfshijnë: mundje, boks, keç, peshëngritje,

<p>Karate. Sportet e ujit: not, kanotazh, zhytje, kërcim artistik nën ujë. Sportet dimërore: mbi dëborë, mbi akull, ski, kërcim, Patinazh, alpinizëm. Fjala kompjuter: fusha leksikore: kompjuter tavoline, laptop, celular, ipad etj. Fusha semantike: kompjuter tavoline; i madh, më vete ekrani nga hardisku, me Shumë programe. Laptop; i lëvizshëm, me bateri, i ka bashkë në një trup ekranin dhe hardiskun, me shumë programe. Celular; mjet me disa programe komunikimi, me bateri, i vogël Ipad; i vogël, me bateri, bën foto, video Fjala muze: fusha leksikore; muze arkeologjik, historik, i armëve, etnografik, botanik, zoologjik, gjeologjik, qytet muze, etj. Fusha semantike: institucione që mbledhin, ruajnë e paraqitin në ekspozita vepra e krijime të ndryshme të artit, të teknikës, sende e objekte e materiale me vlerë historike e shkencore, për qëllime mësimi e studimi. Ushtrimi 4. Mjete me letër; biletë, fletë, libër, fletore. Barna-ilaçe; takipirinë, paracetamol, aspirinë, depon, Ëmbëlsira: bakllava, kadaif, trileçe, kek. Gjendje fiziologjike të njeriut: ëndërr, makth, gjumë. Forma komunikimi: debat, konflikt, bashkëbisedim, prezantim</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: <i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi dallon formën dhe përmbajtjen e fjalës, përdor fjalë me kuptime të figurshme, dallon fjalët që formojnë fushën leksikore dhe fushën semantike</p>	
<p>Burimet: - Teksti i gjuhës shqipe, klasa VII. - Fleta për verifikimin e kompetencave.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera: - Zhvillon komunikimin.</p>
<p>Vlerësimi: - Vlerësim në situatën e të nxënit. - Vlerësimi me gojë në veprimtari në situatë. - Vlerësim me shkrim në zgjidhjet e ushtrimeve në libër.</p>	<p>Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, (sipas kërkesës).</p>

TEMA 4: SINONIMET, ANTONIMET, HOMONIMET

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Leksikologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Sinonimet, antonimet, homonimet		Metoda e teknika: - Puna në grup; - Puna e pavarur; - Tabela e koncepteve.	Fjalë kyçe: Sinonime, antonime, homonime të pjeshme, të plota	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- punë në grupe dyshe</i> Nxënësit japin disa fjalë të tjera me fjalët:</p>				



Hapi i dytë-punë në grupe dyshe

Nxënësit lexojnë grupet e fjalëve dhe japin edhe shembuj të tjerë të ngjashëm, me sinonime, që i kanë mësuar vitin e kaluar, kurse tani mësojnë edhe homonimet.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë- shpjegim

Mësuesi shpjegon temën dhe nxënësit ndërkohë lexojnë informacionin e ri në libër për temën, diskutojnë për shembujt me sinonime, antonime, të pjesshme, të plota, me ngjyrimë shprehëse emocionale.

- Sinonime- *shikoj, vështroj, vërej; shkrimtar, kalemxhi*. I përdorin nx. në fjali për të dhënë ngjyrimet shprehëse emocionale.
- Antonimet-*lart-poshtë, afër-larg, ditë-natë, i gjatë- i shkurtër, i qartë- i paqartë, etj*
- Homonime-*buzë-emër, ndajfolje; ari-flori, kafshë; vesh- folje, emër*

Hapi i katërt-shpjegim

Mësuesi shpjegon se homonime përdoren fjalë me formë të njëjtë dhe me kuptime të ndryshme. Jep disa raste keqkuptimesh me disa homonime në kontekste të ndryshme.

Hapi i pestë-punë në grupe

Në grupe dyshe nxënësit formulojnë përkufizimet për sinonimet, antonimet, homonimet. Japin edhe nxënësit shembuj të tjerë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë-punë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në libër ushtrimet 2, 3, 6, 7 ballafaqojnë punën e njëri- tjetrit në dyshe.

Hapi i shtatë- punë në grupe

Ushtrimi 1, punojnë me gojë lexojnë poezinë pasi e shkruajnë me sinonimet e fjalëve të gjetura (sipas kërkesës).

Hapi i tetë- punë e pavarur

Ushtrimin 5, e punon e gjithë klasa dhe lexojnë me zë fjalitë që kanë plotësuar sipas kërkesës.

- Zgjidhje e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Toka-dheu; koka-kryet; mëmë e at-nënë e baba; guri-stralli; thërrime-kothere

Gjuhën-fjalën; fis e farë- të afërmit; gaz e shpresë-i lumtur e me besim;

Dëshirë-dua; të vdes- të shuhem, të prehem.

Ushtrimi 2. Kokë-krye; rrugë-udhë; refugjat-mërgimtar; zanat-mjeshtëri-profesion;

Marangoz- zdrukthëtar; bahçevan-lulishtar; çoban-bari; ruaj-mbroj;

Mësues-edukator; shikoj-vështroj.

Ushtrimi 3. E ëmbël si mjalti; e zezë si nata; e lehtë si pupla; e ngrohtë si çaji;

E shëmtuar si shtriga; e thartë si limoni; e bardhë si bora; e rëndë si hekuri;

E ftohtë si akulli; e bukur si xana e malit.

Ushtrimi 5. Afrohem-largohet; bërtas-hesht; ndez-fik; largohem-afrohet; i duruar-gjaknxehtë

Ushtrimi 6. vesh-zhvesh; bllokoj-zhbllokoj; qep-shqep; thur-shthur; armatos-çarmatos;

Ushtrimi 7. Kjo varëse është prej ari. Një ari po dilte nga pylli.

Fole e fole, si nuk u lodhe?! Pashë një fole në cep të ballkonit.

Argjendari në lagjen tonë punon me shumë kujdes. Do t'i coj vëthet në një

Argjendari në Tiranë.

<p>Ministri i Arsimit vizitoi shkollën tonë. Në ministri u thirr edhe drejtoresha. Drejtori i ndërmarrjes përshëndeti punëtorët. Thirri edhe disa në drejtori për t'i shpërblyer për punën e mirë që kishin bërë.</p> <p>Ushtimi 8. Homonime të pjesshme: fole-fole; kyçi- e kyçi; afër-ndajfolje, parafjalë; Homonime të plota: bari-bari; ari-ari; sekretari-sekretari; rrobaqepësi-rrobaqepësi.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: <i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi dallon sinonimet, antonimet, homonimet, i përdor ato në fjali, në kontekste të ndryshme, pasuron fjalorin.</p>	
<p>Burimet: - Teksti i gjuhës shqipe, klasa VII. - Fleta për verifikimin e kompetencave.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera: - Zhvillon komunikimin.</p>
<p>Vlerësimi: - Vlerësim në situatë në punën me grupe. - Vlerësimi me gojë në zgjidhjen e ushtrimeve.</p>	<p>Detyra dhe puna e pavarur: - Grupi 1: Ushtrimet 9 (sipas kërkesës). - Grupi 2: Ushtrimin4, krijo një tekst me 10 fjali (sipas kërkesës), vendosi një titull.</p>

TEMA: FJALA SHQIPE DHE FJALËT E HUAJA

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Leksikologji	Shkalla: III	Klasa: VII								
<p>Tema mësimore: Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja</p>		<p>Metoda e teknika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Tabela e koncepteve; • Rrjeti i diskutimit • Puna e pavarur. 	<p>Fjalë kyçe: Leksik, shtresë vetjake, e huazuar, huazime të tërthorta</p>									
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit												
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë- tabelë koncepti/fletë pune Në çdo bankë mësuesi shpërndan 2-3 artikuj gazetash, revistash dhe nxënësit i analizojnë dhe plotësojnë tabelën:</p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 33%;">Gjuhë e huaj</td> <td style="width: 33%;">Kuptimi në kontekstin e përdorimit</td> <td style="width: 33%;">Fjala që i përgjigjet në shqip</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>					Gjuhë e huaj	Kuptimi në kontekstin e përdorimit	Fjala që i përgjigjet në shqip					
Gjuhë e huaj	Kuptimi në kontekstin e përdorimit	Fjala që i përgjigjet në shqip										
<p>Hapi i dytë-punë në grupe Pasi plotësojnë tabelën, nxënësit grupohen në grupe me 6 veta dhe analizojnë punën e tyre. Mësuesja i ndihmon për kuptimin e fjalëve, duke përdorur edhe fjalorin.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i tretë-INSERT Nxënësit punojnë me informacionin që jepet në libër, ndalen te leksiku i shqipes që ka dy shtresa: vetjake, e huazuar; si janë formuar këto shtresa.</p> <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="width: 25%;">+</td> <td style="width: 25%;">v</td> <td style="width: 25%;">-</td> <td style="width: 25%;">?</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>					+	v	-	?				
+	v	-	?									
<p>Hapi i katërt- punë në grupe</p>												

Në grupe dyshe punojnë me shembujt ku fjala e huaj është zëvendësuar me një fjalë shqip dhe nuk është e pranueshme të përdoren fjalët e huaja.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë-punë në grupe

Nxënësit në grupe dyshe punojnë në fletore, shkruajnë fjalën shqip në vend të fjalës së huaj, pastaj pyesin njëri-tjetrin sa i mbajnë mend ato. I përdorin edhe në fjali.

Hapi i gjashtë-rrjet diskutimi

Mësuesi organizon rrjetin e diskutimit me temë: A duhen përdorur fjalët e huaja gjatë komunikimit?

Po? Argumente Jo? Pse?

Nxënësit punojnë individualisht në fletoret e tyre për të dhënë argument pro dhe kundër përdorimit të fjalëve të huaja. Dëgjohen mendimet e tyre.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1.

novitet-risi-formë e re; sensibilitet-ndjeshmëri- I prekur
 aparcencë-dukje-pamje e jashtme; monitoroj-vëzhgoj-ndjek
 interlokutor-bashkëbisedues-bashkëpunues evokoj-sjell në mend-paraqes
 neutral-asnjans-moskokëçarës kontestoj-kundërshtoj-kundërvë
 konfrontoj-ballafaqoj-përball një çështje bilateral-dypalësh-
 absorboj-përthith-përshtat reflektohet-pasqyrohet-dyzohet
 replikë-përgjigje-kundërpërgjigje konstatoj-vërej-zbuloj
 rinovoj-përtërij-përsos gratis-falas-veresije
 esencial-thelbësor-bazik licencë-leje-marrëveshje
 sensacional-I bujshëm-ararmantë integroj-përfshij-përshtat
 tendencë-priorje-drejtimit

Ushtrimet 2, 4, punohen gjatë orës së mësimit, me gazetata e revistat që shpërndan mësuesja nëpër banka.

Ushtrimet 3, 5 do të jenë pjesë e projektit që do të zhvillohet në tri orë mësimore gjatë vitit, sipas një plani të veçantë.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi/ja dallon fjalët e huaja, njeh kuptimin e tyre dhe mbi këtë bazë shmang përdorimin pa vend të tyre kur kemi gje gjegjëse fjalë shqip, është kritik ndaj dukurive të tilla në median e shkruar.

Burimet:

- libri i gjuhës shqipe, klasa VII,
- fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin.

Vlerësimi:

- Vlerësim në situatën e të nxënës.
- Vlerësim me gojë e me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve.
- Vlerësimi në detyrën e shtëpisë.

Detyra dhe puna e pavarur:

Grupi I: Ushtrimi 1 (sipas kërkesës).
 Grupi II: Shkruani në fletore fjalët shqip që zëvendësuat në ushtrimin 1

5. MORFOLOGJI

Tema 1: Klasat e fjalëve

Fusha: Përdorimi drejt i gjuhës	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII				
Tema mësimore: Klasat e fjalëve		Metoda e teknika: -Tabela e koncepteve -Diagram Veni - Punë me grupe	Fjalë kyçe: të ndryshueshme, të pandryshueshme, të mëvetësishme, të pamëvetësishme, kuptimplota, thirrmore.					
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit								
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:								
Hapi i parë- Tabelë koncepti								
Emri	gjini	numër	rasë	trajtë	lakim	I përgjithshëm, i përveçëm	konkret, jokonkret	I pamë, i prejardhur, i përbërë
mbiemri	Gjini	numër	rasë	Shkallë				
folja	kohë	vetë	numër	mënyrë	formë	zgjedhim	kalimtar	
përemri	gjini	numër	rasë	vetë				
numërori	gjini	numër	rasë	i parë, i dhjetë				
Hapi i dytë- punë në grupe								
Nxënësit/et në grupe dyshe diskutojnë për plotësimin tabelën, japin përgjigje duke dhënë shembuj.								
- Nxënësit/et i klasifikojnë pesë pjesët e ligjëratës si të ndryshueshme, sepse lakohen, zgjedhohen, pra në ligjërim ndryshojnë.								
Hapi i tretë- pyetje përgjigje								
Cilat janë pjesët e pandryshueshme? Pse i quajmë të tilla?								
Nxënësit japin përgjigje duke dhënë shembuj: ndajfolje, parafjala, lidhëza, pasthirrma, pjesëza, të cilat do t'i mësojnë gjatë vitit shkollor.								
2. Ndërtimi i njohurive të reja:								
Hapi i katërt- Diagram veni								
Nxënësit/et njihet me informacionin që jepet në libër, klasat e fjalëve, funksionet e tyre në fjali dhe shënojnë termat e reja që jepen: të mëvetësishme, të pamëvetësishme, fjalë kuptimplota, jokuptimplota dhe thirrmore. Krahasojnë përmes Diagramës së Venit.								
Hapi i pestë- Tabelë koncepti								
Nxënësi/et punojnë me tekstin sipas figurës dhe ndajnë fjalët si pjesë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.								
Hapi i gjashtë- Punë në grupe dyshe								
Disa nxënës/e lexojnë fjalitë dhe japin përkatësitë: pjesë ligjërata- funksion.(kryefjalë, kundrinor, përcaktor, kallëzues, rrethorë, etj.								

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:


Hapi i shtatë- punë në grupe

Ndahet klasa në grupe me 5 nxënës/e dhe punojnë në libër ushtrimet 1, 2, 3 Një grup prezanton zgjidhjen e ushtrimeve, grupet e tjera qortojnë gabimet (për pjesët e pandryshueshme).

Hapi i tetë- Diagram veni

Mësuesi/ja jep në tabelë një diagram Veni për të përcaktuar dallimet dhe ngjashmëritë midis fjalëve kuptimplota dhe jokuptimplota

1. Ndryshojnë formë gjatë ligjëritimit.
2. Kryejnë funksione të ndryshme në fjali.
3. Janë fjalë emërtuese e treguese.



1. Ndahen në klasa në bazë të disa rregullave (sipas kuptimit, rolit, funksionit).
2. Mund të jenë fjalë të thjeshta ose jo të thjeshta.
3. Shërbejnë për të krijuar fjali e tekste.

1. Nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali.
2. Nuk ndryshojnë sipas trajtës, numrit, rasës, mënyrave.
3. Janë fjalë shërbyese ose plotësojnë kuptime të fjalëve të tjera.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Të ndryshueshme: disa, ditë, shokë, të tjerë, erdhi, për të kthyer, vizitën, punës, sime, mësues, të kryeja, punë, të tjera, ndihmë, njerëzve, ai, bluante, të gjitha, ne, shokët, e tij, të ngushtë, guxonte, të hapej, unë, përfytyrova, kishte ardhur, ai, i huaji, gjurmëve të mia.

Të pandryshueshme: më, vonë, bashkë, me, përveç, si, më, edhe, shumë, në, dhe, me, nuk, si, pas.

Ushtrimi 2. Emra; mbrëmja, dielli, disk, detin, faqja, dritës, troku, kali, kalorës, grumbullit, të luftëtarëve, Gjon Kastriotit, kalaja e Gurit të bardhë, sytë, luftëtarët, kalorësit, vrapin, djersët, rrëke, faqeve, kali, lodhja.

Mbiemër: i madh i kuq, e kaltër,

Folje: afrohej, prekte, shkëlqente, u dëgjua, rendte, vinte, ngulën, ndali,

Afruan, shkonin, shkumbonte.

Përemra: së tij, i, (atij i), të gjithë, ia (atij i+ ato i) i cili, tyre,

Ndajfolje: befas,

Parafjalë: prej, drejt (grumbullit), nga pranë (tyre), nga.

Lidhëza: dhe, sapo, dhe, si.

Pjesëz: po, po.

Ushtrimi 3. Fjalë të mëvetësishme: Emra; mbrëmja, dielli, disk, detin, faqja, dritës, troku, kali, kalorës, grumbullit, të luftëtarëve, Gjon Kastriotit, kalaja e Gurit të bardhë, sytë, luftëtarët, kalorësit, vrapin, djersët, rrëke, faqeve, kali, lodhja.

Mbiemër: i madh i kuq, e kaltër,

Folje: afrohej, prekte, shkëlqente, u dëgjua, rendte, vinte, ngulën, ndali,

Afruan, shkonin, shkumbonte.

Përemra: së tij, i, (atij i), të gjithë, ia (atij i+ ato i)i cili, tyre,

Ndajfolje: befas

Fjalë të pamëvetësishme: Parafjalë: prej, drejt(grumbullit), nga pranë(tyre), nga.

Lidhëza: dhe, sapo, dhe, si.

Pjesëz: po, po

Ushtrimi 4. Fjalë kuptimplota: ju, më, trembni, tha, rrënja, e trëndafilin, i, kisha menduar, kurrë, këto, gjëra, merret, vesh, e lodhni, shumë, mendjen, keni vrarë, mendjen, ndonjëherë, merrni vesh, ju, lulëzoni, ndodh, kjo, përse, kështu, ndryshe,

Fjalë jokuptimplota: po, më, nuk, po, po, që, nuk, por, a, dhe, si dhe, jo.

Ora e dytë

1-Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë-Tabelë koncepti

Plotëso tabelën:

Ndajfolje	Mirë, herët, jashtë, keq, pak...
Parafjalë	Në, mbi, nën, tek, nga...
Lidhëz	Dhe, ndonëse, prandaj...
Pjesëz	Nuk, mos, pa...
Pasthirmë	Oh, obobo, ah...

Hapi i dytë-punë e pavarur

Nxënësit/et plotësojnë tabelën dhe përsëritin pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

2-Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i tretë- punë në grupe

Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2 4, I diskutojnë me radhë zgjidhjet.

Hapi I katërt-

Klasa punon në libër ushtrimin 6 sipas kërkesës, ndiqen edhe nga mësuesja, dalin në përfundim se cila nga pjesët e ligjëratës përdoret më shpesh. Një nx. bën grafikun në tabelë (Më shumë përdoren emrat, foljet, parafjalët.)

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Malet-emër, me-parafjalë, e-lidhëz, patat-emër, para-ndajfolje, tyre-përemër, gjen-folje, pas- ndajfolje.

Ushtrimi 2. Emra:kuti, lojë, djalë, fletore.

Mbiemra: I zgjuar, I mirë, pranveror.

Përemra: ne, ju unë, ata.

Numërorë: dhjetë, një, tre, tri,

Folje: notoj, kërkoj, duke dalë, luaj

Ndajfolje: shpesh, këndshëm, pak, larg,

Lidhëz: e, edhe, se.

Parafjalë: me, në, nëpër.

Pasthirmë: ah, obobo,

Ushtrimi 3. Ishin disa zëra të dëgjuar. Para tyre u shfaqën disa njerëz me flokë të ndarë në mes. Flokët i kishin të lagura nga shirat që kishin rënë pak më parë. Ishin të ditura rrugët nga ata që kishin ardhur deri këtu. Dukeshin të kënaqur me pamjen e tyre. Por edhe të bindur për të folur si të barabartë me gjithë të tjerët.

Ushtrimi 4. Dhe-lidhëz; në, me, në, poshtë-parafjalë; e, e, sikur- lidhëz, lehtaz, ngadalë-ndajfolje.

Ushtrimi 5. i vogël- i parritur; menjëherë-shpejt; nga të katër anët-anëmbanë; ngado-gjithandej, ndjesi-ndjenjë, shumë-tepër; pranë-afër, shumë-jashtëzakonisht.

Ushtrimi 6. Emra-22; mbiemra-2; folje-17; përemra-8; ndajfolje-5; lidhëza-6; parafjalë-10; Pjesëza-4; pasthirra dhe numërorë nuk ka. Pra më të përdorura janë emrat, foljet dhe parafjalët.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon klasat e fjalëve, emërton funksionet e tyre në fjali, argumenton pse janë pjesë të ndryshueshme, sepse lakohen apo zgjedhohen. Dallon fjalët kuptimplota, jokuptimplota dhe thirrmore.	
Burimet: - njohuritë e nxënësit të marra në klasën e VI; - informacioni në librin e gjuhës VII; - fleta për ushtrimin e kompetencave.	Lidhja me fushat e tjera: - Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përsëkrimit të punës në grup;
Vlerësimi: - Vlerësimi në punën me grupe; - Vlerësimi me gojë dhe me shkrim në detyrat e shtëpisë; - Vlerësimi me pikë i fletës së punës.	Detyra dhe puna e pavarur: - Ushtrimi 4, fq. 184 (Sipas kërkesës) - Ushtrimi 3, fq. 187 (sipas kërkesës) - Plotësimi i ushtrimeve në fletën e punës për verifikimin e kompetencave.

TEMA: EMRAT E DYGJINISHË M

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Emrat e dygjinishëm		Metoda e teknika: -Tabela e koncepteve - Punë me grupe	Fjalë kyçe: Emri, gjinia, emra të dygjinishëm	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:				
Hapi i parë- Brainstorming				
Ç'dinë për gjininë e emrit?				
- Emrat në gjuhën shqipe ndahen në tre grupe: në gjininë femërore, mashkullore, asnjënjëse. Shembuj _____				
- Cdo emër përdoret në një gjini të caktuar, si në njëjës edhe në shmës.				
- Vendosi emrat mashkullore në shumës, shoqëroi me mbiemra:				
Pallat-e të reja libër-libr-a të rinj				
Plan-e _____ gisht-a _____				
Mal-e _____ hekur-a _____				
Problem-e _____ tel-a _____				
Mish-ra _____ film-a _____				
fshat-ra _____ metër-metr-a _____				
Shi-ra _____ emër-emr-a _____				
Hapi i dytë- punë në grupe				

Nxënësit/et në grupe dyshe japin shembuj të tjerë, duke pasur parasysh si e formojnë shumësin emrat dhe t'i dallojnë emrat me mbaresat *e* dhe *ra*.

2. Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi i tretë- INSERT

Nxënësit/et lexojnë në heshtje informacionin në libër për emrat e dygjinishëm, përsëritin shembujt dhe i shoqërojnë me mbiemra të tjerë.

+	V	-	?
---	---	---	---

Hapi i katërt-punë në grupe

Punojnë në grupe dyshe, i shkruajnë shembujt e librit në fletore, i përdorin edhe në fjali, ndërrojnë fletoret me njëri-tjetrin.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë- punë në grupe

Punojnë në grupe dyshe ushtrimin 1, 3 (kthejnë në numrin shumës grupet emërore). Kontrollonjë punën e njëri- tjetrit.

Hapi i gjashtë- punë e pavarur

E gjithë klasa punon me shkrim ushtrimin 2, i përdorin grupet emërore në fjali. Lexojnë disa nxënës fjalitë që kanë shkruar. Mësuesja qorton gabimet që mund të kenë bërë nxë në sit.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Ato brigje; malet e larta; qytete malore; vendime të shpejta; brigje të thepisur; këto mendime; vende turistike; mendime interesante; mallra të huaja; ujë ra të ëmbla; fshatra turistike; djathëra të kripura.

Ushtrimi 2. Malet e thepisura të Alpeve janë interesante për turistët.

Ky lëng ka disa elemente përbërëse.

Në Muzeun Kombëtar u dorëzuan disa dokumente të rëndësishme.

Flitet për disa insekte të rralla, të rrezikshme për shëndetin.

Ushtrimi 3. E saktë është pika A tek të katër grupet e fjalëve.

Ushtrimi 4. Ismail Kadare është një personalitet i shquar në fushën e letrave.

Personazhi pozitiv tek romani që lexova, më bëri për vete.

Mushkonja është insekt helmues dhe shumë i rrezikshëm.

Një bakter i dëmshëm gjendet në sallatën e fushës.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi dallon emrat kur janë të dygjinishëm, sipas mbaresës së shumësit; e, ra, i përdorin ata në fjali.

Burimet:

- njohuritë e nxënësit që kanë marrë në klasë VI;
- informacioni në librin e gjuhës shqipe në klasën e VII;
- fleta për ushtrimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Nxënësi/ja zhvillon fjalorin, komunikimin me njëri-tjetrin gjatë përshkrimit të punës në grup.

Vlerësimi:

- Vlerësimi në punë në grup;
- Vlerësimi me gojë dhe me shkrim në klasë e shtëpi.

Detyra dhe puna e pavarur:

- Ushtrimi 4 (sipas kërkesës)

TEMA: LAKIMI I EMRIT

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lakimi i emrit.		Metoda e teknika: - Punë në grup - Tabela e koncepteve - Diskutim	Fjalë kyçe: Pesë rasat, lakimi, mbaresat, pyetjet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi parë- Parashikim me terma paraprakë Me emrin <u>pranvera</u> shkruani një tekst me 6 fjali, ku ky emër të përdoret në rasi të ndryshme (në 5 rasat) <i>Pranvera është stina më e bukur e vitit. Stina e pranverës këtë vit erdhi me një gjelbërim të veçantë. Shumë nga ne e quan pranverën stinën e luleve, përtëritjen e jetës. Na jep aq shumë kënaqësi, sa na duket çudi sa shpejt pranverës I vjen fundi dhe ia lë vendin verës. Pylli është gjallëruar prej pranverës, sepse janë kthyer zogjtë shtegtarë.</i> Hapi i dytë- punë në grupe Nxënësit/et në grupe dyshe punojnë për të gjetur rasen e emrit. Ndalen të pyetja për çdo rasë. Nxënësit/et lexojnë edhe punë të tjera të ngjashme me tekstin e tabelës.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i tretë- kllaster dhe memorizim njohurish të reja Nxënësit/et rikujtojnë ç'kanë mësuar për rasat dhe lakimin e emrave. Lexojnë në libër përkufizimet për rasat dhe lakimin, i përsëritin në grupe dyshe pastaj i thonë para klasës duke i shoqëruar me shembuj me emra në tre lakimet. Hapi i katërt- tabela koncepti Nxënësit/et lexojnë në libër kur emri është në trajtën e shquar, punojnë me tabelat e lakimit të emrave libri, bregu, fjala, të folurit. Hapi i pestë- pyetje -përgjigje Vendosin pyetjet në tabela për çdo rasë. Ndalen të drejtshkrimi i emrave të përngjitur; i lexon një nxë në s. me zë, pastaj i shkruajnë në fletore.</p> <p>3 Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Hapi i shtatë-punë në grupe Në grupe dyshe nxënësit/et punojnë ushtrimet 3, 4, në libër, plotësojnë tabelat për lakimin e emrave; vëlla, lule, shoku, të menduarit, diskutojnë me njëri – tjetrin. Diskuton klasa në përgjithësi për tabelat. Hapi i tetë- punë në grupe Ushtrimi 1, 2, i punojnë nxënësit/et në libër të ndarë në dy grupe (çdo grup një ushtrim). Këmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri- tjetrit, pastaj i diskutojmë me gjithë klasën, qortojmë gabimet.</p>				
<p>Zgjidhja e ushtrimeve: Ushtrimi 1. Trupi-emërore; gishtërinjtë -emërore; dhëmbët-emërore; ujqërit-emërore; i familjes-gjinore; zhurmë -kallëzore; udhëtarë t-emërore; një shpresë -emërore. Ushtrimi 2. Lojtarët-emërore; fëmijët-emërore; forcën, guximin, rezistencën-kallëzore; kushteve-rrjedhore; të mjedisit-gjinore; shembull-kallëzore; fëmijë -kallëzore; thellësi-kallëzore; të shkretëtirave-gjinore; lojë -kallëzore; kockat-emërore; vështrimin-kallëzore. Ushtrimi 3; Emërore: lapsi ujku gjuha të ngrënit Gjinore: i e lapsit ujkut gjuhës të ngrënit Dhanore: lapsit ujkut, gjuhës të ngrënit Kallëzore: lapsin ujkun, gjuhë n të ngrënit</p>				

<p>Rrjedhore: prej lapsit ujkut gjuhës të ngrënit Ushtimi4. Emërore: lulja lulet një lule disa lule Gjinore: i e lules luleve një luleje disa luleve Dhanore: lules luleve një luleje disa luleve Kallëzore: lulen lulet një lule disa lule Rrjedhore: prej lules luleve një luleje disa luleve</p> <p>Emërore: vëllai vëllezërit një vëlla disa vëllezër Gjinore: i e vëllait vëllezërve një vëllai disa vëllezërve Dhanore: vëllait vëllezërve një vëllai disa vëllezërve Kallëzore: vë llanë vëllezë rit një vë lla disa vëllezër Rrjedhore:prej vë llait vëllezërve një vë llai disa vëllezërve</p> <p>Emërore shoku shokët një shok disa shokë Gjinore i e shokut shokëve një shoku disa shokëve Dhanore shokut shokëve një shoku disa shokëve Kallëzore shokun shokët një shok disa shokë Rrjedhore prej shokut shokëve një shoku disa shokëve</p> <p>Emërore të menduarit një të menduar Gjinore i e të menduarit një të menduari Dhanore të menduarit një të menduari Kallëzore të menduarit një të menduar Rrjedhore prej të menduarit një të menduari</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi dallon emrat në pesë rase, në trajtën e shquar, të pasquar në të katër lakimet në ushtrimet e dhëna në libër. I përdor ata në fjali.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë e nxënësit që kanë marrë në klasë VI; - informacioni në librin e gjuhës shqipe në klasën e VII; - fleta për ushtrimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi/ja zhvillon, pasuron fjalorin, shpreh bukur mendimet me shkrim, mban qëndrim kritik për krijimet e njëri-tjetri.

TEMA:PË RSHTATJA E MBIEMRIT ME EMRIN

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përshtatja e mbiemrit me emrin.		Metoda e teknika -Puna në grupe dyshe -Diskutim.	Fjalë kyçe: Përshtatja në gjini, në numër, në rasë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë-punë e pavarur</i> Korigjoni dhe plotësoni grupet e mëposhtme: Pylli e heshtur djalë- Pylli të heshtura mësues- Pyllin i heshtur shëtitjen- <i>Hapi i dytë-stuhi mendimi</i></p>				

<p>Nxënësit/et i plotësojnë në fletore dhe përsëritin kategoritë gramatikore të mbiemrave dhe japin shembuj të tjerë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i katërt-stuhi mendimi Nxënësit/et rikujtojnë ç'kanë mësuar për mbiemrin (gjini, numër, rasë të emrit që cilësojnë) Hapi i pestë- memorizim njohurish Nxënësit/et lexojnë në libër kur mbiemri është përcaktor i disa emrave; Djem dhe vajza të reja; vajza dhe djem të rinj. Kur emrat janë në gjini të ndryshme, mbiemri është në shumës të gjinisë mashkullore: Vajzën dhe djalin i mbajnë për të zgjuar.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Hapi i shtatë- interpretim dhe reflektim Nga ushtrimi 1 mësuesi kërkon nga nxënësit të recitojnë vargjet e Naimit. Pastaj të gjejnë grupet emërore me mbiemra. Hapi i tetë- punë në grupe Në grupe dyshe nxënësit/et punojnë në libër ushtrimet, grupi 1- ushtrimet 2, 3, grupi 2- ushtrime 3, 4, . Këmbejnë fletoret dhe qortojnë gabimet e njëri- tjetrit. Drejtojnë pyetje për rastet e veçanta. Hapi i nëntë-punë në grupe Prezantojnë punën e bërë 2-3 nxënës/e të grupit të parë dhe 2-3 nxënës/e të grupit të dytë. Vlerësojmë punën e njëri – tjetrit në klasë. Hapi i dhjetë-tabelë koncepti Ushtrimin 5 nxënësit e punojnë me shkrim dhe thonë ndryshimet që pësojnë mbiemrat në numër dhe gjini.</p>	
<p>Zgjidhja e ushtrimeve: Ushtrimi 1. Lisat <u>e gjatë</u>; fushat <u>e gjera</u>; bregore bukuroshe; lumenj <u>të kulluar</u>; Pyje të gjelbëruar; vendëthit <u>e bekuar</u> Ushtrimi 2. Kë ngë e bukur, lajme të reja, pallate të mira, djem guximtarë , ditë e re, nxënës të edukuar, rrap shekullor, ditë e gjatë , gazetë serioze, strehë atë rore. Ushtrimi 3. Mësuese serioze; mësues seriozë ; poete e dashur; poetë të dashur; nxënëse e shkathët; nxënës të shkathët; atlete e shpejtë ; atletë të shpejtë ; gazetarë e zonja; gazetarë të zotë. Ushtrimi 4. Djem të bëshëm; shpatulla të gjera; koka të mëdha; sytë të vegjël; të nxirë ; të vrazhdë; i lehtë; e zakonshme; të gëzuar; trupat të përkulur; të fortë; të bëshëm; me trupa të gjatë; të zakonshëm; shpatulla të larta; veshë të ngjitur; hundë të shtypura (u përshtaten emrave që cilësojnë në gjini, numër e rasë). Ushtrimi 5. Disa shëtitje në natyrë, në mes të gjelbërimit atje, në Syrin e Kaltër do t'i donim të gjithë. Ujërat e pastër dalin nga thellësitë e tokës, duke u dhënë burimeve të rralla ngjyrën e kaltër në formën e syve gjigantë, prej të cilëve merr edhe emrin. Temperaturat e ujërave janë shumë të ulëta, por kjo nuk pengon turistët e pasionuar të zhyten në ujë për disa sekonda.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja analizon mbi emrin për kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit duke iu përshtatur emrit që cilëson. I përdor drejt në fjali.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë e nxënësit që kanë marrë në klasë VI; - informacioni në librin e gjuhës shqipe në klasën e VII; - fleta për ushtrimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin, pasuron fjalorin me shprehje, fjalë.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi në punë në grup; 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrimi 6 (sipas

- vlerësimi me gojë dhe me shkrim për punët në klasë e shtëpi, individualisht.	kërkesës) - Punimi i ushtrimeve në fletën e punës.
--	---

TEMA: SHKALLË T E MBIEMRAVE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkallët e mbiemrit		Metoda e teknika: shkrimi i poezisë; - di/ dua të di/ mësoj; - punë në grupe dyshe; - diskutim	Fjalë kyçe: Mbiemri, shkalla pohore, krahasore, sipërore	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit**1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:****Hapi i parë- shkrim poezie**

Shkruaj një poezi në tabelë dhe nx. gjejnë mbiemrat, u ndryshojnë shkallën, atje ku mundet, pa prishur kuptimin;

E bardhë më mbeti kjo letër (shumë e bardhë);

Një laps mbi të po rri torollak (shumë torollak);

I them të shkruaj patjetër;

Dy vargje të bukur nga larg (të ndjerë nga lart);

Por as dora nuk bindet, as fjala;

Dhe letra më mbeti e bardhë (borë e bardhë);

Ndoshta dhe fjala e pashprehur;

Peshon më shumë se çdo fjalë;

Hapi i dytë-interpretim

Nxënësit/et i lexojnë vargjet e poezisë, i shkruajnë bukur në fletore;

Në cilat shkallë janë përdorur mbiemrat? (gjini, numër, rasë, shkallë);

2. Ndërtimi i njohurive të reja:**Hapi i tretë-memorizim dijesh tabela : di-dua të di-më soj**

Nxënësit/et rikujtojnë çfarë mësuan për mbiemrin. Lexojnë në heshtje informacionin e dhënë në libër për mbiemrin. Plotësojnë tabelën;

Di	Dua të di	Mësoj
I nyjshëm I panyjshëm	Në sa shkallë përdoret mbiemri në fjali?	Mbiemri përdoret në tri shkallë: pohore, krahasore, sipërore, në shkallën krahasore të barazisë, të pabarazisë, të sipërisë relative dhe absolute
Përshtatet me emrin në gjini, numër, rasë		Drejtskrimi i mbiemrave të përngjitur

Hapi i katërt- Rrjet diskutimi

Diskutojmë plotësimin e tabelës dhe sistemojmë njohuritë për shkallët e mbiemrit:

- I nyjshëm, i panyjshëm (shembuj);
- Përshtatet me emrin në gjini, numër, rasë (shembuj);
- Përdorimi i mbiemrit në tri shkallë: pohore (shembuj), krahasore; të barazisë, të pabarazisë, të sipërisë relative dhe absolute (shembuj), sipërore (shembuj).

<p>- Mbiemrat, fjalë të përngjitura, nxënësit i shkruajnë në fletore dhe i përsërisin me njeri-tjetrin në bankë, për t'i mbajtur mend që t'i dallojnë nga fjalët e tjera.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi rezultateve të arritura:</p> <p>Hapi i pestë- punë në grupe Në grupe dyshe punohen ushtrimet 4, 5. Gjejnë mbiemrat dhe dallojnë në cilën shkallë janë përdorur. Diskutojnë me njëri-tjetrin.</p> <p>Hapi i gjashtë-punë në grupe Ushtrimet 1, 2, 3, punohen në libër. Nxënësit/et këmbejnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, qortojnë gabimet. Ushtrimin 6 e punon një nxënës/e në dërrasë (sipas kërkesës) Ndërhyjnë në përgjigjen e tij edhe nx. e klasës.</p>	
<p>Zgjidhja e ushtrimeve</p> <p>Ushtrimi 1. Problemin më të vë shtirë fë mijë shumë i zgjuar; një punë mjaft e vë shtirë ; palestra e madhe; mjete të reja; një karakter shumë të fortë ; më e shkathë t se motra. Ushtrimi 2. Aq i pikëlluar, aq e thellë krahasore e barazisë e vjetër, të madhe, shpatullgjerë – pohore. Më e mira, më e mençura- krahasore e sipërisë absolute. Ushtrimi 3. I fortë - aq i fortë, më i fortë, më pak i fortë, shumë i fortë . I zoti - aq i zoti; më i zoti; më pak i zoti; shumë i zoti I bardhë - aq i bardhë ; më i bardhë; më pak i bardhë; borë i Bardhë Ushtrimi 4. Qielli ishte më i kaltër se sytë e tij Djali ishte më i vogël se e motra. Dielli është më i nxehtë në mesditë . Ishte në fytyrë po aq e bukur sa e ëma. Era frynte më e fortë në pyjet me pisha. Ai është një nxë në s më i dalluar nga shokët. Ujët e detit në dimër është më i ngrohtë se toka. Fjalët më të ëmbla se gjithçka, thuhet për nënën. Ushtrimi 5. Më i lumturi, më i mirë, më i zoti, më i lumtur-krahasore. I dashur- pohore. Ushtrimi 6. I lumtur, aq i lumtur; më i lumtur, shumë i lumtur I mirë, aq i mirë, më i lumtur, shumë i lumtur I dashur, aq i dashur, më i dashur, shumë i dashur I kaltër, aq i kaltër, më i kaltër, shumë i kaltër I vogël, aq i vogël, më i vogël, shumë i vogël I nxehtë, aq i nxehtë, më i nxehtë, shumë i nxehtë. I bukur, aq i bukur, më i bukur, shumë i bukur. I dalluar, aq i dalluar, më i dalluar, shumë i dalluar. I ngrohtë, aq i ngrohtë, më i ngrohtë, valë i ngrohtë Të ëmbla, aq të ëmbla, më të ëmbla, mjaltë të ëmbla.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon shkallën e mbiemrave, i përdor në fjali mbiemrat në shkallën pohore, krahasore (të barazisë, të pabarazisë), sipërore.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuritë e nxënësit që kanë marrë në klasë VI; - Informacioni në librin e gjuhës shqipe në klasën e VII; - Fleta për ushtrimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin, pasuron fjalorin me shprehje, poezi, etj. - Mban qëndrim kritik, vlerësues për

	punën në grup.
Vlerësimi: - Vlerësimi në punën në grupe dyshe; - Vlerësim me gojë e me shkrim për punët në klasë e shtëpi (individualisht dhe në grupe).	Detyra dhe puna e pavarur: - Ushtrimi 7 (sipas kërkesës). - Punimi i ushtrimeve në fletën e punës.

2. DREJTSHKRIMI

Tema: Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura me prapashtesat; -si, -ri, -ar, -tar, -tor, -shëm.

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura me prapashtesat; -si, -ri, -ar, -tar, -tor, -shëm.		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Puna e pavarur; • Pyetje në dyshe. 	Fjalë kyçe: rregulla drejtshkrimore, zanoja ë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë-stuhi mendimi-memorizim</i> Nxënësit lexojnë disa fjalë që shkruan mësuesja në dërrasë dhe analizojnë pjesët përbërëse të tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Besnik-ëri; bujq-ësi; mjek-ësi (marrin ë-në para prapashtesës si) • Flamur-tar; themel-tar; treg-tar; (nuk marrin ë) • Legjendë-ar; këpucë-ar; libër-ar; orë-ar; (bie ë-ja) • I thyeshëm-thyeshmë-ri; i lirshëm- lirshmë-ri; (spostohet ë-ja para prapashtesës ri). Nxënësit dallojnë cilat fjalë shkruajnë gabim. Pastaj i shkruajnë në fletore. <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i dytë- prezantim i rasteve</i> Një nxënës lexon në libër 7 rastet e drejtshkrimit të fjalëve të përbëra. <i>Hapi i tretë-punë në grupe</i> Ndahen nxënësit në 7 grupe dhe në tabakë të bardhë shkruajnë me bojëra uji 1 rregull, bashkë me shembuj, i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit. <i>Hapi i katërt-punë në grupe</i> Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri – tjetrit për rastet e mësipërme, duke dhënë edhe shembuj.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Hapi i pestë- punë e pavarur</i> Ushtrimi 1, 2, dy nxënës i punojnë në dërrasë, kurse klasa i shkruan saktë fjalët në fletore, qortojnë gabimet.</p>				

<p>Hapi i gjashtë-punë e pavarur</p> <p>Ushtrimet 3, 4, nxënësit i plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre. Kërkon nga disa nxënës t'i lexojnë fjalët që edhe t'i shqiptojnë drejt.</p>	
<p>Zgjidhja e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1. Besnik-ëri, bujq-ësi, fshatar-ësi, miq-ësi, pleq-ëri, armiq-ësi, mjek-ësi. Ushtrimi 2. Flamur-tar, gjyq-tar, lundër-tar, oborr-tar, faj-tor, themel-tar, shqip-tar, treg-tar Ushtrimi 3. Thyeshmëri, robëri, shpezëri, bollshmëri, librar, orar, këpucar, legjendar. Ushtrimi 4. Trajta korrekte: rrogë, rrogëtar, bardhë, bardhësi, urtë, urtësi, burrë, burrëri, djalë, djalëri, besnikëri, pishtar, rojtar, zyrtar, atdhe, arsimitar.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p><i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi drejtshkruan fjalët e prejardhura me prapashtesat <i>-si, -ri, -ar, -tar, -tor, -shëm</i>, duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Libri i gjuhës shqipe, klasa VII. • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. • Fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <p>- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe</p>
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën me grupe. <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <p>Grupi I: Shkruaj në fletore të gjitha fjalët e ushtrimeve 1, 2, 3, 4 në libër. Grupi II: Ushtrimi 5 (sipas kërkesës).</p>

Tema: Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra, ku fjala e dytë fillon me zanore.

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore:</p> <p>Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra, ku fjala e dytë fillon me zanore.</p>		<p>Metoda e teknika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Puna e pavarur; • Pyetje në dyshe. 	<p>Fjalë kyçe:</p> <p>rregulla drejtshkrimore, fjalë e përbërë, zanore.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit</p>				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</p> <p>Hapi i parë- Lojë gjuhësore</p> <p>Nxënësit lexojnë disa raste në tabelë dhe thonë ç' mbajnë mend për drejtshkrimin e tyre. Paraardhës, antentegrim, kënddrejtë, kundërreformë, zëvendëssekretar; (shkruhen e shqiptohen të dyja zanoret dhe bashkëtingëlloret e njëjta) I dyanshëm, indoevropian, etj.</p>				

<p>Vetëdukim-vetë+edukim, fletanketë-fletë+anketë, tetorëshi-tetë+orëshi, kokulur-Kokë+ulur, etj. (bie ë-ja e fjalës së parë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tekniko-shkencor, ekonomiko-shoqëror, franko-gjerman, etj. (kryesisht bashkime mbiemërore) <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja:</p> <p>Hapi i dytë- Pyetje përgjigje</p> <p>Një nxënës lexon në libër 4 rastet e drejtshkrimit të fjalëve të përbëra. Nxënësit e tjerë bëjnë pyetje ose japin shembuj të tjerë .</p> <p>Hapi i tretë- punë në grupe</p> <p>Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri- tjetrit për rastet e dhëna në libër, duke dhënë edhe shembuj të tjerë.</p> <p>Hapi i katërt-punë në grupe</p> <p>Ndahen nxënësit në 4 grupe dhe në tabakë të bardhë shkruajnë me bojëra uji secili nga një rregull të dhënë në libër dhe i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit. Shtojnë edhe shembujt që dhamë më lart.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</p> <p>Hapi i pestë- punë e pavarur</p> <p>Ushtrimi 2, një nxënës e punon në dërrasë, kurse klasa i shkruan saktë fjalët në fletore, qortojnë gabimet.</p> <p>Hapi i gjashtë- punë në grupe</p> <p>Ushtrimet 1, 5, nxënësit i plotësojnë në tabelat e librit në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre.</p> <p>Hapi i shtatë - punë e pavarur dhe punë në grupe</p> <p>Ushtrimet 3, 6, i punojnë me shkrim në fletore, nxënësit ndahen në dy grupe, çdo grup nga një ushtrim. Këmbejnë fletoret nxënësit me njëri-tjetrit, korrigjojnë gabimet. Plotëson punën e tyre mësuesi/ja.</p>	
<p>Zgjidhja e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1. Asnjë+anëse; mikroorganizma; flokë+artë; kokë+argjend</p> <p>Ushtrimi 2. Gojë+artë; flokë+argjend; kokë+ulur, gjysmë+analfabet; anë+e+mbanë; gjë+ e +gjëzë (dy të fundit janë fjalë të përngjitura)</p> <p>Ushtrimi 3. Letraro-artistik; anglo-amerikanë; trako-ilir; agraro-industrial.</p> <p>Ushtrimi 4. Vetinduksion, vetëdukim, i shumanshëm; antiimperialist; fletanketë; kryeengjell</p> <p>Tetorëshi; krahartë; fotoelementë; bashkautor, bashkekzistencë.</p> <p>Ushtrimi 5. Bashkautor; gojëmbël; gojju; kokulur; zëmbël (me dy ë)</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:</p> <p><i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi shkruan drejt fjalët e përbëra, kur fjala e dytë fillon me zanore dhe e para mbaron me zanore, duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Libri i gjuhës shqipe, klasa VII. • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. • Fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <p>- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe</p>
<p>Vlerësimi:</p> <p>- Vlerësim me gojë në situatën e të nxënësve.</p>	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi në punën me grupe. - Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve. 	<p>Grupi I: Ushtrimi 4 (sipas kërkesës). Grupi II: Shkruani në fletore të gjitha fjalët që u përkasin katër rregullave të mësuara për fjalët e përbëra.</p>
---	---

TEMA: PËRDORIMI I APOSTROFIT PARA TRAJTAVE TË SHKURTRA.

<p>Fusha: Gjuhësia</p>	<p>Lënda: Gjuha shqipe</p>	<p>Tematika: Drejtshkrim</p>	<p>Shkalla: III</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Përdorimi i apostrofit para trajtave të shkurtra.</p>		<p>Metoda e teknika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Puna e pavarur; • Pyetje në dyshe. 	<p>Fjalë kyçe: apostrofi, rregulla drejtshkrimore, trajta të shkurtra, të bashkuara..</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit</p>				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- Stuhi mendimi</i> Nxënësit japin disa raste që mbajnë mend për përdorimin e apostrofit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • M’i more të gjitha lodrat e mia.(më+i= kujt?-mua më; kë?-ato i) • T’i pranova mendimet e tua, por më dëgjo tani.(të+i= kujt?=ty të; kë?-ato i) • T’u kërkosh mendim edhe shokëve. (të e foljes në lidhore+ kujt?-atyre u) • S’u erdhi mirë nga veprimi yt. (nuk=s’; kujt?=atyre u). <p>Nxënësit japin edhe shembuj të tjerë me përdorimin e apostrofit në trajtat e shkurtra të bashkuara, si dhe më përemrin pyetës çfarë-ç’ Çfarë do nga unë? Ç’do nga unë?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i dytë -punë në grupe</i> Një nxënës lexon në libër rastet e përdorimit të apostrofit që janë dhënë me tabelë. Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri – tjetrit për rastet e përdorimit të apostrofit, duke dhënë edhe shembuj.</p> <p>-Pse përdoret apostrofi? (sepse bie ë-ja në shqiptim) -Kur përdoret apostrofi? (në trajtat e bashkuara, te përemri pyetës çfarë-ç’, te pjesëza mohuese nuk-s’, kur bashkohen me foljen apo me trajtat e bashkuara)</p> <p>-Si do t’i formulojmë rregullat e drejtshkrimit për rastet në tabelë?</p> <ul style="list-style-type: none"> a- Trajtat e bashkuara m’i; t’i shkruhen me apostrof b- Të-ja e foljes në lidhore, kur bashkohet me trajtat e shkurtra ose të bashkuara, përdorim apostrofin. c- Trajta e shkurtër më dhe të, kur bashkohen me pjesëzën u të foljes në të kryerën e thjeshtë, përdoret apostrofi. <p><i>Hapi i tretë-punë në grupe</i> Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në tabelë shkruajnë me bojëra uji 3 rregulla të përdorimit të apostrofit dhe i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.</p>				

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**Hapi i katërt-punë e pavarur**

Ushtrimi 1, një nxënës e punon në dërrasë, kurse klasa i shkruan saktë fjalët në fletore, qortojnë gabimet.

Hapi i pestë - punë në grupe dyshe

Ushtrimet 2, 3, nxënësit i plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre. I shkruajnë në fletore rastet e përdorimit saktë të apostrofit.

Hapi i gjashtë - punë në grupe

Ushtrimin 4, nxënësit në grupe dyshe punojnë me tekstin “Zodiaku” që e kanë në tekst, nënvizojnë rastet e përdorimit të apostrofit dhe thonë cilit rregull i përkasin. Pasi mbarojnë lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Zgjidhja e ushtrimeve

Ushtrimi 1; do t’i kërkoja; do t’i flas; për t’i pasur si dëshmi; me t’i thënë një fjalë; do t’u kërkosh falje; t’u marrësh nga një dhuratë; do t’u kisha lajmëruar; do t’u përgjigjem menjëherë; t’jua them hapur; do t’jua kisha thënë më parë; do t’jua lehtësojë shumë punën; të m’ia thuash të gjitha fjalët; do t’ia tregoja.

Ushtrimi 2; për ta kryer vizitën; më duhej ta mbaja ...; ai s’i dëgjoi këshillat... prandaj s’iu kthye shëndeti.

Ushtrimi 3; drejtori i shkollës; ç’të tha; s’folën; m’i jep lapsat me ngjyra; me t’u dalë përpara; ta mori dorën.

Ushtrimi 4; s’i kam njohur; e si t’i shihje; mund t’i shihja; e lehtë për t’u njohur; s’e njuh dot; s’do të reshtnim; s’kaloi kohë; Po kjo ç’është; s’të linte pikë dyshimi; s’bënte asgjë.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përdor apostrofin, duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.

Burimet:

- Libri i gjuhës shqipe, klasa VII.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.
- Fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe

Vlerësimi:

- Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit.
- Vlerësimi në punën me grupe.
- Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve.

Detyra dhe puna e pavarur:

Grupi I: Shkruani rregullat e përdorimit të apostrofit dhe nga pesë shembuj për secilin
Grupi II: Ushtrimi 5 (sipas kërkesës).

TEMA: DREJTSHKRIMI I EMRAVE QË KA DY TRAJTA SHUMËSI.

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i emrave që ka dy trajta shumësi.		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Puna e pavarur; • Pyetje në dyshe. 	Fjalë kyçe: rregulla drejtshkrimore, emra me dy trajta shumësi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë-Lojë ra gjuhësore

Mësuesi shkruan disa raste që nxënësit i përdorin në të folurin e përditshëm.

- Një rreth- ca rrahë (gjeometrikë);
- Një rreth- ca rrethe (ndarje administrative territoriale);
- Një lëkurë- ca lëkurë (të kafshëve);
- Një lëkurë- ca lëkura (lëkurat e pemëve);
- Një pikë- ca pikë (pikët e fituara në garë, në konkurs);
- Një pikë – ca pika (pikat e shiut, të ujit, etj.);
- Një copë- ca copa (copat e bukës, e basmave);
- Një copë- ca copë (copët e hekurit, e gurit, e tullave, etj.);
- Një vit- ca vjet- (kur shoqërohet me një numëror; 5 vjet, shumë vjet);
- Një vit- ca vite (këto vite, vitet e para, vitet e shkollës, etj.)

Hapi i dytë- punë e pavarur

Mësuesi kërkon nga nxënësit t'i përdorin këto fjalë në fjali dhe të bëjnë dallimin midis tyre.

Grupet e fjalëve i shkruajnë në fletoret e klasës.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë- Një nxënës lexon në libër 2 grupet e emrave me dy forma shumësi.

Hapi i katërt- punë në grupe, pyetje përgjigje

Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri – tjetrit për rastet e përdorimit të emrave me dy forma shumësi, duke dhënë shembuj me fjali.

Hapi i pestë- Punë e pavarur

Me grupin e dytë të emrave që e bëjnë shumësin me –ra, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit t'i përdorin në fjali me ngarkesë stilistikore. P.sh. kohë-kohërat; copë- copëra; gjuhë- gjuhëra; stoli-stolira; kala- kalara;

- Eh, kohëra, ishim të vegjël atëherë dhe mezi prisnim të dilnim në qytet!
- Po, mblidh copërat tani, se ajo u thye, u prish!
- Nuk është mirë të përdorësh këto gjuhëra, moj nuse!
- Stolira për nusen bleve, për motrën, nuk more një palë çizme për dimër!

Hapi i gjashtë- punë në grupe

Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në tabakë të bardhë shkruajnë me bojëra uji 2 grupet e emrave që kanë dy forma shumësi dhe i afishojnë në muret e klasës, qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimimit

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimin 1-2, nxënësit e plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre; Lëkurët e kafshëve- lëkurat e pemëve; copët e lëkurës; copat e bukës; petët e byrekut; petat e gurit, (që luanin fëmijët).

Ushtrimin 3 nxënësit e punojnë në pjesën letrare “Çmimet”, do të gjejnë emra që kanë dy trajta shumësi; (punojnë në grupe pesëshe).

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përdor drejt emrat që kanë dy forma të shumësit duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë me ngarkesë të veçantë stilistikore.

Burimet:		Lidhja me fushat e tjera:		
<ul style="list-style-type: none"> • Libri i gjuhës shqipe, klasa VII. • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. • Fleta për verifikimin e kompetencave. 		- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe		
Vlerësimi:		Detyra dhe puna e pavarur:		
<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën me grupe. - Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve. 		Grupi I: Ushtrimi 3 (sipas kërkesës). Grupi II: Shkruani në fletore emrat që kanë dy forma shumësi, të shoqëruara me shembuj me fjali.		
TEMA : DREJTSHKRIMI I ZANORES Ë NË TRUP TË FJALËS.				
Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i zanores ë në trup të fjalës.		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Lojë gjuhësore • Puna e pavarur; • Pyetje në dyshe. 	Fjalë kyçe: Zanorja ë në trup të fjalës, paratheksore, rregulla drejtshkrimore,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë-punë e pavarur Nxënësit punojnë me ushtrimin 1 në libër, shkruajnë në fletore fjalët e shkruara saktë, mësuesi i shkruan në dërrasë: a-Shpejtësi; shterpësi; trashësi; thellësi; urtësi; vështirësi; zbehtësi; b-Valëzot; c-Shumëfishoj; shumëkëmbësh; qafëgjatë; pulëbardhë; pjesëmarrje;pikënisje; pesëvjeçar; mirëdita; d-vetëdashje</p> <p>Hapi i dytë-punë në grupe Mësuesi pyet nxënësit pse i ndau fjalët në katër grupe, ç’ dinë ata për drejtshkrimine tyre, cilat nga fjalët e dhëna i shkruajnë apo i shqiptojnë gabim</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i tretë- memorizim rregullash Nxënësit lexojnë në libër 3 rastet e përdorimit dhe mospërdorimit të ë-së paratheksore e pastheksore. Thonë rregullat e drejtshkrimit për katër grupet e fjalëve të shkruara në tabelë Hapi i katërt-lojë gjuhësore. Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri – tjetrit në formë loje, për rastet e përdorimit të ë-së duke dhënë edhe shembuj.</p>				

Hapi i pestë- lojë gjuhësore

Mësuesi organizon një lojë mësimore: fotokopjon dy faqet e librit për rregullat e drejtshkrimit të ë-së paratheksore e pastheksore, udhëzon nxënësit që të presin me gërshërë shembujt, sic janë me kuadrate, t'i përziejnë dhe pastaj t'i vendosin prapë përbri rregullës që i përkasin. Kontrollon punën në grupe dyshe. E përsëritin këtë lojë disa herë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë- punë në grupe

Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në tabelë shkruajnë me bojëra uji 3 rregulla të përdorimit të ë-së paratheksore e pastheksore, i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimet 2, 3, nxënësit i plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimin 1. Nxënësit i shkruajnë fjalët në fletore, shkruajnë edhe rregullën e drejtshkrimit (rregulla 3, rregulla 2).

Ushtrimi 2. Mbarësi, miqësi, pemëtar, pjesëtar, shkallar, plotësoj, punëtor, qytetar, rreptësi, pakësoj. Ushtrimi 3. Fjala qytetërim.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përdor drejt në të folur dhe të shkruar fjalët me ë paratheksore dhe pastheksore, duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.

Burimet:

- Libri i gjuhës shqipe, klasa VII.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.
- Fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe

Vlerësimi:

- Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit.
- Vlerësimi në punën me grupe.
- Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve.

Detyra dhe puna e pavarur:

- Grupi I: Ushtrimi 4 (sipas kërkesës).
- Grupi II: Shkruajnë në fletore rregullat e drejtshkrimit dhe shembujt për çdo rregull.

MORFOLOGJI

TEMA: PËREMRRAT VETVETORË, DËFTORË, PYETËS

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përemrrat vetvetorë, dëftorë, pyetës		Metoda e teknika: -Parashikim me terma paraprakë - Puna në grupe dyshe; - diskutim.	Fjalë kyçe: përemrrat vetvetorë, dëftorë, pyetës,	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë-parashikim me terma paraprakë

Mësuesi shkruan në dërrasë fjalët:

ky, këta, të tillë, vetes, cili? Kë?, i sati, me se.

Me këto fjalë krijoni një tekst me 5-6 fjali p.sh.:

Ky libër që i caktova vetes për ta lexuar shpejt, po më duket i mërzitshëm. Ju do të pyesni: Cili është ky libër? Të gjithë këta libra që kam në listën e rekomanduar nga mësuesja e gjuhës shqipe, duhet t'i lexoj, por të tillë, si ky, do të më kërkojnë një kohë më të gjatë. Kë duhet të dëgjoj, mamin apo motrën? Me se do të merrem në kohën e lirë? Të satin do ta lexoj këtë libër? Ma thoni ju.

Hapi i dytë-Punë në grupe

Nxënësit/et lexojnë tekstet e shkruara në fletore dhe emërtojnë përemrat e përdorur për aq sa kanë mësuar në klasën e VI. Gjejnë tek njëri-tjetri në janë përdorur të gjithë fjalët e dhëna në tabelë.

Hapi i tretë-tabelë koncepti

Nxënësit/et përgatisin tabelë me përemrat që kanë mësuar në klasën e VI (vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës).

2. Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi i katërt-Tabelë koncepti

Mësuesi/ja prezanton tabelën e librit me përemrat në dërrasën e zezë (me flipçart ose me video projektor) dhe nxënësit/et përsëritin shtatë llojet e përemrave.

Hapi i pestë-punë në grupe dyshe

Nx. lexojnë në dyshe informacionin e dhënë në libër për përemrat vetvetorë (vetja, vetvetja), dëftorë(ky, kjo, këta, këto, i tillë, i atillë, ai, ajo, ata, ato), pyetës(kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati, (me) se).

Hapi i gjashtë- shpjegim dhe tabelë koncepti/pyetje përgjigje

Mësuesi shpjegon në çështjet kryesore:

-Çfarë tregon përemri vetvetor? Atë që e kryen veprimin dhe atë mbi të cilin bie veprimi. Lakohet.

-Çfarë tregon përemri dëftor? Frymorë që ndodhen:

Afër folësit- ky, kjo, këra, këto, i tillë, i këtillë

Larg folësit -ai, ajo, ata, ato, i atillë, të atillë (lakohen)

Si mund t'i dallojmë përemrat ai, ajo, ata, ato kur janë vetorë dhe ku janë dëftorë? Shembuj.


Cilët janë përemrat pyetës? (kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati, me se).

Përse përdoren ata? Cilët prej tyre lakohen? Shembuj.

3.Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i shtatë-

Mësuesi/ja vizaton në tabelë skema dhe kërkon nga nxënësit/et t'i plotësojnë me sa më shumë përemra vetorë, vetvetorë, dëftorë, pyetës



Hapi i tetë -punë në grupe dyshe

Punohen në libër, në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6 gjejnë llojet e përemrave, (vetvetorë, dëftorë, pyetës) . kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi i nëntë-punë e pavarur

Punohen ushtrimet 7, 8 (sipas kërkesës) nxënësit ndahen në dy grupe Pastaj lexojnë fjalitë që kanë krijuar me përemra vetvetorë dhe pyetës.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi. 1 Unë për veten time; e kam fajin vetë;inatin me veten; është vetvetja;

2. Përemrat dëftorë:atë, këtë, këto, e tillë;

3.Përemrat vetorë:ajo, ne, unë, më(pëlqen), të+e(kapërcejmë);

4.Përemrat pyetës: kush, cili, çfarë, sa, i sati, me se;

5.Përemrat dëftorë: **për afër**:ky, kjo, këta, këto, të këtillë, e këtillë, i tillë; **për larg**: ai, ajo, ata, ato, të atillë, e atillë, i atillë

Ush. 5. (është) ky, ajo, kjo, këtë, atë, të tillë.

Ush.6. Përemrat pyetës:kush, kush, cili, me se, sa, me se.

Ush.7. Më duket vetja e sigurt për mësimin e ri. Mendimi i vetes së tij i dukej më i drejtë. I bie më qafë vetes sime për këtë gjë. E kishte këtë gjendje prej vetes së tij.

Ush.8. Kush e mori librin tim? Cilin mësim morëm sot në lëndën e historisë? Çfarë mendon për këtë punë? I sati ishe në grupin e të rinjve? Me se do të shkoni sot në Durrës?

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon përemrat vetvetorë, dëftorë, pyetës, në fjalitë e dhëna në libër. Zëvendëson në fjali përemrat që mungojnë.

Burimet:

- libri i gjuhës shqipe, klasa VII.
- fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Nxënësi/ja zhvillon komunikimin, pasuron fjalorin.
- Me njohuritë e edukatës shoqërore për edukimin qytetar te nxënësi/ja.

Vlerësimi:

- vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit;
- vlerësimin në punimin e ushtrimeve me gojë e shkrim (individualisht).

Detyra dhe puna e pavarur:

Grupi I: Ushtrimi 9 (sipas kërkesës)

Grupi II: krijoni një tekst me 7-8 fjali, ku të përdoren katër llojet e përemrave.(vetorë, vetvetorë, dëftorë, pyetës).

TEMA: TRAJTAT E SHKURTRA DHE TË BASHKUARA TE PËREMRRAT VETORË.

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara te përemrrat vetorë.		Metoda e teknika: - tabela e koncepteve. - puna në grupe dyshe. - loja gjuhësore.	Fjalë kyçe: m'i, trajta e plotë, trajta e shkurtër, trajtë e bashkuar	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë-tabelë koncepti</i> Mësuesi prezanton tabelën e lakimit të përemrave vetorë; Thonë ç' dinë për përemrrat vetor, çfarë tregon secili përemër sipas vetave. Mësuesi ndalet te rasa dhanore dhe kallëzore, të cilat dalin me trajta të plota dhe të shkurtra. Rasa dhanore: më, të, i, na, ju, u Rasa kallëzore: më, të, e, na, ju, i</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i dytë- lexim në heshtje</i> Lexojmë në heshtje informacionin e dhënë në libër për lakimin e përemrave vetorë dhe përsëritin trajtat e shkurtra.(rasa dhanore, kallëzore). <i>Hapi i tretë-Prezantim me power point/tabelë koncepti</i> Mësuesi/ja mund të prezantojë me Powerpoint tabelën e bashkimit të trajtave të shkurtra të rasës dhanore me trajtën e shkurtër e, i, të rasës kallëzore. Nxënësit/et dallojnë trajtat e shkurtra dhe të bashkuara. Përdorimi i tyre në fjali. <i>Hapi i katërt- punë e pavarur</i> Drejtshkrimi i trajtave të bashkuara ndaras dhe me apostrof.</p> <p>2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Hapi i pestë-punë në grupe</i> Në grupe dyshe punohet ushtrimi 1, në libër (me gojë). Vendosin trajtat e shkurtra që mungojnë. Aktivizohen disa nxënë s. <i>Hapi i gjashtë-punë e pavarur</i> Punohet në libër ushtrimi 2, 3, 4, 6 (sipas kërkesës në libër). Nxënësit/et këmbëjnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Lexojnë ushtrimet para klasës, qortohen gabimet që mund të kenë bërë nxënësit/et. Ushtrimin 5 e punojnë me shkrim në fletore, përdorin trajtat e bashkuara në fjali, lexojnë disa nxënë s. fjalitë, zbërthejnë trajtat e bashkuara. <i>Hapi i shtatë-lojë gjuhësore</i> Lojë gjuhësore: nxënësit/et, radhë njëri pas tjetrit, lexojnë fjalitë që kanë formuar për ush. 5. Nxënësi/ja që nuk përgjigjet shpejt eliminohet nga loja. Loja vazhdon derisa aktivizohen të gjithë nxënësit/et.</p>				
- Zgjidhja e ushtrimeve:				

<p>Ushtrimi 1. Trajtat e shkurtra: ne, i, e, e, na, ta, na, i, m'u, na, ta, na e.</p> <p>Ushtrimi 2. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara dhe përemra vetorë: ti, më, ne, i, ma, më, unë, ma, m'i</p> <p>Ushtrimi 3. Këtë, ti, mua, i, ata, na, ne, ne, ju, ata, ajo, e, ato, prej jush.</p> <p>Ushtrimi 4. Merre, kthema, jepmë, foli, kthemëni, thuaju, thuamëni, jepmani.</p> <p>Ushtrimi 5 shembujt të ngjashëm si në tabelat e librit.</p> <p>Ushtrimi 6. E fiku, i kapi, e mori, t'ia kishin, e shfletoi, t'i fliste, u vinte, i njihte, e dinte, i kishte, u mungonte, ta tregonte.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p>Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrat vetorë, i zbërthen ato dhe i përdor në fjali.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII; • tabela të lakimit të përemrave vetorë; • Fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon komunikimin. - Përforon njohuritë në edukatës shoqërore. - Përdorimi i kompjuterit (prezantimi me Power-Point).
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit. - vlerësimin me gojë e shkrim në veprimtaritë praktike. - vlerësimin në detyrën e shtëpisë. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Gr. 1- Nxënësit/et bëjnë me një fletë dyshe tabelën e bashkimit të trajtave të shkurtra të përemrat vetorë. -Gr. 2- Prezantimi i tabelës me Power-Point -Gr.3- Ushtrimi 7 (sipas kërkesës)

TEMA: FORMA JOVEPRORE E MËNYRËS DËFTORE DHE LIDHORE.

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Forma joveprore e mënyrës dëftore dhe lidhore.		Metoda e teknika: - Puna në grupe dyshe - INSERTI; - diskutim.	Fjalë kyçe: zgjedhim, mënyra, kohë të thjeshta, të përbëra, folje ndihmëse jam, pjesëza u, mbaresa.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë-interpretim</i></p> <p>Lexoni me intonacion poezinë dhe gjeni foljet:</p> <p style="padding-left: 40px;"><u>Në festën e mësueses</u></p> <p style="padding-left: 40px;">1. Lulet e sapoçelura, 5. Në festën tënde, Që solli pranvera, Çdo ditë në 7 Mars,</p>				

S'i **ndërrova** kurrë, Urime nga zemra,
Me lulet e blera. **Shkrova** në dërrasë.

2. Një tufëz manushaqe 6. Mësuese, të **dua**,
Në lëndinë **mblodha** Ndaj **vij** me gëzim,
Bashkë me luleshqerrat, Në klasë e në shkollë,
Gërshetë i **drodha**. Të **marr** diturinë

1. Me sytë që më **qeshin**, 7. Gëzuar 7 Marsin,
Me buzët që **këndojnë**, Gjithë jetën pranverë,
Dhuratë mësueses, Mësuese e dashur,
I **bëj** unë gjithmonë Sa emër me vlerë.

2. një këngë për ty,
që dije na **jep**,
dhe lulet që **mblodha**
në shkëmb e në breg.

Hapi i dytë-punë në grupe

Nxënësit/et në grupe dyshe gjejnë foljet, analizojnë ato: kohë, vetë, numër.

- Si e shpreh mendimin folja: të marr? (veprim të mundshëm)
- Po folja solli, mblodha, këndojnë? (veprim i sigurt, dëftore)

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë- shpjegim /punë e pavarur

Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër për formën joveprore në mënyrat dëftore e lidhore (për 5 minuta).

- Nxënësit/et në grupe dyshe punojnë me tabelën INSERT.

V	+	-	?

Hapi i katërt-tabelë koncepti

Tabelën e mësipërme e diskutojnë me njëri-tjetrin. Pastaj diskutojnë të gjithë nxënësit/et me mësuesin/en, duke plotësuar njohuritë e nxënësve me konceptet e reja për foljen: forma joveprore, mjetet gjuhësore për formimin e saj, tabelat për zgjedhimin e foljes *afrohem* në të gjitha kohët e mënyrës dëftore e lidhore, etj.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë-punë në grupe

Në grupe dyshe nxënësit/et punojnë ushtrimet 1, 2, në libër, i plotësojnë tabelat sipas kërkesës së ushtrimeve dhe këmbajnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit për zgjedhimin e foljeve në mënyrën dëftore dhe lidhore, forma joveprore.

Hapi i gjashtë-punë e pavarur

Ushtrimet 3, 4, i punojnë nxënësit/et (në libër, ushtrimin 3, në fletore, ushtrimin 4.) Klasa ndahet në dy grupe sipas rreshtave, këmbajnë punët, japin përgjigjet e tyre. Mësuesi plotëson përgjigjet e nxënësve.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. U mbështolla, u kapa, u hodha

<p>U mbështolle, u kape, u hodhe U mbështoll, u kap, u hodh U mbështollëm, u kapëm, u hodhëm U mbështollët, u kapët, u hodhët U mbështollën, u kapën, u hodhën</p> <p>Ushtrimi 2. Të mbështillesh të kapesha, të hidhesha Të mbështilleshe, të kapeshe, të hidheshe Të mbështillej të kapej të hidhej Të mbështillemi të kapemi të hidhemi Të mbështilleni të kapeni të hidheni Të mbështillen të kapen të hidhen.</p> <p>Ushtrimi 3. Mbani, të kuptojë, vazhdoni, do të vonojë, paraqitni, të shihni, bëni, vini, të keni soditur, keni treguar, të keni lënë, thoni, mendoj, ka perënduar, ka lindur, të ndodhë, ëndërron, qëndroni, lindi (forma veprorë) të jeni, kufizohuni, është (forma joveprorë)</p> <p>Ushtrimi 4. Filloj fillohem, të fillohem Ndërtoj ndërtohem, të ndërtohem Hedh hidhem të hidhem Mbledh mblidhem të mblidhem Ul ulem të ulem Nxjerr nxirrem të nxirrem</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon foljet në formën veprorë e joveprorë në mënyrën dëftore e lidhore, përdor në fjali foljet në formën joveprorë.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me sportin, me lëndën e biologjisë. - Me edukimin qytetar të nxënësit.
<p>Vlerësimi: Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit; Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht.</p>	<p>Detyra dhe puna e pavarur: -Gr. 1- Ushtrimi 5 (sipas kërkesës) Gr.2- Formo 6 fjali me folje në mënyrën dëftore e lidhore, në formën joveprorë. Plotësimi i fletës për verifikimin e kompetencave.</p>

TEMA: MË NYRA KUSHTORE DHE LIDHORE E FOLJES

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mënyra kushtore dhe habitore e foljes		Metoda e teknika: - Loja zinxhir; - puna në grupe dyshe; - diskutim.	Fjalë kyçe: veprim i kushtëzuar, veprim i papritur, kohë të përbëra, folje ndihmëse.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë- punë e pavarur

Shkruaj në tabelë fjalitë dhe kërkohet nga nxë në si që ta ndajnë në pjesë të dallojnë lidhëzat dhe llojin e tyre.

- Po të luanim më mirë, do ta fitonim ndeshjen (e tashme)

- Po të mos ishte nxituar pak, çdo gjë (e shkuar) Veprime të kushtëzuara do të kishte shkuar mbarë.

Hapi i dytë-shpjegim

Nxënësi/ja dhe mësuesi/ja nga analiza e fjalive për nga kuptimi, nxjerrin se folja në mënyrën kushtore tregon një veprim të kushtëzuar nga një veprim tjetër, se dy fjalitë janë të përbëra; folja në kushtore është në pjesën kryesore, në pjesën e nënrenditur është kushti (po të luanim, po të ishte nxituar).

Hapi i tretë-lojë zinxhir

Përsërit me nx. përkufizimin për mënyrat e foljes:

Format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim a një gjendje sit ë sigurt, (Dëftore) si mundësi (lidhore), si dëshirë, si urdhër, si habi, si kusht, i quajmë mënyra të foljes.

Nxënësit japin shembuj me folje në mënyrën dëftore e lidhore, që kanë mësuar në klasën e gjashtë(në 8 kohët e dëftores, 4 kohet e lidhores)një ri pas tjetrit në formën e lojës zinxhir.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i katërt-shpjegim

Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen në ndarjen e kohëve të mënyrës kushtore: 2 kohë; 1 e thjeshtë, 1 e përbërë, të mënyrës habitore:2 të thjeshta, 2 të përbëra, si ndërtohen ato (mjetet gjuhësore që shërbejnë).

Hapi i pestë-punë në grupe

Nxënësit /et në grupe dyshe punojnë me tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrën kushtore e habitore.

Ndalen në dallimin e temës dhe mbaresës së foljeve dhe në foljen ndihmëse kam, e cila formon kohët e përbëra.

3. Prezantimi dhe demonstrimi rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë- punë e pavarur

Ushtrimin 1 çdo nxënës/e e plotëson në libër, pastaj me anë të lojës zinxhir nxënësit/et zgjedhojnë foljet: vizitohet, hap, fle në dy kohët e mënyrës kushtore. Nxënësi/ja që gabon e zgjedhon foljen me shkrim në fletore.

Hapi i shtatë- punë e pavarur

Ushtrimi 4, çdo nxë në si. e punon në libër, (si me ush.1)

Ushtrimet 2 dhe 6 nxë në si. i punojnë në libër. Këmbejnë librat dhe gjejnë gabimet e njëri - tjetrit. Pastaj ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen zgjidhjet e drejta të ushtrimeve.

Hapi i tetë- punë në grupe dyshe.

Ushtrimet 3, 5, nxënësit i punojnë me gojë, plotësojnë pohimet e sakta për mënyrën kushtore dhe habitore.

<p>Zgjidhja e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1. Do të vizitoja- do të kisha vizituar, do të hapja- do të kisha hapur, do të flija- do të kisha fjetur.</p> <p>Ushtrimi 2. Po të binte shi, do të merrnim cadra. Po të mos ishte i rënduar grafiku, çdo ditë nuk do të arrinim me vonesë në punë. Po të punojnë si duhet të gjithë, punët do të shkonin më mirë. Po të kishim mace, nuk do të loznin minjtë.</p> <p>Ushtrimi 3. Të sakta; pika e dytë dhe e pestë</p> <p>Ushtrimi 4. Menduakam, menduakështa, paskam menduar, paskështa menduar. Prekam, prekështa, paskam prerë, paskështa prerë. Hëngërkam, hëngërkështa, paskam ngrënë, paskështa ngrënë.</p> <p>Ushtrimi 5. Të sakta; pika e parë dhe e tretë.</p> <p>Ushtrimi 6. Paskështa menduar, paskështa shkruar, paskështa folur, kërcyer, udhëtuar, kthyer. Paskësh menduar me kohë për vazhdimin e shkollës së lartë. E paskësh shkruar bukur këtë poezi djali! I paskështa folur shumë ashpër vajzës dje. Sa bukur paskëshin kërcyer nxënësit tanë në festivalin folklorik!</p> <p>Ushtrimi 7. Qenka-habitore, koha e tashme, veta e parë, zgjedhimi i veçantë. Heq-dëftore, e tashme, e parë, i dytë Qenkësh-habitore, e pakryer, e tretë, i veçantë. Paskëshin qenë-habitore, më se e kryer, e tretë, i veçantë Paskësh bërë-habitore, më se e kryer, e tretë, i parë. Flas-dëftore, e tashme, e parë, i dytë. Merrte-dëftore, e pakryer, e tretë, i dytë.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p>Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon foljet në mënyrën kushtore, habitore, jep përkufizimin për kuptimin që shpreh folja në këto mënyra. Dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra (folja ndihmëse kam). Zgjedhon foljet në mënyrën kushtore dhe habitore.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me sportin, me lëndën e biologjisë. - Me edukimin qytetar të nxënësit.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit; - vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gr. 1-Ushtrimi 7 (sipas kërkesës). Gr. 2- Ushtrimi 8 (sipas kërkesës) <ul style="list-style-type: none"> - Plotëso faqen në fletën e verifikimit të kompetencave.

TEMA: MËNYRA DËSHIRORE DHE URDHËRORE E FOLJES

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII						
Tema mësimore: Mënyra dëshirore dhe urdhërore e foljes.		Metoda e teknika: - Puna në grupe dyshe; - Formimi i pyetjeve; - Loja gjuhësore.	Fjalë kyçe: Veprim i dëshirueshëm, urdhër, kohë e përbërë							
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit										
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- diskutim</i> Diskutohet me nxënësit/et për kohet dhe mënyrat e foljeve të më poshtme: Laj; la-va; la-fsha ti laj, thaj, lyej, thyej, ziej, bëj, gjej, blej-bli Lyej; le-va;le-fsha ti e lexo-lexoje; ki-kije; ngri-ngrije; tregojua, Ndiej; ndje-va; ndje-fsha ti hyr! Vër! Lër! Bjer! Shpjer! Shtjer! Shkruaj; shkro-va; shkro-fsha Lidh; lidh-a; lidh-sha Qëndis; qëndis-a; qëndis-sha Mat; mat-a;mat-sha; mat-të; ujit-ujit-a; ujit-sha; ujit-të Lë; lë-në; lën-ca; ha-ngrë-në; ngrën-ca; vë-vë-në;vën-ca; zë-zë-në; zën-ca</p> <p>Hapi I dytë- punë e pavarur /tabelë koncepti Nxënësit këto folje i përdorin në fjali dhe mësuesi/ja ndalet te rastet kur ata i shqiptojnë gabim, hapin fletoret dhe i shkruajnë foljet e grupit të parë në mënyrën dëshirore dhe të grupit të dytë, në urdhërore.</p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%;">Folje të mënyrës dëshirore</td> <td style="width: 50%;">Folje të mënyrës urdhërore</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>					Folje të mënyrës dëshirore	Folje të mënyrës urdhërore				
Folje të mënyrës dëshirore	Folje të mënyrës urdhërore									
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i tretë-shpjegim dhe tabelë koncepti</i> Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër për foljen në mënyrën dëshirore dhe urdhërore. <i>Hapi i katërt- interpretim dhe kërkim /nënvizim</i> Dy nxënës lexojnë bukur, me intonacion vargjet nga Gjergj Fishta dhe Çajupit dhe nënvizojnë foljet në dëshirore dhe urdhërore. <i>Hapi i pestë-pyetje përgjigje/punë në grupe</i> Nxënësit/et në grupe dyshe përgatisin pyetje rreth temës: Ç'tregon folja në mënyrën dëshirore dhe urdhërore? Sa kohë ka mënyra dëshirore dhe urdhërore? Si formohen kohët e këtyre mënyrave? - Lexojnë disa nxënës/e pyetjet e përgatitura, të tjerë nxënës/e japin përgjigjet. <i>Hapi i gjashtë-punë e pavarur</i> Zgjedhojnë foljen <i>ndiej, zë, mat</i>, në kohët e mënyrës dëshirore dhe urdhërore.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Hapi i shtatë-punë e pavarur</i></p>										

<p>Nxënësit/et plotësojnë ushtrimin 1, tabelën me zgjedhimin e foljeve; jam, kërkoj, kap, lë, në dëshirore, qortojnë punën e njëri-tjetrit.</p> <p>Hapi i tetë-lojë gjuhësore</p> <p>Në lojën gjuhësore zinxhir, aktivizohen të gjithë nxënësit/et me zgjedhimin e këtyre foljeve: kush gabon, i zgjedhon foljet me shkrim në fletore.</p> <p>Hapi i nëntë-punë e pavarur/vetë vlerësim//qortim /korrigjim</p> <p>Ushtrimi 3, 5, i punojnë nxënësit/et me gojë, qortojnë punën e njëri-tjetrit. Pastaj ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen përgjigjet e drejta të pohimeve të dhëna, sipas kërkesës.</p> <p>Hapi i dhjetë-punë e pavarur</p> <p>Ushtrimi 4 e punon një nxënës/e në dërrasë, gjen llojin e fjalive dhe thotë rolin e foljes jam komenton ato për kuptimin që shprehin.</p> <p>Ushtrimin 2 e punon e gjithë klasa me shkrim në libër (sipas kërkesës) Pastaj lexojnë disa nxënës/e fjalitë e ndërtuara me folje në mënyrën dëshirore..</p>	
<p>Zgjidhja e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1-kërkoj-kërkofsha-paca kërkuar; kap-kapsha-paça kapur; lë-lënça- paça lënë.</p> <p>Ushtrimi 2 U rritsh e u bëfsh njeri i drejtë! Paçim shëndetin, pa të tjerat shkojnë e vinë! Të këndoftë zemra e paç njëmijë të mira! Theftë qafën andej nga ka ardhur</p> <p>Ushtrimi 3. Pohim i saktë, vetëm i katërti.</p> <p>Ushtrimi 4. Fjali nxitëse, dëftore, dëshirore, dëftore, dëftore</p> <p>Ushtrimi 5. Bëfsha, marrsh, dalsh, vënçim, lënçi, shkofshin (fjali me to)</p> <p>Ushtrimi 6. Pohim i saktë; treshi, katra</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p>Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon foljet në mënyrën dëshirore dhe urdhërore, jep përkufizimin për kuptimin e tyre, zgjedhon foljet në këto mënyra, i përdor ato në fjali.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me letërsinë. - Me edukimin qytetar të nxënësit.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit; - Vlerësimin me notë në zgjidhjen e ushtrimeve gjuhësore me gojë, me shkrim. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrimi 5. (sipas kërkesës) - Plotëso faqen në fletën e verifikimit të kompetencave.

TEMA: FOLJET GJYSMËNDIHMËSE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Foljet gjysmëndihmëse		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Biseda; • Puna e pavarur. 	Fjalë kyçe: këpujore, gjysmëndihmëse, pjesore, emër prejfoljor asnjës	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë-stuhi mendimi

Mësuesi kërkon nga nxënësit të japin shembuj me llojet e kallëzuesit, që kanë mësuar në klasën e gjashtë: dy emra rrugësh, dy emra profesionesh, dy emra titujsh dhe shkruan në dërrasë disa prej tyre. Ndërkohë në një tabak të bardhë (powerpoint) ka përgatitur llojet e kallëzuesit:

KALLËZUESI

Emëror	Foljor
jam+emër	mund+folje në lidhore
jam+mbiemër	duhet+folje në lidhore
-jm+grup emëror	duhet+pjesore; do+pjesore
	-filloj, zë, nis+ folje në lidhore
	-vazhdoj+folje në lidhore.
	-mbaroj+emër prejfoljor asnjane

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë-pyetje përgjigje

Mësuesja kërkon përgjigjen e pyetjes, pasi të lexojnë informacionin që jepet në libër për foljet gjysmëndihmëse:

Japin shembuj të tjerë:

- Nënë Mara është shumë e dashur për nipërit e saj.
- Doktor Sandri është i zoti në profesionin e tij.
- Profesor Eqerem Çabej ishte i shquar në fushën e gjuhësisë.
- Muaji Maj është muaji më i bukur i pranverës.
- Romani “Kështjella”, është roman me temë historike.
- ...

Hapi i katërt- INSERT

Nxënësit lexojnë edhe shembujt e dhënë në libër dhe përforcojnë njohuritë për foljet gjysmëndihmëse. Plotësojnë tabelën e INSERTIT.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë-punë në grupe

Ushtrimin 1, nxënësit në grupe dyshe i plotësojnë në libër, pastaj me të gjithë klasën diskutohet cilat janë folje ndihmëse dhe gjysmëndihmëse, qortojnë punën e njëri – tjetrit.

Hapi i gjashtë-punë e pavarur

Ushtrimet 2, 3, i punojnë në fletore; dallojnë kur foljet janë të mirëfillta dhe kur gjysmëndihmëse. I ndajmë nxënësit në dy grupe. Lexojnë disa nxënës fjalitë, të tjerët vlerësojnë punën e tyre.

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimin 4 e punon e gjithë klasa me shkrim në fletore. Pasi mbarojnë, ndahet klasa në pesë grupe; brenda grupit kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, gjejnë gabimet. Çdo përfaqësues grupi jep rastet gabim që mund të kenë në grup dhe japin variantin e saktë, pasi e kanë korrigjuar.

<p>Zgjidhja e ushtrimeve: Ushtrimi 1; janë krijuar- ndihmëse; duhej luftuar-gjysmëndihmëse Ushtrimi 2; E fillove punën, çoje deri në fund.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kënga e saj vazhdoi e vazhdoi derisa u bë himn. ▪ Mbaron kjo punë ndonjëherë, apo jo?! ▪ Fillove të flasësh me zë të lartë, se s'ke argumente.. ▪ Nëna vazhdoi të këndonte ninullën me zë të ulët., ▪ Mbaroi së lari dhe së fshiri dhe doli në ballkon. <p>Ushtrimi 3. Je ti ajo që ke folur keq për mua?! Je e keqe dhe llafazane...!</p> <p>Ushtrimi 4. Vazhdon të kërkosh atë që s'të takon?</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Edhe unë mund të filloj punë së shpejti. ▪ Ouu, fillove të flasësh për gjëra pa rëndësi... ▪ Tani në fund të vitit nisa të aplikoj për studimet e larta. ▪ Do bërë puna me vullnet e përkushtim për sukses të plotë. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: <i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi njeh foljet gjysmëndihmëse, i dallon ato kur janë ndihmëse, kur janë folje të mirëfillta, kur janë gjysmëndihmëse, duke i përdorur ato në fjali.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon komunikimin.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim në situatën e të nxënit. - Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimeve me gojë e me shkrim. - Vlerësimi në detyrën e shtëpisë. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5 (sipas kërkesës).</p>

TEMA: PJESORJA DHE FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES

Fusha: Gjuha në përdorim	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> - Puna në grupe; - Biseda; - Puna e pavarur. - Teknika e pyetjeve 	Fjalë kyçe: Pjesore, paskajore, përcjellore, formë e pashtjelluar etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- pyetje përgjigje</i> Mësuesi parapërgatit nxënësit për format e pashtjelluara, duke përsëritur rrethorët që</p>				

shprehen me to: kërkon mes pyetjes; Çfarë janë fjalët me shkronja të kuqe?

- Pa aguar mirë dita, të rinjtë u mbloodhën në shesh. (mënyre)
- Ecte përmes serës me domate duke kënduar me zë të ulët. (mënyre)
- Duke luajtur me top, theu këmbën. (shkaku)
- Shkoi në Itali për të kryer studimet e larta. (qëllimi)
- Me të ardhur nëna, të gjithë iu hodhën në qafë. (kohe)
- Një të goditur shkopi në shkallë, ajo brofi te dera. (kohe)

Hapi i dytë-Pyetje përgjigje

Nxënësit analizojnë fjalët me të kuqe, thonë funksionin e tyre në fjali, që i kanë mësuar në klasën e gjashtë. Pse i quajmë forma të pashtjelluara? Si formohen ato?

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë-punë e pavarur/tabelë koncepti

Mësuesi aktivizon një nxënës të lexojë me zë informacionin që jepet për format e pashtjelluara. Analizojnë shembujt e dhënë në libër.

Hapi i katërt-punë në grupe

Klasa ndahet në grupe me nga 5 nxënës, kryetarët e grupeve japin përgjigjet e pyetjeve. Mësuesi plotëson përgjigjet, vlerëson, bën vërejtje për punën në grup të nxënësve:

- Si ndërtohen kohët e përbëra të foljeve?
- Cila pjesë ndryshon gjatë zgjedhimit në këto kohë?
- Cilat forma foljore quhen të pashtjelluara? Pse?
- Si e gjejmë pjesoren e foljes?
- Si ndërtohen format e pashtjelluara?
- Cilat janë funksionet e formave të pashtjelluara në fjali?

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë-punë e pavarur

Ushtrimin 1, 3, nxënësit i punojnë në grupe dyshe duke i plotësuar në libër sipas kërkesës. Këmbejnë librat me njëri- tjetrin, qortojnë gabimet. Përgjigjet i lexojmë para klasës (dallojnë format e pashtjelluara dhe i emërtojnë ato.

Hapi i gjashtë-punë e pavarur

Ushtrimin 2, 4, 5, 6, i punojmë me shkrim, rishkruajnë fjalitë sipas kërkesave, Mësuesi ndan klasën në pesë grupe, kontrollojnë punët brenda grupit dhe çdo përfaqësues grupi jep përgjigjet e sakta. Në fund mësuesi ndërhyr për saktësimin përgjigjeve.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Ngarkuar-pjesore; i ngarkuar-mbiemër; të lagura-mbiemër; lagur- pjesore; i mbyllur-mbiemër.

Ushtrimi 2. Derën e gjeta hapur; Shtëpia ishte larë e pastruar; Kjo poezi nuk është përkthyer mirë.

Ushtrimi 3. Pa marrë- forma mohore; për të kaluar-paskajore; duke ngrënë e duke pirë-përcjellore; për të rrëfyer-paskajore; duke shitur-përcjellore.

Ushtrimi 4. E mundonte veten duke menduar gjëra të pamundura.

- Duke ngritur një peshë të madhe, dëmtoi shtyllën kurrizore.
- Fëmija edukohet duke e afuar e mbajtur pranë për çdo problem.

Ushtrimi 5. Doli, por nuk e përcolli njeri.

<ul style="list-style-type: none"> ▪ Qëndronte i heshtur dhe nuk foli. ▪ Po s' u mendove mirë, nuk fitohet gjë. ▪ Duhej të mbërrinim para se të binte nata. ▪ Fliste edhe kur nuk na shihte në sy. <p>Ushtrimi 6. Njeriu bën gjithçka që të gjejë lumturinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të notuarit ndihmon që të kemi një jetë më të shëndetshme. ▪ Thoshte se nuk do të kthehej më në atë vend. ▪ Ankohej se duhej të bënte shumë detyra. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: <i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi dallon format e pashjelluara, i emërton ato, gjen funksionin e tyre në fjali, i përdor edhe vetë në fjali si rrethanorë.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon komunikimin.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim në situatën e të nxënit. - Vlerësim në punimin e ushtrimeve. - Vlerësimi në detyrën e shtëpisë. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7 (sipas kërkesës), .</p>

TEMA: LIDHËZAT

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lidhëzat.		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> - Puna në grup; - punë e pavarur; - Lojë gjuhësore. 	Fjalë kyçe: lidhëza bashkërenditëse, veçuese, kundërshtore, përmyllëse, nënrenditëse.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë-Plotësim me enigma fjalësh Nxënësit/et lexojnë tekstin në libër dhe vendosin lidhëzat që mungojnë, duke parë figurën (sipas njohurive që kanë marrë në klasën 6). - Dreni dhe gjyshja e tij po hanin akullore në park. (dy fjalë) - Pashë dicka të cuditshme kur po kthehesha në shtëpi (dy fjali) - Nuk kishte këmbë njeriu në rrugë, sepse ishte finalja e botërorit (dy fjali) - Pasi e plotësojnë nxënësit/et, mësuesi/ja prezanton në tabelë tekstin të shkruar në flipcart dhe bllafaqojnë punën e bërë, rumbullakosin lidhëzat. Hapi i dytë-tabelë koncepti/memorizim</p>				

Nxënësit/et dallojnë lidhëzat kur lidhin dy fjalë në fjalinë e thjeshtë, dy pjesë në fjalinë e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të formojnë përkufizimin për lidhëzat si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë-punë në grupe

Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe për t'u njohur me lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse. Punojnë në dy tabelat e llojeve të lidhëzave.

- Nxënësit/et përsëritin me njëri-tjetrin llojet e lidhëzave bashkërenditëse, pyesin njëri-tjetrin.

Hapi i katërt-lojë gjuhësore

Mësuesi/ja organizon lojën gjuhësore: thotë lidhëzën, nxënësi/ja gjen ç'lloj lidhëse është.

Aktivizon të gjithë nxënësit/et për të fiksuar 4 llojet e lidhëzave bashkërenditëse dhe 9 llojet e lidhëzave nënrenditëse.

Hapi i pestë- diktim

Ndalet tek drejtshkrimi i lidhëzave të përngjitura, i shkruajnë në fletore, duke i diktuar mësuesi/ja.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë-punë e pavarur

Mësuesi/ja punon bashkë me nxënësit/et ushtrimin 1, 3, dallojnë llojet e lidhëzave, dallojnë kur lidhëzat lidhin dy fjalë dhe kur lidhin dy fjali.

Hapi i shtatë- punë në grupe dyshe

Ushtrimin 2, 4, nxënësit/et i punojnë në libër në grupe dyshe, vendosin lidhëzat që mungojnë, qortojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi i tetë-punë e pavarur

Ushtrimin 5, e punon një nxënës/e në dërrasë, dallon në fjali llojet e lidhëzave që janë dhënë.(bashkërenditëse, nënrenditëse).

Ushtrimin 6 e punojnë me shkrim në fletore nxënësit e tjerë dhe lexojnë fjalitë që kanë shkruar sipas kërkesës. Qortojnë punën e njëri-tjetrit.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1; por, apo, dhe, sepse, dhe.

Ushtrimi 2. Sepse, që, as, as, por, prandaj, dhe, pra.

Ushtrimi 3. Bashkërenditëse: dhe, e, por, ndërsa, edhe, edhe, por.

Nënrenditëse: që, kur, kur, sesa,

Ushtrimi 4. Dhe- e thjeshtë; sepse- e përngjitur; që- e thjeshtë; dhe – e thjeshtë; që- e thjeshtë; dhe – e thjeshtë; prandaj- e përngjitur.

Ushtrimi 5. Që- mjet lidhës; as- bashkërenditje;që- mjet lidhës; por-bashkërenditëse; sikur-nënrenditëse; edhe-bashkërenditëse; që- mjet lidhës; dhe-bashkërenditëse; që-nënrenditëse.

Ushtrimi 6. Por, as; megjithatë, prandaj; kështu që, në rast se.(përdori në fjali).

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi dallon lidhëzat kur lidh dy fjalë dhe kur lidh dy, fjali.

Dallon lidhëzat bashkërenditëse shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse dhe nënrenditëse, (9 lloje) i përdor ato në fjali.

Burimet:

- libri i gjuhës shqipe, klasa VII,

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin;

<ul style="list-style-type: none"> fleta për verifikimin e kompetencave. 	- kompetenca digjitale.
Vlerësimi: <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi në situatën e të nxënit; Vlerësimin të punës në grup dhe gjatë lojës gjuhësore; Vlerësimi për punimin e ushtrimeve. 	Detyra dhe puna e pavarur: <ul style="list-style-type: none"> Grupi I: Ushtrimi 7, (sipas kërkesës). Grupi II: Prezantimi i njohurive për lidhëzat në Power-Point.

TEMA: PJESËZAT

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pjesëzat		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grupe dyshe; tabela e koncepteve; punë e pavarur. 	Fjalë kyçe: Pjesëzat, pohuese, mohuese, dëftuese, përforcuese, përfruese, dyshuese, zbutëse , etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë-punë në grupe Analizoni fjalitë në fragmentin e dhënë në libër, emërtojnë pjesët e ligjëratës në grupe dyshe: -dhe-lidhëz; Berti-emër; shoku-emër; im-përemër; më-pjesëz trajtformuese; i mirë-mbiemër; e-përemër vetor; kam njohur-folje; qysh-pjesëz përcaktuese; në- parafjalë; fëmijëri-emër, etj.</p> <p>Hapi i dytë-memorizim Nxënësit/e emërtojnë fjalët e tjera në fjalitë që janë dhënë fjalët: Kështu nxënësit/et formulojnë përkufizimin për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. (ndajfolje, parafjalë, lidhëz) Po pjesëza?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i tretë- shpjegim dhe tabelë koncepti Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër për pjesëzat, ndalen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> çfarë shprehin ato në fjali; sa llojesh janë ato sipas ngjyrimeve kuptimore; sa llojesh janë pjesëzat modale cilat janë pjesëzat emocionuese shprehëse sa llojesh janë ato sipas ndërtimit drejtshkrimi i pjesëzave të përngjitura. <p>Hapi i katërt- tabelë koncepti Nxënësit/et punojnë me tabelën për llojet e pjesëzave, i përsëritin në dyshe për të mbajtur mend sa më shumë pjesëza, pyesin njëri-tjetrin, duke i përdorur ato në fjali. - Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të plotësojnë në tabelë sa më shumë pjesëza për të tri llojet: - me ngjyrime kuptimore të përgjithshme: _____</p>				

-pjesëza modale: _____

-pjesëza emocionuese shprehëse: _____

- Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të përdorin në fjali disa prej pjesëzave, të cilat marrin kuptim kur përdoren në fjali.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë- puë n e pavarur

Nxënësit/et punojnë në libër ushtrimin 1, në grupe dyshe. Gjejnë pjesëzat

Pastaj mësuesi ndan klasën në dy grupe. Njëri grup përcakton llojin e tyre sipas kuptimit dhe grupi tjetër, sipas ndërtimit.

Qortohen gabimet që mund të kenë bërë.

Ushtrimi 2. Nxënësit/et vendosin pjesëza të tjera te ushtrimi 1, pa prishur kuptimin e fjalisë.

Kontrollojnë punën e njëri-tjetrit në grupe dyshe.

Hapi i gjashtë-

Ushtrimin 3 nxënësit e punojnë me shkrim në fletore, ndërtojnë pesë fjali me pjesëza që shprehin ngjyrimë kuptimore të përgjithshme dhe pesë me emocionuese shprehëse. Lexojnë disa nxënës fjalitë.

Ushtrimin 5 mësuesi/ja e punon me gojë, duke aktivizuar të gjithë nxënësit, dallojnë pjesëzat dhe llojet e tyre në pjesën e leximit “Kërcimtarja e Dukagjinit

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1. Sipas ndërtimit: gati, edhe, gati, madje, mbase, vetëm, vallë (të thjeshta) thuajse- e përngjitur;

- Sipas kuptimit: gati, thuajse, -përafruese; mbase, vallë-dyshuese; vetëm, madje, edhe-përforcuese;

Ushtrimi 2. Nxënësit/et vendosin pjesëza të tjera te ushtrimi 1, pa prishur kuptimin e fjalisë.

Gati-pothuajse; thuajse-pothuaj; edhe-sidomos; madje-bile; vetëm-veçse; mbase- u kushedi; vallë-ndoshta.

Ushtrimi 3. Qenkan shumë mollë, **pothuajse** 2-3 kilogramë!

Pikërisht, tani të nisemi për punë!

Pse u vonove? **Mos nuk** je mirë me shëndet?

E, **de**, dashke qiqra në hell tani në darkë, zotrote!

Seç desha të thosha dhe e harrova.

Ushtrimin 5. Nxënësit e punojnë në grupe dyshe; duke lexuar një fragment nga pjesa letrare “Kërcimtarja e Dukagjinit” gjejnë pjesëza dhe thonë ç’lloj janë.

Ushtrimin 6. Nxënësit përgatisin një fjalëkryq:

Pjesëza mohuese s’ e pashkurtuar (nuk)

Kur ikin prindërit në punë dhe ngelemi _____? (vetëm)

Si del shumësi i emrit dash? _____ (desh)

Nuk e kape fluturën _____? (dot)

I vendosin fjalët në fjalëkryq.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon pjesëzat, llojet e tyre sipas kuptimit që shprehin dhe sipas ndërtimit, dhe i përdorin ato në fjali.

Burimet:

- libri i gjuhës shqipe, klasa VII,

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin.

<ul style="list-style-type: none"> fleta për verifikimin e kompetencave. 	- kompetenca digjitale.
Vlerësimi: - Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit; - Vlerësimin në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim; - Vlerësimi për detyrën e shtëpisë.	Detyra dhe puna e pavarur: -Gr.1- Ushtrimi 4, (sipas kërkesës) . Gr. 2- Prezantimi para klasës i njohurive për pjesëzat në Power Point.

TEMA : PASTHIRRMAT

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Morfologji	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pasthirrma.		Metoda e teknika: - Puna në grupe dyshe; - tabela e koncepteve; - punë e pavarur.	Fjalë kyçe: Pasthirrmë, emocionale, nxitëse, tingull, imitime	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë-DLTA. pyetje përgjigje Lexon mësuesi pjesën “Gjahu i malësorëve” të K.Kristoforidhit, ose e ka të incizuar nga interpretimi i një nxënësi të klasës, me ngarkesë emocionale: -Ç’muaj është tani?/-Janar./-Sa ka muaji sot?/-Sot ka pesëmbëdhjetë ditë./-A dalim nesër për gjah?/-Me të vërtetë?/-Po, besa./-Në c’ anë?/-Vemi në mal të Tomorit. -Po, atje të vmë të gjuajmë, sepse atje ka mjaft egërsira. Atje ka bisha, atje ka edhe dërra të egër e ujç, e cakej, e arusha, e drerë, e kaproj, e dhi të egra, e dhelpra e lepuj. Atje ka edhe thëllëza mali... ... -Fort mirë, o zotëri, kështu kemi për të bërë./-Bëfshi natën e mirë, o shokë! -Tungjatjeta! Tungjatjeta!/Të nesërmen vijnë gjahtarët dy e nga dy e tre e nga tre e mblidhen në kodrën e kuqe./-Mirëmëngjes! Mirëmëngjes!/- Mirë se ardhët! Mirë se ardhët! - C’kohë është?/- Është natë, do edhe shumë të gdihet.S’ka zbardhëlluar, po këndojnë gjelat. - Ja tk po vijnë gjithë gjahtarët/- Si u gdhitë?/- Mirë, mirë. Po zotëria juaj?/- Mirë/- S’paska ardhë Mark Shalëgjati?/- Ja tek po vjen./- Mirëmëngjes, o gjahtarë./- Mirë se erdhe, o zotëri! - A jeni mbledhë të gjithë?/- Po, zotëri, të gjithë këtu jemi./- A jni gati, o burra shqiptarë?/- pyet Mark Shalgjati./- Po, gati jemi./- Lëshoni qentë e langonjtë të prijnë përpara, bëhuni varg dy e nga dy e shpejtoni këmbët të zëmë malin pa zbardhur dita./- Udhë të mbarë! Udhë të mbarë!/- A s’ma këndonin një këngë, o djem të rinj, të ndihemi të gjallë tek shkojmë udhës, - thotë Mark Shalëgjati./- C’këngë të zëmë?/- thonë djemtë./- Le ta këndojmë këngën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut./- Me zë të lartë e të hollë, që të ulërijë dhe e të gjëmojnë malet. Djemtë zënë e këndojnë./- Ashtu, pra, ju lumtë goja, o djem, e u hëngërshim dasmat! Këndoni dhe shpejtoni këmbët, se arritëm, s’mban edhe pakëz dhe zëmë rrëzën e malit. - Qëndroni aty, o burra shqiptarë, se arrimë. Rrini përdhe e prehuni pakëz, se tashti po zëmë e po gjuajmë. ... - Shkoni , pra i zini pritë e mos luani vendit fare, qëndroni si burra të fortë, gjuani si gjahtarë të mirë, armët mos i nxini./Ty, ty, ty! Ty, ty, ty! Ty, ty, ty! -bie trumbeta e birit. Ha, ha, ha! Ha, ha, ha! Ha, ha, ha! – ndërsejnë qentë/Kam, kam, kam! Kam, kam, kam! Kam, kam, kam! – lehin qentë./Taf, tuf! Taf, tuf! Taf, tuf! – kërcasin pushkët. - Prite, o Nikollë, se po vjen një derr i madh që m’i ka dhëmbët një pëllëmbë jashtë nofullave.Vëre pushkën në sy, shënoje mirë. Bjeri në lule të ballit. A e vrave? Të lumtë! - Prite, o Andre, se të doli përpara një ujç./Taf! I ra ujçut në ije dhe plumbi e shpoi tejpertej.</p>				

.../-Sa mira ia bënë atij ujku që na hante dhentë!.../- Prite, o Toskë atë dhelpër, se e kanë vënë përpara qentë e po ta bien drejt./Taf! –qëllon me pushkë Toska, po i shkon plumbi dëm, s’ e godit dot, sepse dhelpëra bëri dredha e ndërroi udhën./-Ah, e mallkuar!- thotë Toska, - se ma la pushkën në faqe pa e vrarë dot./- Bjeri ti, o Gegë, asaj dhelpëre!./Taf!- qëllon Gega mbi dhelpëren e i këputi bishtin plumbi, po se vrau dot./- Ah, ajo dinakja që na vjedh pulat natën, si më turpëroi pushkën!-thotë Gega./- Prite ti, o Arbër, atë dhelpër se po të shkon pranë./Ah, në të lënca gjallë unë ty!-thotë Arbëri dhe e qëllon me pushkë në kokë./- Të lumtë, o Arbër, se na e zbardhe faqen. – thonë shokët./Kur vijnë gjahtarët ta marrin, tek dergjej përdhe, ajo u ngrit njëherësh në këmbë dh iku m vrap, sepse bënte sikur kishte ngordhur./- Bini, o gjahtarë, bini, o gjahtarë se u turpëruam./Taf, tuf! Taf, tuf! Qëllojnë me pushkë të gjithë gjahtarët dhe e vrasin./Ty, ty, ty! Ty, ty, ty! Ty, ty, ty!/- Lini pushkët e mos gjuani më, o gjahtarë!- urdhëron Mark Shalëgjati.

-Mjaft më, se u ngrys e po na zë nata këtu në pyll.Mblidhni gjahun që kemi vrarë.... Si tëvemë në shtëpi, atje do të ndajmë gjahun, të hedhim short e të marrë secili pjesën që t’i bjerë e të vejë në shtëpi të tij, të hajë e të pijë, të bëjë zemrën e mirë.

(Kostandin Kristoforidhi “Gjahu i malësorëve”)

Hapi i dytë-Punë e pavarur

Nxënësit/et dallojnë pasthirmat, ku qëndrojnë ato në fjali, ç’ marrëdhënie shprehin.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë-tabelë koncepti/shpjegim

Nxënësit/et njihen me informacionin e dhënë në libër për pasthirmat dhe përgatisin pyetje për çështjet kryesore:

- Cili është kuptimi i pasthirmave?
- Ku qëndrojnë zakonisht ato në fjali?
- Cilat janë pasthirmat emocionale?
- Cilat janë pasthirmat nxitëse?
- Cilat janë onomatopetë?
- Drejtshkrimi i pasthirmave të përngjitura

Hapi i katërt-punë në grupe

Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe me pyetjet, provojnë t’u përgjigjen. Pastaj lexojnë pyetjet disa nxënës/e dhe disa të tjerë, u përgjigjen.

Hapi i pestë-tabelë koncepti

Nxënësit/et punojnë me tabelën për ndarjen e pasthirmave në tre grupe, i dallojnë ato nga njëra-tjetra.

Hapi i gjashtë- diktim dhe punë ne pavarur

Mësuesi/ja punon me nxënësit/et për të drejtshkruar disa nga pasthirmat e përngjitura; i dikton ato dhe nxënësit i shkruajnë në fletore. Kontrollon punën e njëri-tjetrit dhe gjejnë gabimet.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimet 1, 2, nxënësit/et i punojnë me gojë, lexojnë fragmentet e dhëna me intonacionin e duhur, dallojnë pasthirmat dhe tingullimitimet.

Hapi i tetë- punë në grupe

Ushtrimin 3, e punojnë nxënësit/et në libër, në grupe dyshe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Pasthirmat emocionale: obobo, ububu, pupupu, uh, ah, iii

Pasthirmat nxitëse; shëët, sus; mirëdita, more, lamtumirë, o burra, mirë se erdhe, tungjatjeta, faleminderit,

<p>Tingullimitime: taf- taf; hi- hi; ku-ku-ku; hs-hs-hs.</p> <p>Hapi i nëntë-punë e pavarur</p> <p>Ushtrimet 5, 7, i punojnë me shkrim në fletore, të ndarë në dy grupe. Lexojnë disa nxënës/e punimet e tyre, mësuesi/ja kontrollon edhe drejtshkrimin e pasthirmave në fjalitë e nxënësve.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p>Përdorimi i drejtë i gjuhës: nxënësi/ja dallon pasthirrat, jep përkufizimin për to dhe kuptimin që shprehin ato në fjali. I përdor ato në fjali.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> libri i gjuhës shqipe, klasa VII fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillon komunikimin; kompetenca digjitale.
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> vlerësimi në punën në grupe dyshe; vlerësimi me gojë dhe me shkrim për punët në klasë e shtëpi, individualisht. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <ul style="list-style-type: none"> Grupi I: Ushtrimi 4 (sipas kërkesës). Grupi II: Prezantimi i njohurive për pasthirrmën në Power-Point.

6. SINTAKSË

TEMA: LLOJET E FJALIVE TË PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grupe; Teknika e pyetjeve; Punë e pavarur. 	Fjalë kyçe: Fjali e përbërë, bashkërenditje; shtuese, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</p> <p>Hapi i parë- punë e pavarur</p> <p>Mësuesi shkruan në dërrasë fjalitë dhe kërkon që nxënësit të dallojnë foljet në çdo fjali: Tringës i vdes vëllai i sëmurë / dhe ajo del për të luftuar në vend të tij. Mbron nderin, pragun, bukurinë e vet. Trimëria e atdhetaria deri në flijim janë bashkuar / e lidhen me një orkestrim të habitshëm e të magjishëm të natyrës. Tringa, në botën poetike të Fishtës, i dorëzohet jo vdekjes, po pavdekësisë.</p> <p>Hapi i dytë- analizë /bashkë bisedim</p> <p>Nxënësit me ndihmën e mësueses analizojnë fjalitë, gjejnë foljet: për fjalinë e dytë folja kallëzues shoqërohet nga tre kundrinorë homogjenë. Nxënësit dallojnë te fjalja e tretë se dy kallëzuesit janë homogjenë, pasi kanë të përbashkët edhe kryefjalën, edhe kundrinorin me parafjalë (me një orkestrim të habitshëm), Pra, janë tri fjali të thjeshta</p>				

dhe një fjali i përbërë me bashkërenditje.(fjalia e parë)

Hapi i tretë-analizë dhe përkufizim

Duke analizuar fjalitë, nxënësit thonë përkufizimin për fjalinë: si një tërësi fjalësh a një fjalë të bashkuar rreth kallëzuesit që na japin një informacion dhe kanë intonacion të përfunduar.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i katërt-shpjegim dhe reflektim

Nxënësit lexojnë 5' informacionin që jepet në libër për fjalitë e përbëra me bashkërenditje. Njohuritë që jepen, nxënësit i shprehin me pyetje (në grupe dyshe).

- Si janë pjesët me njëra-tjetrën në fjalitë me bashkërenditje?
- Në sa grupe i ndajmë fjalitë e përbëra me bashkërenditje?
- Si i dallojmë fjalitë e përbëra me bashkërenditje nga njëra-tjetra?
- Cilat janë lidhëzat që lidhin dy pjesët e bashkërenditura?
- Si i dallojmë për nga kuptimi katër llojet e bashkërenditjes?

Hapi i pestë-pyetje përgjigje

Nxënësit i lexojnë pyetjet që kanë formuluar dhe u përgjigjen atyre duke dhënë shembujt e librit.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë-Punë me grupe

Ushtrimin 1, e punon me gojë. Nxënësit pasi lexojnë fjalitë nënvizojnë foljet kallëzues dhe dallojnë fjalinë e përbërë: Ata mund të flisnin me njëri-tjetrin për ato që kishin për të studiuar.

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimet 1, 3, 2, 4, i punojnë në libër me grupe dyshe, (gr.A, ush. 1, 3; gr.B, ush.2, 4) këmbëjnë librat dhe qortojnë gabimet e njëri- tjetrit. Edhe mësuesja kontrollon punën e tyre.

Hapi i tetë-punë e pavarur

Ushtrimi 6 e punon me të gjithë klasën, nxënësit ndryshojnë rendin e pjesëve të bashkërenditura, atje ku mundet.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1; shtuese, kundërshtore, kundërshtore, shtuese, shtuese, veçuese.

Ushtrimi 2; por, dhe, por, jo vetëm...por edhe, ose... ose,

Ushtrimi 4; Zuri të bjerë shi dhe unë nuk kam marrë çadër (shtuese)

- Arbëri duket i mërzitur, kurse të tjerët flasin e qeshin (kundërshtore)
- Nuk kam shumë kohë, megjithatë do bërë kjo punë (kundërshtore)
- Duhet të nxitojmë, ose do të mbetemi pa vend. (veçuese)
- Duam të blejmë një shtëpi të re, por nuk po shitet e vjetra.(kundërshtore)

Ushtrimi 3; Mirë punon, por flet shumë.

- Më falënderoi për punën dhe më buzëqeshi.
- Ose luajmë me shah, ose shkojmë në teatër.
- As e kam me vete, as nuk e dëshiroj një gjë të tillë.
- Jo vetëm që nuk më falënderoi, por as nuk më përshëndeti.

Ushtrimi 5; Kam uri, prandaj do të doja të haja diçka, por frigoriferi është bosh.

- Bën shumë vapë dhe netëve mezi fle, prandaj më del gjumi herë pas here.
- Qyteti ka trafik të mbingarkuar, prandaj për këmbësorët nuk ka kujdes, kurse

për çiklistët jo e jo.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje. Formulon përkufizimin për to, jep shembuj me fjali të përbëra me bashkërenditje shtuese, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> libri i gjuhës shqipe, klasa VII, fleta për verifikimin e kompetencave. 	Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Zhvillon komunikimin;
Vlerësimi: <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim në situatën e të nxënit. Vlerësim në punimin e ushtrimeve me gojë e me shkrim. Vlerësimi në detyrën e shtëpisë. 	Detyra dhe puna e pavarur: Gr.1 -Ushtrimi 5 (sipas kërkesës). Gr. 2- Gjeni 8 fjali të përbëra me bashkërenditje (dy për çdo lloj) në pjesën e leximit _____, shkruaji në fletore.

TEMA: FJALITË E PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE E NËNRENDITJE

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje e nënrenditje		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grupe; Di/dua të di/mësoj. Punë e pavarur. 	Fjalë kyçe: fjali e përbërë me bashkërenditje, nënrenditje, lidhëza bashkërenditëse, nënrenditëse.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- tabelë koncepti</i> Mësuesja shkruan në tabelë fragmentin dhe kërkon që nxënësit të në nënvizojnë foljet dhe të thonë se sa folje dhe sa fjali ka në çdo periudhë: Nëntë plagë kishte në trup trimi Gjergj Elez Alia, kështu që prej nëntë vjetësh dergjej në shtrat. Armët e Gjergjit rrinin varur në mur. E motra i rrinte te koka dhe ia lante plagët me ujët e gurrës, ia shpëlante me lotët e syve e ia thante me flokët e ballit. Ah, ç'plagë të rënda kishte marrë! Qysh i duronte nëntë dhembje plagësh njëherësh?!</p> <p><i>Hapi i dytë-ndërtim skema fjalish</i> Mësuesi kërkon nga nxënësit të gjejnë foljet, të rrumbullakosin lidhëzat, sipas llojit të lidhëzave përcaktojnë llojin e fjalive: të thjeshta, me bashkërenditje, me nënrenditje. Mësuesi i paraqet fjalitë me skema që t'i shpjegojë ato dhe nga kuptimi.</p>				
P.K	P.K	E motra i rrinte te koka dhe ia lante plagët me ujët e gurrës.		

K.K

pjesë kryesore: (Nëntë plagë kishte në trup Gjergj Elez Alia.)

P.V

pjesa e varur: (*kështu që* prej nëntë vjetësh dergjej në shtrat.)

Fjali e thjeshtë: (Ah, c'plagë të rënda kishte marrë!)

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë- shpjegim/di dua të di mësova

Mësuesi shpjegon informacionin mbi fjalitë e përbëra

. Një nxënës lexon me zë informacionin që jepet në libër për fjalitë e përbëra.

- me bashkërenditje
- me nënrenditje
- a) shtuese (pjesët radhiten, shtohen njëra pas tjetrës)
- b) veçuese (pjesët përjashtojnë njëra- tjetrën)
- c) kundërshtuese (pjesë e dytë kundërshton të parën)
- d) përmbyllëse (pjesa e dytë përmbledh kuptimin e fjalisë)

Hapi i katërt-punë e pavarur

Mësuesi për fjalinë me nënrenditje diskuton me nxënësit shembujt që jepen në libër për të shpjeguar te nxënësit se pjesa e varur nuk mund të qëndrojë pa pjesën kryesore.

Mësuesi na këshilloi *që* të punojmë më shumë. (qëllimore)

Nëse nuk mësojmë, kufizojmë mundësitë tona. (kushtore)

Mësuesin *që* na dha këtë këshillë, e respektoj shumë. (përcaktore)**Hapi i pestë-di dua të di/mësova**

Mësuesi kërkon nga nxënësit të punojnë me teknikën ‘Di/ dua të di/ mësoj’

Di	Dua të di	Mësoj
Fj.e thjeshtë ka vetëm një folje.	Çfarë të kuptoj me njësi kallëzuesore?	Kur është fjalia e thjeshtë, kur është e përbërë.
Fj.përbërë ka më shumë se një folje...	...	Çfarë shprehin FPB dhe FPN.
F.P ndahet në FPB dhe ...		Cilat janë lidhëzat dhe mjetet lidhëse që lidhin pjesët....

1. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**Hapi i gjashtë-punë në grupe**

Ushtrimin 1 e punojmë me gojë, aktivizohen disa nxënës, dallojnë fjalitë e thjeshta dhe të përbëra

Hapi i shtatë-punë në grupe dyshe

Ushtrimin 2, 3, 5 nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe. Këmbejnë librat, kontrollojnë punën e njëri- tjetrit, qortojnë gabimet, argumentojnë përmbajtjen e tyre, duke ndërhyrë mësuesja.

Hapi i tetë-rrjet diskutimi


Mësuesja e ndan klasën në dy grupe sipas rreshtave.

Grupi I- ushtrimi 4

<p>Grupi II- ushtrimi 6</p> <p>Pasi mbarojnë grupet (me shkrim në fletore), një nxënës për çdo grup jep përgjigjen e ushtrimeve. Mund të lexojnë përgjigjet disa nxënës, të tjerët vlerësojnë punën e shokëve.</p>	
<p>Zgjidhja e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1; e thjeshtë, e përbërë me nënrenditje, e thjeshtë, e përbërë, e përbërë, e përbërë.</p> <p>Ushtrimi 2; Kolonistët hynë në shpellë, ku u duhej të ecnin me kujdes.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sipërfaqja e tyre ishte e rrëshqitshme dhe nisën të kërkojnë thesarin. ▪ Kalimi zgjerohej gjithnjë e më tepër dhe dilte në një shpellë të madhe. ▪ Shpella ishte shumë e mirë për ta përshtatur për banesë. (e thjeshtë) ▪ Ai mbolli rrëzë murit bimë kacavjerrëse, të cilat më vonë u rritën e u hijeshuan. <p>Ushtrimi 3; e thjeshtë, e thjeshtë, e thjeshtë, e përbërë me nënrenditje, e thjeshtë, e përbërë me bashkërenditje.</p> <p>Ushtrimi 5; Kam humbur autobusin, prandaj do të mbërrij me vonesë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • (bashkërenditje) • Nuk po ha shumë, sepse jam shëndoshur pa masë.(nënrenditje) • Kishte rënë telefoni, por unë nuk e kisha dëgjuar. (bashkërenditje) 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p>1. Nxënësi dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje me anë të lidhëzave, por edhe nga kuptimi që shprehin, dallon fjalitë nënrenditëse mbi bazën e varësisë të pjesës së varur nga kryesorja. Formon vetë fjalitë me bashkërenditje e nënrenditje me dy pjesë</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon komunikimin;
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim në veprimtari me situatë. - Vlerësim me zgjidhjen e ushtrimeve me gojë e me shkrim. - Vlerësimi në detyrën e shtëpisë. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <p>Ushtrimi 7 (fjalitë t'i shkruajë në fletore).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezanton në Power Point mësimin për llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje e nënrenditje.

TEMA: KRYEFJALA

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kryefjala		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Tabela e koncepteve; 	Fjalë kyçe: kryefjala, pyetja, me se shprehet, gjymtyrë	

	<ul style="list-style-type: none"> • Loja gjuhësore; • Puna e pavarur. 	kryesore.								
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit										
<p>3. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë- kllaster Në dërrasë mësuesi vizaton një lule me pesë petale, në qendër të lules shkruan një folje, p.sh. punon dhe nxënësit shtojnë kryefjalë të ndryshme: (emër, përemër, GE, numëror, emër i pashquar) i përdorin në fjali.</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p>Hapi i dytë- memorizim koncepti Nxënësit kanë njohuri për kryefjalën, prandaj formulojnë përkufizimin për të: Është gjymtyrë kryesore e fjalisë, e cila gjendet duke iu drejtuar foljes me pyetjet kush?, cili?, cila?, cilët?.</p> <p>4. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i tretë-Pyetje /përgjigje Nxënësit komentojnë figurën, japin përgjigjet e pyetjeve, gjejnë kryefjalën. Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe punojnë me informacionin në libër: në çdo rast të kryefjalës shkruajnë me se është shprehur: me emër, përemër, grup emëror. Mësuesja u jep grupeve tabelën e koncepteve, e plotësojnë:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;">Kryefjala</th> <th style="width: 25%;">Shprehet</th> <th style="width: 25%;">Pyetja</th> <th style="width: 25%;">Rendi i saj në fjali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="height: 40px;"></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Hapi i katërt-punë në grupe Një përfaqësues grupi, që mbarojnë më shpejt, lexon çfarë kanë përgatitur për kryefjalën dhe nënvizojnë se kryefjala:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shprehet edhe me pjesë të emëruara, - Kur mungon në fjali, ajo nënkuptohet, - Formon grupin emëror në fjali, - Zakonisht qëndron në krye të fjalisë, por edhe lëviz. - Kryefjala dhe kallëzuesi përshtaten në vetë dhe numër. <p>Fillon diskutimi: grupet e tjera japin mendimet e tyre për punën e prezantuar, plotësojnë, argumentojnë duke dhënë shembuj të tjerë.</p> <p>5. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Hapi i pestë-punë në grupe Nxënësit në grupe dyshe punojnë në libër, plotësojnë me laps përgjigjet e ushtrimeve 1, 2, 4. Pastaj këmbëjnë librat e kontrollojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.</p> <p>Hapi i gjashtë-punë e pavarur Ushtrimi 3 punohet me shkrim në fletore; shkruajnë fjali sipas kërkesës. Këmbejnë fletoret</p>			Kryefjala	Shprehet	Pyetja	Rendi i saj në fjali				
Kryefjala	Shprehet	Pyetja	Rendi i saj në fjali							

dhe lexojnë fjalitë që kanë formuar. Edhe vetë nxënësit vlerësojnë punën e tyre.	
Zgjidhja e ushtrimeve:	
Ushtrimi 1. Kjo punë-GE; tërë pasditja-GE; qielli- emër; qeni i tij- GE; ata- përemër; asnjëra prej tyre- GE; kush- përemër; njeri- emër i pashquar.	
Ushtrimi 2. Kur dal nga apartamenti, unë gjithmonë e mbyll derën dy herë. Kësaj radhe e gjeta të shtyrë dhe kjo më bëri përshtypje. Mendova që do të kishte hyrë zonja e shtëpisë për të më sjellë korrespondencën. Unë hyra. Zjarri ishte akoma i ndezur dhe e ndriçonte paksa apartamentin. Unë mora një qiri dhe shkova ta ndez në vatër.	
Ushtrimi 3. Kënga është shpirti i një populli. Këndoi këngën për kurbetin. Mendimi i drejtë përkrahet nga të gjithë. Dëgjoi mendimet e shokëve. E diela është plot gjallëri e lëvizje. Kaloi të dielën pranë fëmijëve. Ata ndërtuan një shtëpi të re. Shtëpia u kushtoi atyre shumë shtrenjtë.	
Ushtrimi 4. Askush nuk dërgon më kartolina me postë. Dikush e hapi derën. Të gjithë nxënësit janë të talentuar. Erdhi drejtori në shkollë. Mbrëmë pashë filmin në kinema.	
Ushtrimi 5. U ul në një stol dhe një kalimtar e përshëndeti.	
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kalimtari më njohu, por unë nuk e njoh. ▪ Asnjë fjalë e tij nuk më bëri përshtypje. ▪ Fjala është gjysma e bukurisë së njeriut, prandaj flisni ëmbël. ▪ Ky mendim është i mençur. ▪ Mendimi jepet pas shumë studimesh e kërkimesh. ▪ Një tufë zogjsh u ngrit nga pylli me pisha. ▪ Zogjtë janë shpendë të bukur, por edhe të dobishëm. 	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:	
<i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi/ja dallon kryefjalën në fjali me anë të pyetjeve kush?, cili?, thotë me ç’ mjete gjuhësore shprehet, pozicionin që zë ajo në fjali, krijon fjali me kryefjalë me grup emëror, me emër të shquar, të pashquar, me përemër.	
Burimet:	Lidhja me fushat e tjera:
<ul style="list-style-type: none"> • libri i gjuhës shqipe, klasa VII, • fleta për verifikimin e kompetencave. 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon komunikimin. - Kompetenca digjitale.
Vlerësimi:	Detyra dhe puna e pavarur:
<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim në situatën e të nxënit. - Vlerësim me gojë e me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve. - Vlerësimi në detyrën e shtëpisë. 	<p>Grupi I: Ushtrimi 5 (sipas kërkesës).</p> <p>Grupi II: Prezanton me Power Point njohuritë për kryefjalën</p>

TEMA: KALLËZUESI FOLJOR I THJESHTË DHE I PËRBËRË.

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore:		Metoda e teknika:	Fjalë kyçe:	

Kallëzuesi foljor i thjeshtë dhe i përbërë.	<ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Tabela e koncepteve; • Puna e pavarur. 	kallëzues foljor i thjeshtë, i përbërë, grupet e domosdoshme.
---	--	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë-ptp


Mësuesi vizaton dy lule dhe në mesin e njërës vendos emrin nëna, kurse te tjetra vendos foljen punon, (ose t'i përgatisë me një tabak të bardhë)dhe kë rkon që nxë në sit të shkruajnë fjali duke i përdorur ato dy fjalë

Hapi i dytë-punë në grupe

I ndan nxënësit në dy grupe:

Grupi 1. T'i shtojnë kryefjalës sa më shumë kallëzues

Grupi 2. T'i shtojnë kallëzuesit sa më shumë kryefjalë (që të lidhen kuptimisht me fjalën e dhënë; Nëna përgatit, shkon, mëson, këndon, gatuan, lan, shëtit etj. Punon babai, nëna, mekaniku, inxhinieri, makina, bujku, etj.



Këtë mund ta organizojmë si lojë gjuhësore; dalin nxënësit njëri pas tjetrit në tabelë, kush mbaron më shpejt dhe më saktë, fiton lojën (foljet mund të përdoren në të gjitha kohët e mënyrat (emri edhe në trajtën e pashquar).

Hapi i tretë-Pyetje përgjigje

Nxënësit rikujtojnë kryefjalën dhe kallëzuesin që kanë mësuar në klasën e 6-të

- Me ç'pyetje i gjejmë?
- Me se shprehen?
- Rendi i tyre në fjali?
- Sa llojesh është kallëzuesi?

3. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i katërt-koment dhe shpjegim njohurish

Nxënësit bashkë me mësuesin komentojnë figurën, mund të japin disa fjali me lloje kallëzuesish, kryesisht kallëzues foljorë të thjeshtë dhe të përbërë.

Hapi i katërt-punë në grupe dyshe

Një nxënës lexon me zë llojet e kallëzuesve që jepen në libër dhe më tej, në grupe dyshe i thonë njëri – tjetrit përkufizimin për kallëzuesin. Pastaj e thonë disa nxënës para klasës.

Hapi i pestë- shpjegim

Mësuesi bën kujdes të qartësojë lidhjet e kallëzuesit me grupet e domosdoshme në fjalinë e thjeshtë dëftore:

-Kallëzues që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinorë (folje kalimtare).

- Kallëzues që kërkojnë kryefjalë dhe nuk marrin kundrinorë(folje që shprehin lëvizje).
- Kallëzues që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë.
- Kallëzues që nuk pranojnë as kryefjalë, as kundrinorë. (folje pavetore).

Hapi i gjashtë-punë në grupe dyshe

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të japin shembuj me fjali të ngjashëm me ato tël ibrit.

Pra, që kallëzuesia në fjali të jetë e plotë, duhet të plotësohet me gjymtyrë të domosdoshëm. (shkruhet në dërrasë, nxënësit e shkruajnë në fletore, ose në libër).

4. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimet 1, 3, i punojnë në libër, plotësojnë në grupe dyshe tabelat për gjymtyrët e domosdoshëm dhe jo të domosdoshëm. Diskutojnë rreth tyre.

Hapi i tetë- punë e pavarur

Ushtrimi 6 e punon një nxënës në dërrasë ; nxënësi shkruan fjalitë dhe në fund shpjegon pse thjeshtoi gjymtyrët e fjalive që të ruhet kallëzuesia.

Hapi i nëntë- punë në grupe

Ushtrimin 2, 4, nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre dhe ndalet në dallimin e kallëzuesit të thjeshtë nga ai i përbërë

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1.

Kryefjalë	Kallëzues	Kundrinor i drejtë	Kundrinor i zhdrejtë
Fëmijët	përshëndetën	Nënë	
Unë	lexova	Një libër të ri	
Gerta	i dërgoi	librin	Vëllait
Ana	lau	Rrobat	
Fëmija	qante		
-	bubullin	-	-
Sportistët	u dhuruan	uniformat	fëmijëve
Unë	takova	mësuesen time	

Ushtrimi 2. Kallëzues të thjeshtë: do ta mundë; do ta shpinit; do të zgjedhë; ka për të zgjedhur; do të shembet.

Kallëzues të përbërë: mund ta lini; duhet ta ushqeni; mund ta jetojë; do bërë; duhet të jenë; duhet të kenë.

Ushtrimi 4. Jam duke bërë; shkruani; ka kthyer;menduakan, flini; pa ardhur; të ishin; kam për të bërë; me të zbardhur dita; zhurmon.

Ushtrimi 5. Nuk duhet të kalosh me semafor të kuq.

Duhet t'i lash dhëmbët çdo mbrëmje.

Duhet të jesh I sjellshëm me të gjithë.

Ushtrimi 6. Takova një shoqe. Nëna thurte triko. Ç'po bën? Bubullinte.

Ushtrimi 3.

		Kallëzues		
Në mëngjes	fëmijët	përshëndetën	nënë	me dashuri

Në mbrëmje	-	pyeta	vëllanë	për detyrat
ga celulari	Adi	I dërgoi	një mesazh	shokut
Në drekë	Besa	lau	enët	me përtesë
Natën	-	Bubullin	-	-
Pas ndeshjes	lojtarët	u dhuruan	uniformat	fëmijëve
Në rrugë		Takova	dajën	
-	Nëna	qante	-	për djalën e saj

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:
Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi dallon kallëzuesin në fjali me anë të pyetjeve ç'bën?, ç'bëjnë?. Dallon llojet e kallëzuesit foljor të thjeshtë dhe të përbërë, i përdor ato në fjali.

Burimet: <ul style="list-style-type: none"> libri i gjuhës shqipe, klasa VII, fleta për verifikimin e kompetencave. 	Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Zhvillon komunikimin. Kompetenca digjitale.
Vlerësimi: <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim në situatën e të nxënit. Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimeve me gojë e me shkrim. Vlerësimi në detyrën e shtëpisë 	Detyra dhe puna e pavarur: Gr.1- Ushtrimi 5 (sipas kërkesës) Gr. 2- Prezanton me Power Point njohuritë për kallëzuesin.

TEMA: PËRSHTATJA E KRYEFJALËS ME KALLËZUESIN

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grup; Teknika e pyetjeve; Puna e pavarur. 	Fjalë kyçe: Përshtatje në vetë, në numër, kallëzues foljorë, emëror..	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë-punë e pavarur/stuhi mendimi Mësuesi shkruan në tabelë fjalitë më poshtme. Kërkon Nga nxënësit të dallojnë se çfarë janë fjalët e shkruara me ngjyrë tjetër dhe ç'lidhje kanë ato me njëra-tjetrën. Fusha dhe ledhi ishin mbuluar nga gjelbërimi. (folja në shumës, veta, III) Jo vetëm lulet, por edhe bari kishin lulëzuar. (folja në shumës veta, III) Unë me vëllanë ishim të gëzuar që po prisnim gjyshen. (shumës, veta, I) Në qiell nisën të fluturonin <u>disa re si togje pambuku.</u> (veta 3, shumës) Në qiell nisi të fluturonte <u>një re e murrme.</u> (veta 3, njëjës) Në shtëpi nuk po ndihej as zhurmë, as lëvizje. (veta 3, njëjës)				

Si unë, si nënë e dimë nga na erdhi kjo pako. (veta 1, shumës)

Ju jeni i shkathët dhe do ta kryeni në kohë misionin. (ju për ti, në shenjë respekti)

Hapi i dytë-punë e pavarur. punë në grupe dyshe

Të gjitha fjalitë e mësipërme, nxënësit i analizojnë për lidhjen kryefjalë-kallëzues (përshtatja në numër, vetë) Nxënësit fjalitë i shkruajnë në fletore, bashkë me shpjegimet që jep mësuesi për çdo rast. Emërtojnë llojet e kallëzuesve

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë-shpjegim/insert/

Mësuesi shpjegon mësimin e ri. Një nxënës lexon me zë informacionin që jepet në libër për përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin. Nxënësit e rilexojnë duke plotësuar tabelën:

+	v	-	?
---	---	---	---

Hapi i katërt-punë në grupe dyshe

Punojnë për 10 minuta me njëri tjetrin në bankë. Udhëzohen nga mësuesja të ndalen në:

- a- Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin e thjeshtë foljor;
- b- Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin e përbërë;
- c- Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin emëror.

Pyesin njëri-tjetrin për rastet me fjali në libër dhe japin shembuj të tjerë të ngjashëm me ta.

Hapi i pestë-punë në grupe

Mësuesi e ndan klasën në pesë grupe. Brenda grupit ndërtojnë pyetje për përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën. Një përfaqësues nga çdo grup lexon pyetjet:

- Si përshtatet kallëzuesi foljor i thjeshtë me kryefjalën?
- Si përshtatet kallëzuesi foljor i thjeshtë me kryefjalë homogjene?
- Si përshtatet kallëzuesi foljor i përbërë me kryefjalën?
- Si përshtatet kallëzuesi i përbërë kur pjesë të parë ka *mund, duhet*?
- Si përshtatet kallëzuesi emëror?

Grupet u përgjigjen pyetjeve duke dhënë shembuj me fjali.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë- punë e pavarur

Ushtrimi 1 punohet me gojë, nxënësit udhëzohen të vendosin shenjë në kuadratet në libër, për pohimet e sakta ose të gabuara.

Pohimi 2, 4, të sakta;

Pohimet 1, 3, të gabuara.

Hapi i shtatë- punë e pavarur

Ushtrimet 2, 3, 4, 5, i punojnë nxënësit në grupe dyshe ose në grupe 5-she (çdo grup një ushtrim), dhe çdo grup jep para klasës zgjidhjen e ushtrimit. Mësuesi bën plotësime për përgjigjen e tyre.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 2; u mblodh; filloi të votojë; është vënë; duhet të shkojë; duhet të qëndrojë.

Ushtrimi 3. Ishin të hapur; fshatra turistike; brigjeve të thepisura; qyteteve më të lashta; terma të reja.

Ushtrimi 4. Ne dhe shokët flasim mirë

- Mira dhe Lira janë motrat e mia.
- Ti dhe vëllai yt duhet të studioni më shumë.
- E hëna, e marta dhe e enjtja kanë shumë ngarkesë.

Ushtrimi 5. Shiu nisi të bjerë me furi. Nxënësit filluan të vraponin rreth stadiumit. Gjatë gjithë natës vazhdoi të dëgjohej bubullima. Artani mund të ndihmojë për të gjetur adresën e trajnerit. Për këtë ditë mund të tregohen shumë histori.

Ushtrimi 6. Mami dhe babi na porositën që të mos vonohemi.

- Unë dhe ti do të shkojmë në kinema.
- Teuta dhe ata filluan të stërviten.
- Ne dhe ju jemi të ftuar në dasmë.
- Ti dhe ai do të merrni pjesë në diskutimin e një libri të ri.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përshtat me lehtësi kallëzuesin me kryefjalën kur ajo është e shprehur me emër, përemër, me gjymtyrë homogjenë, mbi bazën e lidhjes së kallëzuesisë. I përdor saktë në fjali.

Burimet:

- libri i gjuhës shqipe, klasa VII,
- fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin.
- Kompetenca digjitale.

Vlerësimi:

- Vlerësim në situatën e të nxënit.
- Vlerësim në veprimtari në situatë për lojën gjuhësore.
- Vlerësimi në detyrën e shtëpisë me shkrim.

Detyra dhe puna e pavarur:

- Ushtrimi 6 (sipas kërkesës).
- Prezanton me Power Point njohuritë për tre llojet e kallëzuesve.

TEMA : KUNDRINORI

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kundrinori		Metoda e teknika: Puna në grupe, Formulimi i pyetjeve, Leximi i drejtuar Minikonkurs	Fjalë kyçe: Kundrinor i drejtë, i zhdrejtë gjymtyrë e dytë, pyetja me përemër etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p style="text-align: center;">1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</p> <p>Hapi i parë-konkurs</p> <p>Nxënësit kanë mësuar kundrinorët, prandaj mësuesi mund të organizojë një minikonkurs: Ndahet klasa në tre grupe , sipas rreshtave.</p> <p>Shkruhen në tabelë foljet: mësoj, përcjell, fshij, nxjerr, shqep, mbjell.</p> <p>Çdo grup do të ndërtojë grupe foljorë me kundrinorë;</p> <p>Gr.1 me kundrinorë të drejtë mësoj mësimin</p> <p>Gr. 2 me kundrinorë të zhdrejtë i mësoj asaj</p> <p>Gr. 3 me kundrinorë me parafjalë mësova me motrën</p> <p>Në këtë mënyrë vazhdohet edhe me foljet e tjera. Kështu nxënësit kujtojnë ç'kanë mësuar për kundrinorin.</p>				

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i dytë-Pyetje përgjigje

Mësuesi udhëzon nxënësit të vërejnë figurën, të analizojnë kundrinorët në fragmentin e dhënë dhe të plotësojnë tabelën:

kundrinori	pyetja	rasa	Roli i tij	Ç'tregon	Me se shprehet	Vendi që zë në fjali
I drejtë	Kë? Cilin?	kallëzore	Plotës kryesor	Objektin mbi të cilin bie veprimi i shprehur nga folja	Emër, GE, përemër, trajtë e shkurtër,	Zakonisht pas foljes, si trajtë e shkurtër, para foljes
I zhdrejtë						
me parafjalë						

Hapi i tretë-Tabelë koncepti

Tabelat e plotësuara i lexojnë pesë nxënës(përfaqësuesit e pesë grupeve).Mësuesi sqaron paqartësitë e nxënësve dhe bashkë me ta evidentojnë njohuritë e reja që morën për llojet e kundrinorit.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i katërt-Plotësim tablele

Ushtrimin 5 e punojnë nxënësit me gojë, argumentojnë cilat folje marrin kundrinorë e cilat jo dhe pse. (kujtojnë kallëzuesin foljor me gjymtyrë të domosdoshëm dhe jo të domosdoshëm) Plotësojnë tabelën në libër.

Hapi i pestë - punë në grupe dyshe

Ushtrimet 1, 2, 3, 4, i punojnë nxënësit në grupe dyshe, pastaj këmbëjnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri – tjetrit. Mësuesi dëgjon zgjidhjet e ushtrimeve.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1.

Kundrinori i drejtë	I shprehur me	Pyetja
Gjithfarë sendesh	GE	Çfarë?
Kazanë, enë të çdo madhësie, arka	Kundrinorë homogjenë Emër, GE, emër	Çfarë?
libra	emër	Çfarë?
portën	emër	Kë?
shkallët	emër	Kë?
Atë e	Trajtë e shkurtër	Kë?
asgjë	Përemër i pacaktuar	Çfarë?

Ushtrimi 2.

Kundrinor i zhdrejtë	I shprehur me	Pyetja
Atij i	Trajtë e shkurtër	Kujt?
anijes	emër	Kujt?
Të tjerëve	përemër	Kujt?

Atyre u	Trajtë e shkurtër	Kujt?
Të keqes	emërzim	Kujt?
Guximit tonë	GE	Kujt?

Ushtrimi 3. Kanë të domosdoshëm kundrinorin, fjalitë janë të paplota.

Ushtrimi 4. Cilin ia dhanë çmimin e parë?
 Kujt ia merrte mendja?
 I është grisur fleta librit.
 Për disa çaste ata iu sollën makinës rreth e rrotull.
 Ia dha këngës me hare.
 Ia ktheu atij prapë.

Ushtrimi 5. Marrin kundrinorë: filloj, ndjek, kam, dua, zbres;
 Nuk marrin kundrinorë: vij, dal, jam, fle, përpiqem;

Ushtrimi 6. T'i, të mjerët njerëz, ta (dini) atyre u, sy, i veshët, asgjë.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:
Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi dallon kundrinorin e drejtë, të zhdrejtë, me parafjalë me anë të pyetjeve kë?, cilin? Çfarë? Kujt? Me kë? etj. Tregon me se shprehen dhe ku qëndrojnë në fjali, i përdorin kundrinorët në fjali.


Burimet: <ul style="list-style-type: none"> libri i gjuhës shqipe, klasa VII, fleta për verifikimin e kompetencave. 	Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Zhvillon komunikimin. Kompetenca digjitale.
Vlerësimi: <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim në situatën e të nxënit. Vlerësim në veprimtarinë në situatë. Vlerësimi në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë. 	Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 (sipas kërkesës) Prezanton me Power Point njohuritë e marra për kundrinorin.

TEMA : RRETHANORI I VENDIT DHE I KOHË S

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethanorët e vendit, kohës		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grupe; Formulimi i pyetjeve; Diagrama e Venit Puna e pavarur. 	Fjalë kyçe: rrethanor vendi, kohe, gjymtyrë e dytë jo e domosdoshme, plotësuese.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit


1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:



Hapi i parë- stuhi mendimi/diagramë Veni

Nxënësit në grupe dyshe punojnë me diagramin e Venit për kundrinorët dhe rrethanorët:

Janë gjymtyrë të dyta, por janë plotës kryesorë U përgjigjen pyetjeve me përemra Shprehet me emër, GE, përemër	} Janë gjymtyrë të dyta por jo plotës kryesorë U përgjigjen pyetjeve me ndajfolje Shprehen me ndajfolje, emër, GE, formë të pashtjelluar	}
---	--	---



- Janë gjymtyrë të dyta
- Formojnë GF me kallëzuesin
- Shprehen me emër, GE,

Hapi i dytë-Diagramë Veni

Kur nxënësit mbarojnë, raportojnë punën, mësuesja e plotëson diagramin duke e shkruar në tabelë.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i tretë-pyetje përgjigje

Nxënësit punojnë në dyshe në libër dhe me njëri- tjetrin, u përgjigjen pyetjeve:

- a. Çfarë shpreh rrethanori?
- b. Ç'gjymtyrë e fjalisë është?
- c. Ç'fjalë drejtuese mund të ketë?
- d. Ç'vend zë në fjali?
- e. Sa lloje rrethanorësh njihni?
- f. Me se shprehet rrethanori i vendit? Po i kohës?
- g. Jep nga një shembull për çdo rrethanor.

Hapi i katërt-punë në grupe

E ndajmë klasën në pesë grupe dhe përgatiten për t'ju përgjigjur pyetjeve. Mësuesi kontrollon punën e grupeve, kush është gati, jep përgjigjet. Të tjerët dëgjojnë duke pasur parasysht organizuesin grafik, që mësuesi e ka përgatitur si fletë pune, ose e shkruan në dërrasë.

Çështja	Pyetja për t'u bërë	Çfarë tha folësi	shënime

Hapi i pestë-punë në grupe

Grupet e tjerë mbajnë shënime për përgjigjet e grupit që flet, çfarë tha folësi, kanë mendime të ndryshme apo të kundërta, kanë vërejtje, drejtojnë pyetje etj. Mësuesi ndjek me vëmendje

diskutimin, por edhe debatin dhe vëren sa të vëmendshëm kanë qenë nxënësit në studimin e tekstit dhe si i lidhin njohuritë e mëparshme me ato të reja.

Sipas tabelës, shprehin mendime edhe përfaqësuesit e grupeve të tjera.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i gjashtë-punë e pavarur

Ushtrimet 1, 2, 5, 6 i punojnë nxënësit në grupe dyshe, kontrollojnë punën e njëri tjetrit

Hapi i shtatë-punë e pavarur/në grupe dyshe

Ushtrimet 3, 4, 9, i punon e gjithë klasa në libër, pasi punojnë me njëri-tjetrin në bankë,

Lexojnë disa nxënës fjalitë që kanë plotësuar sipas kërkesave, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1; nga shtrati(folje); nga shtrati(mbiemër); nga shtrati(formë e pashtjelluar) nga shtrati (formë e pashtjelluar)

Ushtrimi 2; ra borë në Tiranë, Elbasan, Korçë etj. Do të nisemi për në Durrës, Kavajë, Lushnje. Tek liqeni ka shumë pemë. Ku ka zë, s'është pa gjë.

Ushtrimi 3. Dje ndoqa një film premierë.

Gjatë muajit mars u organizuan disa veprimtari.

Pas mësimit do të shkojmë në teatër.

Të shtunave shkojmë në Durrës pranë detit.

Në orën tetë nxënësit fillojnë mësimin.

Ushtrimi 4. Ky tren është nisur nga Tirana.

Te kinema "Agimi" po shfaqet një film i ri.

Kam harruar çantën në autobus.

Me të hyrë në tunel, duhen ndezur dritat e makinës.

Ky mall është i ardhur nga Kina.

Për të ecur mbi akull, duhen këpucë të posaçme.

Ata e kthyen shikimin drejt Malit të thatë.

Ushtrimi 5. Sheshin (folje); nën një galeri (folje);përpara syve (folje); nën kubetë e larta (folje) midis arkave, velënxave, djepave, rrangallave (folje)

Ushtrimi 6; pasditeve, pas dy orësh, prej shumë vitesh, brenda javës, dikur (folje)

Ushtrimi 7; Ushqimet e konservuara mund të ruhen për një kohë të gjatë në kuti.

Për një kohë të gjatë mund të ruhen ushqimet e konservuara në kuti.

Mund të ruhen për një kohë të gjatë ushqimet e konservuara në kuti.

Mund të ruhen në kuti për një kohë të gjatë ushqimet e konservuara.

Ushtrimi8; përgjigjja te ushtrimi 6

Ushtrimi9. Të hënën fillova kursin e violinës.

Në fëmijëri kam ëndërruar të bëhem shkrimtar.

<p>Që prej asaj dite, ai nuk është më si dikur. Dje pashë një film të bukur.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi dallon rrethanorët e vendit, kohës me pyetjet ku?, kur?. Tregon me se shprehen, ku qëndrojnë në fjali, krahason të përbashkëtat me të veçantat. I përdor ato në fjali.</p>	
<p>Burimet: Libri i gjuhës shqipe kl. 7 Fleta për verifikimin e kompetencave</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera: Zhvillon komunikimin</p>
<p>Vlerësimi: Në përgjigjen e pyetjeve për rrethanorët Në plotësimin e diagramit të Venit Në punimin e ushtrimeve</p>	<p>Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimin 7 (sipas kërkesës)</p>

TEMA: RRETHANORI I SHKAKUT, QËLLIMIT

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII																		
Tema mësimore: Rrethanori i shkakut, qëllimit		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> - Puna në grupe; - Tabela e kocepteve - Puna e pavarur. 	Fjalë kyçe: rrethanor shkak, qëllimi, pyetjet pse, përse, gjymtyrë fjali jo e domosdoshme, fjalë drejtuese																			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit																						
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë-organizues grafik</i> Nxënësit përqendrohen te organizuesi grafik që mësuesi e jep në tabelë për dy llojet e rrethanorëve, i shkakut, i qëllimit. Rikujtojnë ato që kanë mësuar në klasën e gjashtë për ta.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Rrethanori</th> <th>Ç'tregon?</th> <th>Ku bën pjesë?</th> <th>Me se shprehet?</th> <th>Me ç'pyetje gjendet?</th> <th>Ç'vend zë në fjali?</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>I shkakut</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>I qëllimit</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>					Rrethanori	Ç'tregon?	Ku bën pjesë?	Me se shprehet?	Me ç'pyetje gjendet?	Ç'vend zë në fjali?	I shkakut						I qëllimit					
Rrethanori	Ç'tregon?	Ku bën pjesë?	Me se shprehet?	Me ç'pyetje gjendet?	Ç'vend zë në fjali?																	
I shkakut																						
I qëllimit																						
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i dytë-shpjegim /tabelë koncepti</i> Nxënësit, të drejtuar nga mësuesja, diskutojnë rreth plotësimin të tabelës së kocepteve, plotësojnë mendimin e njëri-tjetrit. <i>Hapi i tretë- punë në grupe dyshe</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshe me tekstin, njihen me informacionin e ri për rrethanorin e shkakut dhe qëllimit. Qëndrojnë 10 minuta, që të nxjerrin të rejtat që prezanton mësimi i ri</p>																						

nga ai i vitit të kaluar: **Fjala drejtuese e tyre; folje, mbiemër.**

Diskutojnë dhe analizojnë shembujt me fjali që jepen në libër, japin shembuj të tjerë, të ngjashme me to.

Mësuesja i udhëzon si ta dallojnë rrethanorin e shkakut nga ai i qëllimit (Me pyetjet: Pse? Përse? Dhe nga kuptimi që shprehin.

3. Prezantimi dhe demonstrimi rezultateve të arritura:

Hapi i katërt-punë e pavarur

Ushtrimin 1, 2, nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe. Këmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Prezantohet puna e tyre, mësuesja plotëson përgjigjet e nxënësve.

Hapi i pestë-punë e pavarur

Ushtrimin 5, e punon një nxënës në tabelë, shkruan dy llojet e rrethanorëve në dy kolona:

<u>Shkaku</u>	<u>Qëllimi</u>
nga gëzimi	për ditëlindjen time
nga era	për rezultate të mira
	për t'i pastruar

Hapi I gjashtë-punë në grupe dyshe

Ushtrimet 3, 4, I punojnë me njëri-tjetrin në bankë, dallojnë fjalën drejtuese të rrethanorëve të shkakut dhe qëllimit.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1; për shkak të mjegullës së dendur; nga lodhja; nga rezultatet e provimit; nga turpi.

Ushtrimi 2. 1+g; 2+e; 3+d; 4+a; 5+f; 6+c; 7+b;

Ushtrimi 3; nga zërat, nga gëzimi, prej frike, pse (nga folje);

Nga era, nga punët e shumta (nga mbiemra);

Ushtrimi 4. Për të vrapuar; për t'u argëtuar; për t'u stërvitur; për tjetër punë.

Ushtrimi 6. Klasat e dyta shkuan tek liqeni për t'u zbavitur;

Përse e more me vete edhe macen?

Duhet të punojmë për të mirën e përbashkët;

Skuadra e specialistëve filloi të punojë për restaurimin e shkollës;

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi drejt i gjuhës: Nxënësi/ja dallon rrethanorët e shkakut, qëllimit me pyetjet pse?, përse?. Tregon me se shprehin, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese, krahason të përbashkëtat me të veçantat. I përdor ato në fjali.

Burimet:

Libri i gjuhës shqipe kl. 7

Lidhja me fushat e tjera:

Zhvillon komunikimin

Vlerësimi:

Vlerësimi në teknikën e pyetjeve
Në plotësimin e diagramit të Venit
Në punimin e ushtrimeve

Detyra dhe puna e pavarur:

Ushtrimin 6 (sipas kërkesës)

TEMA: RRETHANORI I MËNYRËS, SASISË

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethanori i mënyrës, sasisë		Metoda e teknika: - Puna në grupe; - Teknika e formulimit të pyetjeve; - Puna e pavarur. - Tabele e koncepteve	Fjalë kyçe: rrethanor mënyre, sasië, gjymtyrë plotësuese, fjala drejtuese, pyetjet: Si? Sa?	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:

Hapi i parë- pyetje /përgjigje

Nxënësit plotësojnë tabelën e koncepteve, sepse kanë njohuri për këta dy rrethanorë.

rrethanori	Ç'tregon	Ku bën pjesë	Me se shprehet	Me ç'pyetje gjendet	Ç'vend zë në fjali
Mënyre					
Sasië					

Aktivizohen nxënësit për të plotësuar tabelën, duke rikujtuar njohuritë e vitit të kaluar

1. Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i dytë-pyetje /përgjigje

Nxënësit vërejnë figurën në libër dhe shkruajnë dy pyetje për fjalët me shkronja të zeza: Si? Sa?/Si po ndihej gjyshi?/Sa hëngri ai?

Hapi i tretë-INSERT

Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë në libër për rrethanorët e mënyrës dhe sasisë.

Hapi i katërt-Punë në grupe

Nxënësit në grupe dyshe formulojnë pyetje për çështjet kryesore të rrethanorëve:

- Ç'gjymtyrë fjalië janë këto rrethanorë?
- Me ç'pyetje gjenden ato në fjali?
- Nga ç'gjymtyrë varen?
- Me se shprehen ato në fjali?
- Ku qëndron zakonisht në fjali?

Mësuesja kërkon nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve duke shënuar në libër ku gjen përgjigjen çdo pyetje e tyre.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i pestë-punë në grupe

Ushtrimin 3, 7, nxënësit i punojnë në grupe dyshe në libër. Këmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri- tjetrit.

Hapi i gjashtë-dialog

Ushtrimet 1, 5, i punojnë me gojë nën drejtimin e mësuesit, sepse kanë të njëjtën kërkesë, por me tekste të ndryshme, aktivizohen sa më shumë nxënës/e

Hapi i shtatë- punë e pavarur	
Ushtrimin 4 e punon një nxënës në dërrasë: fjalinë e dhënë e shkruan aq herë sa mund të zhvendoset rrethani i mënyrës.	
Zgjidhja e ushtrimeve:	
Ushtrimi 1. Qetë-qetë, pa bujë; me vrap; me forcë (nga folje)	
Ushtrimi 2. Me durim të madh, duke pëshpëritur; me gojë hapur, me shpejtësi të madhe; shpesh.	
Ushtrimi 3. Me vëmendje, menjëherë, me shpejtësi, me dashuri, me vonesë.	
Ushtrimi 4. Edhe duke gabuar, mëson njeriu nga jeta. Nga jeta, edhe duke gabuar mëson njeriu. Njeriu, nga jeta mëson edhe duke gabuar.	
Ushtrimi 5. Shumë, shtatë herë, një herë, një të hedhur gurin larg, një metër, treqind lekë.	
Ushtrimi 6. Sa kokrra vezë more? Mijëra vetë u mblodhën në shesh. T'u deshën dy ditë për të mbaruar temën. I hodha makinës katër litra benzinë. Fol pak dhe dëgjo shumë.	
Ushtrimi 7. Prej 20 vitesh; pesë herë; pesë libra në muaj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:	
Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi dallon rrethanorët e mënyrës, sasisë me pyetjet sa?, si?. Tregon me se shprehen, ku qëndrojnë në fjali, krahason të përbashkëtat me të veçantat. I përdor ato me fjali.	
Burimet: - Libri i gjuhës shqipe kl.VII - Fleta për verifikimin e kompetencave	Lidhja me fushat e tjera: - Zhvillon komunikimin
Vlerësimi: - Vlerësim në situatën e të nxënit - Vlerësojnë nxënësit njëri-tjetrin në punimin e ushtrimeve - Vlerësim në detyrën e shtëpisë.	Detyra dhe puna e pavarur: Gr.1 Ushtrimi 2, (sipas kërkesës) Gr. 2 Ushtrimi 6 (sipas kërkesës)

TEMA : LIGJËRATA E DREJTË DHE E ZHDREJTË

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Sintaksë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë		Metoda e teknika: -Puna në grupe; -Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë me tekstin; -Punë e pavarur.	Fjalë kyçe: Ligjërata e drejtë, e zhdrejtë, fjalë përmendëse, fjalë lajmuese etj.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit		
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Hapi i parë- diskutim Mësuesja paraqet me tabak të bardhë ku ka shkruar ligjëratën e drejtë: (ose e shkruan në dërrasë ose në power point) dhe kërkon që nxënësit të diskutojnë për mënyrën sesi është shkruar teksti./Kush e flet? Kush e shkruan? Pse janë përdorur gjithë ato shenja pikësimi ?etj/ -Ismail Kadare shkruan: “Sillu aq mirë me ata që të lëndojnë, derisa t’u vijë neveri nga vetja e tyre.” -Dikur Sami Frashëri shkruante: “Nëse do të mbjellësh për një vit, mbill misër e grurë, nëse kërkon të mbjellësh përgjithmonë, mbill arsim e kulturë.” - Ismail Kadare shkruan që të sillemi aq mirë me ata që na lëndojnë, derisa atyre t’u vijë neveri nga vetja e tyre. Dikur Sami Frashëri shkruante që nëse do të donim të mbillnim për një vit, të mbillnim misër e grurë, nëse do të donim të mbillnim përgjithmonë, të mbillnim arsim e kulturë. Hapi i dytë-punë e pavarur Nxënësit i lexojnë me vëmendja dhe i shkruajnë në fletore ligjëratat e drejta dhe të zhdrejta, i ndajmë në etiketa; fjalët lajmuese, fjalët përmendësh.</p>		
Ismail Kadare shkruan:	“Sillu aq mirë me ata që të lëndojnë, derisa t’u vijë neveri nga vetja e tyre.”	
Dikur Sami Frashëri shkruante:	“Nëse do të mbjellësh për një vit, mbill misër e grurë, nëse kërkon të mbjellësh përgjithmonë, mbill arsim e kulturë.”	
<p>Hapi i tretë-shpjegim Mësuesi shkruan në dërrasë ligjëratat e drejta edhe në dy pozicione të tjera të fjalëve përmendëse dhe atyre lajmuese , ose ua jep nxënësve me fisha.</p>		
“Sillu aq mirë me ata që të lëndojnë, derisa t’u vijë neveri nga vetja e tyre.”		-shkruan Ismail Kadare.
“Sillu aq mirë me ata që të lëndojnë, -	shkruan Ismail Kadare, -	derisa t’u vijë neveri nga vetja e tyre.”
<p>Nxënësit operojnë me ligjëratat e tjera.</p>		
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: Hapi i katërt-shpjegim dhe punë në grupe Mësuesi i drejton nxënësit të punojnë me informacionin e dhënë në tekst për temën. Komentojnë figurën dhe shkruajnë nga një ligjëratë të drejtë, e kthejnë në të zhdrejtë, si modeli në libër dhe ndalen në:</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Shmanget përdorimi i shenjave të pikësimit; • Foljet dhe përemrat e vetës së parë, kthehen në vetën e tretë; • Ndryshon koha e foljeve. 		

Hapi i pestë-punë në grupe dyshe

Nxënësit lexojnë ligjëratën e drejtë që kanë shkruar në fletore dhe qortojnë punën e njëri-tjetrit, si për formulimin e saj, edhe përdorimin e shenjave të pikësimit në tre pozicionet e fjalëve të autorit (fjalët lajmuese).

1. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**Hapi i gjashtë- punë me etiketa/punë e pavarur**

Mësuesja e fillon me etiketa, ose i shkruan në dërrasë dy thënie të mençura, nxënësit ndahen në dy grupe:

Me fëmijët duhet një gotë urtësi, një kopsht arsye, një det durim, një qiell dashuri.
(Populli)

Kur merr, të mbushen duart, kur jep, të mbushet zemra...! (një thënie e mençur)

I shkruajnë ato si ligjëratë e drejtë me tre pozicione të fjalëve të autorit. Kontrollonjë punën e njëri-tjetrit në grupe dyshe.

Hapi i shtatë- punë në grupe

Ushtrimin 2, 4, nxënësit i punojnë në fletore, të ndarë në dy grupe. Këmbejnë librat, kontrollonjë punën e njëri- tjetrit, qortojnë gabimet. Kontrollohen ushtrimet edhe para klasës duke dhënë nxënësit zgjidhjet. Mësuesi vlerëson.

Hapi i tetë-punë e pavarur

Ushtrimin 3, nxënësit kthejnë në ligjëratë të drejtë fjalitë e dhëna dhe i shkruajnë fjalitë në libër. I lexojnë disa nxënës, vlerësojnë nxënësit e tjerë punën e tyre.

Zgjidhja e ushtrimeve;

Ushtrimi 3. Ai na këshilloi: “Është mirë t’i fikni celularët.”

“Në ç’orë fillon mësimi dhe cilën lëndë bëni?”- më pyeti ai.

Gjyshja më përqafohte e më thoshte: “Ti do të bëhesh njeri i mirë dhe i dashur.”

“Nuk kam frikë nga askush dhe nga asgjë!”- thoshte ai

Kandidati na premtoi: “Unë do të ndërtoj një rrugë të re.”

Ushtrimi 4. – Mos vallë kodra është vendbanim I ndonjë hyji dhe ai nuk po e lë kështjellën të lartësohet? - e pyeti vëllai më i vogël.

Plaku mohoi me kokë.

- Mos vallë muret rrëzohen prej syrit të keq?- e pyeti vëllai I mesëm.
- Plaku mohoi me kokë e me sy.
- Mos vallë ndonjë orë inatçore na ka shituar kushedi përse?- e pyeti I madhi.
- Plaku mohoi për të tretën herë. – Po qe se doni të lartësohen muret, të fshehtë do t’jua rrëfej unë, - u pëshpërit plaku i panjohur. Por pas pak u kumtoi:
- Do t’jua kisha rrëfyer, sikur të mos e dija se do të më merrnin për mëkatar.
- Mëkati yt rëntë mbi supet tanë, - e përbetoi vëllai i madh.

Ushtrimi 5. Babai më tha: “Njerëzit vdesin, vetëm atëherë kur ne i harrojmë.”

Nëna më premtoi: “Do të shkojmë patjetër me pushime në Himarë.”

U premtova prindërve: “Do të dëgjoj gjithmonë këshillat tuaja.”

Blerta m’u përbetua: “Do ta marr patjetër me vete motrën e sëmurë.”

Të urtët thonë: “Dituria dhe arsyeja flasin, injoranca, padrejtësia, ulërijnë.”

Ushtrimi 6. Babai më tha se njerëzit vdesin kur ne i harrojmë. Nëna më premtoi se do të

shkonim patjetër me pushime në Himarë. U premtova prindërve se do t'i dëgjoj gjithmonë këshillat e tyre. Blerta m'u përbetua se do ta merrte patjetër me vete motrën e sëmurë. Të urtët thonë se dituria dhe arsyeja flasin, kurse injoranca dhe padrejtësia, ulërijnë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës: Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi/ja dallon ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë, përdor drejt shenjat e pikësimit, kthen një ligjëratë të drejtë në të zhdrejtë, i përdor ato në ligjërimin e tij	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> libri i gjuhës shqipe, klasa VII, fleta për verifikimin e kompetencave. 	Lidhja me fushat e tjera: - Zhvillon komunikimin;
Vlerësimi: <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim në situatën e të nxënit. Vlerësim me gojë e me shkrim në zgjidhjen e ushtrimit në punën e pavarur. Vlerësimi në detyrën e shtëpisë. 	Detyra dhe puna e pavarur: Gr.1 Ushtrimi 5-6 (sipas kërkesës). Gr.2 Gjeni tri thënie të mençura dhe shkruajini në fletore në tre pozicionet e ligjëratës së drejtë (fjalët e autorit).

DREJTSHKRIM

TEMA: (PIKËSIMI) PËRDORIMI I PRESJES NË FJALI

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i presjes në fjali		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> Puna në grup; Puna e pavarur; Pyetje në dyshe. 	Fjalë kyçe: Ndahet me presje, rregulla pikësimi, vihet midis presjesh	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Hapi i parë- stuhi mendimi</i> Nxënësit japin disa raste që mbajnë mend për përdorimin e presjes në llojet e fjalive me bashkërenditje:</p> <ul style="list-style-type: none"> E kërkoi Benin edhe në shkollë, edhe në palestër, edhe në lagje, por nuk e gjeti. T'i pranova mendimet e tua, prandaj më dëgjo tani. T'u kërkosh mendim jo vetëm shokëve, por edhe prindërve. S'u erdhi mirë nga veprimi yt, kurse unë nuk mendoj ashtu. <p><i>Hapi i dytë-dialog/pyetje përgjigje</i> Nxënësit japin edhe shembuj të tjerë me përdorimin e presjes në llojet e fjalive me bashkërenditje.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hapi i tretë- grupe dyshe</i> Një nxënës lexon në libër rastet e përdorimit të presjes që janë dhënë në dy grupe. <i>Hapi i katërt- punë në grupe/pyetje përgjigje</i> Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri - tjetrit për rastet e përdorimit të presjes, duke</p>				

dhënë edhe shembuj të tjerë, të ngjashëm me ato të librit.

Si do t'i formulojmë rregullat e drejtshkrimit për rastet në libër?

- a- Vendosim gjithmonë presje para lidhëzave kundërshtore dhe përmyllëse.
- b- Ndahen me presje lidhëzat bashkërenditëse shtuese dyfishe (jo vetëm...por edhe) dhe lidhëzat shtuese e veçuese, të përsëritura (as...as, o...o, ose...ose, ja...ja.)
- c- Ndahen me presje fjalitë e bashkuara pa lidhëza.
- d- Ndahen me presje fjalitë e varura me lidhëzat nënrenditëse.

Hapi i pestë- punë në grupe

Në grupe dyshe, nxënësit zhvillojnë lojën mësimore: një nxënës thotë rregullin, tjetri jep shembujt; këmbejnë rolet: ai që tha shembujt, thotë rregullin e kështu me radhë.

Hapi i gjashtë- punë në grupe

Ndahen nxënësit në 4 grupe dhe në tabelë shkruajnë me bojëra uji 4 rregullat e përdorimit të presjes dhe i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i shtatë-punë e pavarur

Ushtrimi 1, klasa e shkruan saktë tekstin në fletore, qortojnë gabimet me njëri-tjetrin në përdorimin e pikës, presjes, shkronjën e madhe.

hapi i tetë-punë në grupe

Ushtrimet 2, 3, 4, nxënësit i plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre. I përsëritin rastet e përdorimit të presjes.

Hapi i nëntë- punë në grupe

Ushtrimin 5, nxënësit në grupe dyshe punojnë me pjesën "Sekreti i shtëpisë në ishull" që e kanë në tekst, nënvizojnë rastet e përdorimit të presjes dhe thonë cilit rregull i përkasin. Pasi mbarojnë, lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1; Nuk do të ndodhë asgjë. Kjo vlejti si përgjigje për dyshimet e Arbenit. Fundja, unë kërkoj nga ju të më ndihmoni. Sidoqoftë, plaku doli nga spitali dhe ai mbeti sërish vetëm. Por të mos harrojmë se kishte lënë pas hijen e trupit të tij të gjatë me energjinë dhe dëshirën për t'u kthyer me doemos pranë bletëve. Meqë mbeti vetëm në dhomë, filloi të ëndërronte.

Ushtrimi 2; bashkërenditëse kundërshtore; shtuese e përsëritur; e nënrenditur rrjedhimore; hyn në mes të një fjalie; shtuese e përsëritur.

Ushtrimi 3; Guri pëlçet, po njeriu s'pëlçet.(kundërshtore).

- Le çanta që na humbi, por na morën edhe çelësat.(shtuese, lidhëza dyshe).
- Vetëm të vinte me ne, pa të bëhej ç'të bëhej.(bashkërenditëse përmyllëse).
- Ishte e pamundur që të ecnim në atë rrugë, prandaj i ramë gjatë. (fjali e përbërë me tri pjesë).
- Shoqja e saj, megjithëse ishte e sjellshme, nuk më pëlqeu.(futet në mes pjesa e varur).
- Ndonëse ishin bllokuar rrugët, ushqimet dhe barnat erdhën shpejt.(fjalia e varur, para kryesores).

Ushtrimi 4; shtuese e përsëritur; shtuese dyshe; fjalia e varur në mes të pjesës kryesore; bashkërenditëse kundërshtore.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përdor presjen, duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.

Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • Libri i gjuhës shqipe, klasa VII. • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. • Fleta për verifikimin e kompetencave. 	Lidhja me fushat e tjera: - Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe
Vlerësimi: <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën me grupe. - Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve. 	Detyra dhe puna e pavarur: Grupi I: Shkruani në fletore rregullat e përdorimit të presjes, nga dy shembuj për secilin. Grupi II: Ushtrimi 6 (sipas kërkesës).

TEMA(PIKË SIMI)PËRDORIMI I I PIKË S DHE PIKË ÇUDITJES

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i pikës dhe pikëçuditjes.		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Puna e pavarur; • Pyetje në dyshe. 	Fjalë kyçe: rregulla drejtshkrimore, pika, pikëçuditja.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:</p> <p>Hapi i parë-punë në grupe</p> <p>Nxënësit japin disa raste që mbajnë mend për përdorimin e pikës dhe pikëçuditjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • M’i mori të gjitha punimet e dorës për t’i shitur. (dëftore) • Sa mirë qenka të dëgjosh mendimet e prindërve! (dëftore thirrmore) • Shpejt, nisu për në stërvitje! (nxitëse thirrmore) • Qofsh i suksesshëm në rrugën e dijes! (dëshirore) • Duhet të punosh çdo ditë me kujdes për detyrat e shtëpisë. (nxitëse, këshillë) <p>Hapi i dytë- diktim</p> <p>Nxënësit japin edhe shembuj të tjerë me përdorimin e pikës dhe pikëçuditjes, sepse kanë mësuar edhe pasthirrmat.</p> <p>Hapi i tretë- punë e pavarur</p> <p>Mësuesi shkruan vargjet e Çajupit: Kullotni, moj bagëti, Ti, ti, ti...! Kullotni, biro, kullotni, kur të vdes të më kujtoni, “Ndjesë pastë”! të më thoni. (Çajupi)Nxënësit diskutojnë për përdorimin e pikëçuditjes dhe pikës.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja:</p> <p>Hapi i katërt- memorizim rregullash</p> <p>Një nxënës lexon me zë rastet e përdorimit të pikës dhe pikëçuditjes që janë dhënë në libër.</p> <p>Hapi i pestë-punë në grupe</p>				

Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri - tjetrit për rastet e përdorimit të pikës dhe pikëçuditjes, i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit:

a-Përse përdoret pika? (për të dhënë intonacionin e përfundimit në fjali)

b-Kur përdoret pika? (në fund të fjalisë dëftore, nxitëse jothirrmore, të fjalive të përbëra,)

c-Përse përdoret pikëçuditja? (shënon përfundimin me intonacion thirrmore)

d-Kur vendosim pikëçuditje? (në fund të fjalive dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore thirrmore; në fund të një fjalie të përbërë me karakter thirrmore; pas pasthirmave dhe një onomatopeje) .

Hapi i gjashtë- punë në grupe

Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në tabakë të bardhë shkruajnë me bojëra uji rregullat e përdorimit të pikës dhe pikëçuditjes, i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.

Hapi i shtatë- punë në grupe

Nxënësit, në grupe dyshe përsëritin rregullat e përdorimit të pikës dhe pikëçuditjes me lojën mësimore: njëri thotë rregullin, tjetri thotë shembuj; dhe anasjelltas, këmbëjnë vendet, derisa t'i fiksojnë

3.Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi i tetë- punë e pavarur

Ushtrimet 1, 2, 3, 4, nxënësit i plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre. I përsëritin prapë rregullat e përdorimit të pikës dhe pikëçuditjes.

Hapi i nëntë- punë në grupe

Ushtrimet 5, 6, nxënësit në grupe dyshe i punojnë në libër, vendosin shenjat e pikësimit që mungojë dhe thonë cilit rregull i përkasin. Pasi mbarojnë lexojnë rastet, argumentojnë

Zgjidhja e ushtrimeve:

Ushtrimi 1; pika a, pika b, pika a, pika b, pika a, pika b, pika a, pika b, pika a, pika b, pika b.

Ushtrimi 2; pika a, pika a, pika c, pika a, pika d,

Ushtrimi 3; Qyteti shtrihej në tërë gjatësinë e fushës dhe syri s'të zinte, veçse shtëpi. Ja lodhur dhe dua të fle. Të gjithë së bashku, njerëzit, toka dhe qielli, akuzonin. Ishte larg, shumë larg puna që bëja nga ëndrrat që thurja. Kjo nuk është e udhës.

Ushtrimi 4; fjalia 1, 2, 3, 5, pika a; fjalia 4, 6, 7, pika b.

Ushtrimi 5; E ku mund të mbajë ajo gjithë atë çantë! – tha ai.

Po ku humbët kështu, more djem?!- i qortoi gjyshja.

Vallë, asnjëra s'kishte dalë për ta parë?! As e ëma?! As e motra?!

Edhe ti je zemëruar me mua?!- e pyeti ai me çudi, duke vënë buzën në gaz.

Ushtrimi 6. Uaaa! – buçiti salla.

Pam! Pam! Pam! – ushtoi arma e tij.

Ha, ha, ha!- qeshi ai me të madhe.

Era ulërinte: - Vuu! Vuu!

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:

Përdorimi i drejtë i gjuhës: Nxënësi përdor pikën dhe pikëçuditjen duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijojnë vetë.

Burimet:

- Libri i gjuhës shqipe, klasa VII.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.
- Fleta për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me fushat e tjera:

- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe

TEMA(PIKË SIMI)PËRDORIMI I TREPIKË SHIT

Fusha: Gjuhësia	Lënda: Gjuha shqipe	Tematika: Drejtshkrim	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i trepikëshit.		Metoda e teknika: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup; • Pyetje në dyshe. • Loja mësimore 	Fjalë kyçe: rregulla drejtshkrimore, trepikëshi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësit				
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:				
<p>Hapi i parë-</p> <p>Mësuesi shkruan një fragment nga romani “Don Kishoti i Mançes” në tabelë që ka përdorimin e trepikëshit:</p> <p>...- Nga thekra bënte bukë më të bardhë se prej gruri. More vesh?... Po a e puthi letrën? A e vuri në ballë?</p> <ul style="list-style-type: none"> - I kishte duart të zëna dhe më tha ta lija mbi thasë... - Donte ta lexonte mënjanë që ta gëzonte më vete... Por kur i vajte afër, a të erdhi një erë aromatike? - Jo, imzot, ajo vinte era djersë, ngaqë punonte... - Do të kesh qenë i ftohur dhe me rrufë, or Sanço. <p>Mësuesi/ja e lexon me intonacionin e duhur dhe kërkon ta lexojnë edhe nxënësit, për të dhënë intonacionin e papërfunduar. Pse?</p>				
2. Ndërtimi i njohurive të reja:				
Hapi i dytë- punë në grupe dyshe , shpjegim				
Një nxënës lexon me zë rastet e përdorimit të trepikëshit që janë dhënë në libër.				
Hapi i tretë- punë në grupe/pyetje përgjigje				
Në grupe dyshe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri – tjetrit për rastet e përdorimit të trepikëshit, i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit:				
<ul style="list-style-type: none"> a-Përse përdoret trepikëshi? (për të dhënë intonacionin e papërfunduar në fjali, apo ndërprerje të një thënieje, a teksti) b-kur përdoret trepikëshi? -në ndërprerjen e një thënieje, që dëgjuesi ta nënkuptojë, -në shkurtimet e fjalëve, ose datave; - pas një numërimi, që nuk jepet deri në fund; -në citimet e paplota; për të lënë vende bosh, që nxënësi t’i plotësojë me numra a shkronja, në matematikë, gjuhë shqipe, etj; - për të shprehur mungesën ose vonesën e përgjigjes në dialog. 				
Hapi i katërt-punë në grupe				
Si do t’i formulojmë rregullat e drejtshkrimit për rastet në libër?				
Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në tabakë të bardhë shkruajnë me bojëra uji rregullat e përdorimit të trepikëshit, i afishojnë në muret e klasës dhe qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.				

<p>Hapi i pestë- punë në grupe</p> <p>Nxënësit, në grupe dyshe përsëritin rregullat e përdorimit të trepikëshit me lojën mësimore: njëri thotë rregullin, tjetri thotë shembuj; dhe anasjelltas, këmbajnë vendet, derisa t'i fiksojnë.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</p> <p>Hapi i gjashtë- punë në grupe</p> <p>Ushtrimin 1, nxënësit e plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi kontrollon punën e tyre. I përsëritin prapë rregullat e përdorimit të trepikëshit.</p> <p>Hapi i shtatë- punë në grupe</p> <p>Nxënësit në grupe dyshe punojnë në libër me pjesën një letrare dhe diskutojnë përdorimin e shenjave të pikësimit që janë përdorur dhe thonë cilit rregull i përkasin. Pasi mbarojnë lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.</p> <p>Hapi i tetë- punë e pavarur /diktim</p> <p>Zgjidhja e ushtrimeve:</p> <p>Ushtrimi 1; pika c, pika b, pika b, pika e, pika e,</p> <p>Mësuesi mund të bëjë një diktim të shkurtër, me 30-40 fjalë dhe të kontrollojë pikësimin.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <p><i>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:</i> Nxënësi shkruan një tekst duke respektuar rregullat gjuhësore. Shpreh drejt një mendim apo kërkesë me gojë apo më shkrim në gjuhën amtare për një situatë të caktuar duke ndërvepruar në grup ose në klasë. Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo për detyrë shkolle.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</p> <p><i>Përdorimi i drejtë i gjuhës:</i> Nxënësi përdor trepikëshin, duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.</p>	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Libri i gjuhës shqipe, klasa VII. • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. • Fleta për verifikimin e kompetencave. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <p>Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe</p>
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën me grupe. - Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve. 	<p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <p>Grupi I: Shkruani rregullat e përdorimit të trepikëshit dhe nga një shembull për secilin.</p> <p>Grupi II: Ushtrimi 9 (sipas kërkesës).</p>

MËSIM MODEL

PROJEKTI: EMISION TELEVIZIV

FUSHA: **Leksikologji**

PUNË ME PROJEKT PËR PASTËRTINË E GJUHËS

Shmangia dhe përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja

1.Kompetenca të fushës:

- Të folurit për qëllime funksionale: -Të diskutojnë për fenomenin e përdorimit pa vend të fjalëve të huaja;
- Të shkruarit- Reflektim me shkrim përmes një eseje mbi argumentet mbi përdorimin pastër të gjuhës shqipe;
- Përdorimi drejt i gjuhës:
- -Të kërkojnë raste të shmangieve nga norma standarde e shqipes; në botime, në mjedise publike, etj duke nxjerrë në pah fenomene gjuhësore; ku ndodh fenomeni në leksik; në struktura sintaksore, në shmangie nga norma gramatikore

2.Kompetenca kyçe

Kompetencë qytetare:

- -Të reflektojnë rreth kritikës e problematikës së standardit të sotëm të shqipes dhe pasurimit të fjalorit tonë me zhvillimet e shkencës,

• teknikës, internetit;

Kompetencë digjitale:

- - Të argumentojnë për rreziqet që shfaq interneti në lidhje me respektimin e standardit të shqipes dhe të risive në fjalor;

Kompetencë qytetare:

- -Të shprehin aftësi të larta të kapjes së rasteve të gabimeve e përdorimeve pa vend të fjalëve të huaja, kudo ku i shohin.

Kompetencë personale:

- -Të vlerësojnë të folurin e e tyre, të mësuesit, të prindërve dhe në komunitet

3.Koha: tre muaj

4.Mjetet e nevojshme

1. Fjalori sinonimik, drejtshkrimor, gramatika, leksikologjia etj....
2. Libri : Urgjenca gjuhësore e GJ. Shkurtaj
3. Aparate filmimi: video, fotografi, etj.
4. Gazeta dhe revista
5. Libra shkollorë
6. Videoprojektor
7. Laptop/kamera/celularë
8. Lojë në role: përgatitja e një emisioni televiziv të llojit “Stop ose Fix fare)
9. Qendër zëri

5.Teknika që do të përdoren:

- a. Hulumtimi, kërkimi

- b. Intervistë
- c. Vizitë në ambiente social-kulturore.
- d. Kërkime në internet dhe në komunitet
- e. Redaktim
- f. Konkurs
- g. Lojë në role

6.Hapat që do të ndiqen:

Hapi i parë - Hulumtimi, kërkimi

Mësuesi prezanton projektin për nxënësit dhe i ndan në grupe duke i dhënë detyrën çdo grupi. (në katër grupe me nga 5-6 nxë në s).

Kërkojnë nëpër komunitet /gazeta/media etj shmangie nga norma standard e gjuhës shqipe.

Puna në bibliotekë:

Grupi i parë do të kërkojë në bibliotekë , fjalorin e drejtshkrimit për gjuhën standarde, fjalorin sinonimik dhe përgatit një ekspozitë në shkollë me tabakë të bardhë ku kanë shkruar rregullat e drejtshkrimit të fjalëve të huaja dhe shumë fjalë shqip që zëvendësohen nga fjalë të huaja.

Kërkime në internet

Grupi i dytë do të kërkojnë në internet veprimtari dhe programe drejtshkrimi që janë përgatitur nga kompani të ndryshme që t'i përdorin për qortimin e gabimeve kur punojnë në kompjuter.

Intervistë

Grupi i tretë të organizojë një takim ose një intervistë me një akademik, gazetar, politikan, ose regjistrime për ta në media, kur flasin për probleme të ndryshme.

Video-DVD-filmime

Grupi i katërt do të filmojë shmangie të medias nga gjuha standarde shqipe, në reklama në rrugë, në postera, në median e folur dhe të shkruar etj.

Hapi i dytë - Konkurs (të gjithë).

Shkruani një ese me titull “Qyteti i gabimeve të mëdha”

Hapi i tretë -Shpallje e rezultateve “Eseja më i mirë” .

Hapi i katërt- Grupet prezantojnë punën e tyre dhe mësuesja bën vlerësimin përfundimtar, evidentojnë së bashku përfitimet nga ky projekt.

Hapi i pestë

Përgatitja dhe realizimi i emisionit “Fix fare” ose “Stop” me temën bazë “Qyteti i gabimeve të mëdha”.

Dy grupe nxënësish, i pari “Fix Fare” dhe i dyti “Stop” shfaqin emisionin televiziv.

Shënim:Rekomandohet që ky aktivitet të kryhet në një sallë të madhe ku të jenë të ftuar nxënës edhe nga klasat e tjera, mësues, prindër etj.

II. PËRGJIGJE PËR USHTRIMET E FLETËVE TË KOMPETENCAVE

FLETË KOMPETENCE 1

Elementet e komunikimit

Shënoni poshtë figurës se çfarë tregojnë shenjat e mëposhtme. (4 pikë)

1. Vend pushimi për mjetet e njerëzve me aftësi të kufizuara
2. Tregon se ka restorant
3. Tregon se është aeroporti..
4. Dritat e semaforit
5. Tregon se ka kthesë.

Përcaktoni mesazhin që japin shenjat në tabelë. (5pikë)

Mjaft; dakord; ja; grusht; zero;

Plotësoni pjesën e fjalisë që mungon. (5 pikë)

Shigjeta e përthyer shënon kthesën _____
Drita e kuqe e semaforit tregon që mjeti të ndalet _____
Kryqi i kuq tregon ndihmën e shpejtë _____
Dy gishta të ngritur lart në formë V-je tregojnë _____
Shenja plus mes dy numrave tregon mbledhjen e atyre numrave _____

Shpjegoni kuptimin që kanë shenjat e mëposhtme. (8pikë)

FLETË KOMPETENCE 2

Fonetikë Grupet e zanoreve dhe diftongjet

Plotësoni fjalët me grupet e zanoreve që mungojnë. (9 pikë)

brazil_ia__n, d_ia__bet, d_ia__gnozë, d_ia__log, d_ia__mant, d_ia__metër, financ_ie__r,
spec_ia__l,
indonez_ia__n, industry_ia__l, iran_ia__n, ital_ia__n, mater_ia__l, mil_ia__rd,
olimp_ia__dë, p_ia__no,
psik_ia__tër, port_ie__r

Plotësoni fjalët me zanoret që mungojnë.

Përcaktoni me GZ grupet zanore dhe me DF diftongjet. (9 pikë)

av_ia__cion (.....), bibl_io__tekë (.....), b_io__grafti (.....), delegac_io__n (.....), dispozic_io__n
(.....), fiz_io__nomi
(.....), funks_io__n (.....), iluz_io__n (.....), injeks_io__n (.....), kam_io__n (.....), kinostud_io__n
(.....), mil_io__n (.....),
reaks_io__n (.....), stac_io__n (.....), vers_io__n (.....), v_io__linë (.....), ak_ua__rium (GZ...),
gr_ua__ (GZ...) Të paqartë diftongjet në librin e nx. te ushtrimi 8

Vendosni theksin e fjalëve të nënvizuara. (5 pikë)

Sot, pothuajse në çdo shtëpi ka një telefon fiks dhe, falë satelitëve, është bërë e mundur që të komunikohet me çdo pjesë të globit.

I gjithë rrjeti telefonik mund të përçojë jo vetëm zërin tonë, por edhe fakset ose mesazhet e postës elektronike.

Shkruani dy fjali pyetëse, dy urdhërore dhe dy dëftore.

Vendosni theksin e fjalisë për çdo rast. (6 pikë)

Mësimi i sotëm ishte shumë i thjeshtë. Edhe detyra e shtëpisë është shumë e bukur.

Nuk e ndoqe shpjegimin e mësueses? Kaq I papërgjegjshëm qenke?!

Shko merri shpejt ato çanta! Ktheu në mbrëmje në shtëpi, se kemi punë.

Shkruani tri fjali me tri fjalë me të njëjtën formë (homonime).

Vendosni theksin në çdo homonim. (6 pikë)

Bari-bimë që hanë bagëti, bari ose ilaçi në farmaci; bari- që ruan bagëtinë.

Në muajin maj bari gjallërohet në çdo vend.

Në mal ishte një bari që ruante bagëtinë.

Ky bari që kërkoni, nuk është në farmaci.

FLETË KOMPETENCE 3

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fjalëformim)

Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve në gjuhën shqipe

Fjalët e prejardhura, të përbëra, të përngjitura

Plotësoni tabelën me nga dy raste për çdo mënyrë fjalëformimi. (7 pikë)

Prejardhje me parashtesim; përdor, mbipeshë

Prejardhje me prapashtesim; dorezë, punëtor

Prejardhje me para+prapashtesim; nëndetëse, përgjithësoj

Përbërje; punëdhënës, kryeqytet

Konversion; ndajfolje-emra; buzë, rreth

Përngjitje; fafëfis, gjëgjëzë, thashetheme, trembëdhjetë

Përzierje; I përbotshëm, marrëveshje

Qarkoni fjalët me të njëjtën rrënjë. (5 pikë)

dorezë, peshkatar, përdor, malësor, dorëzim, i duruar, dorac, dënim, përdorim, rrethor

Formoni fjalë të përbëra duke u shtuar një tjetër rrënjë fjalëve të dhëna. (5 pikë)

a. sypetrit _ b. gojëmbël _ c. shtatlartë _ d. fjalëpakë _ e. _ hekurudhë

Vendosni në tabelë fjalët e dhëna sipas mënyrës së fjalëformimit të tyre. (8 pikë)

Të prejardhura: përuroj, nënshkruaj, punëtor, padituri, dorezë, zbukuroj

Të përbëra: orëndreqës, hekurudhë, gurgdhendës, syshkruar, duarartë.

Të përngjitura: përpara, megjithatë, ndonëse, çdokush, ndërkohë

Formoni nga dy fjalë të prejardhura me temat e mëposhtme. (6 pikë)

a. punë -punëtor, punësoj _____

b. mal _ malësi, malësor, _____

c. sport sportist, sportiv _____

d. vesh _ veshje, zhvesh _____

e. dorë dorëzë, dorezë _____

f. i ditur _ dituri, I paditur _____

Analizoni fjalët e nënvizuara sipas kërkesave të tabelës. (5 pikë)

Ja, pra, ky është flamuri ynë i kuq e me shqiponjën dykrenore të zezë në mes. Dhe tani, të gjithë bashkë,

si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për ta mbrojtur atdheun tonë të pavarur.

Parashtesa Rrënja Prapashtesa Tema Mbaresa

- shqip onj shqiponjë n
- dy+ krena ore dykrenore -
pa nda rë i pandarë -
- at+dhe - atdhe un
pa var ur I pavarur -

FLETË COMPETENCE 4

Kompetenca: Leksikologji- Fusha leksikore dhe fusha semantike/Fjalët e huaja

Shkruani fushën leksikore të fjalëve të mëposhtme. (4 pikë)

Fusha leksikore

Figurë gjeometrike; kënd, rreth, katror, trekëndësh, drejtkëndësh, kon, piramidë.

Lëng; ujë, verë, raki, musht, uthull, etj.

Plastikë; gotë, qese, bodile, pjatë, kuti, varëse, stol, karrige, etj.

mjet sportive; top, veshje, çantë, stekë, gjyle, rrjetë, kaluç, pedal, etj.

Shkruani tri fjalë që japin kuptime të tjera (të figurshme ose jo) të fjalëve: (9 pikë)

qumësht: *a.* qumësht i bardhë *b.* qumësht i ëmbël *c.* ngjyrë qumështi

pranverë: *a.* jeta pranverë të qoftë *b.* sot bëri dita pranverë. *c.*

limon: *a.* I verdhë si limoni *b.* ishte limon në fytyrë (sëmurë) *c.* më i thartë se limoni

Zëvendësoni fjalët e huaja me fjalët shqipe përkatëse. (10 pikë)

Nordike-verior, *komunitet-popullsi*, *nacional-kombëtar*, *internacionale-ndërkombëtar*, *direkte-drejtperdrejtë*, *decisive-përfundimtare*, *unik-I vetëm*, *unifikoj-njehtësoj*, *unifikim -njehtësim*, *komerciale-tregtare ose prodhim I rëndomtë*, *apel-thirrje*, *apeloj-bëj thirrje*, *rishikoj*; *precipiton-kullon*, *perfekt-përkryer*, *asimilim-përvetësim*, *tret*, *thith*, *shkrij një popull*

Decade-dhjetëvjeçar, *demonstron -proteston-tregon*, *distributor-shpërndarës*, *fleksibël -I lakueshëm-I ndryshueshëm*,

Aplikoj-provoj

Shkruani fjali duke përdorur fjalën shqipe në vend të fjalës së huaj. (6 pikë)

Konstruksion-ndërtim I brendshëm

Balancë-baraspeshë _____

Komunitet-popullsi _____

Stabilitet-qëndrueshmëri _____

Enigma- e panjohur _____

Shkruani një tregim me temë “Udhëtimi im më i bukur”, ku të përdorni deri në 6 fjalë që formojnë një fushë leksikore që lidhet me këtë temë. (12 pikë)

Fjalët mund të jenë: avion, valixhe, çanta, euro, Francë, Kulla Eifel, Paris etj.

FLETË KOMPETENCE 5**Kompetenca: Leksikologji-Sinonimet, antonimet, homonimet****Gjeni sinonimet e fjalëve të mëposhtme. (5 pikë)**

*Doktor-mjek*_, *ambulance-qendër shëndetësore* , *infermiere- ndihmës mjeke* , *gëzim-kënaqësi*_, *lojtar-futbollist*_,

Radhë- rresht , *social-shoqëror*_, *producent-financues-prodhues*, *central-qendror*_ *aspiratë-perspektivë- dëshirë*, *shpresë për të ardhmen*

Zëvendësoni fjalët e nënvizuara me fjalë të tjera me kuptim të njëjtë ose të përafërt. (8 pikë)

Gjithandej, nata dimërore kishte mbuluar çdo gjë me ujëra, mjegull dhe erë. Duke futur kokën nën mbulesë, dëgjoja mbyturazi zhurmën të mërzitshme të pikave të shiut mbi strehën e madhe të shtëpisë sonë.

Shkruani nga 5 fjali duke përdorur sinonimet dhe antonimet e fjalëve të mëposhtme. (5 pikë)**Sinonime Antonime**

*Komshi-fqinj*_____ *lartësi-ultësi* _____
*Kokë-krye*_____ *mbarësi-prapësi* _____
*Trim-sypatrembur*_____ *tërheq-kthej-jap* _____
Jashtë-përyjashta _____ *pak -shumë* _____
*Afër-ngjitur*_____ *ngrin-shkrin* _____

Shkruani fjali me homonimet e fjalëve të mëposhtme, duke i përdorur në kuptimin e duhur. (3 pikë)

drejtori i shkollës _____
 verë e kuqe _____
 mjeshtri i gdhendjes së gurit _____

Gjeni antonimet e fjalëve të nënvizuara. (6 pikë)

Kur hyri Pavloja nga fundi i varkës, Fania nuk zhdukej gjëkund, as afër, as larg, as mbi ujë, as nën ujë, as para, as pas, megjithëse ai po kërkonte asgjëkund me sy e me duar në sipërfaqe dhe në thelloma. Vështroi para, asgjë, vështroi majtas, asgjë. Në kokën e tij po luftonte vdekja me mortjen, gëzimi me dhembjen, pushtimi, nënshtrimi me ankthin.

Ujërat e gjolit u luhatën disa herë me radhë, nga veriu në jug dhe nga jugu në veri, gjersa gjetën drejtpeshimin e natyrshëm dhe ranë në shkathtësinë e tyre.

Nënvizoni në tekstin e mëposhtëm 5 fjalë, të cilave mund t'u gjejsh homonimet përkatëse. Shkruajini në çift duke iu vendosur theksin. (5 pikë)

Hedh sytë tutje, nëpër ara. Një grup burrash po punojnë me bel. Më larg brinjës së malit duket një tufë delesh. Në vesh më vjen zëri i këmbësorëve, një zë aq i butë, aq i pastër.

Çuditërisht, në këto çaste më zë syri aty pranë, pas shpatullës së një guri, një tufë të vogël me çaj, që lëkundet lehtë-lehtë. Ngrihem dhe rend me vrap përmes shkurreve të ulëta për te shokët e tjerë që presin.

Bel-vegël pune; bel-mesi I njeriut; brinjë-e malit, brinjë e njeriut; vesh-rrobat, vesh-organ I njeriut; zë-folje, zë- i njeriut; çaj-folje, çaj-lëng që pimë; rend-vrapoj, rend- shoqëror; presin-dikë që të vijë, presin- diçka me thikë.

FLETË KOMPETENCE 6

Kompetenca: Morfologji:Klasat e fjalëve/Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme

Lidhni me shigjetë. (5 pikë)

emri Fjalë e ndryshueshme
mbiemri Fjalë e ndryshueshme
përemri Fjalë e ndryshueshme
numërori Fjalë e ndryshueshme
pasthirrma Fjalë e pandryshueshme
folja Fjalë e ndryshueshme
parafjala Fjalë e pandryshueshme
ndajfolja Fjalë e pandryshueshme
pjesëza Fjalë e pandryshueshme
lidhëza Fjalë e pandryshueshme

Vendosni sipas ndarjes në tabelë fjalët e tekstit të mëposhtëm, emërtojini ato. (15 pikë)

Në tavolinën e gjatë ku isha ulur, vura re katër të panjohur, dy burra e dy gra, që po hanin të njëjtën gjë. Zonjat binin në sy nga kapelat me pupla që gati arrinin tavanin.

<i>Fjalë të ndryshueshme</i>	<i>Fjalë të pandryshueshme</i>
<i>Tavolinën, burra, gra, të njëjtën – emër</i>	<i>në – parafjalë</i>
<i>e gjatë-mbiemër</i>	<i>ku-lidhëz</i>
<i>isha ulur-folje</i>	<i>e-lidhëz</i>
<i>vura re-folje</i>	<i>po-pjesëz</i>
<i>të panjohur-mbiemër</i>	<i>në-parafjalë</i>
<i>dy, katër-numërorë</i>	<i>nga, me-parafjalë</i>
<i>hanin, binin në sy, arrinin-folje</i>	<i>gati-pjesëz</i>
<i>gjë, zonjat, kapelat, pupla, tavanin-emra</i>	
<i>që-përemër lidhor</i>	

Lidhni fjalët me klasën përkatëse. (5 pikë)

Emër-lajm, bukë, fitoret
Mbiemër-i shpejtë, i bukur
Folje-gëzoj, flas
Ndajfolje- shpesh, ngado, pak, kur
Pasthirmë-moj, he, obobo, aha.
Parafjalë-me, në, nga, për.
Pjesëz-ja, pikërisht, sidomos.
Numëror-shtatë, dhjetë, tre.
Përemër-imi, ai, unë, cili.
Lidhëza-që, megjithëse, kur.

Lexoni me kujdes fragmentin, emërtoni fjalët dhe vendosini në tabelë. (10 pikë)

Numri i turistëve në botë e kalon shifrën një miliard në vit dhe të ardhurat nga shpenzimet e tyre ndihmojnë ekonominë globale. Ndërsa shpenzimet e shqiptarëve për jashtë u rritën në treqind e tridhjetë e gjashtë milionë euro.

Emër- numri, I turistëve, botë, shifrën, vit, të ardhurat, shpenzimet, ekonominë, e shqiptarëve, euro
Mbiemër- globale
folje – kalon, ndihmojnë, u rritën,
numëror – miliard, treqind e tridhjetë e gjashtë milionë
përemër – e tyre, e (kë? Atë e)

ndajfolje -jashtë
lidhëz – dhe, ndërsa,
parafjalë-në, në, nga, për, në
pjesëz-
pasthirrme -

Shkruani një tekst të shkurtër deri në pesë fjali me temë “Mëngjesi im”.

Emërtoni pjesët e ligjëratës që keni përdorur. (10 pikë)

Fjalët mund të jenë: në mëngjes, ora 8 oo, uniforma, librat, çanta, qumësht, vezë, reçel, krevati, furça, pasta e dhëmbëve etj.

FLETË KOMPETENCE 7

Morfologji:Lakimi i emrave / Emrat e dygjinishëm

Plotësoni tabelën duke vendosur nga 4 emra për çdo lakim. (8 pikë)

Lakimi I –I libri, çelësi, lapsi, lisi,

Lakimi II –u miku, shoku, shtegu, dheu.

Lakimi III - a/ja Kalaja, shtëpia, kutia, fletorja,

Lakimi IV - emrat asnjans të verdhët, të zitë, të ftohtit, të korrat.

Vendosni në tabelë emrat e nënvizuar në tekstin e mëposhtëm. (6 pikë)

Një ditë, në një kopsht çeli një lule e çuditshme. Ngjyrat ishin shpërndarë kudo: mbi male, fusha, kafshë, qiell.

Ajo kishte një disk të zi, të madh, në krye dhe një bisht të gjatë. Të gjitha lulet e tjera e panë me habi.

Trajta e shquar ; ngjyrat, lulet

Trajta e pashquar; ditë, kopsht, lule, male, fusha, kafshë, qiell, disk, krye, bisht.

Vendosni në tabelë emrat e nënvizuar. Plotësojeni atë sipas kërkesave. (10 pikë)

Nëpër filma e nëpër revista kishte parë plot, por atje nuk i kishin lënë asnjë lloj mbrese. Era e ftoi Lelën t'i vinte pranë, por ajo shkoi nga Merita, duke hetuar mos i kanosej ndonjë rrezik. Dhëmbët e saj të bardhë ndritën në dhomë dhe Lelës i iku druajtja.

Emri gjinia rasa trajta numri lakimi

Filma mashkullore rrjedhore e pashquar shumë I parë

Revista femërore rrjedhore e pashquar shumë I tretë

Mbresë femërore kallëzore e pashquar njëjës I tretë

Era femërore emërore e shquar njëjës I tretë

Merita femërore emërore e shquar njëjës I tretë

Rrezik mashkullor emërore I pashquar njëjës I dytë

Dhëmbët mashkullore emërore I shquar shumë I parë

Dhomë femërore kallëzore I pashquar njëjës I tretë

Lelës femërore dhanore I shquar njëjës I tretë.

Shkruani shumësin e emrave të mëposhtëm. (7 pikë)

ky shteg - këto shtigje; ky gëzim - këto gëzime; shpërblim i mirë - shpërblime të mira; një amanet - disa amanete; ky kuptim - këto kuptime; vlerësim i saktë - vlerësime të sakta; ky zhvillim - këto zhvillime; lëng i ëmbël - lëngje të ëmbla.

Shkruani 6 emra të gjinisë mashkullore që mbarojnë në numrin shumës me: (6 pikë)

-e *male, shtigje* _____

-ra - *ujëra, plehra* _____

-a - *libra, emra* _____

++++ = 37 pikë

FLETË KOMPETENCE 8

Morfologji: Shkallët e mbiemrit / Përshtatja e mbiemrit me emrin

Plotësoni emrat me mbiemra duke i përshtatur në rasë e në numër. (10 pikë)

Një ditë të bukur në një kopsht të gjerë çeli një lule e çuditshme. Ngjyrat e shumta ishin shpërndarë kudo:

mbi male të larta, fusha të gjera, kafshë të ndryshme. Ajo kishte një disk të madh, të madh në krye dhe një

bisht të gjatë. Të gjithë e shihnin me habi.

Lakoni mbiemrat duke i shoqëruar me nga një emër. (8 pikë)

Emërore djali i shkathët vajza e zgjuar; fjala e pathënë; koha e mirë

Gjinore ie djalit të shkathët; vajzës së zgjuar; fjalës së pathënë; i e kohës së mirë

Dhanore djalit të shkathët; vajzës së zgjuar; fjalës së pathënë; kohës së mirë

Kallëzore djalin e shkathët vajzën e zgjuar fjalën e pathënë; kohën e mirë

Rrjedhore prej djalit të shkathët; vajzës së zgjuar fjalës së pathënë; kohës së mirë

Nënvizoni mbiemrat dhe përcaktoni shkallën e tyre me P (për pohore),

K (për krahasore), S (për sipërore). (6 pikë)

– *E megjithatë, ky është më i mirë nga ata, (K) – psherëtiu me keqardhje ai dhe vazhdoi:*

– *Planeti i tij i ri(P) është fare i vogël.(S) Nuk ka vend për dy veta.*

Princit të vogël(P) i dhimbsej ai planet tepër i bekuar, (S) për arsyen e thjeshtë (P)se atje kishte njëmijë e katërqind e dyzet e shtatë perëndime.

Formoni fjali ku të përdorni mbiemrat e mëposhtëm në shkallën sipërore. (4 pikë)

e padëgjuar, e pathënë, e pashpresë, e pamasë

Kjo gjë ishte fare e padëgjuar për ne dhe për ata. _____

Ajo vajzë ishte fare e pashpresë për studimet e larta në Itali _____

Deti, tepër I pamasë, dukej sikur do ta përpinte krocerën _____

Ngjarja për të cilën po flisni, është krejt e pathënë deri tani _____

Shkruani fjali duke i përdorur në shumës emrat e mëposhtëm, të shoqëruar me mbiemra. Nënvizoni ndryshimet që ndodhin. (4 pikë)

djalë i zgjuar - Djem të zgjuar kishte klasa e tyre.

vajzë e sjellshme – Vajza të sjellshme dua të kem shoqe.

*dhomë e vogël – Kjo hyrje ka dhoma të vogla
këngë e re Kemi dëgjuar shumë këngë të reja kohët e fundit nga kompozitorë të rinj.
vit i mbarë – Në bujqësinë tonë do të ketë vite të mbara prodhimi*
++++ = 32 pikë

FLETË KOMPETENCE 9

Morfologji: Zgjedhimi i foljes në mënyrat dëftore dhe lidhore të formës joveprore

Nënvizioni foljet, përcaktoni zgjedhimin e tyre. (5 pikë)

Cicërimat e tij ishin të ngjirura. (I veçantë)

U krodh në ujë dhe u lehtësua. (I dytë, I parë)

Një forcë e çuditshme e hodhi atë në luftë për të mbrojtur të birin. (I dytë)

Po mendohej se ç'titull t'i vinte esesë. (I parë, I tretë)

Prej së largu dëgjoheshin notat e pianos. (I parë)

Foljet *dua, vesh, mbroj, pëlqej*, shkruajini në formën joveprore të mënyrave dëftore dhe lidhore, në vetën e tretë, koha e tashme. (4 pikë)

duhet; të duhet; vishet; të vishet; mbrohet; të mbrohet; pëlqehet; të pëlqehet

Tregoni mënyrën dhe formën (veprorë/joveprorë) e foljeve në tekstin e mëposhtëm. (5 pikë)

Qeni im po i afrohej ngadalë harabelit të vogël. (joveprorë) Papritur, nga një dru aty afër, u sul si një gur mbi fytyrën e tij një harabel i murrëmë, i mplakur. (joveprorë) Ai kërceu nja dy herë mbi gojën e hapur me dhëmbë të bardhë të qenit tim. (joveprorë)

Ai u sul për të shpëtuar dhe për të mbrojtur me trupin e vet birin e tij. (joveprorë) Unë vura re se trupi I dridhej nga tmerri. (veprorë)

Zgjedhoni foljen *mbaj* në kohën e tashme të mënyrave kushtore, habitore dhe dëshirore. (6 pikë)

Veta kushtore habitore dëshirore

Unë do të mbaja mbajtkam mbajtsha

Ti do të mbaje mbajtke mbajtsh

Ai/ajo do të mbante mbajtka mbajttë

Ne do të mbanim mbajtkemi mbajtshim

Ju do të mbanit mbajtkeni mbajtshi

Ata/ato do të mbanin mbajtkan mbajtshin

Ktheni foljet e dhëna në mënyrën urdhërore dhe formoni fjali me to. (5 pikë)

hedh – hidh. Hidhi këto plehra në kosh.

pres – prit dikë; pri diçka me thikë. Prit këtu, se nuk vonohem.

akuzoj – akuzo Akuzo kot, por do të marrësh dënimin e merituar.

Dëmtoj – dëmto. Mos dëmto ato vazo të bukura me lule!

Përçmoj- përçmo Mos e përçmo vendlindjen tënde se është e varfër.

FLETË KOMPETENCE 10

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)

Lidhni fjalitë me funksionin përkatës të formës së pashtjelluar. (4 pikë)

a. Ata po ktheheshin duke kënduar. (Mënyror)

b. Duke folur shpejt, po i merrej fryma. (shkakor)

c. Duke punuar pa u lodhur arrin gjithçka. (kushtor)

d. Duke përfunduar dielli, ata lanë punën. (kohor)

Formoni fjali ku foljet *ha, bie, vij* të përdoren në formën e pashtjelluar mohore. (3 pikë) pa ngrënë, pa rënë, pa ardhur

- Unë nuk nisem për në shkollë pa ngrënë mëngjesin.
- U nis për në punë pa rënë dielli.
- Nuk do të nisemi në ekskursion pa ardhur prindërit e Benit.

Plotësoni tabelën me format e pashtjelluara. (15 pikë)

Folja *duke + pjesore pa + pjesore për të + pjesore me të + pjesore një të + pjesore*
Dëgjoj; duke dëgjuar; pa dëgjuar; për të dëgjuar; me të dëgjuar; një të dëgjuar
Rroj; duke rrojtur; pa rrojtur; për të rrojtur; me të rrojtur, një të rrojtur
Shikoj- duke shikuar pa shikuar, për të shikuar; me të shikuar; një të shikuar. (parë)

Nënvizoni me një vijë foljet ndihmëse dhe me dy vija foljet gjysmëndihmëse. (5 pikë)

Pylli nis e vetëtin nga tisi i florinjti i rrezeve të diellit, që thuhet mes shkëlqimit të gjetheve të pemëve. Ketrat fillojnë e hidhen nga njëra degë të tjetra dhe mbajnë në duart e vockla boçe pishe të hapura. Aromat e luleve, të barit dhe të drurëve janë përzier së bashku dhe kanë krijuar një ndjesi të çuditshme, si jashtëplanetare. Kjo gjendje të bën të nisësh të ëndërrosh për gjëra të gëzuara.

Shkruani pesë fjali, ku të përdorni foljet gjysmëndihmëse: (5 pikë)

vazhdoj – Vazhdoi të bjerë shi pa pushim.
mund – Mund të vish më shpejt për ta marrë fëmijën nga shkolla.
Filloj- Ai filloi të punojë pa u lodhur për provimin e maturës.
nis - Alma, pa drujtje, nisi të përshkruajë rrugën për të dalë nga pylli.
duhet – Duhet të punojmë më shumë për testimin e gjuhës shqipe.
++++
++++ = 57 pikë

FLETË KOMPETENCE 11

Kompetenca: (Morfologji) Përemrat vetvetorë, dëftorë, pyetës
Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor

Lidhni fjalitë që kanë trajta të shkurtra të njëjta. (5 pikë)

- Ma trego edhe mua. d. Tregoma edhe mua.
- I fol djalit seriozisht. b. Foli djalit seriozisht.
- Më tregoni me zë të ulët. c. Tregomëni me zë të ulët.
- Na i trego përrallat. a. Tregona përrallat.
- Ua trego me zë të lartë. e. Tregojua me zë të lartë.

Nënvizoni trajtat e shkurtra në fjalitë e mëposhtme. (4 pikë)

- Ai ua thoshte gjithnjë një fjalë të urtë.
- Shtëpia e vjetër i kishte krijuar asaj një ndjenjë frike.
- Neve na kishte marrë malli për të shkuar në mal.
- Mësuesi kishte folur me ta dhe ata i kishin premtuar se do të vinin.

Shkruani fjali duke përdorur trajtat e shkurtra të bashkuara. (11 pikë)

Ma mori mendja se do të vije. M'i more të gjitha fletoret e reja.
Ta dhashë librin tënd. T'i mblodha ty këto luleshtrydhe.
Ia lexova vjershën që kisha shkruar la hapa dyert e jetës djalit tim.
Na e dërgoi motra pakon nga Anglia. Na i sollën të gjitha valixhet nga aeroporti.

Jua mbarova porosinë që më dhatë Jua dimë hallet, por s'kemi ç'bëjmë tani.
Ua tregova prindërve këngën e re të festivalit. Ua them pa frikë të vërtetën prindërve.

Lidhni grupin e përemrave me llojin përkatës. (4 pikë)

- a.* vete, vetvete *b.* vetvetor
b. kush, cili, cila *c.* pyetës
c i këtillë, ai, ky *a.* dëftor (*I atij- pronor*)
d. unë, ti, ai, ajo *d.* vetor

Zëvendësoni emrat me shkronja të zeza me përemra dëftorë. (6 pikë)

Ky ishte **burri** (ai) që kishte shpëtuar **fëmijën** (atë) që kishte humbur.
Profesori i anglishtes është **profesori** (ai) i vitit të kaluar.
Këpucët (ato) që kanë qenë shumë të përdorshme tre vjet më parë, tani janë jashtë mode.
Personat (ata) që tradhtojnë miqtë, nuk mund t'i mbash pranë.
Shijet e mia për ushqim janë pothuajse të njëjta me **shijet** (ato) të vëllait tim.

Shkruani tri fjali duke përdorur nga një përemër vetvetor, dëftor, pyetës dhe nga një trajtë të shkurtër të bashkuar. (6 pikë)

I dukej vetja si më I zoti nga të tjerët.

Kjo detyrë e kishte vënë para përgjegjësisë, prandaj duhet të kryhej me sukses.

Kush e dinte se do të ndodhte kështu?

+++++ = 36 pikë

Fletë kompetence 12

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)

Lidhëzat, pasthirrat, pjesëzat

Lidhni grupet e lidhëzave me llojin përkatës. (4 pikë)

- a.* si, siç, ashtu si, ashtu siç, sikur *b.* mënyrore
b. që, me qëllim që *d.* qëllimore
c. sa, saqë, aq sa *c.* sasiore
d. se, sepse, ngaqë, meqenëse *a.* shkakore

Plotësoni fjalitë duke përdorur lidhëzat në kllapa.

Përcaktoni llojin e lidhëzës. (4 pikë)

Ata qëndronin si të ngrirë (kur)panë ujkun të afrohej. (kohore)
Ata qëndronin si të ngrirë (sepse)u frikësuan nga deti I tërbuar (shkakore)
Ata rrinin si të ngrirë (edhe pse) shokët u jepnin zemër.(lejore)
Ata rrinin si të ngrirë (sikur) u shemb e gjithë shtëpia (mënyrore)

Nënvizoni lidhëzat dhe ndajini në tabelë sipas llojit që i përkasin. (11 pikë)
(me të kuqe-bashkërenditëse; të nënvizuara-nënrenditëse)

Ajo ndjeu vështrimin e tyre dhe fytyra iu skuq.
Të pritëm gjatë, por ti prapë nuk gjete kohë të na takosh.
Edhe pse po vuante nga të ftohtit, ai nuk tërhiqej.
Donte të arrinte patjetër atje, megjithëse koha nuk po i premtonte.
Ai e dinte se po të mposhte frikën, do të kishte mundësi të ecte përpara.
Ishte aq i lodhur sa po e zinte gjumi në këmbë.
Ajo e dinte se duhej të përpiquej më shumë, që të arrinte fitoren.
Kur mbërriti në vendin e ngjarjes, pa se flakët ishin shuar.
Alma e kuptoi se çfarë po përpiquehin t'i thoshin.
Ajo që tha Elvisi ishte shumë e bukur, por nuk e kuptuan të gjithë.
Ani nuk u kualifikua, sepse nuk plotësoi kriteret.

Shkruani tri fjali duke përdorur pasthirrma që shprehin nxitje, habi, frikë. (3 pikë)

Obobo, ku qenka fshehur ky! _____
Ah, sa të shijshme janë qershitë në kohën e vet! _____
Po hajde, more djalë, se na mori malli ! _____

Shkruani tri fjali duke përdorur pjesëza përforcuese, pohuese, pyetëse, emocionuese. (3 pikë)

Si urdhëron, do të bëj si thua zotrote! _____
A ka fjalë më të ëmbël se fjala e nënës? _____
Merre pra! Është jotja, nuk ta falën!
+ + + + = 25 pikë

FLETË KOMPETENCE 13

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)

Kryefjala

Nënvizioni kryefjalët në fjalitë e mëposhtme.

Tregoni me se janë shprehur ato. (5 pikë)

Pemët e mbushura me fruta lëkundeshin nga era. (_GE _____) Lëkundja e pemëve dhe era që frynte, krijonin një atmosferë magjike. (_GE dhe emër). Gjethet e zverdhura të pemëve binin vazhdimisht në tokë. (_GE _____) Ato tërhiqnin vëmendjen e kalimtarëve. (_përemër)
Treni mbërriti me vonesë. (_emër) Mbërritja e tij me vonesë i zemëroi paksa pasagjerët. (_GE _____)

Zgjeroni me nga dy-tri fjalë grupin e kryefjalës. (8 pikë)

Vajza doli nga klasa. **Vajza e veshur me fustan të bardhë** doli nga klasa.

Libri është mbi tavolinë. Libri im i matematikës
Fluturat lodronin mbi lule. Fluturat e bukura krahëshkruara
Ecja të bën mirë për shëndetin. Ecja me hapa të shpejtë
Shiu nuk kishte të ndalur. Shiu i rrëmbyeshëm i ditës së sotme.

Gjeni kryefjalët në tekstin e mëposhtëm dhe ndryshoni vendin e tyre në fjali pa e ndryshuar kuptimin e saj. (6 pikë)

Përrjashta, nata e ftohtë dimërore kishte mbështjellë çdo gjë me ujëra, mjegull dhe erë.
Duke futur kokën nën jorgan, unë dëgjoja mbyturazi zhurmën e pikave të shiut.
I përfytyroja pikat e panumërta tek rrokulliseshin në faqet e pjerrëta të çatisë.
Nata e ftohtë dimërore, përrjashta kishte mbështjellë çdo gjë
Kishte mbështjellë çdo gjë përrjashta nata e ftohtë dimërore.
Çdo gjë kishte mbështjellë përrjashta nata e ftohtë dimërore
Çdo gjë kishte mbështjellë nata e ftohtë dimërore përrjashta
Unë dëgjoja mbyturazi zhurmën e pikave të shiut, duke futur kokën nën jorgan
Dëgjoja mbyturazi zhurmën e pikave të shiut, duke futur kokën nën jorgan.
Dëgjoja mbyturazi, duke futur kokën nën jorgan, zhurmën e pikave të shiut.

Nënvizioni kryefjalët dhe tregoni me se janë shprehur ato. (5 pikë)

– U bë vonë, – tha Lena, (emër) – roja i konviktit(GE) përsëri do të bëjë fjalë. Eja të ikim. – U ngritën nga stoli dhe ecën krah për krah përgjatë gjithë rrugës. Tani i kishin kthyer shpinën fushës dhe hijet e tyre, (GE) të sajuara nga hëna, zgjateshin e lodronin tutje në asfaltin e zi, sikur të mos kishin asnjë lidhje me ta. Kur hynë në qytet, rrugët(emër) ishin fare të boshatisura. Një polic, (GE) mbështjellë me mushama të zezë, pinte cigare përpara portës së një ambassade. Diku thellë, nga ca rrugë anësore, dëgjoheshin zëra.(emër)

FLETË KOMPETENCE 14**Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)****Kallëzuesi foljor i thjeshtë dhe kallëzuesi foljor i përbërë****Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën****Plotësoni fjalitë me kallëzuesin e duhur. (10 pikë)**

Vajza deshi _të ulej dhe pa se pranë tryezës ndodheshin tri karrige. Njëra ishte e lartë, e Ari Efendiut. Tjetra, e mesmja, e zonjës Areshë, që rrinte pranë tavolinës. E treta, e ulët e me jastëk të kaltër, e Arushëzës, që rrinte pranë krevatit. Ajo u ul në karrigen e lartë dhe u rrëzua. Pastaj u ul tek e mesmja, por dhe aty nuk ndenji rehat. Më në fund, u ul te karrigia e vogël. Kjo ishte _më e mira. Vajza mori tasin e kaltër në gjunjë dhe nisi të hajë.

Në fjalitë e mëposhtme, qarkoni kallëzuesit foljorë dhe nënvizoni ata emërorë. (5 pikë)

Ai ishte mbret. Sa qe në fron, ngjallte frikë, shumë frikë. Gjithnjë rrinte i ngrysur, sepse gjithnjë ishte Ipakënaqur. Njerëzit nuk e donin. Nuk ishte ai i mëparshmi, zemërgjerë dhe i ndershëm, ndaj njerëzit e përzunë. Tani është larg tyre. Ai ishte i vetmuar dhe i pashpresë.

Plotësoni fjalitë e mëposhtme duke përdorur foljen jam sipas funksionit të dhënë. (9 pikë)

Shtëpia ime është (këpujë) e re dhe e bukur
 Shtëpia ime është (kallëzues) në rrugën “Myslym Shyri”
 Shtëpia ime është (folje ndihmëse) ndërtuar kohët e fundit
 Macja ishte (këpujë) e bardhë.
 Macja ishte (kallëzues) afër rrugës, ku desh e shtypi makina.
 Macja ishte (folje ndihmëse) rritur shumë.
 Ai qe (këpujë) mësues në shkollën tonë në ato vite
 Ai qe (kallëzues) edhe tek ne për drekë.
 Ai qe (folje ndihmëse) përpjekur shumë për të mirën e atdheut.

Gjeni kallëzuesit dhe grupojini sipas ndarjeve në tabelën e dhënë. (15 pikë)

Dhelpër e mallkuar/ doli nga shtëpia/ E kish' marr' uria/ Vate për të gjuar/ Sheh një pjergull rrush plot/ Bën t'i zërë e s'i zë dot/ Dhe si s'mundi dot t'i zërë/ Tha: “Qenkan rrush të pabërë”/ S'janë, s'janë për mua/ Nuk i dua, nuk i dua/ Le t'i hajë ndonjë tjetër/ Ç'mund të thoshte zonja dhelpër?

Kallëzues
 foljor i thjeshtë foljor i përbërë emëror
 277 kish marr' Bën, zë
 vate, sheh, t'i zërë, zë, tha mund të zërë qenkan të pabërë
 janë, dua, t'i hajë mund të thoshte

FLETË KOMPETENCE 15**Kompetenca: Foljet ndihmëse****Nënvizoni me një vijë kallëzuesit foljorë të thjeshtë dhe me dy vija kallëzuesit foljorë të përbërë. (4 pikë)**

Dijetari i vendeve të ftohta, që ishte i ri dhe i mençur, e ndiente veten si në ndonjë furrë të zjarrtë. U dobësua përherë e më shumë. Madje, hija e tij filloi të zvogëlohej, sepse dielli s'e linte pa prekur edhe atë. Vetëm pasi perëndonte dielli, ai niste të dukej si duhej. S'kishte pamje më zbavitëse!

Formoni fjali ku foljet filloj, nis, të jenë një herë pjesë e kallëzuesit foljor

të përbërë dhe një herë pjesë e kallëzuesit të thjeshtë foljor. (4 pikë)

P.sh.: a) Albana filloi të përgatiste mësimet. b) Mësimi filloi.

Herët në mëngjes filloi të bjerë një shi I rrëmbyeshëm në Tiranë.

I fillove mësimet për t'i përgatitur? _

Po nise të bësh naze për ushqimin, do të kesh probleme me shëndetin.

Avioni për në Itali u nis në orën 14.00 nga Tirana. _

Nënvizioni kallëzuesit e përbërë. Shkruani përbri secilës fjali çfarë tregon folja gjysmëndihmëse (fillim, vazhdim, mbarim të veprimt, mundësi, domosdoshmëri). (4 pikë)

Ti nuk mund të jesh zana ime, Ding. (Mundësi)

Ela vazhdoi të këmbëngulte me pyetje. Vazhdim)

Macja rendi te tasi i vet dhe filloi ta lëpinte. (fillim)

Zoti kryetar nisi të qeshte, por atë nuk e shoqëroi njeri. (fillim)

Ktheni në numrin shumës kryefjalët e fjalive të mëposhtme.

Nënvizioni ndryshimet që ndodhin. (4 pikë)

Dora iu drodh. Duart iu drodhën.

Shkrepësja u fik. Shkrepëset u fikën.

Vajza vazhdoi rrugën. Vajzat vazhduan rrugën.

Ky djalë, me siguri do të bëhet shumë i mençur. Këta djem me siguri do të bëhen shumë të mençur (edhe folja kallëzues vihet në shumës, veta e tretë)

++++++ = 51 pikë

FLETË KOMPETENCE 16

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë) - Kundrinori

Nënvizioni kundrinorët dhe përcaktoni llojin e tyre. (10 pikë)

Vendin e pishës për ndriçimin e shpellës e kishte zënë dheu i shkarë prej kohësh. (I drejtë)

Kjo gjë i bëri përshtypje Melit. (I zhdrejtë)

Ua shtrëngoi dorën atyre që e quanin veten kapedanë. (I drejtë, I zhdrejtë, I drejtë)

Përcolli shikimin e mprehtë në kubetë e shpellës. (I drejtë)

Shikoi ngultas secilin nga burrat, pastaj iu drejtua Gath Kërcëllimës. (I drejtë, I zhdrejtë)

Në fjalitë e mëposhtme nënvizioni kundrinorët.

Tregoni me se janë shprehur. (12 pikë)

Lakmia pas pronës na bën kusarë e jonjerëzorë. (trajtë e shkurtër)

Kur njeriu do të faktojë diçka, mund të faktojë gjithçka. (përemër I pacaktuar)

Do të kemi gjithmonë kohë për t'u plakur. (GE)

Njeriu jeton me të ardhmen dhe vetëm pak me të tashmen. (emër)

Të falësh vërtet, do të thotë ta marrësh e ta pranosh tjetrin ashtu siç është. (përemër+trajtë e shkurtër)

Mos t'i kërkosh pendesë dhe besnikëri të verbër deri në nënshtrim. (GE+trajtë të shkurtër)

Plotësoni fjalitë e dhëna duke i përgjigjur pyetjeve.

Nënvizioni kundrinorët. (5 pikë)

Harri mezi po priste (kë) shokun e tij

Ai po mendonte (për kë?) për eksperimentin e djeshëm.

Fëmijët nuk kujtoheshin (për se?) për të ngrënë mëngjesin

Roni nuk u ishte përgjigjur (kujt?) pyetjeve të shumta.

Këtë javë, Albi do të blejë (çfarë) një top futbollli.

Shkruani fjali duke i përdorur fjalët e mëposhtme si kundrinorë të drejtë dhe kundrinorë të zhdrejtë. (6 pikë)

Këngët e festivalit I pëlqyen të gjithë sa ishin aty.

Jehonën e këngëve e përcjellin të gjitha radiot lokale.

Flakën olimpike të lojërave evropiane e ndezi një artiste greke.
Ata u kishin dhënë këngëve tekste shumë të bukura.
Jehonës I erdhi një letër nga prindërit.
Flakës së zjarrit I hodhën ujë të bollshëm që të shuhej.

Fjalët e nënvizuara vendosini në tabelë sipas funksionit që kanë në fjali. (6 pikë)

Kryefjalë Kundrinor

Fëmijët Mirin e

Ai për detin, më

Ajo skuadër Më

Kujtimet e fëmijërisë.

Mirin e lavdëruan para shkollës.

Atë mbrëmje, fëmijët ishin të shqetësuar.

Shpesh, ai më fliste për detin.

Më ka dalë nga zemra ajo skuadër.

Nuk harrohen kujtimet e fëmijërisë.

++++ = 39 pikë

FLETË KOMPETENCE 17

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)= Rrethanori

Nënvizioni rrethanorët. Shkruani në kllapa llojin e tyre dhe me se janë shprehur. (8 pikë)

Java kaloi shpejt. (sasië.) Do të vish edhe ti te bregu? (vendi)

Sot më erdhi mirë që fole. (kohe.) E pëlqyen shumë atë shfaqje. (sasië)

Vendosni në vendet bosh fjalët e duhura:

shumë, lart, të katra, si piramida, varg–varg, si polen, qetësisht. (7 pikë)

Atë mbrëmje të bukur vjeshte qielli shkëlqente shumë. Dritat e festës, që ishin vendosur varg-varg në të katra pemët e larta, që ngriheshin si piramida përreth kalasë, Shkonin lart te Sheshi i Tabakëve. Mbi qytetin plak kishte rënë një tis i purpurt ngjyrash që binte si polen mbi kokat e njerëzve që shëtitnin qetësisht atë buzëmbremje.

Zgjeroni fjalitë me nga dy rrethanorë. (10 pikë)

Dëgjohej vetëm kërcitja e zjarrit. (në vatër, pranë oxhakut)

Ai merrte më shumë. (ushqime në Big-market për të gatuar gjatë javës)

Ata nuk i flasin më njëri-tjetrit. (as në punë, as në rrugë)

Unë kam shumë miq. (në Tiranë dhe në Korçë)

Kinemaja është mbyllur. (për t'u rinovuar skena deri në fund të qershorit)

Shkruani nga një fjali, ku fjalët e dhëna të shërbejnë si: (5 pikë)

rrethanor shkaku: *për mungesë kohe .Nuk e mbaroi projektin për mungesë kohe.*

rrethanor mënyre: *pa pushim Këndonte pa pushim në dasmën e vëllait.*

rrethanor vendi: *në lartësi Në lartësi të Dajtit shkon me teleferik.*

rrethanor sasië: *tre-katër .Dëgjoji tri-katër këngë dhe e mbylli radion.*

rrethanor kohe: *pa rënë vesa U ngrit herët, pa rënë vesa për t'u ngjitur në mal.*

Në fragmentet e mëposhtme nënvizioni rrethanorët dhe ndajini në tabelë sipas llojit të tyre. (7 pikë)

Aroma e dyllit i kujtoi mjaltin e atyre anëve e që ka aromë dëllinje prej kullotës së malit të Gjerë.

Kronisti vështrioi majën e penës dhe iu duk sikur aty qenë grumbulluar përleshje, ngjarje, vrasje,

intriga që pritnin të shtriheshin në letër. Mungonte vetëm një emër... Kronisti përshkroi gjithë betejën

e përgjakshme. Shumë herë qenë mundur për mungesë armatimi. Po edhe më shumë qenë ngritur përsëri nga inati dhe zemërimi që u vlonte në gj.

Rrethanorë

Vendi; në letër; në gj; aty

kohe -

mënyre; përsëri

sasie; shumë herë

shkaku; prej kullotës; për mungesë armatimi, nga inati dhe zemërimi

qëllimi-

Plotësoni fjalitë e mëposhtme me nga një rrethanor qëllimi. (4 pikë)

Fondet u mbledhën për t' u ndërtuar rruga në lagjen tonë.

U hapën regjistrimet për të marrë pjesë në konkursin e recituesve.

Duhet përdorur ky kod për të mbajtur të bllokuar këtë program në kompjuter.

Shtëpia e tyre është gjithnjë e hapur për të pritur miq të mirë.

FLETË KOMPETENCE 18

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe me nënrenditje

Nënvizoni fjalitë e përbëra dhe lidhëzat e tyre. (3 pikë)

Rrugët, kthesat, qoshet, pragjet e shtëpive, shtyllat e telefonit dhe gjithçka tjetër ishin si të derdhura në gur, në largësi të përcaktuara me centimetra nga njëra-tjetra. Kurse te babazoti, çdo gjë ishte e butë dhe e ndryshme.

Atje, rrugët dhe rrugicat bënë sikur harronin vendin nga kalonin një javë më parë dhe, qetë-qetë e pa bujë, zhvendoseshin nga e majta apo nga e djathta.

Përcaktoni llojin e fjalisë (me bashkërenditje/me nënrenditje). (3 pikë)

U ngrit në këmbë dhe rregulloi syzet mbi hundë. (bashkërenditje)

Dhoma e saj u kthye në një sallë, ku ajo kalonte pasditen duke luajtur në piano. (nënrenditje)

Rrezet e diellit përhapeshin dhe zgjonin çdo gjë me ngrohtësinë e tyre. (bashkërenditje)

Gjeni dhe zëvendësoni lidhëzat bashkërenditëse me një nga këto lidhëza:

po, kurse, jo vetëm... por as, e. (4 pikë)

Në shtëpi dhe në lagje nuk kishte ndryshuar asgjë, por te fusha përtej lumit diçka po ndodhte.

Kalimtarët qëndronin shpesh në rrugët dhe në rrugicat, ktheheshin nga lumi dhe vështronin të menduar për një kohë të gjatë. Gjyshja dukej më e qetë, megjithatë nuk e fshihte dot një trazim të brendshëm. As nuk fliste, as nuk i ngrinte sytë nga toka.

Shkruani fjali të përbëra me bashkërenditje duke përdorur: (4 pikë)

lidhëza shtuese: Gjyshja jo vetëm që dukej më e qetë, por as e fshihte dot gëzimin e saj për nipin.

lidhëza veçuese: Ose shkojmë në stadium, ose e shohim ndeshjen në television.

lidhëza kundërshtore: Ai e lexoi shpejt librin, por nuk mbajti asnjë shënim.

lidhëza përmbyllëse; Iu prish makina rrugës, prandaj u vonua për në concert.

Nënvizoni me një vijë lidhëzat bashkërenditëse dhe me dy vija ato nënrenditëse. (5 pikë)

Djali rrinte në breg të detit, ku e kishin syrgjynosur armiqtë, dhe priste se mos shihte ndonjë barkë, e cila do të sillte lajme nga atdheu. Hera-herës i shkonin sytë në qiell dhe vështronin një lejlek. I ngjante se ai lejlek i vinte nga Shqipëria, nga vendlindja. I riu tregonte se kishte mbajtur në shtëpi një shpend të tillë dhe e kishte ushqyer. Për ta dalluar, i kishte vënë në këmbë një pe të kuq.

Plotësoni fjalitë e mëposhtme me nga një pjesë fjali. Qarkoni lidhëzat dhe përcaktoni llojin e tyre. (5 pikë)

Ju qenkëshit më të shpejtë se kishit bërë stërvitje (shkakore)

Ai e vënkësh kapelën më shpesh se ç'ë mendoja. (krahasore)
Ata e paskëshin kthyer librin më vonë se nuk e kishin mbaruar së lexuari. (shkakore)
Ajo paska çuar fjalë më herët se ç'ë kishin menduar. (krahasore)
Ne paskëshim pasur vështirësi më shumë se të ishim në mal. (Krahasore)

FLETË KOMPETENCE 19

Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë) Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë

Nënvizioni ligjëratat e drejta. (5 pikë)

“Fushata zgjedhore në Kosovë u zhvillua e qetë”, deklaruan vëzhguesit e huaj.

“Po, - tha i vendosur, - na duhet të ecim përpara pa u ndalur”.

Ai gjithmonë pyeste me habi: “Po si është e mundur që nuk po zgjidhet mungesa e dritave te ne?!”.

“Kur do të shkojmë bashkë në bibliotekë?”, - pyeste vajza nënën e vet.

Në librin e nxënësit shkruhet: “Edukimi qytetar, as nuk fillon dhe as nuk përfundon në shkollë”.

Shkruajini ligjëratat e drejta të ushtrimit 1, duke i kthyer në ligjërata të zhdrejta. (5 pikë)

- Vëzhguesit e huaj deklaruan se fushata zgjedhore në Kosovë u zhvillua e qetë.
- Ai tha i vendosur se duhet të ecim përpara pa u ndalur.
- Ai gjithmonë pyeste me habi se si është e mundur që nuk po zgjidhet mungesa e dritave tek ne.
- Në librin e nxënësit shkruhet se edukimi qytetar nuk fillon dhe nuk përfundon në shkollë.

Në ligjëratat e drejta vendosni shenjat e pikësimit që mungojnë. (6 pikë)

“Njeriun, - thotë një fjalë e urtë, - prite nga veshja dhe përcille nga mendja”.

Nuk thonë kot: “ Punën e sotme mos e lër për nesër.”

“I çuditshëm je, mor djalë, - foli e nxehur nëna. - Dhoma jote është gjithmonë rrëmujë.”

“Edhe në vështirësi, - më thoshte babai, - njeriu s’duhet të bëhet zemërlepur.”

“Kur do të zhvillohet konkursi i fjalës artistike?” - pyetën nxënësit.

“E paske shkruar shumë bukur këtë poezi, - i tha mësuesja Erës.

Shkruajini ligjëratat e drejta të ushtrimit 3, duke i kthyer në ligjërata të zhdrejta. (6 pikë)

- *Një fjalë e urtë thotë që njeriun prite nga veshja dhe përcille nga mendja.*
- *Gjithmonë thonë që punën e sotme të mos e lëmë për nesër.*
- *Nëna më foli e nxehur se dhoma ime është gjithmonë rrëmujë.*
- *Babai më thoshte se njeriu s’duhet të bëhet zemërlepur edhe në vështirësi.*
- *Nxënësit pyetën se kur do të zhvillohet konkursi I fjalës artistike.*
- *Mësuesja I tha Erës se e kishte shkruar shumë bukur poezinë.*

Në thëniet e mëposhtme, ktheni ligjëratën e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë (4 pikë)

“Gjuha shqipe, - ka thënë Eqerem Çabej, - është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij”.

“Gjuha shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe i përparimit”, - ka thënë një albanolog i shquar.

Gjergj Fishta ka thënë: “Gjuha shqipe është një pasuri fjalësh dhe është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen me të klasikët e çdo kombi, e çdo kohe”.

Në një proverb popullor thuhet: “Gjuha ruhet atje ku shkruhet”.

Eqerem Çabej ka thënë se gjuha shqipe është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij.

Një albanolog I shquar ka thënë se gjuha shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe përparimit.

Gjergj Fishta ka thënë se gjuha shqipe është një pasuri fjalësh, ka ardhmëri e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen me të klasikët e çdo kombi, e çdo kohe.

Një proverb popullor thotë se gjuha ruhet atje ku shkruhet.

FLETË KOMPETENCE 20

Drejtshkrim

Plotësoni tabelën me shembuj sipas rastit. (6 pikë)

Vihet pikë: Shembuj

- në fund të një fjalie dëftore;
Gjuha shqipe ruhet atje ku shkruhet.
- pas një fjale a togu fjalësh ose pas një pjesëze me vlerën e një fjalie kur nuk shqiptohen me intonacion pyetës a thirrmos;
Pranverë e harlisur. rrugët dhe parqet plot gjelbërim.
- Në fund të një fjalie të përbërë.
Pyete motrën se kur do të fillojë koncerti.

Shkruani në shumësin e pashquar fjalët e mëposhtme. (3 pikë)

- centrale....., elefantë....., laborantë....., aparate... shpate....., kafaze.....
- dembelë....., hotele....., tunele....., studentë....., klientë....., portierë.....
- horizonte....., shkopinj....., feudalë....., punëtorë, përtacë....., afrikanë.....

Shkruani në shumësin e shquar emrat e mëposhtëm. (2 pikë)

- bijtë , deshtë....., djemtë....., barinjte....., miqtë....., bukuritë....., kalatë....., retë.....
- rrufetë....., folehtë....., mirësitë....., pyjet....., armiqtë....., përrrenjtë....., zogjtë....., lumenjtë....., shkëmbinjte.....

Shkruani si duhet fjalët që janë shkruar gabim. (7 pikë)

Lyy-lyej, i pëlqyeshëm, pyetje, thyesë, grua, hetus-hetues, pastruse-pastruese, punokam-punuakam, I afrushëm-I afrueshëm, vijushmëri-vijueshëm, shkruajtur-shkruar, thyhet, i lakushëm- I lakueshëm, ndërtuse-ndërtuese.

Në tekstin e mëposhtëm plotësoni fjalitë me fjalët që mungojnë. (9 pikë)

Këto fjalë qenë të papritura. Ne e dinim dashurinë e vogëlushes për lulet. Ballkoni ynë qe kthyer në një lulishte: tulipanë, karafila, lulekine, trëndafila, begonja, lule shpate, fikuse, zymbyla. Unë kisha rregulluar edhe një dërrasë si raft, ku mami, së bashku me Anën, patën renditur një sërë tjetër me saksi. Vogëlushja u gëzohej luleve. Rrinte me orë të tëra aty në ballkon. I njomte çdo mëngjes, u gërmonte dheun saksive, hiqte gjethet e thata, lidhte lehtë e me kujdes pas hekurave ndonjë kërcell të lëvarur.

++++ = 27 pike

FRAGMENTE PËR DËGJIM

Mësimi: *Kërkesa, shpjegime, keqkuptime*

Fragmente situatash komunikimi

1. Joni, prapë i ke marrë ngjyrat e mia? I ke harxhuar të gjitha, dhe mua më duhen. Sa herë të ka thënë mami që të mos i trazosh gjërat pa leje.
2. Aulona, në takimin me prindër, mësuesja më tha që nuk e ke vëmendjen në mësim. Të njëjtën gjë më kanë thënë edhe mësuesit e tjerë. A ka ndonjë gjë që po të shqetëson? Ti e di që mund t' i thuash çdo gjë mami.
3. Sidriti: -Mami, të gjithë shokët po luajnë poshtë pallatit. A mund të dal edhe unë?
Mami:- Sidrit, a e sistemove dhomën tënde?
Sidriti: -Jo, harrova...
Mami: - Po ti e di që nuk mund të dalësh pa kryer detyrimet e tua.

Mësimi: *Zbërthejmë përmbajtjen e filmit për fëmijë*

Zbërthejmë përmbajtjen e filmit për fëmijë

Riçardi bashkë me familjen do të nisen me rulot për pushime dhe do të marrin me vete Bethovenin, qenin e vëllait të tij, që i kujton qenin e fëmijërisë.

Pas shumë debatesh familjare, ata vendosin të mos e marrin me vete Bethovenin, por ta lënë në një strehë kafshësh.

Bethoveni nuk i pëlqen aspak Betit, gruas së Riçardit, por Sara, vajza e tyre e vogël, është veçanërisht e dhënë pas tij.

Bethoveni i shpëton nga duart kujdestares dhe ndjek nga pas familjen.

Ata ritakohen dhe vazhdojnë udhëtimin së bashku.

Dy keqbërës ndjekin familjen, e cila ka një CD që përmban një program për zhbllokimin e kompjuterave.

Keqbërësit vjedhin rulotin e familjes, brenda të cilit ndodhen Sara dhe Bethoveni.

Bethoveni shpëton Sarën dhe policia arreston dy hajdutët.

Bethoveni fiton dashurinë dhe vlerësimin e gjithë familjes, por ata duhet t'ia kthejnë atë xhaxha Xhorxhit.

Xhaxha Xhorxhi ka lënë një letër, ku i kërkon familjes të kujdeset për Bethovenin.

Familja e Riçardit zgjerohet: Bethoveni dhe disa miq të tij bëhen pjesë e saj.

Mësimi: *Raporti informues*

Raport informues për bibliotekat

Ky raport paraqet dhe interpreton të dhënat e vjela nga *Observatori rreth praktikave pozitive të bibliotekave shqiptare*, i realizuar në kuadrin e projektit “Biblio-Dok”, i cili ka qëllim përhapjen e teknikave të vlerësimit të shërbimeve bibliotekare, në mënyrë që të zhvillohen aftësitë e vetëvlerësimit.

Observatori synon vlerësimin e shërbimeve tradicionale, si dhe të shërbimeve teknologjikisht të reja, të cilat ofrohen nga bibliotekat që i janë nënshtruar këtij observatori. Vlerësimi i këtyre shërbimeve u bë nga përpunimi i të dhënave që u mbledhën nëpërmjet një pyetësoi.

Sot sistemi bibliotekar i Shqipërisë artikullohet në një bibliotekë kombëtare, dyzet biblioteka publike, disa dhjetëra biblioteka speciale (publike e private, këto të fundit laike ose fetare), disa qindra biblioteka shkollore, disa dhjetëra biblioteka universitare.

Biblioteka e parë publike shqiptare është Biblioteka Kombëtare, e cila është themeluar më 1920 dhe përruar më 1922. Duhet thënë se edhe sot ajo luan një rol të rëndësishëm në jetën e bibliotekave publike shqiptare, duke qenë ndërlidhësja dhe burimi kryesor i informacionit për këto biblioteka.

Ky raport shoqërohet edhe me disa grafikë dhe tabela ku janë përfshirë të dhënat e nxjerra nga pyetësoret. Shpërndarja e pyetësorëve u parapri nga disa takime me drejtorët e bibliotekave të Elbasanit, Shkodrës, Peshkopisë, Pogradecit etj. Po kështu pyetësoi u parapri nga një letër, e cila u shpjegonte dhe u bënte të qarta bibliotekarëve qëllimet dhe motivet e këtij hulumtimi, kërkonte bashkëpunimin e tyre, sidomos për të dhëna sa më të përditësuara. Pas kësaj, pyetësoi i hartuar iu dërgua të gjitha bibliotekave, një pjesë prej të cilave janë edhe vizituar, vizitë që ka shërbyer edhe për të sqaruar disa çështje të mbetura pezull ose të paqarta nga përgjigjet e dhëna.

Numri i bibliotekave të cilave u është dërguar pyetësoi është 28, përgjigje kanë dhënë 16. Pyetësoi ka 16 rubrika, ku secila ka nënçeretat e vet.

Rubrika **parametrat fizikë**: biblioteka si ndërtesë është një element ndikues i rëndësishëm si në tërheqjen e lexuesit, edhe në cilësinë e shërbimit. Të dhënat kryesore që kërkohen në këtë rubrikë kanë të bëjnë me sipërfaqen totale, sipërfaqen në dispozicion të përdoruesve, të personelit, të hapësirave për librat etj. Raporti i sipërfaqes në dispozicion të publikut është një e dhënë e rëndësishme që të bën të kuptosh karakterin e një biblioteke: a është ajo një bibliotekë e hapur apo shërben vetëm si një magazinë për të ruajtur librat?

Orari i bibliotekës: orari i hapjes ndikon për të tërhequr lexuesit. Kuptohet që një numër sa më i madh

orësh është një tregues pozitiv.

Në rubrikën **Materialet ekzistuese** ka zëra në lidhje me librat, por edhe me materiale të tjera (projektorë, mikroforma, CD ROM etj.) Për librat është kërkuar sasia e përgjithshme.

Shërbimi. Këtu janë përfshirë kërkesa që lidhen jo vetëm me marrjen hua të librit, që është shërbimi i parë dhe kryesor i bibliotekës, por edhe përdorimi dhe shfrytëzimi i materialeve të tjera, periodikë, katalogë etj.

Në pyetësoi janë përfshirë edhe rubrika të tjera, si: **Drejtimi i bibliotekës, Bashkëpunimi, Publikimi dhe prezantimi, Marrëdhëniet me biblioteka të tjera etj.**, me kërkesa që lidhen ngushtësisht me menaxhimin e bibliotekës.

Pas mbledhjes së pyetësorëve të plotësuar, të dhënat e tyre janë regjistruar, analizuar dhe përmbledhur me kujdes nga grupi i punës, për të ofruar një kuadër të hollësishëm të gjendjes së bibliotekave.

INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

Nga të dhënat e mbledhura mund të ndërtohet një tablo e bibliotekave publike shqiptare, e cila na lejon të dallojmë karakteristikat e tyre:

Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se **hapësira e bibliotekave publike shqiptare** në dispozicion të përdoruesve (lexuesve) është rreth 276,7 m² (si mesatare aritmetike). Të dhënat e

veçanta konfirmojnë një prirje: bibliotekat që janë rikonstruktuar ose që janë rindërtuar pas vitit 1997 kanë sipërfaqe më të mëdha, pra synojnë të zgjerojnë sipërfaqet. Biblioteka që vë në dispozicion të përdoruesve sipërfaqen më të madhe është biblioteka publike e qytetit të Fierit me 1300 m², e ndjekur nga biblioteka publike e qytetit të Lezhës me 670 m². Bibliotekat me sipërfaqet më të vogla në dispozicion të përdoruesve, janë bibliotekat publike të Tiranës, pasi janë të shumta, ndërkohë që nëpër qytete ka vetëm një të tillë.

Sasia më e madhe e **materialeve** përbëhet nga libra. Mesatarja aritmetike është 75 200 tituj librash për çdo bibliotekë publike. Biblioteka që zotëron numrin më të madh të librave është biblioteka publike e Durrësit me 235 000 libra, e ndjekur nga biblioteka publike e Elbasanit me 205 000 libra.

Për sa u përket **periodikëve**, rezulton se dy biblioteka publike të Tiranës nuk disponojnë asnjë të tillë (biblioteka nr. 3 dhe biblioteka nr. 5). Biblioteka e Peshkopisë ka një traditë të mirë pasi në të ekzistojnë koleksione të hershme. Numrin më të madh të periodikëve e zotëron biblioteka publike e Shkodrës (18 300), e ndjekur nga biblioteka publike e Durrësit (11 000 / përkatësisht 22 gazeta dhe 8 revista), dhe ajo e Lezhës (me 7 100).

Përveç bibliotekës publike të Fierit, asnjë nga bibliotekat që iu nënshtrua pyetësorit nuk zotëron **mjete për njerëzit me nevoja të veçanta ndjesore dhe fizike**. Edhe pjesa që lidhet me materialet audiovizive paraqet

shifra absolutisht të varfra. Po ashtu edhe **sasia e CDROM** është mjaft e vogël në të gjitha këto biblioteka, po të marrim parasysh se biblioteka publike e Durrësit ka 600 të tilla, ndërkohë që disa biblioteka nuk disponojnë asnjë dhe të tjerat kanë një mesatare prej rreth 30 CDROM.

Materiale të rralla (antikuariate) kanë vetëm pak biblioteka. Ndër to veçojmë bibliotekën e Elbasanit me 635 të tilla dhe bibliotekën publike të Shkodrës, ku ndër materialet e rralla përfshihen edhe 4 inkunabule.

Shërbimi: Përdorimi është kyçi i suksesit në bibliotekë. Pothuajse të gjitha bibliotekat ofrojnë një shërbim javor prej 40 orësh. Këtu bën përjashtim biblioteka e Elbasanit, e cila ofron 54 orë shërbim të plotë në javë, duke përfshirë edhe ditën e shtunë nga ora 09:00-13:00.

Shërbimi në të gjitha bibliotekat përfshin trajnimin e përdoruesve në mënyrë që të përdorin katalogët, softuerin e bibliotekës, fondet e hapura etj.

Integrimi: Bibliotekat publike shqiptare nuk mund të klasifikohen si “biblioteka digjitale”, pasi janë shumë larg qenies si të tilla. Shumica e këtyre bibliotekave e klasifikojnë veten si “biblioteka hibride”, duke lënë kështu pas “bibliotekën tradicionale”, megjithëse disa biblioteka janë shprehur se modeli që ato përfaqësojnë është ai tradicional (biblioteka nr. 2 & 3 Tiranë, biblioteka e Pogradecit dhe biblioteka e Shkodrës). Ndërkohë të gjitha bibliotekat e tjera kanë zgjedhur si model përfaqësues modelin e bibliotekës hibride.

PËRFUNDIME

Në bibliotekat publike shqiptare vërehen dobësi organizative, pasi patëm vështirësi në mbledhjen e pyetësorëve, morëm disa përgjigje të turbullta dhe disa përgjigje kontradiktore.

Numri i punonjësve është i vogël, gjë që mund të ndikojë negativisht në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Mesatarja e numrit të përdoruesve që shkojnë në bibliotekë është e kënaqshme (kemi biblioteka me 30 përdorues në muaj (biblioteka e Kuçovës) dhe biblioteka me rreth 250 300 përdorues në ditë (biblioteka e Elbasanit).

Fondet e bibliotekave na mundësojnë të dalim në përfundimin se cilësia e shërbimit mund të konsiderohet cilësore, për sa i përket varësisë së saj nga pasuria në materiale.

Për ta mbyllur, themi se bibliotekat publike shqiptare kanë një traditë të konsoliduar tashmë që duhet t'i hedhë sytë drejt së ardhmes digjitale për të ecur krahas simotrave evropiane.

Mësimi: *Udhëzime, shpjegime, receta*

Si të bëjmë një prezantim në klasë

Hapi 1: Planifikoni prezantimin tuaj.

Hartoni planin e punës për realizimin e prezantimit tuaj, duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; Përpunoni idenë tuaj për çështjen e caktuar në varësi të qëllimit, planifikoni aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre dhe parashikoni pengesat e mundshme gjatë realizimit;

Regjistroni, skedoni dhe përdorni teknika të tjera për të menaxhuar informacionin/ faktet ose formulat për një temë duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë;

Hapi 2: Praktikohuni.

Pratikohuni para familjes, miqve tuaj, ose para pasqyrës, duke lexuar prezantimin tuaj. Kjo është një mënyrë e mirë për t'u parapërgatitur dhe zbutur emocionet tuaja, për momentin final ku do të referoni para klasës. Pyesni miqtë tuaj për reagimet dhe kritikën pasi të keni përfunduar prezantimin tuaj. A u realizua prezantimi në kohën e duhur? Si ishte paraqitja e prezantuesit? A u shtjelluan në mënyrë të qartë të gjitha pikat?

Hapi 3: Përgatitni prezantimin.

Veçoni informacionet që ju nevojiten nga librat, gazetatat, revistat, interneti, radioja, TV etj., i komentoni dhe i shfrytëzoni ato si referencë gjatë prezantimit tuaj;

Organizoni mendimet tuaja për temën/ problemin e dhënë dhe parashtroni pyetje (pse, çfarë, si, kur), gjatë prezantimit të materialit tuaj.

Argumentoni ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në zgjidhjen e një problemi, nëse ai qëndron në thelb të materialit tuaj;

Shpjegoni qartë dhe saktë kuptimin e termave të përdorur, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;

Ju, sigurisht nuk jeni një ekspert, apo të keni lexuar çdo libër ose faqe interneti të shkruar për temën tuaj, por ju duhet të jeni në gjendje t'i përgjigjeni çdo pyetjeje të mësuesit tuaj ose të shokëve të klasës. Merrni citate nga burime të besueshme. Thëniet e bukura e të gjetura e pasurojnë dhe e bëjnë interesant një prezantim. Sigurohuni që burimet tuaja të informacionit janë të besueshme, gjithashtu. Kini kujdes! Jo gjithmonë mund t'i besohet informacioneve të marra nga interneti.

Hapi 4: Prezantoni.

Menaxhoni emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo diku tjetër). Lexoni rrjedhshëm, me intonacionin e duhur. Buzëqeshni me audiencën tuaj. Tregohuni i kënaqur: ju jeni gati për t'u mësuar të tjerëve diçka që ata nuk e dinin më parë.

Në një prezantim, ju mund të përdorni mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive; Prezantimi juaj mund të jetë digjital ose mund të përdoren mjete të punuara nga vetë nxënësit, si: tabela konceptuale, postera, makete, albume me fotografi etj.

Hapi 5: Tregoni siguri në prezantimin tuaj. Flisni duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (e fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje të të tjerët;

- jepni informacione, ide, ndjesi, emocione duke përdorur fjalorin e duhur;
- përshtatni të folurin në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës;

Hapi 6: Përdorni në mënyrë korrekte gjatë të folurit elementet joverbale si: gjestet, mimika, kontakti me sy;

Shfaqni me siguri e besim në vetvete mendimet, përvojat dhe argumentet tuaja;

Si të veprojmë për të mbjellë lule në kopshtin e shkollës

Planifikoni mbjelljen e lules me kujdes duke siguruar mjedisin më të mirë për rritje, varësisht nga lloji i lules.

Hapi 1

Planifikoni mbjelljen e lules me kujdes duke siguruar mjedisin më të mirë për rritje, varësisht nga lloji i lules. Krijoni një vizatim të oborrit të shkollës, vëzhgoni pozicionin e rrezeve të diellit gjatë gjithë ditës, dhe shënoni vendet e thata ose me ato me lagështi. Përdorni këto detaje për të planifikuar gjelbërimin e kopshtit tuaj.

Hapi 2

Zgjidhni vendin për të mbjellë lulen në varësi të rrezeve të diellit në atë pjesë. Zgjidhni vendet me diell për të gjitha bimët që kërkojnë diell të plotë dhe vendet me hije për lulet që kërkojnë hije. Ky informacion gjendet në paketimin e farës së lules që blini.

Hapi 3

Koha më e mirë për të mbjellë lule është në fillim të pranverës, por shumë lloje lulëzojnë në verë apo vjeshtë.

Hapi 4

Përgatitni tokën duke pastruar gjetet dhe barërat e këqija. Përdorni vegla dore për të kultivuar tokën në një thellësi prej të paktën një këmbë dhe shtoni pleh të ngadalshëm apo lëndë organike për të pasuruar tokën.

Hapi 5

Hapni gropa të thella, të mjaftueshme për të mbjellë lule. Mos harroni se lulet e ndryshme kërkojnë thellësitë specifike për mbjellje. Pyesni për këtë kur të blini këto lloje të luleve.

Hapi 6

Kontrolloni rrënjët e luleve para mbjelljes dhe pritni çdo rrënjë të dëmtuar apo të brishtë. Vendosni më shumë pleh tek rrënjët për t'i ushqyer ato.

Hapi 7

Njomini të gjitha lulet e mbjella rishtas me ujë. Shtoni më shumë dhe në zonën e mbjelljes, nëse është e nevojshme, për të mbuluar rrënjët e ekspozuara.

Hapi 8

Vini pleh mbi lule për t'i ushqyer rrënjët dhe për t'i mbrojtur nga barërat e këqija.

Recetë gatimi: Kek me çokollatë

Përbërësit e kësaj ëmbëlsire:

400 g miell, 2 vezë, 2 fixhan çaji sheqer, ½ filxhan çaji vaj, 100g fruta të thata: manaferra, luleshtrydhe, rrush, vanilje, pluhur fryrës, 200 g grimca cokollate.

Përgatitja: Ngrohni paraprakisht furrën në 180 gradë-350 gradë C. Përdorni një tavë 20 cm të trashë për pjekjen e kekut. Hidhni miellin, pluhurin e kakaos dhe sodën në një tas të madh dhe përziejini me sheqerin. Në një enë matëse, matni vajin dhe qumështin, pastaj shtoni vezët dhe vaniljen. Rrihni së bashku me një mikser elektrik. Hidhni përzierjen e lagësht në përbërësit e thatë dhe përziejini mirë. Hidhni përzierjen në tavë dhe piqeni për 25-30 minuta deri sa të jetë elastike për prekjen. Ftoheni kekun për pak në tavë, përpara se ta ktheni në një zgarë për t'u ftohur plotësisht. Bëni kremin e ëmbëlsirës. Hidhni pluhurin e kakaos në një tigan të vogël dhe përziejini me sheqerin. Përziejeni me qumështin dhe kosin deri sa të treten mirë me njëra tjetrën



dhe pastaj nxehini me ngadalë, duke i trazuar vazhdimisht, deri sa të ziejnë. Gatujini për 2 minuta, duke i trazuar vazhdimisht. Kremin mund ta hidhni përsipër kekut duke e sheshuar, ose duke e lënë të ftohet me ngadalë, pastaj përhapni përsipër pjesën më të trashë të kremit. Rregulloni frutat e thata: (manaferrat, rrushin, luleshtrydhet) në pjesën e sipërme.

Mësimi: *Argumente rreth përdorimit të internetit*
Letra e prekëse që Umberto Eco la për nipin e tij

“I dashur nip, nuk do të dëshiroja që kjo letër krishtlindjesh të tingëllonte shumë e sheqerosur (term sipas librit të autorit De Amicis “Zemra”) dhe të kujtonte ty këshilla për dashurinë ndaj të afërmve tanë, për atdheun, për botën, apo gjëra të ngjashme. Nuk do t’ua vije veshin dhe në momentin e vënies në praktikë (ti i rritur dhe unë i thyer në moshë), sistemi i vlerave do të jetë kaq shumë i ndryshuar sa mundet që rekomandimet e mia të duken jashtë kohe.

Kështu që do të preferoja të ndalesha në një rekomandim të vetëm, të cilin do jesh në gjendje që ta vësh në zbatim edhe tani, teksa je zhytur në iPad-in tënd; por as nuk do të bëj gabimin që mos të ta këshilloj këtë gjë, jo për faktin se do dukesh një gjysh harraq dhe nopran, por sepse atë e bëj edhe unë.

...Ajo për të cilin doja të të flisja, është më tepër sesa për një sëmundje që ka goditur brezin tënd dhe madje edhe atë të djemve më të rritur sesa ty e që ndoshta shkojnë në universitet.

Kjo është humbja e kujtesës. Është e vërtetë se nëse të shkon në mendje të dish se kush ka qenë Karli i Madh apo ku bie Kuala Lumpuri nuk të duhet veçse të shtypësh ndonjë tast dhe menjëherë interneti do të ta thotë. Bëje këtë gjë kur duhet, por pasi ta kesh bërë, mundohu të kujtosh çfarë të është thënë për të mos qenë i detyruar që ta kërkosh për herë të dytë nëse do të jetë e domosdoshme, qoftë edhe për një punim në shkollë. Ka rrezik që ndërkohë që ti mendon se kompjuteri mund të ta thotë në çdo moment, ti humbet shijen e të nxënit vetë.

Do të ishte njësoj sikur, duke ditur se për të shkuar nga një rrugë në tjetrën, ka autobusë apo metro që të mundësojnë të zhvendosesh pa u lodhur (që në vetvete është shumë komode dhe bëje sa herë që nxiton) mendon se kështu nuk ke më nevojë të ecësh. Por nëse nuk ecën mjaftueshëm, bëhesh pastaj “i aftë tjetërsj”, siç thuhet sot për ata që janë të detyruar të lëvizin me karrocë me rrota. Dakord, e di që merresh me sport dhe kështu vë në lëvizje trupin tënd, por të kthehem te mendja jote. Kujtesa është një muskul si ata të këmbëve, të cilën nëse nuk e ushtron rrudhet dhe ti transformohesh me një tjetër lloj aftësie, pra, që të flasim qartë, një idiot. Për më tepër, sikurse për të gjithë ekziston rreziku që me plakjen vjen edhe Alzheimeri, një nga mënyrat që të shmanget ky incident i pakëndshëm është të ushtrosh memorien.

Dhe ja cila është dieta ime. Çdo mëngjes mëso ndonjë varg, një poezi të shkurtër. Mirë do ishte të bëje ndonjë garë edhe me miqtë e tu për të parë se kush mban mend më shumë. Nëse nuk e pëlqen poezinë atëherë bëje këtë me formacionet e futbollistëve, por kujdes, sepse nuk duhet vetëm të dish se kush janë futbollistët e Romës sot, por edhe ata të skuadrave të tjera, pse jo edhe të skuadrave të së shkuarës. Bëj gara të kujtesës, ndoshta edhe për librat që ke lexuar Provo njëherë nëse miqtë e tu do të kujtojnë dot se kush ishin shërbyesit e tre muskëtjerëve. Dhe nëse nuk do duash të lexosh “Tre muskëtjerët atëherë bëje, ku di unë, me një nga historitë që ke lexuar. Duket një lojë (dhe është e tillë) por do ta shohësh sesi koka jote do të popullohet nga personazhe, histori, kujtime të çdo lloji. Do ta kesh pyetur veten se përse dikur kompjuterët quheshin tru elektronik.

Ndodhte sepse ata konceptoheshin mbi modelin e trurit (tonë) tënd; por truri ynë ka më shumë lidhje sesa një kompjuter. Është një lloj kompjuteri që e mban me vete, që rritet dhe forcohet përmes ushtrimit, kurse kompjuteri që kë mbi tavolinë, sa më shumë e përdor aq më shumë humbet shpejtësinë e veprimeve dhe pas disa vitesh do ndërruar. Ndërkohë që truri yt mund të zgjasë deri në 90 vjet dhe në këtë moshë (nëse do ta kesh ushtruar) do të kujtojë më shumë gjëra nga ato që kujton tani. Dhe falas. Është pastaj kujtesa historike, ajo që nuk ka të bëjë me faktet e jetës tënde apo me gjërat që ke lexuar, por me ato që kanë ndodhur para se ti të lindje. Sot, nëse shkon në kinema, duhet të hysh në një orë fikse, kur filmi fillon dhe sapo fillon dikush të kap si të thuash nga dora dhe të tregon se çfarë ndodh.

Në kohët e mia mund të hyje në kinema në çdo moment, e kam fjalën edhe në mes të spektaklit, arrije aty ndërkohë që po ndodhnin disa gjëra dhe përpiqeshe të kuptoje se çfarë kishte ndodhur më parë. Ja pra, jeta është si një film i kohëve të mia. Ne vijmë në jetë ndërkohë që shumë gjëra kanë ndodhur tashmë, prej qindra e mijëra vjetësh dhe është e rëndësishme të kuptosh atë që ka ndodhur para se ne të lindim. Kjo për të kuptuar më mirë se përse sot ndodhin shumë gjëra të reja. Tani, shkolla duhet të të mësonte të memorizojë atë që ka ndodhur përpara se ti të lindje, por shihet se ajo nuk ia arrin siç duhet kësaj gjëje, pasi shumë të hulumtime na thonë se të rinjtë e sotshëm, edhe ata të mëdhenjtë që shkojnë në universitet, nëse ta zënë kanë lindur në 1990-ën nuk e dinë (dhe ndoshta nuk duan ta dinë) se çfarë ka ndodhur në vitin 1980 (dhe këtu nuk e kam fjalën për ata që ka ndodhur 500 vjet më parë).

Po pse është kaq e rëndësishme të dish se çfarë ka ndodhur më parë? Sepse në shumë raste, ajo që ka ndodhur të jep një shpjegim se përse disa gjëra ndodhin sot dhe në çdo rast, njësoj si për formacionet e futbollistëve, kjo është një mënyrë për pasuruar kujtesën tonë.

Ki parasysh se këtë nuk mund ta bësh vetëm mbi librat dhe revistat, mund të bëhet shumë mirë edhe në internet, i cili duhet përdorur jo vetëm për të çatuar me miqtë e tu, por edhe për të çatuar me historinë e botës. Kush ishin hititët? Kur u zhdukën dinosaurët? Po arka e Noes a mund të ketë patur një timon? A kishte më shumë tigra 100 vjet më parë? Çfarë ishte perandoria e Malit? Dhe kush fliste për Perandorinë e të Keqes? Kush ka qenë Papa i dytë në histori? Kur u shfaq Topolino? Mund të vazhdoja në pafundësi dhe do të ishin të gjitha aventura të bukura kërkimi. Të gjitha këto duhen kujtuar. Do të vijë dita kur do të jesh plak dhe do të ndihesh sikur ke jetuar 1000 vjet, sepse do të jetë sikur ti të kishe qenë i pranishëm në betejën e Vaterlosë, të kesh asistuar në vrasjen e Jul Çezarit. Të tjerë miq të tu, që nuk do të kenë kultivuar memorien e tyre, do të kenë jetuar një jetë të vetme, të tyre, që duhet të ketë qenë kush e di sa melankolike dhe e varfër në emocione."